



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) SHA”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë
ekonomike dhe financiare”**

Tiranë, Prill 2021

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE		
1.	Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit.....	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	8
II. HYRJA		
1.	Objekti i auditimit.....	11
2.	Qëllimi i auditimit.....	11
3.	Identifikimi i çështjes.....	11
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12
5.	Përgjegjësitë e audituesve.....	12
6.	Kriteret e vlerësimit.....	12
7.	Standardet e auditimit.....	13
8.	Metodat e auditimit.....	14
9.	Dokumentimi i auditimit.....	14
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT		
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	15
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	16
2.1.	Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm të KLSH-së...16	
2.2.	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e organeve drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.....	27
2.3.	Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomik-financiare në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet eprore, si dhe realizimi i tij.....	34
2.4.	Mbi zbatimin e strukturës organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës, dhënien e pagave dhe shpërblimeve gjatë periudhës që auditohet.....	38
2.5.	Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj).....	45
2.6.	Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësit e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë; analiza e debitorëve e kreditorëve; arkëtimi i detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj., ndaj buxhetit të shtetit.....	54
2.7.	Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.....	70
2.8.	Mbi zbatimin rregullave dhe procedurave të shitje-blerjes të energjisë elektrike.....	135
2.9.	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.....	146
2.10.	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.....	148
2.11.	Mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm.....	155
2.12.	Të ndryshme, që do të dalin gjatë auditimit.....	164
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET		172
V. ANEKSE		201

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit

KLSH në periudhën gusht-shtator 2020 ka kryer auditimin e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare OSHE SHA për aktivitetin nga data 1.07.2017 deri më 30.06.2020, duke u përqendruar kryesisht në çështjet e zbatimit të ligjshmërisë nga organeve drejtuese; hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko-financiare; administrimit të marrëdhënieve të punës; auditimin e shpenzimeve; mbajtjen e evidencës kontabile; ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe zbatimin e kontratave; zbatimit të rregullave dhe procedurave të shitje-blerjes të energjisë elektrike; funksionimit të auditit të brendshëm e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit etj.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj, analizoj dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja funksionimit oragnizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si verifikimi i transaksioneve, intervistomi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, të shpërblimeve të dëmit dhe të mungesës së përdorimit me efektivitet të fondeve publike, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të OSHEE SHA për periudhën nga data 01.07.2017 deri më datë 30.06.2020, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë opinion të modifikuar/kulaifikuar, për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të këtij subjekti.

I.2 Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Në periudhën 2017-2020 rezulton se janë komanduar drejtues dhe specialistë jashtë vendbanimit të tyre për periudha të gjata kohore mbi 3 muaj në 6 raste duke rënduar koston me 17,938,000 lekë si rezultat i shpenzimeve për udhëtim e dieta.		E mesme	Përcaktimi në Rregulloren e Brendshme të rasteve në të cilat punonjësit komandohen me afat deri në tre muaj pa të drejtë përsëritjeje, përfshirë dhe elementët e trajtimit financiar të punonjësve të komanduar.
2	Lidhur me zbatimin e rekomandimeve, Grupi i auditimit edhe pse ka vijuar me kërkesat e vazhdueshme drejtuar shoqërisë, nuk i është dorëzuar asnjë dokument justifikues apo informacion shkresor në lidhje me shkallën aktuale të realizimit të rekomandimeve të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe në proces.		E lartë	Këshilli mbikëqyrës i OSHEE SHA të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos realizimin e masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, si dhe të merrin masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, në proces dhe të zbatuara pjesërisht, duke i kushtuar vëmendje të

				posaçme rekomandimeve të cilat janë në procese gjyqësore.
3	<p>Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit mbikëqyrës është konstatuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Këshilli mbikëqyrës nuk ka zbatuar kërkesat e nenit 18, pika 2 të Statutit për t'u mbledhur të paktën gjashtë herë në vit, për vitin 2018 dhe 2019; - Gjatë veprimtarisë së tij në periudhën gjashtëmujori i dytë 2017 - 30.06.2020, këshilli mbikëqyrës ka marrë 55 vendime qarkulluese ose 39 % e nivelit të vendim-marrjes, për çështje me rëndësi jetike për veprimtarinë e OSHE, në kundërshtim me kuadrin rregullator për funksionimin e tij, pasi vendim-marrja është atribut i mbledhjeve të këtij organi; - Me vendimin nr.33 datë 14.07.2017 është miratuar shpenzimi për vlerën e kompensimit të pronarit që shpronësohet për realizimin e projektit "Ndërtimi i nënstacionit të TEC Kombinat 110/120 kV, Tiranë, me kosto më të lartë prej 26,674,674 lekë se sa përlllogaritjet sipas legjislacionit shqiptar përkatës, pa u bazuar në legjislacionin përkatës shqiptar, duke sjellë për pasojë shpenzime afër 16 herë më të larta për këtë qëllim; - Me vendimin qarkullues nr.38, datë 20.12.2018, këshilli mbikëqyrës ka miratuar një shpërblim për 3 anëtarë të komisionit të vlerësimit disiplinor në shumën 120,000 në mënyrë të paligjshme; - Vendimi qarkullues nr.1, datë 15.01.2019, është marrë përpara se të dalë VKM nr. 18, datë 16.01.2019 dhe të hyjë në fuqi, 18.01.2019; - Vendimi nr. 15, datë 05.06.2019 për miratimin e fillimit të procedurave për dhënin me qira të ambientit me sipërfaqe 30 m², me destinacion njësi shërbimi lokal me adresë Lagja Kushtrimi, zyrat e Drejtorisë Rajonale OSHEE Vlorë për një afat 5-vjeçar, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014, pasi afati i dhënies me qira është një vit. 		E lartë	<p>Këshilli mbikëqyrës të ushtrojë plotësisht detyrat e tij, duke u mbledhur të paktën 6 herë në vit, si dhe të përfshijë kontrollin mbi librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë, si dhe publikimin e raporteve financiare dhe të audituesve të pavarur;</p> <p>- Të shqyrtojë, analizojë me vëmendje, të debatojë dhe të miratojë me votim në mbledhje çështjet që vihen në rendin e ditës dhe të tjera për diskutim, me qëllim që të konsolidohet ecuria e shoqërisë OSHEE.</p> <p>- Këshilli mbikëqyrës t'i kushtojë vëmendje të veçantë referencës ligjore të raporteve dhe relacioneve në shqyrtim, duke kërkuar dhe asistencën e juristëve të shoqërisë për vendim-marrje të veçanta; të revokojë vendimin qarkullues nr.38, datë 20.12.2018, si dhe të rivendosë në afate vendimin nr. 15, datë 05.06.2019.</p>
4	<p>Nga auditimi planifikimit dhe realizimit të buxhetit në llogaritë e arkëtueshme u konstatua se nga ana e OSHEE SHA për çdo vit llogaritë e arkëtueshme zhvlerësohet sipas metodologjisë së re të zhvlerësimit të kërkesave tregtare për arkëtim të raportuar nga audituesi ligjor BTA SHPK në raportin e miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 39 datë 20.07.2017. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" neni 80, Kontrata e furnizimit me energji elektrike, neni 82 -Të drejtat e furnizuesit, përveç të drejtave të përcaktuara në kontratë, neni 84 dhe neni 92.</p>		E mesme	<p>Departamenti Ekonomik të marrë masa për rakordimin e detyrimeve me Departamentin e Borxhit dhe matjen e saktë të llogarive të arkëtueshme duke bashkërenduar punën për arkëtimin e tyre sipas afateve kohore të përcaktuara në ligj, si dhe të hartojë relacione shpjeguese për llogaritë e arkëtueshme neto nga klientët, metodën e zhvlerësimit të ndjekur çdo vit dhe përpjekjet e kryera nga ana e shoqërisë për arkëtimin e detyrimeve.</p>
5	<p>Shoqëria nuk ka përfunduar procesin e kalimit të pronësisë nga Inventari i pronave të paluajtshme shtetërore. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 "Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA", pikat 1, 2 dhe 3, për regjistrimin e pasurive në zbatim të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, neni 45. Mos përfundimi i këtij procesi rrit riskun, që objektet që nuk kanë të përfunduar procesin mund të tjetërsohen nga palë të treta.</p>		E lartë	<p>Administratori i shoqërisë të marrë masa që të ndiqet me përgjegjshmëri dhe të përshejtojë përfundimin e procesit të kalimit të pronësisë nga Inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, në shoqërinë OSHEE SHA.</p>
6	<p>Në pasqyrat financiare të shoqërisë ekziston një mospërputhje e llogarive të arkëtueshme midis</p>		E lartë	<p>Nga Drejtoria Ekonomike dhe e Financës në bashkëpunim me</p>

	<p>sistemit faturimit & arkëtimit dhe të pozicionit financiar “Të arkëtueshme” (kontabilitetit) për gjendjen e klientëve më 31 dhjetor 2017. Mospërputhja midis sistemit “SAP” dhe sistemit faturimit, arkëtimit dhe kontabilitetit më 31.12.2017 arrijnë në vlerën 1,169,392 mijë lekë, kundrejt 1,287,749 mijë lekë që rezultonte kjo mospërputhje më 31.12.2016.</p> <p>- Shoqëria OSHEE SHA rezulton me gjendje negative të kapitalit aksioner për (33,212,472) mijë lekë, i cili ka ardhur kryesisht nga humbjet e akumuluar në vitet e kaluara, ku në fund të vitit 2017 rezultojnë (69,292,022) mijë lekë.</p> <p>Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.</p>			<p>drejtoritë e tjera, të merren masa për verifikimin dhe saktësimin e diferencave të llogarive të arkëtueshme klientë që janë ndërmjet sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe sistemit të faturimit.</p>
7	<p>OSHEE SHA ka njohur të ardhura nga penalitetet ndaj KESH SHA si rezultat i mos respektimit të kontratës në vlerën prej 5,543,701 mijë lekë me faturën nr. 4, datë 31.03.2018. Nga KESH SHA, kjo faturë nuk është pranuar duke argumentuar se furnizimi me energji nuk u realizuar për arsye të kushteve të thata klimaterike, pra për arsye madhore të përcaktuara në kontratë. Me shkresën nr. 2260/1 datë 02.05.2018, administratori i KESH SHA, ka refuzuar firmosjen e faturës së mësipërme duke trajtuar argumentet e tij për pasaktësinë e lëshimit të penalitetit, duke njoftuar dhe MIE.</p> <p>Diferenca që vjen nga deklarimi si e ardhur e kësaj fature në rezultatit e vitit 2017 sjell efektet që shoqëria ka pasur si rezultat financiar fitim të periudhës në vlerën 3,422,482 mijë lekë paratimit mbi fitimin dhe 1,566,726 mijë lekë pas taksave, kur në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit nuk duhej ta përfshinte si të ardhur vlerën 5,543,701 mijë lekë, duke pasur rezultatit në vlerën 2,121,219 mijë lekë humbje.</p>		E lartë	<p>Drejtimi i shoqërisë duhet të marrë masa që në të ardhmen, përgatitja dhe hartimi i pasqyrave financiare të kryhet me përgjegjshmëri, vërtetësi e në afatet përkatëse, sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, duke pasqyruar situatën financiare dhe performancën ekonomike, për disponimin e informacioneve palëve të interesuara në kohë, për vendim-marrjet përkatëse.</p>
8	<p>Në opinionin e dhënë nga audituesit e pasqyrave financiare, në raportet auditimit dhe/apo letrat e rekomandimit për drejtimin, konstatohet se audituesit e pasqyrave financiare ndër vite, kanë kryer auditimin e tyre në zbatim të SNA 200 “Objektivat e përgjithshëm të audituesit të pavarur në kryerjen e një auditimi, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”, por nuk janë shprehur për zbatimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë në përputhje me SNA 250 “Mbajtja parasyshe e ligjeve dhe rregullave në një auditim të pasqyrave financiare”, pikat 2-3.</p> <p>Mos pajtueshmëria me ligjet dhe rregullat mund të rezultojë në dënimin me gjopa, hapjen e çështjeve gjyqësore apo në pasoja të tjera, të cilat mund të kenë një efekt material në pasqyrat financiare.</p>		E mesme	<p>Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të marrin masa që në të ardhmen, audituesit ligjorë në auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë, të marrin në konsideratë dhe SNA 250 “Mbajtja parasyshe e ligjeve dhe rregullave në një auditim të Pasqyrave Financiare</p>
9	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbajtur për inventarët e datës 31.12.2019 u konstatua se shoqëria ka gjendje 4069 pjesë materiale e artikuj të ndryshëm, të vlerësuar si jashtë përdorimit me vlerë kontabël të mbetur 179,436,025 lekë.</p> <p>Nga administratori i shoqërisë janë iniciuar procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit pas vlerësimit të komisioneve të ngritura. Më datë 04.06.2018, eksperti i vlerësimit i caktuar nga MIE, ka dorëzuar raportin e vlerësimit, për shkarkimin nga librat kontabël vlerën e inventarit prej 179,436,025 lekë, dhe më datë 18.10.2018, me vendimin nr. 29, Këshilli Mbikëqyrës ka aprovuar raportin si dhe ka miratuar vlerën e inventarit</p>		E Lartë	<p>Administratori i shoqërisë të marrë masa për hapjen e procedurës së ankandit publik për shitjen e materialeve skrap, bazuar në raportin e ekspertit vlerësues, duke realizuar në këtë mënyrë testimin real të tregut, dhe proceduar më pas në vijimësi sipas situatës.</p>

	108,784,007 lekë të vlerësuar për tu shitur si skrap, sasinë 495,137 kg në vlerën 30,956,459 lekë, si dhe miratimin e vlerës së inventarit 70,593,018 lekë për tu asgjësuar.			
10	<p>Gjatë procesit të inventarizimit fizik të vlerave materiale në magazinat e OSHEE-së, në zbatim të Urdhrit nr. 24506, datë 06.12.2019, "Për inventarizimin e vlerave materiale në magazinat e shoqërisë, nga komisionet përkatës, u evidentuan artikuj me qarkullim të ngadalshëm në këto magazina, me vlerë totale në 283,914,390 lekë, artikuj të bërë hyrje në periudha të mëparshme dhe në ato të fundit.</p> <p>Nga filtrimi i informacionit për artikujt me qarkullim të ngadalshëm u konstatua se në inventarin e datës 31.12.2019, nga hyrjet e bëra në vitin 2017, kishte akoma gjendje artikuj në vlerën 60,755,110 lekë. Në relacionin teknik drejtuar Drejtorisë Ekonomike, për nevojat e shoqërisë për bazë materiale për mirëmbajtje, për buxhetin e vitit 2017, nga drejtori i Divizionit të Shpërndarjes, janë hartuar dhe përlogaritur në Planin e Mirëmbajtjes, sasisë vjetore të parashikuara. Nga kjo drejtori nuk janë kryer me saktësi llogaritjet për sasisë e artikujve të kërkuar për buxhetin e vitit 2017, duke krijuar material stok</p>		E lartë	Nga administratori i shoqërisë të merren masa që në të ardhmen, strukturat e ngarkuara për planifikimin e bazës materiale për mirëmbajtje, të kryejnë kërkesat e tyre të bazuara në raporte të mirë argumentuara, të specifikuara dhe të detajuara, për shmangien e krijimit të materialeve stok dhe një menaxhim me efektivitet dhe eficient të burimeve financiare të shoqërisë.
11	<p>Nga auditimi i procedurave të prokurimit është konstatuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Janë vendosur kritere të pa argumentuara teknisht dhe ligjërisht, si dhe jo në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si numri i punonjësve ("Pajisja me kartela të sigurimit teknik për punonjësit e OSHEE" 2019, "Shërbimi i internetit" 2017), gjuha e ofertës jo në gjuhën shqipe ("Blerje ndarësa, izolatorë fishekë siguresë TM për DR, morseta detaje etj. për DTL" 2019) në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, neni 61, paragrafi i dytë i pikës 2 dhe DST, seksioni 4, pika 4.6 etj.; - Grupi i përlogaritjes së fondit limit, specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të kualifikimit nuk ka ezauruar plotësisht kërkesat e VKM nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, neni 59, pika 2, duke sjellë për pasojë mungesë saktësie në përlogaritjen e fondit limit si në procedurat e prokurimit "Inspektimi dhe konformiteti për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në n/stacione, linjat 35 KV dhe kabina elektrike", "Blerje videowall për godinën e OSHEE SHA" etj.; - Nga Komisioni i vlerësimit të ofertave janë skualifikuar OE me ofertën më të ulët, për detyrime në ditën e hapjes së ofertave ("Blerje materiale të nevojshme për Arkivën Qendrore dhe Arkivat e Drejtorive Rajonale" 2019), me evidentim gjobë të pa njoftuar dhe të likuiduar në vlera të pa konsiderueshme në sistemin tatimor ("Blerje uniforme dhe pajisje sigurie për punonjësit e OSHEE") etj., nuk është në përputhje me frymën e legjislacionit për prokurimin publik, kjo edhe në funksion të nxitjes së pjesëmarrjes dhe të konkurrencës së operatorëve ekonomikë, në kuptim të rritjes së eficientësisë dhe efikasitetit të procedurave të prokurimit publik; - Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka skualifikuar OE me ofertën më të ulët për çështje si mosrealizim 		E lartë	Autoriteti Kontraktor OSHEE SHA të marrë masa për përzgjedhjen dhe trajnime të specifikuara të zyrtarëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si dhe për raste të veçanta të kërkojë nga APP mendime paraprake për trajtimin e tyre, me qëllim që të eliminohen efektet negative të konstatuara dhe të arrihet menaxhimi me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike.

<p>i numrit të fuqisë punëtore prej 0,75 % (“Pajisja me kartela të sigurimit teknik për punonjësit e OSHEE” 2019), për shkak të mungesës së përkthimit të një pjese të dokumentacionit teknik (“Rikonstrukcion i kabinave elektrike muraturë, Fiderat A6, A7, A11, A12, A14, A15 NST Rajonal Tiranë 220/20 kV”), në një kohë që në zbatim të nenit 53, pika 4 të LPP, Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla;</p> <p>- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE të cilat nuk kanë plotësuar të gjitha kriteret e kualifikimit si specifikimet teknike (“Furnizim me vaj transformatori i pa përdorur për nevoja të Drejtorisë së Tensionit të Lartë dhe për nevojat të tjera të OSHEE SHA” 2018), mungesë e kopjeve të certifikuara të bilanceve nga organet tatimore (“Blerje mjetesh motorike në kuadër të grupeve të përbashkëta të kontrollit OSHEE SHA dhe Polici e Shtetit”) etj. ;</p> <p>- Kanë shfaqur mangësi zyrtarët e ngarkuar gjatë zbatimit të kontratave kryesisht atyre të shërbimeve lidhur me afatet dhe cilësinë e tyre (“Inventarizimi dhe vlerësimi i Aktiveve Materiale Afatgjata të OSHEE SHA, si dhe ngritja e sistemit të administrimit dhe përgatitja e procedurave të brendshme të menaxhimit të tyre”, “Marrje me qira operacionale të makinave për NJOS” etj.), duke vepruar në kundërshtim me kushtet dhe afatet e kontratave.</p>			
<p>Nga auditimi i sistemit billing u konstatua se janë identifikuar 21277 abonentë të cilët vetëm për periudhën 2018-2020 kanë krijuar një borxh në vlerën 7,218,283,741 lekë dhe 2,942,019,409 lekë kamatëvonesa. Kjo vlerë për OSHEE SHA konsiderohet si llogari e arkëtueshme ose të ardhura të munguara. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” nenet 80, 82, 84 dhe 92.</p>		E lartë	<p>Administratori i OSHEE SHA të marrë masa të menjëhershme për identifikimin e abonentëve problematik, qofshin këto buxhetorë apo Jo buxhetorë, njoftimin e tyre për detyrimin e krijuar, trajtimin rast pas rasti duke u nisur dhe nga natyra e secilit dhe gjetjen e një zgjidhje sa më efektive për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura dhe shmangien e krijimit të debitorëve të rinj.</p>
<p>Nga auditimi i kontratave të blerjes së energjisë nga importi për periudhën 2017-2020 u konstatua se nga ana e furnitorëve të energjisë elektrike për sasinë e energjisë së blerë në import për mbulimin e humbjeve nuk respektohen kushtet e kontratës nenet 1-5. Edhe pse në total sasia e furnizuar është e plotë, oraret e furnizimit furnitorëve nuk janë respektuar në përputhje me kushtet kontratore.</p> <p>Sasia totale e energjisë e furnizuar jo në përputhje me kushtet e kontratës është 13,346 MWh, në vlerë 914,024 euro (113,256,714 lekë me kursin e këmbimit të BSH 123,91 lekë/euro) vlerë e cila përbën shpenzim jo në përputhje me kushtet e kontratës.</p>		E mesme	<p>Administratori i OSHEE SHA të marrë masa që në të ardhmen të kryej një monitorim të plotë të sasive të furnizuara dhe respektimit të kushteve të hartuara pranuar dhe nënshkruara nga palët me kontratat respektive, me qëllim realizimin e një furnizimi me energji në rrejt për përmbushjen e nevojave të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike</p>
<p>Shoqëria OSHEE SHA, nuk ka ndërtuar gjurmën e auditimit për proceset kryesore të punës, si dhe nuk ka hartuar as plane të kontrollit të brendshëm (Plani lokal), në kundërshtim me ligjin Nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin” neni 4/ pika 19, dhe neni 4/ pika 3, për të ndihmuar në kryerjen e veprimtarive të njesisë publike, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.</p>		E mesme	<p>OSHEE SHA dhe Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit, të merren masa për monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të shoqërisë në nivel qendror dhe rajonal sipas shkallës së përgjegjësisë dhe të raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njesisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për</p>

				riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga shoqëria, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë.
	OSHEE SHA është njoftuar nga Avokatura e Shtetit për një dëm në vlerën 8,367,087 Euro (1,036,765,750 lekë me kursin e BSH prej 123,91 lekë/Euro) dhe 901,576 CHF (104,267,264 lekë me kursin e BSH prej 115,65 lekë/CHF) referuar çështjes së arbitrazhit ndërkombëtar SCAI nr.600491/2017, me palë paditëse EFTAG dhe palë të paditur "OSHEE" SHA dhe deri në zbardhjen e vendimit OSHEE përballet me rritjen e interesave për këtë detyrim. Njohja e vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit "SCAI", njohur dhe dhënë fuqi ligjore në Republikën e Shqipërisë me vendimin nr.118, datë 10.11.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë, plotësuar me vendimin nr.125, datë 24.11.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë, pritet ti shkaktojë OSHEE SHA, pasoja të rënda në likuiditetin e saj, referuar kostove të energjisë. Sipas vendimit të datës 21.01.2020 të Gjykatës së Lartë të Kantonit Zvicër, Shoqëria EFTAG i ka kërkuar OSHEE SHA me shkresë pagesën në mënyrë vullnetare të detyrimit (i cili deri në datë 11.12.2019 ka qenë rreth 9,196,521 Euro) (1,139,540,917 lekë me kursin e BSH prej 123,91 lekë/Euro).	E lartë	Nga OSHEE SHA, të merren masa për krijimin e provizioneve për shkak të ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit përfundimtar të arbitrazhit në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar SCAI Case no.600491-2017 të datës 21.01.2020 i Gjykatës së Lartë të Kantonit Zvicër, njohur nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.118, datë 10.11.2020, plotësuar me vendimin nr.125, datë 24.11.2020, për detyrimin ndaj Shoqërisë EFTAG si palë paditëse	

I.3 Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Opinionin e përrputshmërisë së modifikuar/kualifikuar:

Për mendimin tonë, rezultati i auditimit për çështjet e përrputshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare të OSHEE SHA për periudhën 01.07.2017 deri më 30.06.2020 nuk është në përrputhje në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara në këtë auditim, që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator. Krahas parregullsive materiale sasiore, në arritjen e opinionit, grupi i auditimit në dhënien e opinionit ka marrë në konsideratë dhe gabime/parregullsi të caktuara të natyrës cilësore, pavarësisht vlerës së tyre.

*Në përrfundim të auditimit, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përrshtatshme të auditimit, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat janë materiale por jo të përrhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar të përrputshmërisë.***

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përrputshmërisë.

Ne jemi përrpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale.

Konkluzionet dhe opinionin ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga OSHEE SHA, e cila konsiderohet nga ana e jonë përrfaqësuese, e mjaftueshme, e përrshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përrdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përrshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionit me siguri të

arsyeshme.

Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, ISSAI 1500 (ISA 500)¹ dhe ISSAI 1530 (ISA 530)²; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në këtë auditim përputhshmërie.

Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinionit të gabuar rreth objektivit të auditimit.

Bazuar në punën e kryer të auditimit, nga gjetjet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e opinionit të mësipërm, veçojmë:

- Si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të administratës së OSHEE SHA është shkaktuar një dëm ekonomik prej 7,939,674 lekë që përfaqëson shpërblime të padrejta, penaltete dhe pagesa për punime të pakryera gjatë zbatimit të kontratave, si dhe në shitblerjen e energjisë elektrike;
- Janë konstatuar efekte negative në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të tyre në vlerën prej 881,417.5 mijë lekë, nga të cilat 92 % për shpërblimin në natyrë të punonjësve, për gjyqet për largimet e padrejta nga puna të punonjësve etj., dhe pjesa e tjetër në zbatimin e procedurave të prokurimit publik;
- Këshilli mbikëqyrës ka miratuar vendimin nr.33 datë 14.07.2017 për shpenzime kompensimi të pronarit që shpronësohet për realizimin e projektit “Ndërtimi i nënstacionit të TEC Kombinat 110/120 kV, Tiranë, me kosto më të lartë në një vlerë prej 26,674,674 lekë, jo në përputhje me legjislacionin shqiptar përkatës;
- Shoqëria nuk ka përfunduar procesin e kalimit të pronësisë nga inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, të iniciuara me VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA;
- Në pasqyrat financiare të shoqërisë të vitit 2017 ekziston një mospërputhje e llogarive të arkëtueshme midis sistemit faturimit & arkëtimit dhe të pozicionit financiar “Të arkëtueshme” (kontabilitetit) për gjendjen e klientëve në vlerën 1,169,392 mijë lekë;
- OSHEE SHA, në mars 2018 ka njohur të ardhura nga penalteteti ndaj KESH SHA si rezultat i mos respektimit të kontratës në vlerën prej 5,543,701 mijë lekë e cila nuk është pranuar dhe nuk është firmosur nga KESH SHA, dhe e ka përfshirë në rezultatin financiar, në kundërshtim me standardet ndërkombetare të kontabilitetit;
- Nuk është kryer ankandi për gjendjen e pjesëve materiale në fund të vitit 2019 në vlerën prej 108,784,007 lekë;
- Nga inventarizimi i vitit 2019 janë evidentuar mallra me qarkullim të ngadalshëm në vlerën totale në 283,914,390 lekë, nga të cilat 60,755,110 lekë i përkasin hyrjeve të vitit 2017;
- OSHEE ka krijuar detyrime të reja ndaj KESH, për periudhën 2019 në vlerën 944,117,000 lekë;
- Janë identifikuar 21,277 abonentë të cilët vetëm për periudhën 2018-2020 kanë krijuar një borxh në vlerën 7,218,283,741 lekë dhe 2,942,019,409 lekë kamatëvonesa, e llogaritur nga OSHEE SHA konsiderohet si llogari të arkëtueshme ose të ardhura të munguara;
- OSHEE SHA, ka rreth 3 vjet pa amenduar politikat dhe udhëzimet e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në shoqëri, në kundërshtim me ligjin nr.10296 dt.08.07.2010 “Për

¹ Objektivit i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij.

² Objektivit i audituesit është të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivit.

menaxhimin financiar dhe Kontrollin”;

- OSHEE SHA është njoftuar nga Avokatura e Shtetit për një dëm në vlerën 8,367,087 Euro dhe 901,576 CHF referuar çështjes së arbitrazhit ndërkombëtar SCAI nr.600491/2017, me palë paditëse EFTAG dhe palë të paditur “OSHEE” SHA dhe deri në zbardhjen e vendimit OSHEE përballet me rritjen e interesave për këtë detyrim etj.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të OSHEE SHA:

Strukturat drejtuese të OSHEE SHA, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), përfshirë ato për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike.

Strukturat drejtuese të OSHEE SHA janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve.

Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullative.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme³, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinioni i auditimit janë të përshtatshme.

³ ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 546/1 prot., datë.23.06.2020 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 29.06.2020 deri më datë 18.09.2020, në subjektin Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për periudhën nga 01.07.2017 deri më 30.06.2020 u krye auditimi “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. GJ P Përgjegjës grupi
1. B SH, Auditues
2. S H, Auditues
3. J ZH, Audituese
4. I B, Audituese

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.07.2017 deri më datë 30.06.2020 përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator.

Objekti i Auditimit është dhënia e opinionit të përputhshmërisë nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë:

1. Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
2. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të drejtimit;
3. Dhënia e një sigurie të arsyeshme nëse;
 - Informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacioneve janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
 - Burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
 - Asetet janë ruajtur dhe mirë administruar;
 - Veprimtaria e shoqërisë është në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara për këtë qëllim;
 - Kërkesat nga organet ligjvënëse, agjencitë financuese ose organizatat donatore janë respektuar sipas kushteve të marrëveshjeve të financimit.
4. Vlerësim mbi shkallën e zbatimit të legjislacionit dhe rregullave përkatëse të prokurimit publik, si dhe zbatimi i detyrimeve kontraktore;
4. Shkalla e realizimit të objektivat kryesore të përcaktuar në programet ekonomike dhe financiare;
5. Dhënia e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së OSHEE.

2. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuarra i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Gjithashtu, qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit; hartimi, miratimi dhe dërgimi në subjekt i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve; si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim në ecurinë ekonomike dhe financiare të OSHEE SHA.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i auditimit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të OSHEE SHA të periudhës 01.07.2017 - 30.06.2020 ka identifikuar sipas kriterëve specifike të

vlerësimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- Zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm të KLSH-së;
- Ligjshmërinë për emërimet dhe funksionimin e këshilli mbikëqyrës dhe administratorit;
- Hartimin, shqyrtimin dhe miratimin si dhe realizimin e programit ekonomiko-financiare;
- Zbatimin e strukturës organizative dhe administrimin e marrëdhënieve të punës;
- Rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve;
- Mbajtjen e evidencës kontabile dhe analiza e debitorëve e kreditorëve;
- Zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave;
- Zbatimin rregullave dhe procedurave të shitje-blerjes të energjisë elektrike;
- Zbatimi i dispozitave ligjore për dhënie dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.
- Organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit;
- Organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm të OSHEE SHA.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese kanë për detyrë dhe përgjegjësi që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës të fushës së aktivitetit ekonomik të OSHEE SHA.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënie të një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, e shprehur nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënie të këtij opinionit.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në shprehjen e konkluzioneve dhe opinionit me siguri të arsyeshme mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare, bazuar në rezultatet e auditimit të çështjeve nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj.;

- njëherësh aspektet e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet), si dhe respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik;

- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të ndërmerren veprime korrigjuese, si dhe të identifikojë strukturat dhe personat përgjegjës për veprimet e tyre.

6. Kriteret e vlerëimit

Kriteret e vlerëimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, në dispozita të tjera, si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligji 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për

kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 26.11.2003 “Për arkivat”; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar; Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës e Shqipërisë”, i ndryshuar” etj.

- VKM nr.570, datë 3.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”; VKM Nr. 244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik”; VKM nr. 338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar; VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar; VKM nr. 864, date 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”; VKM Nr. 171 “Për miratimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike”; VKM Nr. 317, datë 27.04.2016 “Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike”; VKM Nr. 449 datë 15.6.2016 “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”; VKM Nr. 5192 datë 13.7.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”; VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore“ etj.

- Vendime të ERE që ndikojnë veprimtarinë e OSHEE.

- Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”; Udhëzimi i APP nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar; Udhëzimi i APP nr. 4, datë 09.01.2018 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”; Udhëzimi i APP nr. 2, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike”; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar; akti i themelimit; statuti dhe rregullorja e brendshme e shoqërisë etj.

- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që kanë rezultuar të nevojshëm gjatë auditimit.

7. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI). Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Kërkesat e Kushtetutës së Shqipërisë (Pjesa XIV, nenet 162 – 165);

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;

- ISSAI 400- Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;

- ISSAI 4000- Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;

- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;

- ISSAI 1530 (ISA 530)- Objektivi i audituesit është të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi;

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;

- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH;
- si dhe në praktikat më të mira të fushës.

8. Metodatat e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar: shoqëri publike me rëndësi strategjike, kompleksiteti i veprimtarisë kryesore në blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve fundorë; periudha tre vjeçare e aktivitetit të audituar; periudha dhe koha e zhvillimit të auditimit, në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhme:

- a. *Verifikimi i transaksioneve* - duke marrë informacion për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, dhe krahasimin me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër;
- b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- c. *Raportet dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht drejtimeve të auditimit;
- d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;
- g. *Modelimet e thjeshta statistikore* – në lidhje me përzgjedhjen sa më përfaqësuese të shembullit për shqyrtim në çështje të caktuara të auditimit;
- h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve dhe opinionit të auditimit.

9. Dokumentimi i auditimit

Audituesit e KLSH, për dokumentimin e auditimit janë mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, që të jetë i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e OSHEE SHA, audituesit e KLSH kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura në zbatimin e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

“Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” (OSHEE) SHA është një nga tre shoqëritë publike të sistemit energjetik, e regjistruar 100% në pronësi të shtetit shqiptar, me autoritet publik përfaqësimi Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, sipas VKM nr. 317, datë 27.04.2016 “Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike”.

Me Vendimin nr. 862, datë 20.12.2006, Këshilli i Ministrave ka vendosur krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) SHA. OSSH është regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me Numër Unik të Identifikimit të Personit të Tatuësëm (NIPT) K72410014H, në bazë të Vendimit nr. 38587, datë 19.06.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar VKM së lartpërmendur, pronësia e 100 % të aksioneve të OSSH SHA i përkiste shoqërisë KESH SHA. Me Urdhrin e Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) nr. 329, datë 29.05.2008, titulli i pronësisë së aksioneve të OSSH SHA u kalua nga KESH SHA tek METE. Me ligjin nr. 10116, datë 23.04.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 % të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) SHA ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s”, titulli i pronësisë së 76 % të aksioneve të OSSH i kaloi shoqërisë CEZ a.s, Pragë. Në datën 24 Shtator 2010, u vendos ndryshimi i emrit të shoqërisë nga OSSH SHA në CEZ Shpërndarje SHA. Me Vendimin nr. 5, datë 21.01.2013, Enti Rregullator i Energjisë ka vendosur vënien në administrim të përkohshëm të shoqërisë CEZ Shpërndarje SHA. Në datën 23 Korrik 2014, është vendosur ndryshimi i emrit të shoqërisë nga CEZ Shpërndarje SHA në “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” (OSHEE) SHA. Me Urdhrin e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 454, datë 22.10.2014, aksionet e Shoqërisë OSHEE SHA, janë regjistruar 100% në pronësi të shtetit shqiptar. Aksioneri i Shoqërisë “OSHEE” SHA për periudhën nga 23.10.2014 deri në 05.05.2016 ka qenë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Me hyrjen në fuqi të VKM nr. 317, datë 27.04.2016, autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë “OSHEE” SHA është Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

OSHEE SHA është person juridik që funksionon si shoqëri aksionare, në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe vepron sipas ligjeve specifike të fushës si: ligji nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjit nr. 124/2015 “Për efëncën e energjisë” etj.

Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike, me Vendim nr. 96 dhe 97 datë 27.10.2014 ka licencuar OSHEE SHA për ushtrimin e aktivitetit të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë.

Objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë është të ofrojë energji elektrike nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes për fuSHAt e mëposhe:

a. Kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe të drejtpërdrejta të lidhura me blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për furnizimin e klientëve tariforë të lidhur me rrjetin e saj të shpërndarjes, me tarifa të rregulluara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencën e akorduar;

b. Kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe drejtpërdrejta të lidhura me funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencën e akorduar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- ndërtimin, funksionimin dhe pronësinë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve;
- lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike; dhe
- instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike.

c. Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe bazuar në ndryshimet rajonale apo territoriale të kërkesës;

d. Shërbime të tjera për klientët, që janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet ndaj tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Organet e OSHEE SHA janë asambleja e përgjithshme dhe këshilli mbikëqyrës, si dhe një administratorë, ku funksionet e administrimit e të mbikëqyrjes shpërndahen ndërmjet këtyre dy organeve (sistemi me dy nivele).

OSHEE SHA, në kuadrin legjislativ dhe operues, ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar si dhe ligji 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” përbëjnë aktet bazë, krahas gërshetimit të veprimtarisë dhe me ligjet e tjera, si Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”, ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar etj.

Auditimi i përputhshmërisë së OSHEE SHA është i rëndësishëm, pasi ky subjekt është një nga tre subjektet e sistemit energjetik, me rëndësi kombëtare për efekt të funksionit që ka për furnizimin me energji elektrike të klientëve tariforë të lidhur me rrjetin e saj të shpërndarjes, si dhe zhvillimin e veprimtarisë ekonomike dhe financiare në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të fushës.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1 Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm të KLSH-së.

1. Titulli i Gjetjes Shkalla e realizimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Situata:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara subjektit Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA, nr.272/16, datë 27/09/2017, rezultoi se Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA ka hartuar programin dhe ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, brenda afatit 6 mujor nga data e njoftimit të raportit të përfundimtar të auditimit. Për zbatimin e rekomandimeve të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe në proces të evaduar në zbatim të vendimit të Kryetarit të KLSH nr.56, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është ri-kërkuar zbatimi i tyre ***dhe shkalla e realizimit ka qenë si më poshtë vijon:***

-Janë rekomanduar 13 masa organizative nga të cilat, 6 masa janë zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht, 6 masa janë në proces zbatimi.

-Janë rekomanduar 9 masa për shpërblim dëmi nga të cilat, 1 masë është zbatuar plotësisht, 7 masa janë zbatuar pjesërisht, 1 masë është në proces zbatimi.

-Është rekomanduar 1 masë për eliminimin e efekteve negative financiare, nga të cilat, 1 masë është zbatuar pjesërisht.

-Janë rekomanduar 13 masa disiplinore nga të cilat, 10 masa janë zbatuar plotësisht dhe nuk janë zbatuar 3 masa disiplinore.

Grupi i auditimit edhe pse ka vijuar me kërkesat e vazhdueshme drejtuar shoqërisë, për sa më sipër nuk i është dorëzuar asnjë dokument justifikues apo informacion shkresor ***në lidhje me shkallën aktuale të realizimit për periudhën objekt auditimi deri në datën 30.06.2020***, për zbatimin e rekomandimeve të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe në proces, të evaduar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.56, datë 22.06.2018 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar në periudhën korrik-shtator 2017”, drejtuar OSHEE SHA me shkresën nr.482/20, datë 25.06.2018. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 15 shkronja (j) dhe nenin 30 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”. *Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr.1, datë 18.09.2020*

Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, OSHEE SHA, vënë në dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020 ka sjellë përgjigje megjithatë ky informacion nuk është përditësuar me gjendjen aktuale të rekomandimeve

dhe vendimet aktuale të organeve drejtuese në lidhje me zbatimin e tyre, për rrjedhojë shkalla e realizimit paraqitet si më poshtë vijon:

- Për **6 masat organizative të mbetura në proces** konstatohet se **2** rekomandime janë në proces, **3** rekomandime nuk janë zbatuar dhe **1** rekomandim është zbatuar pjesërisht :

- Për **8 masat për shpërblim dëmi të zbatuara pjesërisht dhe 1 masë për shpërblim dëmi të mbetura në proces,** konstatohet se **6** masa nuk janë zbatuar në vlerën 262,908,779 lekë , **1** masë është në proces në vlerën 6,852,652 lekë dhe **1** masë është zbatuar pjesërisht në vlerën 50,271 euro.

- Për **1 masë për eliminimin e efekteve negative financiare të zbatuara pjesërisht,** konstatohet se **1** masë nuk është zbatuar në vlerën 188,060,525 lekë.

- **Nga 3 masat disiplinore që kanë rezultuar të pazbatuara,** konstatohet se janë zbatuar **3** masa.

Kriteri: Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c, ku përcaktohet:

Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet:

c) t’u rekomandojë drejtuesve të njëjste të audituara apo organeve të kompetencës të ndërmarrin, në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore apo administrative.

Ndikimi/Efekti: Zbatimi i plotë i rekomandimeve do të ndikojë në përmirësimin e aktivitetit të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA

Shkaku: Nisur nga eksperiencia e zbatimit të rekomandimeve nga ky subjekt, konstatohet se rekomandimet nuk janë zbatuar plotësisht.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandime: Këshilli mbikëqyrës i OSHEE SHA të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos realizimin e masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, si dhe të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, në proces dhe të zbatuara pjesërisht, duke i kushtuar vëmendje të posaçme rekomandimeve të cilat janë në procese gjyqësore.

Më hollësisht rezultatet e auditimit për këtë çështje paraqiten si më poshtë:

A.MASA ORGANIZATIVE

I. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm, u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi:

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, përgjithësisht i kanë trajtuar me korrektesë rekomandimet e KLSH-së, dërguara me shkresën nr. 495/20 prot., datë 24.09.2015, por nuk kanë marrë plotësisht masa për zbatimin e tyre.

1.1 Rekomandimi:

- Nga Shoqëria “OSHEE” SHA të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultuan të pazbatuara, si dhe të ndjekë me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore. Të merren masa të menjëhershme për rikuperimin e vlerës së konsideruar dëm ekonomik nga KLSH në auditimet e mëparshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2 Rekomandimi:

Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa të menjëhershme për të përfshirë në veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, auditimin e aktivitetit të të gjitha kompanive të mbledhjes së borxhit të keq të

energjisë elektrike, dhe për të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e tyre, të informohet Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë. Gjithashtu, nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të kryhet auditim i plotë i veprimtarisë administruese dhe menaxhuese, ekonomike dhe financiare të ish-CEZ Shpërndarje SHA, në periudhën e administrimit të përkohshëm duke filluar nga data 21.01.2013, si dhe duke analizuar në veçanti kallëzimin penal të Avokaturës së Shtetit, përcjellë organit të Prokurorisë me shkresën nr. 526/34, datë 24.07.2013, për arsye se KLSH nuk mund të auditojë këtë ish- shoqëri për vet statusin privat të saj.

Menjëherë

1.3 Rekomandimi:

Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa të menjëhershme për të përfshirë në veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, auditimin e 13 059 rasteve të konstatuara në sistemin e faturimit (Billing), duke zbatuar procedurat audituese për problemin e konstatuar, dhe për të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e tyre, të informojë Këshillin Mbikëqyrës dhe Administratorin e Shoqërisë.

Menjëherë

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, OSHEE SHA, vënë në dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020 ka sjellë përgjigje por informacioni bashkëlidhur në lidhje me këtë rekomandim është i vitit 2018 dhe konkretisht shkresa 22934/1, datë 23.03.2018, gjithashtu ky informacion nuk është përditësuar me gjëndjen aktuale të tij, për rrjedhojë nuk përcaktohet shkalla aktuale e realizimit të rekomandimit. ***Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar***

II. Nga auditimi mbi mbajtjen e evidencës kontabile në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen e bilancit dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e varësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore etj., ndaj buxhetit”, u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi:

Shoqëria “OSHEE” SHA nuk ka përfunduar inventarizimi fizik të aktiveve afatgjata, si dhe nuk është zbatuar plotësisht VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë nga KESH SHA në pronësi të Shoqërisë “OSHEE” SHA

1.1. Rekomandim:

Nga Shoqëria “OSHEE” SHA të merren masa tekniko-organizative dhe të ndiqen procedurat e nevojshme ligjore për;

-kryerjen e inventarizimit fizik të aktiveve afatgjata, si dhe zbatimin e plotë të VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Shoqërisë “Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA”.

-hartimin e plotë të rregullores për menaxhimin e aseteve në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Menjëherë

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, OSHEE SHA, vënë në dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020 ka sjellë përgjigje por informacioni bashkëlidhur ,konstatohet se në datën 23.01.2019 nga ana e OSHEE SHA dhe KDADAAHTTMWAU s.r.l është lidhur kontrata me objekt “Inventarizimi dhe vlerësimi i aktiveve materiale afatgjata të OSHEE SHA si dhe ngritja e sistemit të administrimit dhe përgatitja e procedurave të brendshme të menaxhimit të tyre”. Ky projekt ka 8 faza dhe aktualisht projekti është në fazën e pestë të zbatimit të tij. ***Rekomandimi konsiderohet në proces***

2. Gjetje nga auditimi:

Në pasqyrat financiare të shoqërisë ekziston një mospërputhje e llogarive të arkëtueshme midis sistemit faturimit & arkëtimit (Billing- ut) dhe të pozicionit financiar “Të arkëtueshme” (kontabilitetit) për gjëndjen e klientëve më 31 dhjetor 2015. Mospërputhja midis sistemit “SAP” dhe sistemit “Billing- ut” (faturim & arkëtim) dhe kontabilitetit më 31.12.2015 arrijnë në vlerën 1,641,669 mijë lekë, kundrejt 1,318,805 mijë lekë që rezultonte kjo mospërputhje më 31.12.2014,

ose me një rritje prej 322,864 mijë lekë, fakt që nuk jep siguri në funksionimin e kontrollin lidhur me të ardhurat.

2.1. Rekomandim:

Nga Shoqëria "OSHEE" SHA të merren masat e nevojshme për përmirësimin e sistemit të faturimit "Billing" me kontabilitetin "SAP", për të eliminuar mospërputhjet llogarive të arkëtueshme.

Menjëherë

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020 vënë në dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020 OSHEE SHA, ka sjellë përgjigje por informacioni bashkëlidhur konstatohet se informacioni bashkëlidhur në lidhje me këtë rekomandim është i vitit 2018 dhe konkretisht shkresa 22934/1, datë 23.03.2018, ka dhe shkresa, fatura për vitin 2019 por nuk janë përditësuar me gjëndjen aktuale të tij, për rrjedhojë nuk përcaktohet shkalla e realizimit të rekomandimit. *Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar*

3. Gjetje nga auditimi:

Shoqëria "OSHEE" SHA nuk ka arritur të finalizojë rakordimin e detyrimeve të ndërsjella me Shoqërinë "KESH" SHA, Shoqërinë "OST" SHA dhe Shoqërinë "Posta Shqiptare", në kundërshtim me urdhrin e Kryeministrit nr. 74, datë 27.05.2015 "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për evidentimin dhe adresimin e problematikave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja në sektorin e energjisë elektrike".

3.1. Rekomandim:

Nga Shoqëria "OSHEE" SHA të merren masa për përfundimin e rakordimeve të detyrimeve të ndërsjellta me Shoqërinë "KESH" SHA, Shoqërinë "OST" SHA dhe Shoqërinë "Posta Shqiptare".

Menjëherë

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, OSHEE SHA, vënë në dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020 ka sjellë përgjigje por informacioni bashkëlidhur në lidhje me këtë rekomandim konkretisht emaili i datës 10.12.2020 (komunikimi elektronik i Posta Shqiptare SHA dhe OSHEE SHA) ka paqartësi në përcaktimin e balancës së detyrimeve të ndërsjella gjendje deri me datë 31.12.2019 dhe rakordimi sipas këtyre emaileve nuk ka përfunduar, për rrjedhojë nuk përcaktohet shkalla aktuale e realizimit të rekomandimit. *Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar*

IV. Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria "D" SHPK, me objekt "Rinstruksioni i 14 linjave 35 kv", viti 2016, u konstatua se nuk është arsyetuar mosrealizimin në afatin e përcaktuar të kësaj kontrate, me një vonesë të përlllogaritur deri më 30.06.2017, datë në të cilën përfundoj auditimi për 6- muaj (Afati i zbatimit të punimeve për këtë kontrate është 6- muaj nga dorëzimi i sheshit 21.06-21.12.2016). Referuar nenit 37 pika 37.1 (a) penaliteti (tarifa ditore) për moszbatim kontrate është 4/1000 ose 0.004 e vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës, ka krijuar një penalitet në vlerën 69,191,252 lekë, i cili në rast mos pasje të arsye të justifikuara, duhej llogaritur, njoftuar dhe ndaluar penalitetin kontraktor. Theksojmë se punimet për realizimin e kontratës vazhdojnë.

Rekomandimi:

Nga Shoqëria "OSHEE" SHA të shqyrtohen arsyet e mos realizimit të kontratës në afatin e përcaktuar, si dhe të merren masa të plota për vendosjen e afateve të tjera prekulzive, referuar Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Në rast se punimet nuk realizohen në afatin e rivendosur, të llogariten penalitetet përkatëse dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e tyre, nga shoqëria "D" shpk.

Menjëherë

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, OSHEE SHA, vënë në dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020 ka sjellë përgjigje informacioni bashkëlidhur dhe konstatohet se informacioni bashkëlidhur në lidhje me këtë rekomandim përfshin

llogaritjen e dëmit ekonomik nga Drejtoria e Tensionit të Lartë dhe është prerë fatura e penaliteteve nr.4, datë 30.10.2018, për situacionet nr.3,4 dhe nr.5 me vlerë 33,079,118 lekë dhe shkresat nr.1652, date 27.11.2018 nga Drejtoria e Tensionit të Lartë ku vihet në dijeni operatori D SHPK për detyrimin ndaj OSHEE SHA dhe Drejtori i Departamentit Ekonomik dhe Drejtori i Departamentit të Administratës së Korporatës evidentohet arkëtimi i detyrimit të penalitetit të këtij operatori ndaj OSHEE SHA, likuiduar me faturën nga operatori “D” në masën 95 %. **Rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht**

VI. Nga auditimi i zbatimit të rregullave dhe procedurave të shitje -blerjes të energjisë elektrike, u konstatua që:

1. Gjetje nga auditimi:

OSHEE ka marrëveshje me 72 shoqëri gjeneruese të energjisë elektrike në juridiksionin e të cilave ndodhen 112 HECE, që janë të lidhur në rrjetin shpërndarës të OSHEE 35/10/6 KV. Nga të 112 HEC-et e lidhura në rrjetin shpërndarës, vetëm 2 HEC-e janë lidhur sipas skemës “Degëzim” me linjat ekzistuese 35kv, konkretisht HEC S... dhe HEC N....Pra të 110 HECET e tjerë, shfrytëzojnë hapësirat fizike dhe pajisjet (transformator etj.) të nënstacioneve të OSHEE dhe nuk paguajnë asnjë detyrim apo tarifë. Shfrytëzimi i hapësirave fizike dhe pajisjeve (transformator etj.) të nënstacioneve të OSHEE, nga 110 HECE e tjerë, të cilët nuk paguajnë asnjë detyrim apo tarifë, është në kundërshtim me Ligjin 43/2015 “Për sektorin e energjisë”, neni 28 pika 4 “Kostot për lidhjen me rrjetin” pika 2, Vendimin e ERE nr. 166, datë 10.10.2016 të ERE “Për miratimin e rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, KAP III, pika 3.2.16, KREU IV, pika 4.15

1.1 Rekomandimi:

-Nga Shoqëria “OSHEE” SHA të merren masa për të hartuar marrëveshje me HECET që shfrytëzojnë hapësirat fizike dhe pajisjet (transformator etj.) të nënstacioneve të OSHEE, konform dispozitave të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, për pagesën e detyrimeve përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, vënë në dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020 OSHEE SHA ka sjellë përgjigje sipas të cilës konstatohet se informacioni bashkëlidhur në lidhje me këtë rekomandim përfshin ngritjen e grupit të punës nga Administratori i OSHEE SHA, evidentimi i sipërfaqeve të zëna nga pronarët e objekteve që kanë zënë sipërfaqet ,statuset e objekteve ,zonat kadastrale dhe numrat përkatëse të pasurisë për 215 asete. Nga ky numër asetesh pjesë e konsiderueshme e sipërfaqeve rezulton të jenë të zëna nga OST SHA dhe në bazë të Kodit Civil të RSH dhe Rregullores për Lidhjet e Reja, OSHEE SHA ka draftuar kontratat e qirasë. Aktualisht procesi është në fazën e përgatitjes së praktikave për njoftimin e secilit subjekt me qëllim arritjen e marrëveshjes për tarifën e qirasë sipas përcaktimeve në rregulloren për lidhjet e reja. **Rekomandimi konsiderohet në proces**

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi:

Në përcaktimin e fondit limit (preventivi i projekt zbatimit), në objektin “Rikonstruksioni i 14 linjave 35 kV, viti 2016, u konstatua se nuk provohet plotësisht rritja e distancave të linjave me 2.28 km në vlerën 8,135,047 lekë, konstatim referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit (gjatë auditimit dhe me observacione), pasi një pjesë e dokumentacioni justifikues bazë është me mangësi.

1.1 Rekomandimi:

Nga Shoqëria “OSHEE” SHA të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës të pa përfshirë në projektim dhe preventivim, i cili të kryejë ekzaminimet teknike duke respektuar kërkesën e materialitetit dhe të paraqitjes së sinqertë dhe të vërtetë të distancave për çdo linjë dhe preventivin respektiv. Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se nuk provohet rritja e distancave të linjës me 2.28 km në vlerën 8,135,047 lekë, referuar legjislacionit në fuqi (KTP Libri VI17.18.19- 1978, manualët e ndërtimit dhe analizat përkatëse, si dhe projekteve respektive të çdo linje), kushteve teknike të projektimit dhe atyre të zbatimit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 15.02.2001 “Për miratimin e standardeve

dhe kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe Standardin Evropian EN 50341 Retun, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës 8,135,047 lekë nga shoqëria "D" SHPK.

Menjëherë

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, vënë në dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020 OSHEE SHA, ka sjellë përgjigje por informacioni bashkëlidhur dhe konstatohet se informacioni bashkëlidhur në lidhje me këtë rekomandim është i vitit 2018 dhe konkretisht shkresa 22934/1, datë 23.03.2018 por nuk është përditësuar me gjëndjen aktuale të tij për rrjedhojë nuk përcaktohet shkalla e realizimit të rekomandimit dhe nuk shoqërohet me dokumente justifikuese të relacionit të grupit teknik mbi ekzaminimet teknike. ***Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar***

2. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “D” SHPK, me objekt “Rinstruksioni i 14 linjave 35 kv”, viti 2016, u konstatua se kjo shoqëri pas demontimit të përcjellësve në rikonstruksionin e 14 linjave, nuk provohet plotësisht të ketë dorëzuar në magazinë sasinë e demontuar me një diferencë 31,549 kg përcjellës CU dhe 8,024 kg përcjellës ALC me vlerë 20,557,396 lekë, konstatim referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit (gjatë auditimit dhe me observacione), pasi një pjesë e dokumentacioni justifikues bazë është me mangësi .

2.1 Rekomandimi:

-Nga Shoqëria “OSHEE” SHA të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës të pa përfshirë në projektim, preventivim, kolaudim dhe marrjen në dorëzim, i cili të kryejë ekzaminimet teknike duke respektuar kërkesën e materialitetit dhe të paraqitjes së sinqertë dhe të vërtetë të procesit të demontimit në fazën e projektimit, preventivimit, situacionit dhe dorëzimit.

-Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se procesi i demontimit nuk është kryer konform legjislacionit tekniko-juridik në fuqi, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës 20,557,396 lekë nga shoqëria "D" SHPK.

Menjëherë

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, vënë në dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020 OSHEE SHA, ka sjellë përgjigje por informacioni bashkëlidhur dhe konstatohet se informacioni bashkëlidhur në lidhje me këtë rekomandim është i vitit 2018 dhe konkretisht shkresa 22934/1, datë 23.03.2018 dhe nuk është përditësuar me gjëndjen aktuale të tij për rrjedhojë nuk përcaktohet shkalla e realizimit të rekomandimit dhe nuk shoqërohet me dokumente justifikuese. ***Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar***

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga bashkimi i operatorëve EESHPK dhe A SHPK, me objekt “Spostimi i N/stacionit 110/20 KV, Tiranë Qendër”, viti 2016, u konstatua se dokumentacioni teknik i zbatimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit nuk është i plotë dhe i saktë, duke krijuar një dëm ekonomik për llogari të Shoqërisë “OSHEE” SHA dhe Buxhetit të Shtetit në vlerën 6,852,652 lekë

3.1 Rekomandimi:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 6,852,652 lekë, nga bashkimi i operatorëve EESHPK dhe A SHPK, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës së punëve civile me objekt “Spostimi i N/stacionit 110/20 KV, Tiranë Qendër, viti 2016”.

Menjëherë

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, vënë në dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020 OSHEE SHA, ka sjellë përgjigje por informacioni bashkëlidhur dhe nga dokumentet justifikuese bashkëlidhur konstatohet se përmes shkresës nr.5190/1, datë 05.04.2019, OSHEE SHA i ka kërkuar operatorëve EESHPK dhe A SHPK të

paguajnë dëmin e shkaktuar në vlerën 6,852,652 lekë , pasi u konstatua se dokumentacioni teknik i zbatimit dhe kolauditimit të punimeve për kontratën me objekt “Spostimi i N/stacionit 110/20 KV, Tiranë Qendër, viti 2016”, nuk është i plotë dhe i saktë. Operatorët e sipërcituar, nuk i kanë përcjellë asnjë përgjigje OSHEE SHA për zgjidhjen e situatës dhe për pagimin e vlerës së kërkuar e në këto kushte në datë 28.06.2019 OSHEE SHA ka ngritur padi përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. **Rekomandimi konsiderohet në proces**

4. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga shoqëria EESHPK dhe A SHPK, me objekt “Spostimi i N/stacionit 110/20 KV, Tiranë Qendër, viti 2016” ,u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve dhe pjesëve elektrike, nuk është i plotë dhe i saktë për pajisjet: Xhunto për kabull XLPE 110 KV AL 1 X800 RM copë 3 për vlerën 4,320,000 lekë dhe Kabëll XLPE 20 KV CU 1x630 RM për vlerën 21,924,000 lekë. Konkretisht ka mospërputhje midis dokumentacionit të kërkuar në specifikimet teknike dhe test raportit të fabrikës për Kabëllin XLPE 20 KV CU 1x630 RM, ndërsa Xhunto për kabëll nuk janë shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar (test raport) për të provuar parametrat teknik.

-Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jep opinion e Tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmonte që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar, për të cilat bashkimi i operatorëve EESHPK dhe A SHPK, ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

4.1 Rekomandimi:

Nga Shoqëria “OSHEE” SHA të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës, i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve .Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga bashkimi i operatorëve EESHPK dhe A SHPK, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës 26,244,400 lekë nga bashkimi i operatorëve EESHPK dhe A SHPK.

Menjëherë

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, vënë në dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020 OSHEE SHA, ka sjellë përgjigje por informacioni bashkëlidhur dhe konstatohet se informacioni bashkëlidhur në lidhje me këtë rekomandim është i vitit 2018 dhe konkretisht shkresa 22934/1, datë 23.03.2018 dhe shkresa të vitit 2019 por nuk është përditësuar me gjendjen aktuale të tij për rrjedhojë nuk përcaktohet shkalla e realizimit të rekomandimit dhe nuk shoqërohet me dokumente justifikuese. **Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar**

5. Gjetje nga auditimi:

Nga Shoqëria “OSHEE” SHA për vitin 2015, është marrë në evidencë dhe është pasqyruar në kontabilitet zbatimi i vendimeve të ERE nr. 90 datë 15.11.2010 dhe nr. 94, datë 01.12.2010 për faturat sistemuese të “Dëmit ekonomik” dhe “Energji e pamatur, të lëshuar për periudhat 2008-2011 në vlerën 1,763,504 mijë lekë, duke pakësuar debinë e klientëve, në zbatim të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 58, datë 05.10.2015 dhe vendimit të Asamblesë së Aksionareve nr. 2765/1, datë 11.05.2016.

Përveç vlerës 1,763,504 mijë lekë, në kundërshtim me urdhrin e administratorit nr. 1971 prot, datë 30.01.2015, nga Dega e Shitjes dhe Drejtoria e IT janë hequr nga gjendja debitore 2920 fatura afrofe me vlerë 148,980,422 lekë.

- Ndryshimi i gjendjes së debisë në vlerën 1,374,946,977 lekë për llogari të Shoqërisë “OSHEE” dhe Buxhetit të Shtetit dhe TVSH vlerën 287,370,056 lekë, pa llogaritur kamat vonesën është bërë, jo nga palët Shoqëria “OSHEE”, SHA dhe klientëve familjar, priva tët dhe buxhetorët që kanë marrëdhënie kontraktuale me njëri tjetrin, por si pasojë e vendimeve të ERE. Referuar legjislacionit tatimor, ky është një problem, që ka lindur me interpretimin e ndryshimit të vlerës së

transaksioneve, për furnizimin me energji elektrike klientëve referuar kontratave respektive. Meqenëse, nuk kemi të bëjmë me ndryshim të deklarimeve për 2008-2011, me inicim nga vetë tatimpaguesit (Shoqëria “OSHEE” SHA dhe klientëve), por nga një ent shtetëror (ERE), Shoqëria “OSHEE” SHA duhet ti ishte drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, pas kërkesës së bërë nga ERE, e cila duhet të kishte dhënë udhëzime të hollësishme, me qëllim jo vetëm të kreditimit dhe disbursimit të TVSH, por edhe të llogaritjes së penalteteve përkatëse. Kjo pasi korrigjimi i çdo deklarate mujore që nga viti 2008-2011, ka pasojë jo vetëm për kreditimin dhe disbursimin e TVSH, por edhe në llogaritjen e kamatëvonesës. Referuar këtij fakti shoqëria “OSHEE”, ka deklaruar dhe derdhur në organin tatimor më shumë TVSH të pagueshme, ndërkohë që rishikimi në ulje i saj, d.m.th, që të rritet TVSH e zbritshme e saj, ku diferenca nga TVSH e deklaruar më parë, pakëson detyrimin e TVSH së derdhur për llogari të organit tatimor dhe buxhetit të shtetit. Në terminologjinë financiare referuar legjislacionit në fuqi, anulimi i faturave ka një ndikim tepër negativ me rreth 15 milion euro në të ardhurat e Shoqërisë “OSHEE”, SHA, si dhe ka një ndikim sinjifikativ në reduktimin e konsiderueshëm të detyrimeve të TVSH të Shoqërisë “OSHEE”, SHA përkundrejt Autoritetit të Tatimeve, i cili duhet të rimbursonte Shoqërinë “OSHEE” respektivisht me një vlerë të përafërt 305,997,507 lekë, vlerë e cila nuk mund kreditohet për llogari të shoqërisë OSHEE.

Në terminologjinë energjitike referuar legjislacionit në fuqi, anulimi i faturave ka një ndikim tepër negativ ndaj Shoqërisë “Kesh” SHA dhe Buxhetit të Shtetit (pra është prekur bilanci energjistik), pasi një pjesë e kësaj energjie është blerë me çmim të rregulluar nga Shoqëria “Kesh” SHA, e cila në sasinë më të madhe e ka blerë me çmim tregu nga operatorët e tregut, sipas situatave hidrike të krijuara nga viti 2008 deri në vitin 2011, e cila nuk mund të llogaritet, pasi fatura sistemuese nr. 1487, datë 31.01.2015 është vetëm në vlerën 1,374,949 mijë lekë, pa përcaktuar sasinë, si dhe nuk është kryer identifikimi specifik (nominal) për sasinë e energjisë dhe vlerën respektive të saj. ERE në vendimet nr. 90 datë 15.11.2010 dhe nr. 94, datë 01.12.2010, ka paraqitur paqartësi madje edhe konflikt të vetë dispozitave të rregullave të tregut, të cilat nuk janë hartuar në përputhje me Ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003, Ligjin, Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe kanë qenë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar”, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

5.1 Rekomandimi:

- Këshilli Mbikëqyrës të rishqyrtojë pakësimin e debisë në vlerën 1,763,504 mijë lekë, që i përket faturave sistemuese të “Dëmit ekonomik” dhe “Energji e pamatur” të lëshuar për periudhat 2008-2011 në zbatim të vendimeve të ERE nr. 90 datë 15.11.2010 dhe nr. 94, datë 01.12.2010 dhe vlerën 148,980,422 lekë që i përket faturave afrofe, të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Shoqërinë “OSHEE” dhe Buxhetin e Shtetit përbën dëm ekonomik.

Brenda datës 30.06.2018

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, vënë në dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020, OSHEE SHA ka sjellë përgjigje por informacioni bashkëlidhur por informacioni bashkëlidhur në lidhje me këtë rekomandim është i vitit 2018 dhe konkretisht shkresa 22934/1, datë 23.03.2018, gjithashtu ky informacion nuk është përditësuar me gjëndjen aktuale të tij, për rrjedhojë nuk përcaktohet shkalla aktuale e realizimit të rekomandimit.

Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar

6. Gjetje nga auditimi:

Nga zbatimi i vendimeve të ERE nr. 148, datë 26.12.2014 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tarifor për vitin 2015” dhe vendimin nr. 128, datë 29.07.2016 “Mbi tarifën e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët e lidhur në TM me matës në TU, deri më 31.05.2017, si pasojë e ankimeve që abonent të ndryshëm që kanë bërë në gjykatë, Shoqëria “OSHEE” SHA ka dëmshpërblyer 23 raste për vlerën 45,907,419 lekë. Ky dëm ekonomik ka ardhur pasi, ERE me veprimet apo mosveprimet e saj, ka krijuar një situatë konfuze në tregun e shitjes së energjisë elektrike, duke dëmtuar në këtë mënyrë interesat e ligjshme të Shoqërisë “OSHEE” SHA dhe të Buxhetit të Shtetit, fakt i provuar me shkrësat si më poshtë vijon:

- Me shkresën nr. 508 prot., date 14.07.2015 të ERE-s drejtuar Administratorit të Shoqërisë OSHEE SHA me lëndë: Mbi ankimet e konsumatorëve të lidhur në TM për mos aplikimin e tarifave të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e lidhur në TM, sipas Vendimit nr. 148 datë 26.12.2014 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të Energjisë Elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015”.

- Me shkresën nr. 6092 prot., datë 26.05.2014 Shoqëria “OSHEE” SHA, i kërkon ERE interpretim se cilat janë referencat për përcaktimin e çmimit të abonentëve jo familjar, ku miratimi i pikës së lidhjes është TU/TM, apo ku është instaluar marrja nga TU/TM.

ERE me shkresën nr. 475/1prot., datë 24.07.2014 ka kthyer përgjigje duke u shprehur në mënyrë eksplicite se “...lidhur me sa mësipër kërkuar, ju bëjmë me dije se: tarifatat do të reflektojnë sasinë e energjisë në nivelin që maten, ashtu siç është përcaktuar dhe në dispozitat II.7.4 dhe III.3 “Kodi i matjes”.

Pra si u përshkrua më sipër, ERE në dy shkresa mban dy qëndrime të ndryshme. Gjithashtu, këto shkresa bien në kundërshtim me:

- a. Ligjin nr. 9072, date 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar (shfuqizuar në Prill 2015), neni 51 “Matja e energjisë elektrike të furnizuar”.

- b. Kodi i Matjes, miratuar me Vendimin nr. 101, date 26.08.2008, pikat i, ii, iii.

- c. Udhëzimin ERE “Mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”, i cili ka qenë në fuqi në momentin e aplikimit të disa klientëve për furnizim me energji elektrike, miratuar me vendim nr. 17, dt. 19.12.2001 të ERE, pika 1.2, 1.4, 4.4, 5.1, 7.2.

- d. Kontrata e furnizimit me energji elektrike për klientët jo familjar, miratuar me vendim ERE nr. 109 datë 21.10.2011, pikat 6.1, 6.2, 13.1, 13.2, 13.3.

Vlera 45,907,419 lekë përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “OSHEE” dhe Buxhetin e Shtetit, vlerë e cila nuk mund të dëmshpërblehet, fakt që ngarkon me përgjegjësi ERE.

6.1 Rekomandimi:

- Nga Shoqëria “OSHEE” SHA të prezantohet në organet drejtuese vlera 45,907,419 lekë, që ka të bëjë me dëmshpërblimin e abonentëve të ndryshëm, si pasojë e ankimeve që kanë bërë në gjykatë, nga zbatimi i vendimeve të ERE nr. 148, datë 26.12.2014 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tarifor për vitin 2015” dhe nr. 128, datë 29.07.2016 “Mbi tarifatat e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët e lidhur në TM me matës në TU për periudhën 01.07-31. 12.2016.

Brenda datës 30.06.2018

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, vënë në dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020 OSHEE SHA, ka sjellë përgjigje por informacioni bashkëlidhur por informacioni bashkëlidhur në lidhje me këtë rekomandim është i vitit 2018 dhe konkretisht shkresa 22934/1, datë 23.03.2018, dhe shkresa të vitit 2019, por ky informacion nuk është përditësuar me gjëndjen aktuale të tij, për rrjedhojë nuk përcaktohet shkalla aktuale e realizimit të rekomandimit. ***Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar***

7. Gjetje nga auditimi:

Operatorët e tregut me të cilat Shoqëria “OSHEE” SHA ka lidhur kontratë për blerjen energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin energjetik, nuk kanë respektuar kontratën e nënshkruar midis palëve, konkretisht përcaktimet e pikave të kontratave 1, 3, 4, 5 dhe 7, duke sjellë penalitete të pa llogaritura dhe pa mbajtura nga Shoqëria “OSHEE” SHA, për operatorët e tregut në një vlerë 27,501 euro, konkretisht kompanitë G në vlerën 3,351 euro, EFTAG në vlerën 19,419 euro dhe GSA SHPK në vlerën 4,731 euro: Vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “OSHEE” SHA dhe Buxhetin e Shtetit

7.1 Rekomandimi:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 27,501 euro, nga G në vlerën 3,351 euro EFTAG në vlerën 19,419 euro dhe GSA SHPK në vlerën 4,731 euro.

Brenda datës 30.06.2018

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, vënë në

dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020 OSHEE SHA, ka sjellë përgjigje por informacioni bashkëlidhur dhe nga dokumentet justifikuese bashkëlidhur konstatohet se sipas shpjegimit të OSHEE SHA referuar shkresave 22934/1, datë 23.03.2018 dhe nr.9048/1, datë 21.05.2018, sipas këtyre shkresave është arkëtuar vlera 4,731 Euro nga subjekti GSA SHPK, megjithatë ky informacion nuk është përditësuar me gjëndjen aktuale të tij, për rrjedhojë nuk përcaktohet shkalla aktuale e realizimit të plotë të këtij rekomandimi. **Rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht**

8. Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi u konstatua se Shoqërisë “OSHEE” SHA i është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 13,084,095 lekë, si pasojë e mos bërjes së plotë dhe në kohë të procedurave gjyqësore në Gjykatën e Lartë për shpërblim dëmi pasuror për L. N etj. Konkretisht:

- Shkalla e parë dhe Apeli: Pranuar pjesërisht kërkesë padia me vlerë 13,084,095 lekë shpërblim dëmi pasuror dhe jo pasuror, lidhur me vdekjen e të ndjerit K. N. Ndaj vendimeve të gjykatave OSHEE ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë me shkresën nr. 7322, datë 20.4.2016, por nuk ka kërkuar në objektin e saj dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga zyra e përmbarrimit, duke kundërshtuar në këtë mënyrë veprimet përmbarrimore bazuar në nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile. Nga ana tjetër nga OSHEE nuk administrohet asnjë dokument që vërteton se me datë 26.4.2016 sipas libër protokollit të OSHEE, rekursi është dorëzuar në protokollin e Gjykatës së Lartë. Për pasojë nga zyra e përmbarrimit me datë 29.4.2016 është ekzekutuar vendimi i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, duke i dhënë mundësi palës paditëse të ekzekutoj vendimin, duke i sjell Shoqërisë “OSHEE” dhe Buxhetit të Shtetit një dëm ekonomik në vlerën 13,084,095 lekë, çka ngarkon me përgjegjësi E Ame detyrë drejtore e drejtorisë juridike, e cila me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka realizuar mos përmbushje të rregullt të detyrës, duke dëmtuar interesat e ligjshme të Shoqërisë “OSHEE” SHA dhe Buxhetit të Shtetit në vlerën 13,084,095 lekë, nga mos kryerja plotësisht dhe në kohën e duhur veprimeve proceduriale .

8.1 Rekomandimi:

Nga Shoqëria “OSHEE” SHA të shqyrtohet vlera 13,084,095 lekë, vlerë e cila ka ardhur si pasojë e mos kryerjes plotësisht dhe në kohën e duhur e veprimeve proceduriale nga drejtoria juridike për shpërblim dëmi pasuror dhe jo pasuror për L.N etj. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës për dëmshpërblim.

Brenda datës 30.06.2018

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, vënë në dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020 OSHEE SHA, ka sjellë përgjigje por informacioni bashkëlidhur por nga dokumentet justifikuese bashkëlidhur konstatohet se sipas shpjegimit të OSHEE SHA referuar shkresave 22934/1, datë 23.03.2018 dhe nr.9048/1, datë 21.05.2018, sipas këtyre shkresave informacioni nuk është përditësuar me gjëndjen aktuale të rekomandimit, për rrjedhojë nuk përcaktohet shkalla aktuale e realizimit të tij. **Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar**

C. SHPENZIME JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETIT, EFIÇENCËS DHE EFEKTIVITETIT

Për shpenzimet të cilat kanë sjellë një efekt negativ financiar në të ardhurat e shoqërisë, duke sjellë një rëndim të kostove, pasi në realizimin e shpenzimeve që shoqëria duhet të kryejë nuk është zbatuar parimi i 3E-ve, Ekonicitetit, Efikasitetit dhe Efijçencë.

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi, janë ekzekutuar 288 çështje gjyqësore për zgjidhje të kontratës së punësimit (largimet nga puna), për të cilat shuma e kërkuar nga punonjësit nëpërmjet proceseve gjyqësore është në vlerën 188,060,525 lekë, vlerë e cila ka sjellë shoqërisë efekte negative financiare

1.1 Rekomandimi:

- Nga Shoqëria “OSHEE” SHA të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbarrimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, vënë në

dispozicion grupi të auditimit në datë 28.12.2020 OSHEE SHA, ka sjellë përgjigje por informacioni bashkëlidhur por nga dokumentet justifikuese bashkëlidhur konstatohet se sipas shpjegimit të OSHEE SHA referuar shkresave 22934/1, datë 23.03.2018 dhe nr.9048/1, datë 21.05.2018, sipas këtyre shkresave informacioni nuk është përditësuar me gjëndjen aktuale të rekomandimit, për rrjedhojë nuk përcaktohet shkalla aktuale e realizimit të tij. **Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar**

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës neni 63, kontratave individuale të punës, pika 6, i kërkojmë Administratorit të Shoqërisë, që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

I. “Zgjidhje të kontratës së punësimit” për:

1. **J S**, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit për periudhën 01/08/2015 dhe në vazhdim.

2. **E A**, me detyrë drejtore e drejtorisë juridike për periudhën 23/09/2013 dhe në vazhdim.

II. “Kalim në një detyrë të niveli apo klase më të ulët, që paguhet më pak për një periudhë deri në 6-muaj” deri në “Zgjidhje të kontratës së punësimit” për

3. **A F**, me detyrë Drejtor Kabineti, ne cilësinë e ish-drejtorit të Divizionit të Shitjes për periudhën 04/12/2014-11/10/2016.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Me observacionin nr.5842/37, datë 25.09.2020, OSHEE SHA ka sjellë përgjigje në lidhje me shkallën aktuale të realizimit të rekomandimit për periudhën objekt auditimi deri në datën 30.06.2020 për punonjësit e më sipër janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me OSHEE SHA. **Rekomandimi konsiderohet i zbatuar**

2.2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e organeve drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

I. Emërimi i këshillit mbikëqyrës, është kryer në referencë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 155, pika 2 e cila përcakton midis të tjerave se afati i emërimit është ai i përcaktuar në statut, por që nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Numri i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës është 6, në përputhje me kërkesat e pikës 1, shkronja “b” të VKM nr.570, datë 3.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”.

Për mungesë të dhënash, grupi i auditimit nuk e ka të mundur të verifikojë në se ndonjë nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës është pjesëmarrës në më shumë se 2 këshilla mbikëqyrës, sipas kërkesave të pikës 3 të VKM nr.570, datë 3.10.2018.

Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009, kreu III, pika 1 këshilli mbikëqyrës *nuk e ka zhvilluar veprimtarinë e tij nëpërmjet mbledhjeve të anëtarëve mbi bazën e një programi vjetor të miratuar për aktivitetin e drejtorisë dhe të mbledhjeve të tjera të posaçme të kërkuara nga vetë këshilli apo drejtoria*, kjo deri më 8.10.2018.

Këshilli mbikëqyrës ka zbatuar kërkesat e VKM nr.570, datë 3.10.2018 duke u mbledhur jo më pak se katër herë në vit, si dhe ka raportuar vazhdimisht për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë, institucionit administrativ të linjës dhe përfaqësuesit të pronarit, për pronën shtetërore, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Gjatë veprimtarisë së tij në periudhën e auditimit, Këshilli mbikëqyrës ka marrë 141 vendime, nga të cilët 55 qarkulluese dhe vendimet e tjera janë marrë në 15 mbledhje. Këto vendime janë marrë në bazë të relacioneve përkatëse të përgatitura dhe të dërguara nga OSHEE SHA dhe që janë të lidhura me aktivitetin e shoqërisë, si për procedurat e prokurimit, shtyrje afat pagese për detyrimet e prapambetura të klientëve familjarë dhe jo familjarë, shpenzime shpronësimi, për rialokim fondesh, krijim sektorësh në strukturën organizative, miratim raporti të drejtorisë së auditimit, dhënie shpërblimi të veçantë mbi pagën në fund të vitit për punonjësit, mbulim shpenzimesh për punonjës të aksidentuar, hapje limit overdraft, për dhënien e granti, miratimin e raportit për nxjerrjet jashtë përdorimit, miratimin e projekt-programit të zhvillimit ekonomik, shtese fuqie punëtore, miratim lidhje marrëveshje overdrafti, miratimin e pasqyrave financiare etj. Vendim-marrja e mësipërme është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 154, pikat 1, shkronjat “b” deri në “g” dhe 2 të këtij neni.

1. Titulli i Gjetjes Mangësi funksionimi lidhur me numrin e mbledhjeve gjatë vitit, mungesë kontrolli i librave kontabël dhe mos-publikimi i raporteve financiare.

Situata: - Këshilli mbikëqyrës nuk ka zbatuar kërkesat e nenit 18 të Statutit në vitin 2018 dhe 2019 për t’u mbledhur të paktën gjashtë herë në vit, pika 18.2:

Këshilli mbikëqyrës do të mblidhet të paktën gjashtë herë në vit

- Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 154, pika 1, germa “dh”, këshilli mbikëqyrës rezulton se nuk ka shqyrtuar dhe kontrolluar librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë:

Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi: dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

- Këshilli mbikëqyrës nuk ka siguruar publikimin e raporteve financiare dhe të audituesve të pavarur që nga viti 2016, në kundërshtim me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 23, pika 1:

“Organi i drejtimet ekzekutiv të njësisë ekonomike dhe organi mbikëqyrës, në varësi të kompetencave që u njeh ligji, janë përgjegjës solidarë për të siguruar që pasqyrat financiare vjetore dhe raporti i ecurisë së veprimtarisë/raporti i konsoliduar i ecurisë së veprimtarisë të njësisë ekonomike, të hartohen dhe të publikohen në përputhje me kërkesat e këtij ligji, aktet në zbatim të tij dhe standardet e miratuara të kontabilitetit”

- Kriteri:** - Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 154, pika 1, germa “dh”;
- Ligji nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 23, pika 1;
- Statuti i shoqërisë, neni 18.
- Ndikimi/Efekti:** Funksionim me mangësi dhe mungesë transparence.
- Shkaku:** Mungesë vëmendjeje e këshillit mbikëqyrës në zbatimin tërësor të detyrave të tij.
- Rëndësia:** I mesëm.
- Rekomandime:** Këshilli mbikëqyrës të ushtrojë plotësisht detyrat e tij, duke u mbledhur të paktën 6 herë në vit, si dhe të përfshijë kontrollin mbi librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë, dhe publikimin e raporteve financiare dhe të audituesve të pavarur.

2. Titulli i Gjetjes Marrja e vendimeve qarkulluese, pa u diskutuar dhe votuar, për çështje me rëndësi jetike për ecurinë e OSHE SHA

Situata: Gjatë veprimtarisë së tij në periudhë gjashtëmujori i dytë 2017 – 30.06.2020, këshilli mbikëqyrës ka marrë 55 vendime qarkulluese ose 39 % e nivelit të vendim-marrjes, për çështje me rëndësi jetike për veprimtarinë e OSHEE, si ato për lirin dhe emërimin e administratorit, procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit të materialeve të papërdorshme, rialokim shpenzimesh (viti 2017), hapjen e disa limiteve bankare, amendim Letër Kredie (viti 2018), shtesë overdrafti, dhënie kredie bankare, lidhje marrëveshje për overdarfte, krijim i njësisë organizative të reja (2019) etj., pa u diskutuar, shqyrtuar, analizuar dhe votuar në mbledhje nga ana e këshillit mbikëqyrës. Një veprimtari e tillë është në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005, “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore” i ndryshuar, pika 8 e cila përcakton se këshilli mbikëqyrës duhet të mbledhet, si dhe Udhëzimi nr. 318, datë 8.4.2009, i ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore” kreu i III, pika 1 dhe 5 që përcaktojnë se zhvillimi i mbledhjeve të këshillit mbikëqyrës dokumentohet në librin e protokollit nga sekretari i këshillit mbikëqyrës dhe mbi bazën e protokollit të mbajtur zbardhen vendimet e këshillit mbikëqyrës, kjo për veprimtarinë deri më 8.10.2018. Për periudhën tetor 2018 – 30.06.2020 marrja e vendimeve qarkulluese është në kundërshtim me VKM nr.570, datë 3.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”, pika 9 e cila përcakton:

“Këshilli mbikëqyrës mbledhet jo më pak se katër herë në vit...”

pra e zhvillon veprimtarinë e tij nëpërmjet mbledhjeve dhe jo me vendime qarkulluese pa u mbledhur.

Për më tepër, referuar Statutit të shoqërisë, në nenin 18 është përcaktuar procesi vendim-marrës i këshillit mbikëqyrës, me vendin e zhvillimit të mbledhjeve, mënyrën e thirrjes me çështjet kryesore të rendit të ditës, si dhe procesverbalet e mbledhjeve.

Gjithashtu, marrja e vendimeve qarkulluese e këshillit mbikëqyrës pa u mbledhur, është në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr. 8480, datë

27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, i cili përcakton:

“Organi kolegjial merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes,…”

si dhe vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votës (neni 14, pika 1).

- Kriteri:** - Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 8;
- VKMnr.570, datë 3.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”, pika 9.
- Ndikimi/Efekti:** Mangësi me efekt në ecurinë e konsoliduar të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të OSHEE SHA.
- Shkaku:** Mungesë vëmendjeje të shtuar nga këshilli mbikëqyrës lidhur me çështje ekonomike dhe financiare të një rëndësie të veçantë për ecurinë e OSHEE SHA.
- Rëndësia:** I lartë.
- Rekomandime:** Këshilli mbikëqyrës të shqyrtojë, analizojë me vëmendje, të debatojë dhe të miratojë me votim në mbledhje çështjet që vihen në rendin e ditës dhe të tjera për diskutim, me qëllim që të konsolidohet ecuria e shoqërisë.

3. Titulli i Gjetjes Këshilli mbikëqyrës ka marrë vendime jo në përputhje me legjislacionin shqiptar lidhur me shpronësimin, me shpërblimin e veçantë për një komision, të parakohshëm dhe për dhënie me qira.

Situata: - Me vendimin nr.33 datë 14.07.2017 është miratuar shpenzimi në shumën 28,466,674 lekë për vlerën e kompensimit të pronarit që do të shpronësohet për realizimin e projektit “Ndërtimi i nënstacionit të TEC Kombinat 110/120 kV, Tiranë. Sipas relacionit përkatës, rezulton se kemi të bëjmë me dy pasuri me sipërfaqe përkatësisht 3200 m² dhe 800 m² e llojit tokë bujqësore “arë”. Fillimisht OSHEE ka për efekt vlerësimi ka zbatuar VKM nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të personave të tretë”, i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës. Referuar ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, komisioni i posaçëm i ngritur për këtë qëllim me urdhër ministri, ka vendosur masën e shpërblimit 1,792,000 lekë, për të cilat është nënshkruar dhe akt-marrëveshja për procedurën e shpronësimit. Me njoftimin e pronarëve, ato nuk kanë pranuar kushtet e ofruara në lidhje me vlerën e shpronësimit, duke vënë në dijeni dhe Bankën Botërore për këtë qëllim, si financuese e projektit. Sipas relacionit BB ka kushtëzuar financimin e këtij komponenti me implementimin e një lloji vlerësimi për kompensim, i cili del jashtë kontestit të ligjit shqiptar për shpronësimet. BB ka hartuar një raport vlerësimi, mbi bazën e të cilit OSHEE SHA kërkon miratimin e vlerës së kompensimit prej 28,466,674 lekë, vlerë të cilën Këshilli mbikëqyrës e ka miratuar, dhe më pas dhe Ministri i Energjisë dhe infrastrukturës në cilësinë e pronarit. *Në këtë mënyrë Këshilli mbikëqyrës ka marrë një vendim të pabazuar në legjislacionin shqiptar, për shpenzime afër 16 herë më të larta, ose me kosto më të lartë prej 26,674,674 lekë.* Në po të njëjtën datë, për të njëjtën çështje Këshilli Mbikëqyrës ka marrë vendimin nr.34, datë 14.07.2017 në të cilin është miratuar shpenzimi në vlerën 1,152,530.7 lekë për kryerjen e shpronësimit të tokës për ndërtimin e nënstacionit 110/20 kV GjI i Lalëzit, duke zbatuar

legjislacionin shqiptar.

- Me vendimin qarkullues nr.38, datë 20.12.2018, këshilli mbikëqyrës ka miratuar një shpërblim të veçantë në fund të vitit për disa anëtarë të komisionit disiplinor, vetëm për anëtarët që përfaqësojnë MIE (pika 1 e vendimit) me 40,000 lekë, sipas propozimit të Kryetarit të Komisionit Disiplinor të NJOS, paraqitur me shkresë në të njëjtën datë. Këshilli mbikëqyrës ka përdorur një referencë ligjore të pa detajuar në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; ligjin nr.43/2015, datë 30.04.2015 ”Për sektorin e energjisë elektrike”; VKM nr.763, datë 20.12.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 1086, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e task-forcës për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike”, Urdhrit nr.261, datë 06.11.2015 për përbërjen e komisionit të vlerësimit disiplinor”, në asnjërin akt ligjor nuk përcaktohet krijimi dhe pagesa e një komisioni të tillë, për më tepër në mënyrë të veçantë dhe akordimi i një shpërblimi të veçantë. Në këtë mënyrë shpërblimi në fund të vitit 2018 për: A D, E S dhe B L, nga 40,000 lekë secili, gjithsej 120,000 lekë i cili përbën përfitim të paligjshëm.

- Vendimi qarkullues nr.1, datë 15.01.2019, i bazuar në propozimin e dërguar nga administratori datë 14.01.2019, është marrë përpara se të dalë VKM përkatës dhe përpara se të hyjë në fuqi. VKM nr. 18, datë 16.01.2019 “Për disa ndryshime në VKM nr.1086, datë 14.12.2013 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e task-forcës për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike”, ka përcaktuar në pikën 1: “Paragrafi i fundit i pikës 3 dhe pika 5/1 e vendimit nr.1086, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shfuqizohen”, i cili është botuar në fletoren zyrtare nr.4, datë 18.01.2019.

- Vendimi nr. 15, datë 05.06.2019 për miratimin e fillimit të procedurave për dhënin me qira të ambientit me sipërfaqe 30 m², me destinacion njësi shërbimi lokal me adresë Lagja Kushtrimi, zyrat e Drejtorisë Rajonale OSHEE Vlorë, bazuar në relacionin përkatës për një periudhë 5 vjeçare janë në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore“ të ndryshuar, kreu i I, pika 5/a e cila përcakton:

“dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m², të cilat jepen me afat deri në 1 vit”.

Kriteri:

- Ligji nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”

- Ligji nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”;

- VKM nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të personave të tretë”;

- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore“ të ndryshuar, kreu i I, pika 5/a.

Ndikimi/Efekti:

Rritje e kostos së shpronësimit, rritje të shpenzimeve nga akordimi përfitimeve të paligjshme, si dhe deformim të vendim-marrjes.

Shkaku:

Mangësi të njohjes së kompetencave dhe të detyrave të veta nga Këshilli mbikëqyrës.

Rëndësia:

I lartë.

Rekomandime: Këshilli mbikëqyrës t'i kushtojë vëmendje të veçantë referencës ligjore të raporteve dhe relacioneve në shqyrtim, duke kërkuar dhe asistencën e juristëve të shoqërisë për vendim-marrje të veçanta; të revokojë vendimin qarkullues nr.38, datë 20.12.2018, si dhe të rivendosë në afate vendimin nr. 15, datë 05.06.2019.

Si konkluzion:

Këshilli Mbikëqyrës është emëruar në përputhje me kriteret ligjore përkatëse dhe ka ushtruar aktivitetin e tij në përputhje me kuadrin rregullator përkatës, me përjashtimet e mëposhme:

- Këshilli mbikëqyrës nuk ka zbatuar kërkesat e nenit 18, pika 2 të Statutit për t'u mbledhur të paktën gjashtë herë në vit në 2018 dhe 2019;

- Gjatë veprimtarisë së tij në periudhën gjashtëmujori i dytë 2017 - 30.06.2020, këshilli mbikëqyrës ka marrë 55 vendime qarkulluese ose 39 % e nivelit të vendim-marrjes, për çështje me rëndësi jetike për veprimtarinë e OSHE, jo në përputhje të plotë me kuadrin rregullator për funksionimin e tij;

- Me vendimin nr.33 datë 14.07.2017 është miratuar shpenzimi në shumën 28,466,674 lekë për vlerën e kompensimit të pronarit që do të shpronësohet për realizimin e projektit "Ndërtimi i nënstacionit të TEC Kombinat 110/120 kV, Tiranë", pa u bazuar në legjislacionin shqiptar përkatës, duke sjellë për pasojë shpenzime afër 16 herë më të larta për këtë qëllim;

- Me vendimin qarkullues nr.38, datë 20.12.2018, këshilli mbikëqyrës ka miratuar një shpërblim për tre anëtarë të komisionit të vlerësimit disiplinor në shumën 120,000 lekë në mënyrë të paligjshme;

- Vendimi qarkullues nr.1, datë 15.01.2019, është marrë përpara se të dalë VKM nr. 18, datë 16.01.2019 dhe të hyjë në fuqi më datë 18.01.2019;

- Vendimi nr. 15, datë 05.06.2019 për miratimin e fillimit të procedurave për dhënin me qira të ambientit me sipërfaqe 30 m², me destinacion njësi shërbimi lokal me adresë Lagja Kushtrimi, zyrat e Drejtorisë Rajonale OSHEE Vlorë për një afat 5-vjeçar, është në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014, pasi afati i dhënies me qira është një vit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Këshilli Mbikëqyrës.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projektin raportin me shkresën nr.12149/3 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

1. Lidhur me gjetjen "Mbarim afati i anëtarit të këshillit mbikëqyrës", Kryetari i Këshillit mbikëqyrës z. I B ka argumentuar se Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me Urdhrin nr.355, datë 04.10.2019 "Për emërimin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës" ka riemëruar z. I B anëtar të këtij këshilli, urdhër i depozituar në QKB;

2. Lidhur me numrin e mbledhjeve dhe vendimet qarkulluese, në observacionin subjekti ka paraqitur një informacion dhe bazën ligjore në të cilën është bazuar vendim-marrja e këshillit mbikëqyrës, duke theksuar midis të tjerave se, vendimet qarkulluese janë marrë në referencë me nenin 18.8 të statutit për vendimet qarkulluese i cili nuk përcakton përqindje të vendimeve që mund të merren me këtë formë. Po ashtu, dhe numri i mbledhjeve nuk është në përputhje me statutin pasi ka pasur për referencë VKM e shfuqizuar nr.642, datë 11.10.2005;

3. Lidhur me mungesën e kontrollit të librave kontabël dhe mospublikimin e raporteve financiare, në observacionin pretendohet nëpërmjet përkrahimit të ligjit nr.9901 dhe ligjit nr.25/2018, duke bashkëlidhur vendimet përkatëse;

4. Lidhur me vendimin nr.33, datë 14.07.2017 për shpronësimin, bëhet një përkrahim i tij, në vijim vihet në dukje se është miratuar dhe nga Asambleja e shoqërisë, dhe se këshilli mbikëqyrës ka miratuar propozimin e administratorit.

Për vendimin nr.38, datë 20.12.2018 për shpërblimin e anëtarëve të komisionit disiplinor, cilësohet referenca në ligjin nr. 9901, datë 10.04.2018 dhe ligjin nr.10405, datë 24.03.2011, si dhe VKM nr.763, datë 20.12.2017 i ndryshuar, më pas një përkrahim i të veprimtarisë së këtij komisioni.

Gjithashtu, cilësohet se dhe vendimi nr. 15, datë 05.06.2019 është marrë në përputhje me

parashikimet e VKM nr. 54, datë 5.2.2014;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e subjektit për Projektraportin dhe arrin në përfundimet e mëposhme:

1. Pasi verifikoi në QKB riemërimin e z. I B anëtar të Këshillit Mbikëqyrës, pasi observacioni nuk kishte bashkëlidhur kopje të këtij urdhri, si dhe për faktin se as gjatë auditimit në subjekt dhe as në observacionit për Akt-konstatimin përkatës, nuk na është vënë në dispozicion ky dokument, grupi i auditimit e merr në konsideratë dhe gjen pasqyrim në trajtimin më lart të kësaj çështjeje;

2. Lidhur me referencën në nenin 18.8 të statutit për vendimet qarkulluese, theksojmë se statuti e lejon si mundësi, por jo të konsiderohet si formë e vazhdueshme e veprimtarisë së këshillit mbikëqyrës. Veç kësaj duhet të shtojmë se këshilli mbikëqyrës nuk ka përgatitur udhëzim se si duhet të veprohet në këto raste, kërkesë kjo e statutit, si dhe në çdo rast është në kundërshtim me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 8;

Lidhur me mosplotësimin e kërkesës së statutit për t’u mbledhur jo më pak se 6 herë në vit, nuk justifikohet me fazën e rishikimit të statutit;

3. Miratimi i pasqyrave financiare nuk do të thotë kontroll i librave kontabël dhe publikim i pasqyrave financiare;

4. Vendimi këshillit mbikëqyrës nr.33, datë 14.07.2017 për shpronësimin e një sipërfaqeje toke për nën stacionin në Kombinat, i propozuar nga administratori dhe i miratuar nga asambleja, nuk justifikon miratimin e bërë nga Këshilli mbikëqyrës jo në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Shpërblimi i anëtarëve të komisionit disiplinor, me vendimin e këshillit mbikëqyrës nr.38, datë 20.12.2018, është marrë në referencë të gabuar me ligjin nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, pasi këshilli mbikëqyrës vendos shpërblimin e punës, pra të punonjësve dhe jo të komisioneve, të cilët shpërblehen për këtë veprimtari shtesë, si dhe kjo është një strukturë jashtë kompetencës vendim-marrëse të saj.

Dhënia me qira e sipërfaqes 30 m², me destinacion njësi shërbimi lokal me adresë Lagja Kushtrimi, zyrat e Drejtorisë Rajonale OSHEE Vlorë për një afat 5-vjeçar me vendimin nr.15, datë 05.06.2019, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014, pasi afati i dhënies me qira është një vit.

Bazuar në sa më sipër grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin në lidhje me mangësitë e evidentuara në veprimtarinë e këshillit mbikëqyrës, dhe për këtë arsye nuk e merr në konsideratë.

II. Gjatë periudhës së auditimit 01.07.2017 deri më 30.06.2020, administrator i shoqërisë është emëruar z. A Ç, me vendimin qarkullues të këshillit mbikëqyrës nr.27, datë 28.06.2017 i cili pas plotësimit të afatit 3 vjeçar është riemëruar me vendimin qarkullues të këshillit mbikëqyrës nr. 12, datë 19.06.2020. Emërimet e kryera nga këshilli mbikëqyrës janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 154, pika 1 germa “f”, si dhe të Statutit të shoqërisë, neni 16, pika 16.3, germa “j”.

Administratori i shoqërisë e ka zhvilluar veprimtarinë e tij në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 158, pika 3, me të drejtën dhe detyrimin të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë; kujdesjen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; kryerjen e regjistrimit e publikimeve të detyrueshme të të dhënave të shoqërisë etj., si dhe në bazë të statutit të shoqërisë, neni 20 - Kompetencat e administratorit, lidhur me administrimin e shoqërisë duke zbatuar politikat e saj, përfaqësimin me palët e treta, përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raportin e performancës, krijimin e një sistemi monitorimi, raportimin në këshillin mbikëqyrës në lidhje me zbatimin e politikave të biznesit etj.

Në veprimtarinë e tij Administratori ka nxjerrë një numër të konsiderueshëm të urdhrave të ndryshëm në procedurat e prokurimit si: për ngritjen e komisioneve për përcaktimin e fondit limit dhe të specifikimeve, fillimin e procedurave të prokurimit, njësitë e prokurimit, komisionet e vlerësimit të ofertave, miratimin e raporteve në procedurat e prokurimit, krijim komisionit të blerjes

me vlerë të vogël, caktimin e administratorit të kontratave të shërbimit përbarimor, për caktim kolaudatori, etj.; urdhra të brendshëm për ngritjen e grupeve të posaçme të punës si për ndjekjen e procesit të arbitrazhit me EFT, për kryerjen e veprimeve të ndryshme, procedurat e përzgjedhjes dhe të emërimit të drejtuesve të Drejtorive Rajonale, për dorëzim objekti të marrë me qira, autorizime të ndryshme për çështje të prokurimeve, miratim i raporteve të ndryshme, për miratimin e anëtarëve dhe sekretariatit të këshillit teknik, ngritje komision inventarizimi, ngritje grupe pune për çështje të ndryshme, për ngritjen e grupit të punës lidhur me aplikimin e tarifave të qirasë ndaj klientëve që shfrytëzojnë hapësirat e nënstacioneve dhe përcaktimin e metodologjisë mbi kostot e mirëmbajtjes dhe operimit ndaj përdoruesve të rrjetit, kontrolle në agjenci të ndryshme, ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik, trajtimit të ankesave të qytetarëve, për administrimin e riskut në OSHEE, zbatimin e masave të rekomanduara nga auditimi i brendshëm, zbatimin e masave anticovid etj.

Grupit të auditimit të KLSH i janë vënë në dispozicion 145 dokumente të nxjerra nga administratori që kanë të bëjnë me urdhra të brendshëm, autorizime dhe për çështje të tjera, krahas dokumentacionit të shqyrtuar në procedurat e prokurimit dhe në relacionet dhe raportet e përgatitura për këshillin mbikëqyrës.

Ngritja e grupeve të punës për çështje të ndryshme është shoqëruara dhe me raportet përkatëse të veprimtarisë së tyre, si dhe relacione për zbatimin e urdhrave dhe të vendimeve të këshillit mbikëqyrës.

Gjatë auditimit të veprimtarisë së Administratorit një pjesë e urdhrave të brendshëm, kryesisht në periudhën gjashtëmujori i dytë 2017-2019, nuk kanë të vendosur numrin dhe datën përkatëse, pavarësisht se përmbajnë numrin e protokollit dhe datën e protokollimit.

4. Titulli i Gjetjes Administratori i shoqërisë ka caktuar vetëm një zyrtar për shqyrtimin e ankimeve për procedurat e prokurimit kundër vendimeve të autoritetit kontraktor.

Situata: Gjatë shqyrtimit të ankimeve për procedurat e prokurimit kundër vendimeve të autoritetit kontraktor është caktuar vetëm një zyrtar. Një veprim i tillë nuk është në përputhje të plotë me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 78, pika 6, germa “a” e cila përcakton:

“Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përgjatimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm i cili duhet të jetë ekspert fushë”

Kriteri: - VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 78, pika 6, germa “a”.

Ndikimi/Efekti: Risk për shqyrtimin me mangësi të ankimeve për prokurimet ndaj vendimeve të autoritetit kontraktor.

Shkaku: Mungesë vëmendjeje nga ana e administratorit për këtë çështje.

Rëndësia: I ulët

Rekomandime: Administratori i shoqërisë të marrë masa për caktimin e komisionit të shqyrtimit të ankimeve ndaj autoritetit kontraktor të përbërë nga tre persona, ku të paktën njëri të jetë ekspert i fushës.

Si konkluzion:

- Në emërimin dhe riemërimin e administratorit janë zbatuar kriteret ligjore për këtë qëllim. Gjithashtu, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij administratori ka nxjerrë aktet përkatëse në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator.

- Në shqyrtimin e ankimeve për procedurat e prokurimit kundër vendimeve të autoritetit kontraktor është caktuar vetëm një zyrtar, gjë që nuk është në përputhje të plotë me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 78, pika 6, germa “a”.

2.3. Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomik-financiare në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet e prore, si dhe realizimi i tij

Nga auditimi u konstatua se:

Për vitin 2017. Programi ekonomik për vitin 2017 është hartuar nga shoqëria dhe është përcjellë për miratim në Këshillin Mbikëqyrës me nr. 30118 prot., datë 14.12.2016. Pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës, me vendimin nr. 58 datë 19.12.2016, është miratuar nga MEI, Drejtoria e Financës me shkresën nr. 7470/7 prot., datë 03.03.2017, pra 2 muaj nga fillimi i aktivitetit, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, kreu III, pika 2, ku nga ana e drejtorisë së shoqërisë praktika e plotë e projekt-programit përcillet brenda datës 01 nëntor të çdo viti për miratim në Këshillin Mbikëqyrës dhe deri më 30 janar të çdo viti për miratim përfundimtar në MEI. Programi ekonomik është dorëzuar 43 ditë me vonesë nga drejtoria në Këshillin Mbikëqyrës dhe është miratuar 30 ditë me vonesë nga MEI.

Për vitin 2018. Programi ekonomik për vitin 2018 është hartuar nga shoqëria dhe është përcjellë për miratim në Këshillin Mbikëqyrës me nr. 28118 prot., datë 27.12.2017. Pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës, me vendimin nr. 67 datë 27.12.2017, është miratuar nga MEI, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar me shkresën nr. 3664/4 datë 28.02.2018 në kundërshtim me Udhëzimin e Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, kreu III, pika 2, ku nga ana e drejtorisë së shoqërisë praktika e plotë e projekt-programit përcillet brenda datës 01 nëntor të çdo viti për miratim në Këshillin Mbikëqyrës dhe deri më 30 janar të çdo viti për miratim përfundimtar në MEI. Programi ekonomik është dorëzuar 57 ditë me vonesë nga drejtoria në Këshillin Mbikëqyrës dhe është miratuar 27 ditë me vonesë nga MEI.

Për vitin 2019. Programi ekonomik për vitin 2019 është hartuar nga shoqëria dhe është përcjellë për miratim në Këshillin Mbikëqyrës me nr. 24052 prot., datë 27.12.2018. Pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës, me vendimin nr. 40 datë 28.12.2018, është miratuar nga MEI me shkresën nr. 9921/9 prot., datë 31.12.2018 në kundërshtim me Udhëzimin e Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, kreu III, pika 2, ku nga ana e drejtorisë së shoqërisë praktika e plotë e projekt-programit përcillet brenda datës 01 nëntorit të çdo viti për miratim në Këshillin Mbikëqyrës dhe deri më 30 janar të çdo viti për miratim përfundimtar në MEI. Programi ekonomik është dorëzuar 58 ditë me vonesë nga drejtoria në Këshillin Mbikëqyrës dhe është miratuar në kohë nga MEI.

Për vitin 2020. Programi ekonomik për vitin 2020 është hartuar nga shoqëria dhe është përcjellë për miratim në Këshillin Mbikëqyrës me nr. 25969 prot., datë 27.12.2019. Pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës, me vendimin nr. 01 datë 06.01.2020, është miratuar nga MEI, Drejtoria e Financës me shkresën nr. 660/4 prot., datë 31.01.2020, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, kreu III, pika 2, ku nga ana e drejtorisë së shoqërisë praktika e plotë e projekt-programit përcillet brenda datës 01 nëntor të çdo viti për miratim në Këshillin Mbikëqyrës dhe deri më 30 janar të çdo viti për miratim përfundimtar në MEI. Programi ekonomik është dorëzuar 57 ditë me vonesë nga drejtoria në Këshillin Mbikëqyrës dhe është miratuar në kohë nga MEI.

Titulli i gjetjes: Raportim i vonuar i programit ekonomik

Situata: Programi ekonomik për vitet 2017-2020 hartohet me vonesë nga

Departamenti Ekonomik si pasojë e vonesave të krijuara nga çdo Drejtori dhe Divizion dhe miratohet me vonesë nga MEI.

Kriteri: Situata është në kundërshtim me Udhëzimin e Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, kreu III, pika 2, ku nga ana e drejtorisë së shoqërisë praktika e plotë e projekt-programit përcillet brenda datës 01 nëntor të çdo viti për miratim në Këshillin Mbikëqyrës dhe deri më 30 janar të çdo viti për miratim përfundimtar në MEI

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Departamenti Ekonomik të marrë masa për bashkërendimin e punës në kohë reale me të gjithë departamentet dhe divizionet e tjerë në mënyrë që të bëhet i mundur hartimi dhe raportimi i programit ekonomik sipas afateve ligjore.

-Sipas programit ekonomik nr. 25969 prot., datë 27.12.2019 janë arkëtuar 101% të vlerës së faturuar (jo numrit të faturave) në këtë vlerë ka dhe fatura të viteve të mëparshëm Aktmarrëveshjet etj., dhe provizionet për llogaritë e arkëtueshme sipas programit faqe 53 janë 1,9 miliard lekë.

Sipas bilancit llogaritë e arkëtueshme janë 26,862,946,000 lekë.

Në bilanc llogaritë e arkëtueshme jepen me vlerën neto të realizueshme pasi aplikohet zbritja nga provizioni, jepen sqarime në pasqyrat financiare se si është aplikuar metoda e provizionimit të llogarive të arkëtueshme dhe cilat llogari janë provizionuar. Ndërkohë në programin ekonomik llogaritë e arkëtueshme jepen me vlerën fillestare. Metoda e provizionimit të llogarive të arkëtueshme është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 39 datë 20.07.2017 sipas rekomandimeve të audituesit ligjor “BTA” SHPK në “Raportin e zhvlerësimit të kërkesave tregtare për arkëtim” të shoqërisë OSHEE SHA për vitin 2016.

Në metodën e paraqitur në raportin e audituesit ligjor sipas **Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 9 Instrumentet Financiar është kryer zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme. Ky standard citon**

Matja e humbjeve të parashikuara të kredisë

5.5.17 Një njësi ekonomike duhet të masë humbjen e parashikuar të kredisë të një instrumenti financiar në një mënyrë të tillë e cila reflekton:

(a) një shumë të paanshme dhe të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një gamë e rezultateve të mundshme;

(b) vlerën në kohë të parasë; dhe

(c) informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur i cili është i disponueshëm pa ndonjë kosto ose përpjekje të pa arsyeshme në datën e raportimit për ngjarjet e shkuara, situatën aktuale dhe parashikimet për kushtet ekonomike në të ardhmen.

5.5.19 Maksimumi i periudhës së marrë në konsideratë kur bëhet matja e humbjes së parashikuar të kredisë është maksimumi i periudhës kontraktuale (përfshi mundësinë e zgjatjes) gjatë të cilës njësisia ekonomike është e ekspozuar kundrejt rrezikut të kredisë dhe jo më gjatë, edhe pse një periudhë më e gjatë mund të jetë në përputhje me praktikën e biznesit

Në raportin e paraqitur nga audituesi ligjor është Gtraguuar nga pika 5.5.17 C dhe 5.5.19 për maksimumin e periudhës kontraktuale.

Në metodologjinë e paraqitur nga “BTA” SHPK është Gtraguuar nga të dhënat statistikore të kërkesave për arkëtim të shoqërisë meqenëse informacioni nuk mund të merrej pa kosto apo mundim të tepërt sipas sqarimeve të dhëna në pikën 5.6 faqe 15 Çështje të tjera të këtij raporti. Raporti paraqet metodologjinë e zhvlerësimit të llogarive të arkëtueshme sipas standardit të raportimit SNRF 9. Shoqëria OSHEE nuk duhet të marrë parasysh veç metodologjinë e standardit por edhe ligjet kombëtare bashkë me ligjet e faljes së detyrimeve të cilat janë të parat që duhen reflektuar në pasqyrat financiare dhe më pas në programin ekonomik.

Gjithashtu Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët, Kontratat me klientët citon *Paragrafi 113 Një njësi ekonomike duhet të japë informacion*

shpjegues për periudhën e raportimit për të gjitha shumat në vijim, me përjashtim të rastit kur këto shuma janë paraqitur veçmas në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse në përputhje me Standardet e tjera: (b) çdo humbje nga zhvlerësimi të njohur (në përputhje me SNRF 9) nga çdo llogari e arkëtueshme ose aktive kontrate që vijnë nga kontratat e njësisë ekonomike me klientët, për të cilat njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues veçmas nga humbjet nga zhvlerësimi i kontratave të tjera.

Ky informacion nuk detajohet.

Raporti i shoqërisë BTA Shpk është për vitin 2016, nuk janë paraqitur raporte të tjera apo mënyrën e ndjekur nga vetë OSHEE për zhvlerësimin e Llogarive të arkëtueshme në vitet 2017,2018,2019 e cila është dhe periudha objekt auditimi

Titulli i gjetjes: Pasaktësi në zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme

Situata: Është kryer zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme të shoqërisë sipas metodologjisë së re të zhvlerësimit të kërkesave tregtare për arkëtim të raportuar nga audituesi ligjor BTA Shpk në raportin e miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 39 datë 20.07.2017, ku n, ku në të cilin audituesi ligjorë shprehet se “nuk mbaj përgjegjësi për ankimime nga pala të treta etj.” jep vetëm opinionin e tij.

Kriteri: Veprimi është në kundërshtim me Ligjin Nr. 43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike” Neni 80 Kontrata e furnizimit me energji elektrike, Neni 82 Të drejtat e furnizuesit, përveç të drejtave të përcaktuara në kontratë, sipas nenit 80, të këtij ligji, Neni 84 dhe Neni 92, Masat e ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve të papaguara

Për të siguruar ekzekutimin e detyrimit të papaguar furnizuesi, në përputhje me parashikimet e kontratës, merr masat e mëposhme:

a) fillon procedurën e ndërprerjes së energjisë elektrike;

b) fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, duke kërkuar lëshimin e urdhrat të ekzekutimit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 8662, datë 18.9.2000, “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, të ndryshuar;

c) vendos barrën hipotekore mbi pasurinë e paluajtshme që furnizohet me energji elektrike, në rast se detyrimi i papaguar, që rrjedh nga një kontratë furnizimi energjie elektrike, është mbi 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për klientin jo familjar.

Në kundërshtim me **Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 9 Instrumentet Financiar. Matja e humbjeve të parashikuara të kredisë.**

5.5.17 Një njësi ekonomike duhet të masë humbjen e parashikuar të kredisë të një instrumenti financiar në një mënyrë të tillë e cila reflekton:

(c) informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur i cili është i disponueshëm pa ndonjë kosto ose përpjekje të pa arsyeshme në datën e raportimit për ngjarjet e shkuara, situatën aktuale dhe parashikimet për kushtet ekonomike në të ardhmen.

5.5.19 Maksimumi i periudhës së marrë në konsideratë kur bëhet matja e humbjes së parashikuar të kredisë është maksimumi i periudhës kontraktuale (përfshi mundësinë e zgjatjes) gjatë të cilës njësia ekonomike është e ekspozuar kundrejt rrezikut të kredisë dhe jo më gjatë, edhe pse një periudhë më e gjatë mund të jetë në përputhje me praktikën e biznesit.

Situata është në kundërshtim me **Standardin Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët**, Kontratat me klientët *Paragrafi 113 Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për periudhën e raportimit për të gjitha shumat në vijim, me përjashtim të rastit kur këto shuma janë paraqitur veçmas në pasqyrën e të*

ardhurave përmbledhëse në përputhje me Standardet e tjera: (b) çdo humbje nga zhvlerësimi të njohur (në përputhje me SNRF 9) nga çdo llogari e arkëtueshme ose aktive kontrate që vijnë nga kontratat e njësisë ekonomike me klientët, për të cilat njësisia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues veçmas nga humbjet nga zhvlerësimi i kontratave të tjera.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandimi

Departamenti Ekonomik të hartojë relacione shpjeguese për llogaritë e arketueshme neto nga klientët, metodën e zhvlerësimit të ndjekur çdo vit efektet negative që ka sjell, shkaqet që sollën këtë situatë, si dhe përpjekjet e kryera nga ana e shoqërisë për arkëtimin e detyrimeve koherente dhe të prapambetura.

Departamenti Ekonomik të marrë masa për rakordimin e detyrimeve me Departamentin e Borxhit dhe matjen e saktë të llogarive të arkëtueshme duke bashkërenduar punën për arkëtimin e tyre sipas afateve kohore të përcaktuara në ligj.

Pretendimet e subjektit:

Observacioni i paraqitur për faqen 3 paragrafi 2 dhe faqe 5 paragrafi 2 argumentohet me:

- 1) Detajimin e vlerës së llogarive të arkëtueshme
- 2) Shpjegimin e metodës së zhvlerësimit të llogarive të arkëtueshme (vlera debisë- provizionin) nga eksperti kontabël miratuar me Vendimin nr. 39 datë 20.07.2017
- 3) Programi ekonomik bazohet mbi të dhënat e parashikuara ndërsa pasqyrat financiare mbi të dhënat faktike

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes merr pjesërisht në konsideratë argumentet e pasqyruara në observacionin me argumentet si më poshtë vijon:

- 1) Detajimi i vlerës së llogarive të arkëtueshme merret në konsideratë dhe është reflektuar në material.

Çdo shpjegim tjetër mbi llogaritë e arkëtueshme nuk merren në konsideratë më argumentet si më poshtë vijon:

Së pari jemi në kushtet e llogarive të arketueshmë që lindin apo krijohen nga Abonentë dhe jo klientë si në çdo rast tjetër që mund të kenë kompanitë. Abonenti është i lidhur ngusht me shoqërinë në referencë të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” nenet 80, 82, 84 dhe 92 si dhe kontratës mes palëve. Pra në abonenti praktikisht ka një kontratë pa afat me shoqërinë ndryshe nga Klienti i cili ka kontratë me afat, si e tillë mundësia identifikimit dhe kërkimit të borxhit ndaj një abonenti mbetet gjithmonë e hapur.

2.4. Mbi zbatimin e strukturës organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës, dhënien e pagave dhe shpërblimeve gjatë periudhës që auditohet.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit “Nr.546/1, datë 23.06.2020”,u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Struktura organizative
- 2) Dosjet e personelit
- 3) Rregullorja e brendshme
- 4) Rregullorja për përcaktimin e e kriterëve të punësimit sipas pozicionit të vendit të punës
- 5) Kontrata kolektive dhe ato individuale të punës
- 6) Procedurat e rekrutimit dhe përfundimit të marrëdhënieve të punës
- 7) Procedurat e dhënies të masave disiplinore
- 8) Hartimi i listë - pagesave të pagesave të pagave.

1. Titulli i Gjetjes Komandimi pa afat i punonjësve dhe trajtimi financiar i tyre.

Situata:

Me shkresën nr.13397/9 prot., datë 02.10.2017, nga Administratori i OSHEE SHA, është komanduar në detyrën e Drejtorit të Njesisë së OSHEE SHA Vlorë z. E O i cili deri në periudhën aktuale ka përfituar vlerën 3,366,000 lekë, si shpenzim dieta dhe shërbime. Nga auditimi konstatohet se Drejtori i Njesisë së OSHEE SHA Vlorë paguhet me pagën e pozicionit të drejtorit të Burimeve Njerëzore në drejtorinë e përgjithshme të OSHEE, dhe jo me pagën e pozicionit të komandimit

- Me shkresën nr.2561/3 prot., datë 31.08.2017, nga Administratori i OSHEE SHA, është komanduar në detyrën e Elektricitist (Verifikim Matja) të Njesisë së OSHEE SHA Vlorë z. K T, i cili deri në periudhën aktuale ka përfituar vlerën 3,591,500 lekë, si shpenzim dieta dhe shërbime.

- Me shkresën nr.1967/13 prot, datë 03.07.2017, nga Administratori i OSHEE SHA, është komanduar në detyrën e Drejtorit të Njesisë së OSHEE SHA Vlorë z. A D, i cili deri në periudhën aktuale ka përfituar vlerën 3,630,000 lekë, si shpenzim dieta dhe shërbime.

- Me shkresën nr.13397/9 prot., datë 03, nga Administratori i OSHEE SHA, është komanduar në detyrën e Drejtorit të Njesisë së OSHEE SHA Vlorë z. M K, i cili deri në periudhën aktuale ka përfituar vlerën 3,575,000 lekë, si shpenzim dieta dhe shërbime.

- Me shkresën nr. 1337/2, datë 09.05.2018 B C komanduar Shef i Sektorit të Asistencës Teknike në Rajonin Gjirokastrë, dhe me shkresën nr. 1337/2, datë 09.05.2018 deri në datën 21.11.2019 komanduar Drejtor i Rajonit Gjirokastrë, i cili deri në periudhën aktuale ka përfituar vlerën 1,861,000 lekë, si shpenzim dieta dhe shërbime.

-Me shkresën nr.118 prot., datë 17.01.2019, nga Administratori i OSHEE SHA, është komanduar në detyrën e Drejtorit të Njesisë së OSHEE SHA Lezhë z. A K, i cili deri në periudhën aktuale ka përfituar vlerën 1,914,500 lekë, si shpenzim dieta dhe shërbime.

Duke ju referuar VKM 329, datë 20.04.2016, dietat për shërbime brenda vendit, në opinionin e grupit të auditimit i referohen një afati të caktuar, për një çështje të caktuar e cila nuk mund të zgjasë pafundësisht. Po ashtu koncepti i komandimit lidhet me zgjidhjen e një problematike të caktuar emergjente, deri në plotësimin e vakancës të krijuar në strukturë, duke mos penguar në këtë mënyrë vazhdimësinë e procesit të punës dhe duke shmangur problematikat të cilat mund të rrjedhin nga këto vonesa.

Sa më sipër, konstatohet se vendimet e komandimit i kanë shkaktuar shoqërisë OSHEE SHA kosto shtesë në vlerën 17,938,000 lekë. Kjo kosto

shtesë rëndon më tej situatën financiare të shoqërisë duke pasur parasysh dhe rezultatin financiar negativ të saj. Gjithashtu, komandimi afatgjatë i punonjësve rrezikon të ndikojë në performancën e tyre dhe të punonjësve në varësi të tyre.

Kriteri: VKM 329, datë 20.04.2016.

Ndikimi/Efekti: Vendimet e komandimit dhe të shpërblimit me dieta për shërbim brenda vendit i kanë shkaktuar shoqërisë OSHEE SHA kosto shtesë në vlerën 17,938,000 lekë.

Shkaku: Mos plotësimi i vakancave të krijuara në strukturë, dhe komandimi për një periudhë të pacaktuar.

Rëndësia: I lartë

Rekomandime: **1:** Nga Administratori i OSHEE SHA dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të merren masa lidhur me punonjësit që komandohen dhe dërgohen me shërbim jashtë qendrës të punës, brenda vendit, duke përcaktuar qartë në Rregulloren e Brendshme të rasteve në të cilat punonjësit komandohen, duke përcaktuar afatin e komandimit deri në tre muaj dhe pa të drejtë përsëritje, duke përcaktuar dhe elementët e trajtimit financiar të punonjësve të komanduar.

Nga OSHEE SHA të merren masa të menjëhershme për plotësimin e vendeve vakante, amendimi i procedurave të lëvizjeve të stafit, duke përcaktuar qartë afatin dhe kriterin e komandimit, pasi mos përcaktimi i këtyre kriterëve krijon mangësi në performancën e punonjësve dhe kosto financiare shtesë për shoqërinë publike.

2.Titulli i gjetjes: Ndryshimet në strukturën organizative.

Situata: Nga auditimi u konstatua se struktura organizative të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë SHA (OSHEE) është ndryshuar një herë në vitin 2018, një herë në vitin 2019 dhe një herë në vitin 2020, si më poshtë:

- Me shkresën nr.20113/1 prot., datë 20.09.2017, është njoftuar Ministri i Infrastrukturës dhe Energjetikës lidhur me hapat e marra në funksion të ndarjes së OSHEE SHA.

- Vendimi nr.48, datë 28.09.2017 “Krijimin e Sektorit të Teknologjive dhe Aseteve të Automatizuara, si njësi organizative në varësi të Departamentit të Zhvillimit dhe Menaxhimit të Aseteve, në Divizionin e Shpërndarjes, në OSHEE SHA”.

-Vendimi qarkullues i Këshillit Mbikëqyrës nr.2, datë 25.01.2018 “Miratimi i një ndryshimi në strukturën e OSHEE SHA”, në të cilin është miratuar struktura e Departamentit të Zhvillimit të Biznesit, e përbërë nga 4 drejtori (Drejtorja e Qeverisjes së Korporatës, Drejtorja e Monitorimit të Projekteve dhe Strategjisë së Biznesit, Drejtorja e Projekteve dhe e Marrëdhënieve me të Tretët dhe Sektori i Marketingut). Po ashtu me këtë vendim Drejtorja e Ofrimit të Rrjetit me të gjitha funksionet dhe detyrat, si dhe Sektori SCADA + GIS me të gjitha funksionet dhe detyrat kalojnë tek Departamenti i Zhvillimit të Biznesit.

-Me shkresën nr.1777/1 prot, datë 15.02.2018 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është dërguar urdhri nr.157, datë 12.02.2018 “Krijimin e tre Shoqërive të Kontrolluara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA”.

-Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.13, datë 24.05.2018 “Mbi miratimin e Strukturës së Njesisë për Koordinimin e Ankesë/Kërkesave të paraqitura në Platformën e Bashkëqeverisjes, pranë Kabinetit, në OSHEE SHA”.

-Me shkresën e Entit Rregullator të Energjisë nr.798/2, datë 20.12.2018, është dërguar vendimi nr.264, datë 20.12.2018 lidhur me miratimin e vendosjes së periudhës tranzitore për bërjen efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë OSHEE SHA tek shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SHA”, licencës së furnizimit me energji elektrike dhe detyrimi të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike të shoqërisë OSHEE SHA tek shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA”. Me anë të kësaj shkresë është

lënë një afat prej 12 muajsh, për përcaktimin e saktë të strukturave organizative dhe proceseve të menaxhimit të portofolit të energjisë elektrike në përputhje me funksionet dhe veprimtarinë që të mbulojë çdo operator.

-Me shkresën e Këshillit Mbikëqyrës nr.21, datë 02.07.2020 “Mbi miratimin e strukturës organizative të OSHEE Group SHA (Shoqëria mëmë)”, është miratuar në parim struktura e saj. Me anë të këtij vendimi janë miratuar departamentet, sektorët dhe njësitë e strukturës organizative, por nuk janë miratuar sa punonjës do të ketë çdo departament/sektor /njësi e shoqërisë. Kjo bie në kundërshtim me vendimin e Entit Rregullator të Energjisë nr.798/2, datë 20.12.2018, në të cilin përcaktohet periudha tranzitore që do të përfundonte pas 12 muajsh, pra në datën 20.12.2019, ku përfshihej dhe sa më lart cituar përcaktimi i saktë i strukturave organizative.

Deri në periudhën e auditimit në terren datë 18.09.2020, nuk ka dalë një vendim i cili përcakton saktë strukturën dhe përbërjen e saj, me numra punonjësish të OSHEE SHA.

-Niveli i klasave në këtë vendim është bërë në 4 grupe nga 1 më i ulëti te 4 më i larti, por në këtë klasifikim nuk janë përcaktuar kriteret që i diferencojnë qartë këto klasa. *Nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nuk ka kriteret të përcaktuara qartë dhe praktika e krijuar ka qenë klasifikimi nga 1, si shkalla më e ulët në 4, si shkalla më e lartë, duke ju lënë në dorë drejtuesve në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore (duke ruajtur fondin e pagave), sipas aftësive dhe përgjegjësive, detyrave dhe shkalles së vështirësisë në kryerjen e tyre, si dhe volumit të punës që punonjësit kanë.* Nga sa më sipër rezulton se nivelet e pagave për vitet 2017-2020, nuk janë miratuar nga organet kolegjiale drejtuese të shoqërisë tregtare, me kapital mbi 50 % shtetëror, brenda kufit minimal e maksimal të pagës të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive financiare të OSHEE SHA.

Kriteri: Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, shkronja (a), *ku citohet se organe kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50% shtetëror, miratojnë: a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës.*

Ndikimi/Efekti: Mos përcaktimi i qartë dhe mos miratimi i strukturës organizative (miratim vetëm në parim), numrave të punonjësve dhe paqartësia e krijuar në ndarjen e niveleve të pagave ndikon në performancën e shoqërisë OSHEE SHA.

Shkaku: Mos respektimi i detyrave funksionale të përcaktuara në ligjin nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, shkronja (a).

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi : Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë OSHEE SHA të merren masa të menjëhershme për hartimin dhe miratimin e plotë të strukturës organizative, përcaktimin e numrit të nevojshëm të punonjësve për çdo departamentet, sektorët e njësi; si dhe përcaktimin e qartë të kriterëve të cilat diferencojnë klasat e pagave për çdo pozicion.

3.Titulli i gjetjes: Mos plotësimi i numrit mesatar të punonjësve.

Situata: Në vitin 2017, numri mesatar faktik i punonjësve në OSHEE SHA ka qenë 6423, punonjës dhe fondi total i realizuar për pagat ka rezultuar në vlerën 4,912,548,844 lekë.

Sipas programit ekonomik për vitin **2017**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 6731 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2017 është realizuar 6423 punonjës. Fondi i pagave ka qenë 2,952,232,694 lekë, pra 69,864,262 lekë më pak se programi.

Sipas programit ekonomik për vitin **2018**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 6331 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar 6296 punonjës. Fondi i pagave ka qenë 4,912,548,844 lekë, pra 366,617,031 lekë më pak se programi.

Sipas programit ekonomik për vitin **2019**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 6331

punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave rezultojnë se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2019 është realizuar 6298 punonjës. Fondi i pagave ka qenë 4,974,112,431 lekë, pra 169,884,567 lekë më pak se programi.

Nga grupi i auditimit konstatohet se planifikimi bëhet me rezerva çdo vit, si dhe nuk është argumentuar dhe planifikuar saktë si numri i fuqisë punëtore dhe fondi i pagave.

Kriteri: Përcaktimet e programeve ekonomike të viteve 2017, 2018 dhe 2019.

Ndikimi/Efekti: Mos plotësimi i nevojave të shoqërisë me numrin e parashikuar të punonjësve ndikon në performancën e saj.

Shkaku: Numri i punonjësve të shoqërisë është më i ulët se parashikimet e programit dhe për pasojë sjell mos plotësimin e nevojave të saj.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 4: Nga Administratori i shoqërisë dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të merren masa për planifikimin e saktë sipas ecurisë në vite të fuqisë punëtore, nevojave të identifikuar nga çdo sektor, si dhe plotësimi i nevojave për punonjës të shoqërisë referuar parashikimeve të programit ekonomik.

4. Titulli i gjetjes: Procedura e Rekrutimit të Punonjësve.

Situata: Për periudhën objekt auditimi konstatohet se në Drejtorinë e Përgjithshme të OSHEE SHA:

- Nuk është hartuar Rregullorja e Brendshme. Nga OSHEE SHA janë hartuar “Procedura e lëvizjeve të stafit”, “Kodi i sjelljes”, “Procedura e rekrutimit” dhe “Udhëzimet operative në sektorin e planifikimeve, trajnimeve dhe vlerësimet e performancës”.

- Megjithëse “Procedura e rekrutimit” është hartuar dhe miratuar, nuk është bërë për asnjë rast shpallja e vendeve vakante dhe as intervistimi apo testimi i kandidatëve. Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë, nga Burimet Njerëzore, pranë OSHEE SHA nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura, sepse nuk ka të dokumentuar asnjë nga hapat që duhet të ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.

- Nga auditimi konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 70 masa disiplinore, në Drejtorinë e Përgjithshme të OSHEE SHA, mëposhe nga këto 46 “Vërejtje me shkrim” dhe 24 masa “Vërejtje me shkrim, paralajmërim për largim nga puna”. Janë audituar 30 nga këto procedura, pra 42%. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedurë transparente, dhe nuk ka komision apelimi. Në rastet e apelimit të dhënies të masave, rishikimi bëhet nga drejtoria e cila ka dhënë masën.

Kriteri: Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015.

Ndikimi/Efekti: Mos zbatimi i procedurave të rekrutimit të marrëdhëniesve të punës sipas ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015 sjell parregullsi dhe mangësi në punësimin e punonjësve për shoqërinë OSHEE SHA.

Shkaku: Mos zbatimi i ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë” dhe mangësitë në zbatimin e procedurave rekrutimit të punonjësve të rinj të shoqërisë OSHEE SHA.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 1: Nga Administratori dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj duke u bazuar në “Procedura e rekrutimit”, dhe hartimi dhe miratimi i rregullores së brendshme të shoqërisë OSHEE SHA.

Rekomandimi 2: Nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies të masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit të apelimit lidhur me masat disiplinore në shoqërinë OSHEE SHA.

5. Titulli i gjetjes : Paga në natyrë më tepër nga kuota e miratuar.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën mars 2018 – qershor 2020 rezultoi se; Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune. Nga ana e Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Burimeve njerëzore nuk janë marrë masat për reflektimin e ndryshimeve ligjore për caktimin e dietës ushqimore në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet përkatëse për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive. Nga llogaritja e listë pagesave të periudhës mars 2018 – qershor 2020 rezulton se ky përfitim është në masën 195,454,000 lekë, nga 117,470,696 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma e përlllogaritur me afërsi nga grupi i auditimit *662,473,260 lekë e cila konsiderohet efektit financiar negativ për buxhetin e shoqërisë. (Shënim: Llogaritja është kryer në bazë të shumës totale të përfituar, pjesëtuar me vlerën prej 500 lekë/ditë, dhe më pas është shumëzuar me 200 lekë/ditë, e cila është shuma e përfituar më tepër).*

Kriteri: Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a).

Ndikimi/Efekti: Efekt financiar negativ në shumën prej 662,473,260 lekë.

Shkaku: Mos azhurnimi i ndryshimeve ligjore dhe ndryshimi i kontratës kolektive të shoqërisë në përputhje me këto ndryshime.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi : Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masat e duhura, për azhurnimin e legjislacionit, të negociohet me sindikatën e punëmarrësve, bazuar në Kodin e Punës dhe Rregulloren e brendshme të Shoqërisë. Administratori i Shoqërisë, Departamenti Ligjor të marrë masat e duhura dhe të kryejë ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive, duke nxjerrë aktet përkatëse për mos vazhdimin e dietës ushqimore më tepër nga përcaktimet ligjore.

6.Titulli i gjetjes : Proceset gjyqësore për ndërprerjen e paligjshme të marrëdhënieve të punës.

Situata: Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur **89** çështje në **Gjykatën e Apelit**, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **61,898,675 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore; për periudhën objekt auditimi, janë humbur **45** çështje gjyqësore në **Gjykatën e Lartë të Tiranës**, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **38,889,675 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Për periudhën objekt auditimi, janë humbur **4** çështje gjyqësore në **Gjykatën e Shkallës së Parë**, në vlerën **3,689,300 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. **Në total** për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera parashikohet të jetë **105,285,897 lekë e cila konsiderohet efektit financiar negativ për buxhetin e shoqërisë**

Kriteri: Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015.

Ndikimi/Efekti: Efekt financiar negativ në shumën prej 105,285,897 lekë.

Shkaku: Mos zbatimi i ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, dhe mangësitë në zbatimin e procedurave të largimit nga puna të punonjësve, të shoqërisë OSHEE SHA.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi : Nga Administratori, Departamenti Ligjor dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të shoqërisë të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që

mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Konkluzione:

- 1. Vendimet e komandimit** i kanë shkaktuar shoqërisë OSHEE SHA **kosto shtesë në vlerën 17,938,000 lekë**. Kjo kosto shtesë rëndon më tej situatën financiare të shoqërisë duke pasur parasysh dhe rezultatin financiar negativ të saj. Gjithashtu, komandimi afatgjatë i punonjësve rrezikon të ndikojë në performancën e tyre dhe të punonjësve në varësi të tyre.
- 2.** Nuk ka dalë një vendim i cili përcakton saktë strukturën dhe përbërjen e saj, me numra punonjësish të OSHEE SHA.
- 3.** Procedura e ndjekur gjatë kësaj përzgjedhje nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar asnjë nga hapat që duhet të ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.
- 4.** Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, dhe nuk ka komision apelimi.
- 5.** Nga llogaritja e listë pagesave të periudhës mars 2018 – qershor 2020 rezulton se ky përfitimi i pagës në natyrë është në masën 195,454,000 lekë, nga 117,470,696 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma prej **662,473,260 lekë** e cila konsiderohet efektit financiar negativ për buxhetin e shoqërisë. (Shënim: Llogaritja është kryer në bazë të shumës totale të përfituar, pjesëtuar me vlerën prej 500 lekë/ditë, dhe më pas është shumëzuar me 200 lekë/ditë, e cila është shuma e përfituar më tepër).
- 6.** Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **105,285,897 lekë** e cila konsiderohet efektit financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z. A Ç në cilësinë e Administratorit, znj. B I në cilësinë e drejtorit të burimeve njerëzore, znj. E A në cilësinë e ish Drejtorit Ligjor, znj. N Z në cilësinë e ish Drejtorit Ligjor z. A L në cilësinë e Drejtorit Ligjor.

Pretendimet e subjektit:

Në observacionin e dërguar me nr.12149/6, datë 22.12.2020, nga z. A Ç dhe B I në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datën 28.12.2020, në të cilin citohet se:

- 1-“...komandimet në detyrë të punonjësve në OSHEE SHA kanë ardhur si rrjedhojë e nevojës për rritjen e treguesve të performancës në zonat e vështira ...duke u shprehur në vlera ekonomike shoqëria ka pasur përfitime në këto rajone...”
- 2- “... pika 2, germa b, citohet ‘në kontratën kolektive apo individuale, palët mund të përcaktojnë dhe trajtime të tjera, si dhe ndryshimin e kufijve të pagës në natyrë, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit’ ...marrëdhënie e cila është në fuqi prej 10 vitesh...”
- 3-“...ndërprerja e marrëdhënieve të punës nga OSHEE SHA është bërë bazuar në legjislacionin në fuqi, kodin e punës, kontratës kolektive dhe kontratës individuale...”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1-Lidhur me observacionin tuaj sa më sipër, ju sqarojmë se komandimi nuk mund të zgjasë pafundësisht. Përfitimet në rajone nuk mund të jenë kurrsesi rezultat i punës të një punonjësi të vetëm, por i punës në grup të gjithë punonjësve të drejtorisë rajonale. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

2- Lidhur me observacionin tuaj ju sqarojmë se asnjëherë kontrata kolektive, dhe as ajo individuale nuk prevalojnë mbi përcaktimet ligjore dhe nënligjore. Ju në observacionin tuaj konfirmoni se kontrata kolektive është e njëjtë prej 10 vitesh, dhe nuk ka qenë subjekt i ndryshimeve ligjore të ndodhura gjatë kësaj periudhe. Në cilësinë e Administratorit dhe të Drejtorit të Burimeve Njerëzore, ju mbani përgjegjësi sepse duhet të bëni propozime për zbatimin dhe përshtatjen kundrejt ndryshimeve ligjore. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

3-Lidhur me observacionin tuaj ju sqarojmë se duke ju referuar vendimeve të gjykatave, konstatohet se nga ana juaj nuk është respektuar në të gjitha rastet e shkëputjes të marrëdhënie të punës, procedura ligjore lidhur me këtë pikë. Sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:

Në observacionet e dërguara me: nr.12149/7, datë 22.12.2020, nga A L, me nr.12149/8, datë 25.09.2020 nga E J, dhe observacioni me nr.12149/9, datë 25.09.2020 nga N Z në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 28.12.2020, në të cilët jepet i njëjti shpjegim, citohet si më poshtë:

1-“...referuar parashikimit të VKM është mjaft e qartë që punëdhënësi në kontratën kolektive të nënshkruar me përfaqësuesit e punëmarrësve kanë të drejtë të ndryshojnë kufijtë e pagës në natyrë...”

2-“...aplikimi i masës 300 lekë në ditë do të cenonte përparësinë që ka kontrata kolektive e punës ndaj akteve të tjera...”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1-Lidhur me observacionin tuaj, ju bëjmë me dije se referuar parashikimeve të VKM-së, paga në natyrë për një vakt është 300 lekë, dhe për dy vakte është 500 lekë. Për rrjedhojë, observaoni juaj nuk merret në konsideratë.

2- Lidhur me observacionin tuaj, ju bëjmë me dije se Kodi i punës dhe aktet nënligjore të tij (përfshi këtu dhe VKM nr.68, datë 07.02.2018), prevalojnë mbi kontratën kolektive, e cila hartohet sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Për rrjedhojë, observaoni juaj nuk merret në konsideratë.

2.5. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj.)

Është shqyrtuar dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni i pagesave të bankës
- Dokumentacioni i arkëtimeve, pagesave të arkës.
- Dokumentacioni hyrjeve dhe daljeve të magazinës.
- Dokumentacioni i mbajtur mbi marrjen në dorëzim të furnizimeve.
- Dokumentacioni i mbajtur për blerjet me vlera të vogla
- Dokumentacioni i mbajtur për shpenzimet për dieta brenda dhe jashtë vendit
- Dokumentacioni për konsumin e karburantit
- Dokumentacioni për sponsorizimet

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- Me urdhrin nr. 532, datë 10.01.2018, administratori i OSHEE-së, ka ngritur komisionin e blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga L M , kryetar, AG anëtar dhe E D anëtare.
- Me urdhrin nr. 341, datë 08.01.2019, administratori i OSHEE-së, ka ngritur komisionin e blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga L M , kryetar, AG anëtar dhe E D anëtare.
- Me urdhrin nr. 421, datë 09.01.2019, administratori i OSHEE-së, ka ngritur komisionin e blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga A G, kryetar, A G anëtar dhe E D anëtare.
- Me urdhrin nr. 550, datë 15.01.2020, administratori i OSHEE-së, ka ngritur komisionin e blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga L M , kryetar, AG anëtar dhe E D anëtare.

Titulli i Gjetjes: Kryerja e blerjes së valutës pa procedura të vlerësimit të ofertës më të mirë dhe mos pasja e një sistemi të monitorimit të skadencave të detyrimeve të pagueshme.

Situata:-Në verifikimet e pagesave me bankë u konstatua se shoqëria pagesat e energjisë së importuar i kryen kryesisht në Euro. Procedura e blerjes së valutës kryhet duke bërë një vlerësim të kurseve të këmbimit që bankat e nivelit të dytë ofrojnë në faqet web të tyre, duke i kërkuar më pas ofertë bankës C e cila nga rastet e verifikuara deri tani e ka pasur ofertën e kursit të këmbimit më të ulët se kurset e këmbimit të deklaruar nga bankat e tjera në faqet web.

Duke qenë kurset e këmbimit që bankat e nivelit të dytë publikojnë në faqet web janë për shumën të vogla, përgjithësisht nën 1,000 euro, dhe se OSHEE këmben vlera në miliona euro, oferta që mund të ofrojnë bankat nëse u bëhet kërkesë zyrtare mund të ndryshojë në favor të shoqërisë duke pasur oferta më të favorshme.

Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë kryer procedurat e marrjes së ofertave nga bankat e nivelit të dytë për të përcaktuar ofertën më ekonomike.

-Nga verifikimi i pagesave të furnitorëve u konstatua se nga Departamenti Ekonomik dhe i Financës nuk është ngritur dhe miratuar procedura e monitorimit të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve në kohë si dhe për të dokumentuar që pagesat kryhen sipas skadencave kronologjike.

Kriteri:Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Neni 1,ku citohet:

Objekti i ligjit. Ky ligj përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin. Neni 2. Qëllimi i ligjit. Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më efektiv, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë. Neni 3, Fusha e zbatimit të ligjit. Ky ligj zbatohet në njësitë e sektorit publik, ku, sipas këtij ligji, përfshihen: 1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme. 2. Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ku citohet:

“Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues 2. Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së: gj) garantimin që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mospagesë nga kreditorët, nëpunësi zbatues duhet t’ia shpjegojë rrethanat nëpunësit autorizues.”

dhe nenit 16, pika 2, detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit ku citohet:

2. Titullarët e njësisë publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ndikimi/Efekti: Marrja e ofertave të këmbimit valutor, favorizon konkurrencën dhe zgjedhjet ekonomike për shoqërinë. Pajisja me sistem të monitorimit të skandencave të detyrimeve të pagueshme, ul riskun e shoqërisë për krijimin e penaliteteve për mos pagesa në afat.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime:

1. Nga administratori i shoqërisë të merren masa për hartimin dhe kryerjen e procedurave të blerjes së valutave të huaja, që të kenë një gjithë përfshirje të bankave të nivelit të dytë, që operojnë në tregun kombëtar duke reflektuar parimet e economicitetit dhe konkurrencës. Nëpërmjet planifikimit të afateve të pagesave, të komunikohet me bankat për afatet kur do të kryhen transaksionet, për të evituar vështirësitë e transferimit të vlerave ndërmjet bankave.

2. Nga administratori i shoqërisë të merren masa për të ngritur dhe miratuar procedura të monitorimit të afateve të skandencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve sipas kontratave përkatëse. Ky sistem do të shërbej për uljen e riskut të shoqërisë për krijimin e penaliteteve për mos pagesa në afat dhe vlerësimin e gjurmës së auditimit për korrektësinë e veprimeve të Nëpunësit Zbatues.

Për sa më sipër mban përgjegjësi C K, në cilësinë e drejtorit të Departamentit Ekonomik dhe të Financës.

Titulli i Gjetjes: Kryerja e procedurave të prokurimit për shërbime me natyrë të përsëritur

Situata:-Gjatë procesit të auditimit të procedurave të prokurimit “Zhdoganimi i praktikave të OSHEE-së”, u konstatua se në vitin 2017 janë prokuruar vlerat 735,000 lekë, për vitin 2018, 570,000 lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 565,000 lekë. Praktikave të OSHEE në importin e mallrave kanë të bëjnë me blerjen e energjisë në tregun e jashtëm. Sasia e blerjeve të energjisë si dhe praktikave doganore që kanë lidhje me to, janë të pa parashikueshme pra duke e vështirësuar procesin e llogaritjes së vlerës së fondit limit. Në këtë situatë do të ishte e përshtatshme përdorimi i procedurës së “Marrëveshjes kuadër”.

Kriteri: Sa më sipër është në vijimësi të nenit 43, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, ku citohet:

“Një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur dhe/ose kur është e vështirë ose e pamundur për të përcaktuar paraprakisht volumet që duhet të prokurohen dhe nuk ka siguri për kohën e dorëzimeve/realizimeve e të ekzekutimit të kontratave.”

Ndikimi/Efekti: Problematika në zbatimin e kontratave nëse sasia faktike është më e madhe ose më e vogël se ajo e prokuruar.

Rëndësia: E mesme

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime: Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që në të ardhmen, shoqëria të kryejë

prokurimin e shërbimit të zhdoganimit të praktikave doganore, duke përdorur marrëveshjen kuadër, për një shfrytëzim sa më me efektivitet të fondeve të saj.

Titulli i Gjetjes: Mos përcaktim i saktë i objektit të procedurës së prokurimit

Situata:-Në procedurën e prokurimit iniciuar me urdhër nr. 15801/2 Prot., datë 13.08.2018, me objekt “Blerje karta SIM për nevoja të OSHEESHA”, u konstatua se objekti i procedurës ishte i ndryshëm me natyrën e shërbimit që kërkohej nga Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit.

Në shkresën nr.15801 Prot., datë 09.08.2018, të drejtorit të drejtorisë së teknologjisë dhe informacionit, J S , në kuadër të Projektit të azhornimit të fiderave kërkohej blerja e 800 kartave SIM, bashkëlidhur me specifikimet teknike, për të mundësuar lidhjen me rrjetin e internetit për tabletat e përdorur për projektin.

Në ftesën për ofertë komisioni i blerjeve të vogla, në specifikimet teknike ka kërkuar nga OE të ofrojë një pool total GB, pavarësisht sasisë së kartave të aktivizuara në sistem si dhe nga OE duhet të ofrohet shërbimi me APN private me IP Statike. Gjithashtu OE duhet të mbulojë me shërbim interneti 2G, 3G dhe 4G, duke pasur si parametra mbulimi të territorit kombëtar për 3G 88% dhe 99 %, të mbulimit të popullsisë së Shqipërisë.

Nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, nuk është përcaktuar qartë dhe saktë objekti i blerjes pasi kërkohej 800 karta SIM, por në thelb kërkohej shërbim interneti.

Në specifikimet teknike kërkohej mbulimi me internet sipas parametrave të kërkuar por pa e saktësuar se cili autoritet certifikues do të japë vërtetimet përkatëse për sa më sipër.

Kriteri:Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23, ku citohet: “

Specifikimet teknike

1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të pa anshme të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësitë kufizuara.

3.Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar: a)standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 40, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014:

3. Kur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyre.

Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës duhet të përllogaritë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 59 të këtyre rregullave, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme. Urdhri i prokurimit duhet të shoqërohet me ftesën për ofertë, që u drejtohet operatorëve ekonomikë, në të cilën përcaktohen të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me objektin e prokurimit.

Më datë 15.08.2018, komisioni me proces verbalin nr.2, shprehet se pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga OE V , e gjykoj të përshtatshëm si fitues të procedurës.

Në ofertën e sjellë nga OE, cilësohen karta SIM V , 800 copë, tarifa fikse mujore për SIM 600 lekë, me 1 GB internet për SIM, APN private, njësia pas tejkalimit të sasisë (pool) totale është 1 GB dhe kushton 600 lekë me TVSH.

-Pra oferta e OE është e ndryshme nga ftesa për ofertë e komisionit i cili ka kërkuar karta SIM.

Në dokumentacionin e sjellë nga OE, nuk mund të verifikohet nëse shoqëria V SHA kryente mbulimet e 3G dhe 4G në të gjitha zonat e kërkuara nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla. Më datë 17.08.2018 është lidhur kontrata ndërmjet palëve me titull “Blerje karta SIM për nevoja të OSHEESHA, për një periudhë 1 (një) muaj.

Në procesin e marrjes në dorëzim punonjësi T K , si i ngarkuar për marrjen në dorëzim të mallrave, ka mbajtur shkresën për konfirmimin e shërbimit më datë 15.08.2018, duke u shprehur se shërbimi i kryer me operatorin V SHA është në përputhje me kërkesën e bërë nga Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit. Nga dokumentacioni i dosjes u konstatua se fatura e OE V ishte lëshuar më datë 11.10.2018 dhe ishte për vlerën e shërbimit të VPN-së në shumën 400,000 lekë pa TVSH dhe me vlerë 480,000 lekë me TVSH.

Deklarimi i plotësimit të marrjes në dorëzim të mallit pa faturën tatimore të OE është në kundërshtim me pikat 35,45 të Udhëzimit nr.30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku citohet:

35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumenta origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në: b. **Dokumenta vërtetues** - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe te tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi. 45. Kur ka mospërputhje ndërmjet sasive të mallrave të shënuara në fletëdalje, në faturat ose në dokumentet e tjera shoqëruese dhe sasive efektive që gjenden brenda ambalazhit, si dhe në cilësi, llojshmëri, qenien e plotë dhe markën e prodhimit, komisioni ndërpret verifikimin dhe lajmëron shitësin që të paraqitet brenda një afati kohor të përcaktuar (në varësi të vendndodhjes brenda ose jashtë juridiksionit ku ushtron veprimtarinë njësitë publike në marrëdhënie me furnitorin).

Ndikimi/Efekti: Mos respektimi, dhe zbatimi me korrektësi i procedurave të blerjeve të mallrave ose shpenzimeve sjell në rritjen e riskut të keqpërdorimit të burimeve financiare të shoqërisë.

Rëndësia: e mesme

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime: Nga titullari i Autoritetit Kontraktor të merren masat që në të ardhmen grupet e ngritur për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve të ndjekin të gjitha përcaktimet ligjore për marrjen në dorëzim, me qëllim shmangien e praktikave që mund të sjellin rritjen e riskut të keqpërdorimit të burimeve financiare të shoqërisë.

Titulli i Gjetjes: Kryerja e parapagimit të një shërbimi me periudhë 1 vjeçare.

Situata:-Në auditimin e procedurës me objekt prokurimi “Suporti dhe mirëmbajtja e sistemit Call-Center”, me urdhrin e prokurimit nr. 15913/3 datë 30.07.2019 u konstatua se në kontratën me vlerë 936,000 lekë me TVSH, për një periudhë 12 mujore, lidhur me OE fitues “Communication Progress”, SHPK, datë 02.08.2019, me nr. 15913/4 Prot., kushtet e veçanta neni 8, pagesa paraprake cilësohet: “AK do të paguajë OE vlerën prej 936,000 lekë, për shërbimin që ofron menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate”. Operatori ekonomik ka kryer sigurimin e kontratës në vlerën 93,000 lekë. Pra AK, ka pranuar në kontratë të parapaguajë një shërbim i cili mund dhe të mos ofrohej nga OE.

Kriteri:Veprimi sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. Nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Neni 2, ku citohet:

“Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë.”

Vendosja e kushtit në kontratë për pagesën e menjëhershme të vlerës, pa përfunduar kontrata është kryer në kundërshtim me nenin 2 të sipërcituar si dhe me pikën c), të nenit 13, që një ndër rastet kur kundërshtohet urdhri i nëpunësit autorizues nga nëpunësi autorizues është dhe rasti ku citohet:”

Urdhri për pagesën përfundimtare jepet pa u përfunduar shërbimi, pa hyrjen e vlerave materiale në njësi ose marrjen në dorëzim nga njësitë e investimit të përfunduar”, si dhe nenit 61 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku citohet: “...Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë të detyruara të procedojnë me kryerjen e pagesës për mbylljen e detyrimeve menjëherë pas marrjes së faturës tatimore nga furnitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit/marrjes në dorëzim të aktiveve në përputhje me kushtet e kontratës. Për moszbatimin e këtij detyrimi zbatohen sanksionet ligjore të përcaktuara në kontratën e lidhur në mes palëve ose në marrëveshjet përkatëse dypalëshe për të cilat mban përgjegjësi Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i njësisë respektive”

Ndikimi/Efekti: Parapagimi i shërbimit për të gjithë periudhën, duke vlerësuar se sigurimi i

kontratë ishte në vlerën 10 %, të saj, ka shtuar riskun për keqpërdorimin e burimeve financiare të shoqërisë.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime: Nga titullari i AK dhe sektori i prokurimit në Drejtorinë Juridike të merren masa që në të ardhmen, formalizimi i marrëdhënieve kontraktuale për blerjen e mallrave ose shërbimeve, të kryhet duke reflektuar parimet e menaxhimit të riskut, lidhur me identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike.

Për sa më sipër mban përgjegjësi E B, në cilësinë e hartuesit të kontratës me OE.

Titulli i Gjetjes: Kryerja e blerjeve të biletave të avionit, jo konform udhëzimeve përkatëse

Situata: Nga verifikimi i procedurës “Blerje bileta avioni për linjën ajrore Tiranë-Mynih e kthim”, me urdhër prokurimi nr. 8938/4 datë 19.04.2019, u konstatua se OE fitues në objektin e aktivitetit kishte: “*Shërbime ne fushën e turizmit si udhëtime brenda dhe jashtë vendit.*”, por pa e cilësuar transportin ajror ndërkombëtar si dhe i mungonte licenca XIII.1.A “Agjenci Udhëtimi” e cila konsultohet në regjistrin e QKB-së.

Kriteri: Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 4 datë 09.01.2018, “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”, pika 6, ku citohet:

“ Si rregull autoriteti kontraktor do të verifikojë në Qendrën Kombëtare të Biznesit nëse operatori ekonomik ofertues ka në objektin e ushtrimit të veprimtarisë së tij edhe objektin që po prokurohet. Në këtë kuptim, operatorit ekonomik ofertues nuk do t’i kërkohe paraqitja e Ekstraktit të QKB.”

Në raste specifike, komisioni i sistemit dinamik i biletave, në vartësi të specifikës së objektit të prokurimit, mund të kërkojë plotësimin e një ose disa kriterëve të veçanta, duke përcaktuar në ftesën për ofertë dokumentacionin përkatës provues si p.sh., certifikate akreditimi ose një vërtetim nga (IATA) që OE është i akredituar nga International Air Transport Association. (IATA).

Ndikimi/Efekti: Mos respektimi, dhe zbatimi me korrektësi i procedurave të blerjeve të mallrave ose shpenzimeve sjell në rritjen e riskut të keqpërdorimit të burimeve financiare të shoqërisë.

Rëndësia: e mesme

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime: Nga titullari i Autoritetit Kontraktor të merren masat që në të ardhmen, blerjet e biletave të transportit ajror të kryhen në përputhje me udhëzimet përkatëse, me qëllim shmangien e praktikave që mund të sjellin rritjen e riskut të keqpërdorimit të burimeve financiare të shoqërisë.

Shpenzimet për dieta

Në 82 procedura të audituara u konstatuan problematikat si vijon:

Titulli i Gjetjes: Plotësimi i dokumentacionit justifikues për shpenzimet e dietave jo konform udhëzimeve përkatëse

Situata: -Në 46 raste në urdhrin e shërbimit në përcaktimin e qëllimit të kryerjes së shërbimit ishte përshkrimi i përgjithshëm “Arsye pune”, pa u detajuar specifikimet e shërbimit.

-Në 36 formularë të kërkesave për shërbim mungonin të shpjeguar qartë dhe me detaje qëllimi i udhëtimit dhe plani i punës.

-Në 82 procedura të audituara ishte specifikuar vetëm data e nisjes por mungonte data e përfundimit të shërbimit.

-Në 6 procedura të audituara të muajit dhjetor 2019, të punonjësve K T, S M, D H, K R, në urdhër shërbimet e dhëna nga drejtori i DRM, A Z janë specifikuar vetëm datat e nisjes 10,16,18,26, dhe 31 dhjetor dhe F K e R C për në datat 10,16,18,26, dhe 30 dhjetor. Vendet ku do të shkohet me shërbim janë Shkodër dhe Kukës dhe qëllimi i kryerjes së shërbimit është kontrolli dhe verifikimi i të gjithë kategorive, familjarë dhe privatë në fidera që kanë humbjet më të mëdha, kontroll për lidhje të jashtëligjshme, linja të dyta, verifikim i abonentëve debitor, dhe kontroll i ndërhyrjeve në matës.

Në asnjë nga këto urdhër shërbime nuk janë përcaktuar saktë vendi dhe data e kryerjes së shërbimit

si dhe qëllimi është i përgjithshëm dhe jo i shoqëruar me fiderat përkatës që kanë humbjet më të mëdha, abonentët debitor, zonat se ku ndodhen, etj.

Nga verifikimi i pasqyrave të shërbimeve u konstatua se më datë 18 dhjetor, të gjithë punonjësit e sipërcituar janë kthyer në ora 18.00 nga Kukësi në Tiranë, dhe po këtë ditë janë nisur nga Tirana në Shkodër. Arsyet se përse grupi u kthye në Tiranë dhe më pas vazhdoi për në Shkodër nuk janë të përcaktuara në urdhër shërbim.

Gjithashtu punonjësit K T, S M , D H , K R dhe pse në urdhër shërbim kanë pasur si datë nisje datë 31.12.2019 nga pasqyra e shërbimeve dhe faturat tatimore të fjetjes në hotel rezulton se janë nisur më datë 30.12.2019.

Kriteri: Të gjitha këto parregullsi janë në kundërshtim me nenin 4, pika 19 dhe neni 16, pikat 2.3 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, ku citohet:

“Neni 4 Përkufizime Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 19. "Gjurma e auditimit" përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Neni 16 Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit 1. Ministri i Financave është përgjegjës për miratimin e gjurmëve standarde të auditimit, që lidhen me procedurat e unifikuara për të gjitha njësitë e sektorit publik. 2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.”

Ndikimi/Efekti: Mos respektimi, dhe dokumentimi me korrektësi i procedurave të rimbursimit të shpenzimeve për dieta sjell në rritjen e riskut të keqpërdorimit të burimeve financiare të shoqërisë.

Rëndësia: E mesme.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime: Administratori i shoqërisë duhet të marrë masa që në ardhmen, procedurat e rimbursimit të shpenzimeve për dieta, të ndiqen me korrektësi, duke plotësuar të gjitha dokumentat justifikues përkatës, me qëllim që të jenë efektive, dhe të shërbejnë për pasqyrimin e gjurmës së auditimit.

Për këto çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt Raportin me shkresën nr. 12148/10 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH-së, më datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

Bazuar ne Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr.2. date 24.01.2019 "Mbi krijimin dhe miratimin e strukturës organizative te Departamentit te Kontrollit dhe Rikuperimit te Humbjeve, Procedurës Nr 11480 date 23/05/2019", " Udhëzimet e punës se ekipeve te kontrollit ne terren", ku citohet se: Qëllimi i krijimit te departamentit është institucionalizimi i aktivitetit te kontrollit dhe rikuperimit të humbjeve, rritjes së të ardhurave, realizimin e kontrolleve efektive te konsumatorëve, trajnimi i duhur i stafit dhe pajisjen e tij me instrumentet e nevojshme për arritjen e qëllimit. DKRH realizon kontrollet për planet ditore te vizitës te klienti bazuar ne planin e punës mujor/ javor te miratuar nga Administratori ose Drejtori i Departamentit. Ne rast se është e nevojshme puna vijon dhe jashtë orarit zyrtar. Urdhri i punës njoftohet me ane te e-mail dhe/ose urdhër me shkrim.

Për sa i përket pyetjes tuaj te drejte ne Akt Konstatimin Nr.6 , Dokumenti 8 "Arsyet pse grupi është kthyer nga Kukësi ne Tirane me date 18.12.2019 dhe po atë ditë janë nisur në Shkodër", ju shpjegoj pse: Më datë 10/12/2019 është ngritur Urdhri Punës mujor i firmosur nga Administratori i OSHEE dhe Drejtori i Departamentit të Kontrollit dhe Rikuperimit të Humbjeve me Nr. 24631. Në këtë urdhër, grupi i punës kanë qenë të urdhëruar me shërbim në Shkodër.

Bazuar në kërkesën për suport të Drejtorit Rajonal Kukës, është ngritur programi i Punës Nr. 25000 me datë 13.12.2019 i përbërë nga grupi i lartpërmendur. Afati i këtij Programi Pune ka qene

16/12/2019 -18/12/2020. Me përfundim te programit, grupi i punës, siç e përmban "Udhëzimet e punës së ekipeve të kontrollit në terren", dorëzon në qendër Proces Verbalet e Konstatimit lidhur me programin e punës.

Pasi janë dorëzuar Proces Verbalet e Konstatimit lidhur me programin e punës, pranë zyrave qendrore ne Tirane, grupi i punës është nisur në Shkodër për te kryer detyrat e tyre funksionale bazuar ne Urdhrin e Punës mujor Nr.2463 i cili afatin e mbarimit e kishte me date 10.01.2019.

Bashkëlidhur do te gjeni dokumentacionet përkatëse.

Oëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nuk është sjellë asnjë evidencë mbështetëse shtesë për sa më sipër konstatuar, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa më sipër mban përgjegjësi A Z në cilësinë e drejtorit të Departamentit të Kontrollit dhe Ikupeimit të Humbjeve.

Titulli i Gjetjes: Plotësimi i dokumentacionit justifikues për shpenzimet e karburantit jo konform udhëzimeve përkatëse

Situata: Në procesin e dokumentimit të shpenzimeve për karburant, në Drejtorinë Rajonale Tiranë, u konstatua se në 26 raste në fletët e udhëtimit nuk është shënuar emri i personit që ka përdorur makinën si dhe fletët e udhëtimit nuk janë kontrolluar dhe firmosur nga personi i autorizuar për këtë procedurë.

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me pikat 35,45 të Udhëzimit nr.30, datë 27.11.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, ku citohet:

35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në: b. **Dokumenta vërtetues** - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe te tjera akte me natyre verifikues shpenzimi. 45. Kur ka mospërputhje ndërmjet sasive të mallrave të shënuara në fletëdalje, në faturat ose në dokumentet e tjera shoqëruese dhe sasive efektive që gjenden brenda ambalazhit, si dhe në cilësi, llojshmëri, qenien e plotë dhe markën e prodhimit, komisioni ndërpret verifikimin dhe lajmëron shitësin që të paraqitet brenda një afati kohor të përcaktuar (ne varësi te vendndodhjes brenda ose jashtë juridiksionit ku ushtron veprimtarinë njësia publike ne marrëdhënie me furnitorin).

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Procedurat Operacionale të Menaxhimit të Mjeteve Motorike, (moduli i fletës së udhëtimit), autorizuar nga Administratori i shoqërisë, më datë 06.03.2015.

Ndikimi/Efekti: Mos respektimi, dhe dokumentimi me korrektësi i procedurave të shpenzimeve për karburant sjell në rritjen e riskut të keqpërdorimit të burimeve financiare të shoqërisë.

Rëndësia: I mesëm

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tiranë, duhet të marrë masa që në ardhmen, procedurat e rimbursimit të shpenzimeve për karburant, të ndiqen me korrektësi, duke plotësuar të gjitha dokumentat justifikues përkatës, me qëllim që të jenë efektive, dhe të shërbejnë për pasqyrimin e gjurmës së auditimit.

Për sa më sipër mban përgjegjësi A G, në cilësinë e shefit të Sektorit të Shërbimeve të Brendshme.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin nr. 546/4 Prot, datë 19.11.2020 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.12149/10, datë 22.12.2020, vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH-së, më datë 28.12.2020. nga E B, L M , A G , E D, dhe T K ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Me shkresën nr. 5842/35 datë 18.09.2020 "Akt konstatimi nr. 6", për urdhrin nr. 532 datë e 10.01.2018, urdhrin nr 341 date 08.01.2019, urdhrin nr. 421 date 09.01.2019 dhe urdhrin nr. 550 date 15.01.2020 me objekt "Për krijimin e komisionit të blerjeve në vlere të vogël", Kontrolli i

Larte i Shtetit, përfaqësuar nga z. B SH dhe z.G P , kanë kryer auditimin e procedurave te prokurimit për objektet e mëposhe:

Ne shkresën nr 5842/35 date 18.09.2020, për auditimin e bere nga ana Juaj për procedurën e prokurimit me objekt: "Zhdoganimi i praktikave te OSHEE SHA", ju konstatooni se per vitet 2017, 2018 dhe 2019 praktikat e OSHEE për importin e mallrave kane te bëjnë me blerjen e energjisë në tregun e jashtëm. Në këtë konstatim, Ju mendoni se janë të paparashikueshme sasia e blerjes së energjisë dhe praktikat e doganore qe kane lidhje me to, vështirësojnë procesin e përlllogaritjes së vleres së fondit limit.

Në shkresën nr 24567 date 07.11.2017, shkresën nr 14802 date 25.07.2018 dhe shkresën nr 990 date 22.07.2019, Kërkesë për ofrimin e shërbimit të praktikave të zhdoganimit", Departamenti Ekonomik ne OSHEE SHA, specifikon: "Ju informojme se OSHEE SHA kryen rreth 300 veprime doganore në vit për nevojat te saj".

Referuar VKM nr 914 date 29.12.2014 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, Neni 43, paragrafi pare ku citohet: "Një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyre te përsëritur dhe/ose kur është e vështire ose e pamundur për të përcaktuar paraprakisht volumet qe duhet te prokurohen dhe/ose nuk ka siguri për kohën e dorëzimeve/realizimeve e te ekzekutimit te kontratave" bazuar ne kërkesat e bëra nga Departamenti Ekonomik, ku specifikohet sasia dhe afati kohor për realizimin e kontratës për zhdoganimin, Komisioni i Blerjeve me vlere te vogël e ka te pamundur zhvillimin e një procedure marrëveshje kuadër.

Sipas rekomandimit Tuaj, mendojmë se ne një të ardhme bashkëpunimi midis Departamentit Ekonomik dhe Departamentit te Shërbimeve Mbështetëse (Sektori Prokurimeve) do jete për një zhvillim sa me efikas për këtë procedure prokurimi.

Referuar nenit 57 te VKM nr 914 date 29.12.2014, i ndryshuar, ku kërkohet "Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit (Ndryshuar me VKM nr.797, date 29.12.201, pika 3 paragrafi pare ku citohet: "Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion", Komisioni i blerjeve me vlere te vogël i është referuar kërkesës dhe specifikave te Drejtorisë së Teknologjisë se Informacionit, si drejtoria përkatëse për fushën e teknologjisë dhe informacionit.

Për sa i përket faktit te konstatuar nga Grupi i Auditimit se Z. T K ka përpiluar marrjen ne dorëzim te kartave SIM dhe në një periudhe te mëvonshme është bere pranimi i faturës tatimore sqarojmë se pikërisht nga vete titulli i procedurës" Blerje karta SIM" me hartimin e kontratës OE V SHA duhet te bënte dorëzimin e këtyre kartave për tu përdorur nga pajisjet ne dispozicion te punonjësve. Me pranimin e faturës Z. T K ka konfirmuar marrjen e shërbimit sipas specifikimeve teknike qe shoqëronin kartën SIM, pra mbulimin me internet, konsumin e internetit etj.

Referuar udhëzimit nr 4 date 09.01.2018 "Mbi përdorimin e sistemit dinamik te transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", leu specifikohet: "Ne raste specifike. KSDBTAN në varësi të specifikes së objektit të prokurimit mundtë kërkojë plotësimin e një ose disa kriterëve te veçanta. duke përcaktuar ne (ftesën për oferte dokumentacionin përkatës provues si: certifikatë akreditimi ose një vërtetimi të lëshuar nga IATA".

Gjithashtu ju konstatuat se OE ne fushën e aktivitetit nuk kishte objektin e prokurimit.

Komisioni, duke ju referuar njoftimit nr 6504/3 date 26.09.2018 "Njoftim" të Agjencisë se Prokurimit Publik, pika 4, paragrafi 1, paragrafi 2, paragrafi 3 dhe paragrafi 4, ka patur ne konsiderate këtë rekomandim ku objekti i prokurimit duhet te jete përfshirë ne fushën e veprimtarisë se ofertuesve por jo domosdoshmërisht i specifikuar në mënyrë te njëjtë sipas emërimit te objektit të prokurimit.

Në lidhje me procedurën "Suporti dhe mirëmbajtja e sistemit Call-Center" ju keni konstatuar se sipas përshkrimit specifik ne kontrate OE Communication Progress SHPK ka marre parapagim vlerën e kontratës se lidhur ne procedurën e sipërcituar. Sqarojmë Grupin e Auditimit se duke pare me kujdes specifikimet teknike te kësaj procedure, kuptohet qe realizimi i objektit të kontratës ka te beje me blerjen e një licencë. Si pasoje duke pasur parasysh se aktivizimi i kësaj licence behet qe me datën e fillimit te kontratës, OE kërkon që vlera ti behet parapagim pasi software qe

kryen menaxhimin e sistemit blihet nga prodhuesi i këtij softwari per llogari te AK dhe për te garantuar funksionimin e pajisjes ne fjale. Gjithashtu bëjmë me dije Grupin e Auditimit se ndërkohe behet fjale për një kontrate e cila është zbatuar me sukses dhe është konfirmuar si e tille. Ne lidhje me faktin e konstatuar nga Grupi i Audituesve për dokumentimin e shpenzimeve te karburantit ne SSHB/DSHM, se nuk janë firmosur fletët e udhëtimit nga personat përgjegjës, sqarojmë se: Bazuar ne "Procedurën e përdorimit te mjeteve motorike ne OSHEE SHA", është e vërtetë qe fleta e udhëtimit përben një nga dokumentacionet qe duhet te plotësohet për kontrollin dhe verifikimin e lëvizjeve te mjetit. Duke pasur parasysh qe kjo procedure është hartuar ne një kohe kur nuk ekzistonte as mbushja elektronike e mjeteve me karburant dhe as monitorimi i mjeteve me sistemin gjurmues GPS, atë kohe plotësimi i këtij formulari konsiderohej me se i nevojshëm. Qe nga momenti i aktivizimit te këtyre sistemeve shume te rëndësishëm, dhe duke qene se përdoruesi i mjetit konfirmon tërheqjen e sasisë me ane te flete-daljes dhe formularit mujor te lëvizjes, Bashkuar këto me raportin mujor qe sistemi GPS gjeneron, mendojmë se këto dokumente janë më se te mjaftueshme për te dokumentuar konsumin e karburantit ne OSHEE SHA gjate kësaj kohe SSHB është angazhuar se bashku me DZHB për rishikimin e procedurës se përdorimit te mjeteve motorike, duke vendosur aty edhe risitë që vijnë nga aplikacionet e vendosura gjate kësaj kohe për monitorimin dhe kontrollin e konsumit te karburantit dhe disiplinimin e lëvizjes se mjeteve motorike.

Për sa trajtuam më sipër, kërkojmë të merret në konsideratë observacioni ynë në lidhje me Projekt raportin bazuar në Akt Konstatimin Nr. 6 të Grupit të Auditimit dhe të rishihet përgjegjësia e Z.L M , A G , E D, E B në procedurat e konstatuara nga Grupi i Auditimi në OSHEE SHA.

Oëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, të cilat janë diskutuar dhe në intervistat e punës, të kryera për çështjet e trajtuara në Projekt Raport, dhe duke mos u sjellë evidencë vërtetuese e re, komentet sa më sipër nuk merren në konsideratë dhe trajtohen në materialin e auditimit.

Për sa më sipër mban përgjegjësi J S në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit, L M , në cilësinë e kryetarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla, A G, E D në cilësinë e anëtarëve të komisionit të blerjeve me vlera të vogla, T K në cilësinë e marrësit në dorëzim të shërbimit.

Si konkluzion: Shoqëria duhet të kryejë një rishikim të produrave të rimbursimit të shpenzimeve për dieta dhe ato të shpenzimeve për karburant, me qëllim që të jenë efektive për pasqyrimin e gjurmës së auditimit.

2.6. Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësit e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë; analiza e debitorëve e kreditorëve; arkëtimi i detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj., ndaj buxhetit të shtetit.

Është shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni i pasqyrave financiare për periudhat ushtrimore 2017-2018. Pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore 2019, nuk ishin aprovuar nga drejtimi i shoqërisë për gjatë periudhës së auditimit, për arsye të shtyrjeve të afateve të dorëzimit të pasqyrave financiare nga situata e krijuar nga Covid-19.
- Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.
- Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.
- Dokumentacioni i mbajtur mbi përllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve fiskale.
- Dokumentacioni i mbajtur mbi detyrimet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Përgatitja dhe paraqitja e pasqyrave financiare është bërë përgjithësisht në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe statutit të shoqërisë. Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, (SNRF). Shoqëria i ka përgatitur pasqyrat financiare në bazë të parimit të vijimësisë që supozon se shoqëria do të përmbushë kërkesat e veta për financime, apo për të paguar detyrimet e saj në kohën kur kërkohen dhe për të vazhduar aktivitetet e saj në të ardhmen.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç rasteve kur SNRF kërkon baza të tjera matje.

Titulli i Gjetjes: Shoqëria nuk ka kryer inventarizimet fizike të aktiveve afatgjata për periudhat 2017, 2018

Situata: -Shoqëria nuk ka kryer inventarizimet fizike të aktiveve afatgjata për periudhat 2017, 2018, duke mos kryer verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre.

-Shoqëria nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky regjistër.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7, Inventari i aktiveve dhe detyrimeve, ku citohet: *1. Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse. 2. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivitet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore.*, dhe pikat 73 e 74 Inventarizimi i aktiveve, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar ku citohet:

73. Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike. 74. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

Si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30, ku përcaktohet:

“Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit,

përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia”.

Ndikimi/Efekti: Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivitetet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Vështirësitë për realizimin lidhur me shpërndarjen dhe numrin e madh të aktiveve gjendje në kontabilitet.

Rekomandime: Administratori i shoqërisë, dhe Nëpunësi Zbatues duhet të marrin masa për kryerjen e inventarizimeve vjetore të aktiveve fizike të shoqërisë, si dhe për plotësimin e regjistrit të aktiveve që shoqëria zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Për sa më sipër mban përgjegjësi drejtimi i shoqërisë.

Titulli i Gjetjes: Mos marrja e certifikatave të pronësisë, në vijim të VKM-ve përkatëse për kalimin e pronave shtetërore në zotërim të OSHEE

Situata:-Shoqëria nuk ka përfunduar procesin e kalimit të pronësisë nga Inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, të iniciuara me VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA”, për arsye të zënies së aseteve nga palë të treta, vonesave në çështje gjyqësore, mungesë dokumentacioni.

Kriteri: -Shoqëria nuk ka zbatuar plotësisht VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA” pikat 1,2,3, për regjistrimin e pasurive në zbatim të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar me ligjin nr. 9/2016, datë 11.02.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 33/2012, neni 45 ku citohet:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) SHA, sipas lidhjeve (gjithsej 1416 fletë), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Heqjen nga inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, të sistemit të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, në përgjegjësi administrimi të KESH SHA-së, miratuar me vendimin nr.122, datë 4.3.2004 të Këshillit të Ministrave, të pronave, që i përkasin sistemit të shpërndarjes, sipas fletëve, të përcaktuara në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në inventarin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të prodhimit dhe të transmetimit të energjisë elektrike, në përgjegjësi administrimi të KESH SHA-së, ndryshohen të dhënat për pronat, sipas tabelave (gjithsej 3 fletë), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

-Neni 45 Regjistrimi i kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ. Në rastet kur shteti, personi juridik/fizik ka fituar të drejtën e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme, me anë të ligjit, vendimit gjyqësor të formës së prerë për fitimin apo kalimin e së drejtës së pronësisë apo të aktit të një organi administrativ, regjistruesi, mbështetur në këto akte të paraqitura nga personi i interesuar, bën regjistrimin, duke shënuar pronar shtetin, personin juridik/fizik, të cilit i ka kaluar e drejta e pronësisë.

Ndikimi/Efekti: Mos përfundimi i këtij procesi rrit riskun, që objektet që nuk kanë të përfunduar procesin mund të tjetërsohen nga palë të treta.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime: Nga titullari i shoqërisë të merren masa që në të ardhmen, të ndiqet me përgjegjshmëri përfundimi i procesit të kalimit të pronësisë nga Inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, në shoqërinë OSHEESHA.

Për sa më sipër mban përgjegjësi A Ç, në cilësinë e administratorit të shoqërisë dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

Për afatet e hartimit dhe deklarimit të pasqyrave financiare

Departamenti Ekonomik ka dorëzuar në sistemin tatimor në datën 22.01.2019, pasqyrat financiare për vitin 2017, të shoqëruara me relacionin përkatës është miratuar në Këshillin Mbikëqyrës me vendimin nr. 42 datë 28.12.2018 “ Për miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2017”.

Me vendimin nr. 42, datë 28.12.2018, Këshilli Mbikëqyrës vendosi miratimin e pasqyrave financiare të periudhës 2017.

Miratimi i bilancit të vitit 2017, për SHA “OSHEE”, Tiranë, është bërë nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 9921/10, datë 31.12.2018, duke miratuar rezultatin e ushtrimit nga aktiviteti në vlerën 1,830,159,671 lekë duke e kaluar për mbulimin e humbjeve të periudhave të mëparshme.

-Për vitin 2018, pasqyrat financiare janë dorëzuar në sistemin tatimor më datë 19.08.2019.

Me vendimin nr. 29, datë 27.09.2019 Këshilli Mbikëqyrës miratoi pasqyrat financiare të periudhës 2018.

Miratimi i bilancit të vitit 2018, për SHA “OSHEE”, Tiranë, është bërë nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 8851/4, datë 24.12.2018, duke miratuar rezultatin e ushtrimit nga aktiviteti në vlerën 1,947,375,000 lekë, duke e kaluar për mbulimin e humbjeve të periudhave të mëparshme.

Titulli i Gjetjes: Depozitimi i pasqyrave financiare, në organet përkatëse, jo sipas afateve ligjore.

Situata:-Depozitimi në sistemin tatimor është kryer jashtë afatit ligjor në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 29.

-Aprovimi nga asambleja e ortakëve është kryer jashtë afatit të caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1.

-Më datë 31.01.2019, me numrin e çështjes CN-085852-01-19, nga shoqëria është kryer depozitimi i pasqyrave financiare të periudhës 2017, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në regjistrin e shoqërive tregtare.

Kriteri: Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 29, Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit ku citohet:

“ 1. Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

-Aprovimi nga asambleja e ortakëve është kryer jashtë afatit të caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1 ku citohet:

“Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit I. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asambleshë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahe në formë dividendi”.

Depozitimi jashtë afateve ligjore është në kundërshtim me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, neni 43, Regjistrimet e tjera të detyrueshme dhe neni 46 ku citohet :

“....3. Përveç sa parashikohet në pikën I të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:a) pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme; Neni 46, Regjistrimi i pasqyrave financiare, 1. Subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë, në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5, të nenit 22, të këtij ligji, detyrohen në çdo rast t'i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar.”

Ndikimi/Efekti: Vonesat në hartimin, aprovimin dhe depozitimin kanë pasoja në vlerësimin e

gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike si dhe për vendim-marrjet e palëve të interesuara.

Rëndësia: E lartë

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të merren masa që në të ardhmen, pasqyrat financiare të hartohen, të depozitohen, të aprovohen brenda afateve ligjore, duke mundësuar vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike lidhur me vendim-marrjet që duhet të marrin palët e interesuara, si asambleja e ortakëve, institute kredidhënie etj.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi administratori i shoqërisë dhe Këshilli Mbikëqyrës, lidhur me përgjegjësinë që kanë për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të shoqërisë.

Titulli i Gjetjes: Mos përputhshmëri ndërmjet sistemit të mbajtjes së kontabilitetit SAP dhe sistemit të faturimit

Situata:-Në pasqyrat financiare të shoqërisë ekziston një mospërputhje e llogarive të arkëtueshme midis sistemit faturimit & arkëtimit dhe të pozicionit financiar “Të arkëtueshme” (kontabilitetit) për gjendjen e klientëve më 31 dhjetor 2017. Mospërputhja midis sistemit “SAP” dhe sistemit faturimit, arkëtimit dhe kontabilitetit më 31.12.2017 arrijnë në vlerën **1,169,392** mijë lekë, kundrejt **1,287,749** mijë lekë që rezultonte kjo mospërputhje më 31.12.2016.

-Shoqëria OSHEE SHA rezulton me gjendje negative të kapitalit aksioner për (33,212,472) mijë lekë, i cili ka ardhur kryesisht nga humbjet e akumuluar në vitet e kaluara ku në fund të vitit 2017 rezultojnë (69,292,022) mijë lekë.

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku citohet:

Qëllimi i pasqyrave financiare 1. Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësisë ekonomike” dhe neni 136, pika 3, e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ku citohet:Asambleja e përgjithshme duhet të thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.”

Ndikimi/Efekti: Mos përputhja e vlerave nuk jep besueshmëri për paraqitjen e pasqyrave financiare. Kapitali negativ i shoqërisë është tregues i gjendjes jo të mirë financiare të shoqërisë.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese dhe lidhur me pjesën e dytë kompleksiteti i situatës së trashëguar që ndodhet shoqëria.

Rekomandime: Nga drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe të Financës të merren masa për verifikimin e diferencave të llogarive të arkëtueshme klientë që janë ndërmjet sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe sistemit të faturimit.

Për sa më sipër mban përgjegjësi drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Financës, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare.

Titulli i Gjetjes: Njohje e njëanshme e të ardhurave të shoqërisë nga penalitetet ndaj KESH SHA.

Situata:-OSHEE SHA ka njohur të ardhura nga penalitetet ndaj KESH SHA si rezultat i mos respektimit të kontratës në vlerën prej **5,543,701** mijë lekë me faturën nr. 4, datë 31.03.2018.

Nga KESH SHA, kjo faturë nuk është pranuar duke argumentuar se furnizimi me energji nuk u realizuar për arsye të kushteve të thata klimaterike, pra për arsye madhore të përcaktuara në kontratë.

Me shkresën nr. 2260/1 datë 02.05.2018, administratori i KESH SHA, ka refuzuar firmosjen e faturës së mësipërme duke trajtuar argumentet e tij për pasaktësinë e lëshimit të penalitetit, duke njoftuar dhe MIE.

Diferenca që vjen nga deklarimi si e ardhur e kësaj fature në rezultatin e vitit 2017 sjell

efektet që shoqëria ka pasur si rezultat financiar fitim të periudhës në vlerën 3,422,482 mijë lek para tatimit mbi fitimin dhe 1,566,726 mijë lek pas taksave kur në zbatim të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit nuk duhej ta përfshinte si e ardhur vlerën 5,543,701 mijë lek duke pasur rezultatin në vlerën 2,121,219 mijë lek humbje.

Veprimi i mësipërm ka ndryshuar rezultatin e shoqërisë nga humbje duke u paraqitur me fitim të vitit ushtrimor. Vlera **5,543,701 mijë lek përbën 10 % të vlerës së të ardhurave totale** të OSHEE-së për vitin 2017 e cila është 53,542,863 mijë lekë, pra është një vlerë materiale në raport me të ardhurat e shoqërisë.

Marrëdhëniet mes shoqërisë KESH SHA dhe OSHEESHA, janë objekt i VKM Nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, neni 5.

Nga sa më sipër marrëdhënia mes dy shoqërive përcaktohet në kontratën mes palëve e cila miratohet nga ERE, kontratë e cila në vitin 2017 nuk është pranuar nga KESH SHA.

Administratori i OSHEE-së, me shkresën nr. 14369/1 Prot., datë 07.08.2018, “Situata e krijuar nga KESH në lidhje me mos pranimin e njëanshëm të faturës së penaltetit për “Kompensim dëmi për mos lëvrim sasive energjie”, sipas kontratës dypalëshe”, drejtuar MIE, ka adresuar problematikën e krijuar.

Me shkresën nr. 498/4, datë 04.09.2018, drejtuar KESH SHA, OSHEESHA dhe MIE, Enti Rregullator i Energjisë, si përgjigje të shkresave të palëve për sqarime, ka cituar nenin 2, “Sasia e kontraktuar”, dhe nenin 9, “Zhdëmtimet/Kompensimet”, duke u shprehur se KESH SHA ka detyrimin për livrimin e energjisë elektrike për OSHEESHA, referuar kontratës mes palëve për periudhën 2017, pa u shprehur qartë se fatura duhet të njihet nga KESH SHA.

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe VKM nr. 317, datë 27.04.2016, “Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike”, me vendimin nr. 9687/4 datë 20.12.2018, ish-Ministri i MIE, në cilësinë e aksionerit të vetëm të shoqërisë KESH, ka vendosur për njohjen e faturës dhe ka urdhëruar administratorin për aplikimin e vendimit.

Si konkluzion: Në një situatë normale mos marrëveshja mes palëve do të zgjidhej në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, e Kodit Civil, dhe njohja e faturës nr. 4, datë 31.03.2018, nuk duhet të ishte bërë si e ardhur në pasqyrat financiare të periudhës 2017, por do të mbahej me rezervë në shënimet shpjeguese deri në vendimin e organeve gjyqësore.

Në situatën mes KESH SHA dhe OSHEESHA, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e pronarit ka vendosur për pranimin e një penalteti që ka sjellë zvogëlim në aktivet e shoqërisë KESH SHA.

Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, i hartuar për mbrojtjen e të drejtës së pronës së aksionerëve, nuk ka asnjë dispozitë që të ndalojë ortakun të pranojë zvogëlim të aktiveve në shoqërinë ku zotëron kuotat e kapitalit.

Kriteri: Veprimet më sipër janë në kundërshtim me ligjin Nr.9228, d/atë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare parimet dhe përbërësit e pasqyrave financiare”, Neni 9, ku citohet:

Respektimi i standardeve kontabël, pika,1. Pasqyrat financiare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen financiare dhe rrjedhjen e parasë së njësisive ekonomike. Pasqyrat financiare përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël. Neni 18, Përgjegjësitë, 1. Organi i drejtimit ekzekutiv të njësisë ekonomike dhe organi i tij mbikëqyrës, të punësuar ose jo, janë përgjegjës për përmbushjen e të gjitha kërkesave, të parashikuara nga dispozitat e këtij ligji.

Këto veprime janë në kundërshtim me Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar, pjesa për paraqitjen besnike, ku citohet:

“KC12, Raportet financiare paraqesin dukuritë ekonomike në fjalë dhe në shifra. Që të jetë i dobishëm, informacioni financiar jo vetëm duhet të përfaqësojë fenomene përkatëse, por gjithashtu duhet të

paraqesë me besnikëri fenomenet që ai synon të paraqesë. Që të ketë një paraqitje besnike të përkryer, një përshkrim duhet të ketë tre karakteristika. Ai duhet të jetë i plotë, neutral dhe pa gabime.

KC14. Një përshkrim neutral është zgjedhja apo paraqitja e informacionit pa paragjykim. Një përshkrim neutral nuk shtrembërohet, ponderohet, theksohet ose jo, **ose ndryshe nuk manipulohet për të rritur probabilitetin që informacioni financiar të merret i favorshëm apo i pafavorshëm nga përdoruesit.** Informacioni neutral nuk do të thotë informacion pa asnjë qëllim apo pa asnjë ndikim në sjellje. **Në të kundërt, informacioni financiar përkatës është, sipas përkufizimit, i aftë të bëjë një ndryshim në vendimet e përdoruesve.”**

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, **kreu II, neni 167, ku citohet:**

“Përbërja, të drejtat e detyrimit e këshillit mbikëqyrës dhe administratorët; 1. Këshilli mbikëqyrës është përgjegjës për të gjitha funksionet e përcaktuara në pikat 1, shkronjat “b” deri në “g” e “i” dhe 2 të nenit 154 të këtij ligji. Neni 154, “Të drejtat dhe detyrimet; 1. Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi: e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrimit për t’iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;”

Neni 164 - Përgjegjësia solidare e këshillit të administrimit dhe e administratorëve. Anëtarët e këshillit të administrimit dhe administratorët përgjigjen në mënyrë solidare për vërtetësinë e të gjitha pasqyrave financiare, të publikimeve të detyrueshme dhe informacioneve të tjera kryesore të veprimtarisë së organizimit të shoqërisë, si ato vijuese, por pa u kufizuar në to, informacionin për sistemin e menaxhimit të riskut të shoqërisë, prospektet e veprimtarisë, planet e investimeve, burimet teknike, organizative dhe burimet, strukturat e praktikave të miradministrimit të shoqërisë.

Pikat 3 e 5 të nenit 163 të këtij ligji zbatohen edhe për parashikimet e këtij neni.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 5, të VKM Nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, ku citohet:

“Dispozita të veçanta për detyrimin e shërbimit publik, Neni 5, Detyrimi i Shërbimit Universal të Furnizimit 1. Shërbimi Universal i Furnizimit është një detyrim i shërbimit publik që i vendoset Furnizuesit të Shërbimit Universal, i cili siguron të drejtën e furnizimit me energji elektrike për një kategori të caktuar të klientëve, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një cilësi të caktuar të furnizimit, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese. 2. Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i vendoset detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti. **Sasia e energjisë elektrike përcaktohet në kontratën e rregulluar ndërmjet palëve, që miratohet nga ERE, bazuar në një regjim racional shfrytëzimi të kapaciteteve gjeneruese dhe nivelit historik mesatar vjetor të prodhimit.** 3. Në rastet kur Furnizuesi i Shërbimit Universal **nuk mund të sigurojë sasinë e nevojshme nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, sipas përcaktimeve të vendosura në pikën 2, të këtij neni, Furnizuesi i Shërbimit Universal ka detyrimin që të sigurojë sasinë e nevojshme të energjisë në tregun e parregulluar.**

Furnizuesi i Shërbimit Universal kompensohet nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, për sasinë e siguruar në tregun e parregulluar, sipas diferencës ndërmjet çmimit të rregulluar të prodhimit të energjisë elektrike dhe çmimit mesatar të bursës hungareze HUPX, për periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë, për produktin/profilin në bandë, siç publikohet në website-in e kësaj burse (www.hupx.hu).

4. Sasia e tepërt e energjisë elektrike, e krijuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga furnizimi universal, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, sipas përcaktimeve të vendosura në pikën 2, të këtij neni, i shitet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për mbulimin e humbjeve, sipas çmimit mesatar të b h HUPX, për periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë, për produktin /profilin në bandë, siç

*publikohet në website-in e kësaj burse dhe përcaktohet, në mënyrë të detajuar, në kontratë. Në këtë rast, sasia e shitur Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të tejkalojë sasinë e energjisë që është e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet. **Kontrata ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe prodhuesit të energjisë elektrike miratohet nga ERE.***

Ndikimi/Efekti: Diferenca që vjen nga deklarimi si e ardhur e kësaj fature në rezultatin e vitit 2017 sjell efektet që shoqëria ka pasur si rezultat financiar fitim të periudhës në vlerën 3,422,482 mijë lek para tatimit mbi fitimin dhe 1,566,726 mijë lek pas taksave kur në zbatim të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit nuk duhej ta përfshinte si e ardhur vlerën 5,543,701 mijë lek duke pasur rezultatin në vlerën 2,121,219 mijë lek humbje.

Veprimi i mësipërm ka ndryshuar rezultatin e shoqërisë nga humbje duke u paraqitur me fitim të vitit ushtrimor. Vlera 5,543,701 mijë lek përbën 10 % të vlerës së të ardhurave totale të OSHEE-së për vitin 2017 e cila është 53,542,863 mijë lekë, pra është një vlerë materiale në raport me të ardhurat e shoqërisë.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë duhet të marrë masa që në të ardhmen, përgatitja dhe hartimi i pasqyrave financiare të kryhet me përgjegjshmëri, vërtetësi e në afatet përkatëse, duke pasqyruar situatën financiare dhe performancën ekonomike, për disponimin e informacioneve palëve të interesuara në kohë, për vendim- marrjet përkatëse.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ish ministri i MIE, në cilësinë e ortakut të vetëm të OSHEE dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë.

Titulli i Gjetjes: Mos dhënia e informacionit për normat e amortizimit të aplikuara, si dhe vendosje e normave menaxheriale jo të argumentuara

Situata: -Për periudhën 2017, janë përllogaritur shpenzime amortizimi në vlerën 2,528,909,000 lekë. Në shënimet shpjeguese nga drejtimi i shoqërisë nuk janë paraqitur informacione sqaruese lidhur me vlerësimet dhe arsyet e përcaktimit të jetës së dobishme së AAM-ve, pra për normat e amortizimit të aplikuara në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore në kundërshtim me pikën 75 të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16, Aktivitet Afatgjatë Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje).

-Në lidhje me përllogaritjen e shpenzimeve të amortizimit, shoqëria përdor norma menaxheriale si dhe normat fiskale, duke paraqitur diferencën në shpenzimet e pa zbritshme, të rezultatit të periudhës ushtrimore. Normat menaxheriale dhe ato fiskale të përdorura kanë mbetur të pandryshuara nga periudha e ish CEZ. Jetëgjatësia e aktiveve është rishikuar nga vlerësimi i kryer nga grupi i ekspertëve vlerësues dhe kontabël, që me urdhrin nr. 1460, datë 20.02.2015, i ndryshuar të ministrit të MZHETTS si dhe bazuar në kontratën nr. 23318 prot., datë 31.12.2015 “Për rivlerësimin e aktiveve afatgjatë materiale të shoqërisë OSHEESHA”.

Nga shqyrtimi i normave menaxheriale dhe atyre fiskale në rastin e klasës VE1, automjete autovetura është vendosur jeta e dobishme e asetit në 4 vjet. Nga verifikimet u konstatua se në periudhën 2016, ishin blerë 11 Makina elektrike tip "Golf" (autovetura), me vlerë totale 50,024,700 lekë me afat amortizimi në 4 vjet. Vendosja e jetës së dobishme nuk është e justifikuar dhe e argumentuar me materiale shpjeguese ose manualët përkatëse.

Duke mos përdorur norma menaxheriale të mirëargumentuara nga specialistët përkatës dhe duke mos e përcaktuar me fleksibilitet jetëgjatësinë e aktiveve, duke vlerësuar dhe zhvillimin e teknologjisë, shoqëria rrezikon të mos kryej me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 23, shkronja d, e Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Kriteri: Kjo është në kundërshtim me pikën 75 të SNK 16, Aktivitet Afatgjatë Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje), ku citohet:

“Zgjedhja e metodës së amortizimit dhe vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve është çështje gjykimi. Prandaj dhënia e informacioneve shpjeguese për metodat e përdorura dhe vlerësimet e jetëve të dobishme ose të normave të amortizimit, u siguron përdoruesve të pasqyrave financiare informacion që

i lejon ata të shqyrtojnë politikat e zgjedhura nga drejtimi dhe mundëson krahasimin me njësi të tjera ekonomike., dhe 76 “Në përputhje me SNK 8 një njësi ekonomike jep informacion shpjegues për natyrën dhe efektin e një ndryshimi në vlerësimin kontabël që ka efekt në periudhën aktuale ose pritet të ketë efekt në periudhat e mëpasshme. Dhënia e këtyre informacioneve shpjeguese për aktivet afatgjata materiale mund vijë nga ndryshimet në lidhje me: (a) vlerat e mbetura; (b) kostot e vlerësuara të zbërthimit, heqjes ose rikrijimit të zërave të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje); (c) jetët e dobishme; dhe (d) metodat e amortizimit.”

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 23, shkronja d, e Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku citohet:

Përcaktimin e sistemeve dhe procedurave për zëvendësimin apo shtimin e aktiveve afatgjata. Planifikimi në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të tyre të jetës është një tjetër mënyre për parandalimin e mosfunksionimit dhe papritur të ndonjë aktiviteti. Jetëgjatësia standarde që jepet në regjistrin e aktiveve afatgjata nëpërmjet normave të amortizimit është një tregues se kur një aktivitet duhet të zëvendësohet. Është e rëndësishme që jetëgjatësia standarde të mos ndiqet verbazi, pasi aktiviteti mund të vazhdojë të jete në gjendje pune dhe njëkohësisht i nevojshëm ose i dobishëm për plotësimin e objektivave të njësisë. Dobishmëria e çdo aktiviteti duhet vlerësuar nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, i cili ngrihet dhe funksionon sipas kriterëve të këtij udhëzimi.

Ndikimi/Efekt: Duke mos përdorur norma menaxheriale të mirëargumentuara nga specialistët përkatës dhe duke mos e përcaktuar me fleksibilitet jetëgjatësinë e aktiveve, duke vlerësuar dhe zhvillimin e teknologjisë, shoqëria rrezikon të mos kryej me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të merren masa për vlerësimin e jetëgjatësisë së aktiveve, duke përdorur fleksibilitet dhe relacione të mirë argumentuara nga specialistët përkatës, për klasa specifike të aktiveve dhe jo të përgjithshme, për planifikimin në kohë të zëvendësimit të aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.

Për sa më sipër mban përgjegjësi C K, në cilësinë e nëpunësit zbatues të shoqërisë.

Titulli i Gjetjes: Mos zbatim i SNA 200 “Objektivat e përgjithshëm të audituesit të pavarur në kryerjen e një auditimi, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”, nga audituesit ligjorë.

Situata: Në opinionin e dhënë nga audituesit e pasqyrave financiare, në raportet auditimit dhe/apo letrat e rekomandimit për drejtimin, konstatohet se audituesit e pasqyrave financiare ndër vite, kanë kryer auditimin e tyre në zbatim të SNA 200 “Objektivat e përgjithshëm të audituesit të pavarur në kryerjen e një auditimi, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”, por nuk janë shprehur për zbatimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë në përputhje me SNA 250 “Mbajtja parasysh e ligjeve dhe rregullave në një auditim të pasqyrave financiare”, pikat 2-3, gjë që evidentohet me gjetjet e trajtuar në këtë raport, në të cilat citohet:

Kriteri: Sa më sipër është në kundërshtim me SNA 250 “Mbajtja parasysh e ligjeve dhe rregullave në një auditim të pasqyrave financiare”, pikat 2-3, në të cilat citohet:

Efekt i Ligjeve dhe Rregullave 2. Efekt në pasqyrat financiare i ligjeve dhe rregullave ndryshon shumë. Këto ligje dhe rregulla, të cilëve ju nënshtrohet entiteti, përbëjnë edhe kuadrin ligjor dhe rregullator. Dispozitat e disa ligjeve apo rregullave kanë një efekt të drejtpërdrejtë mbi pasqyrat financiare për faktin që ato përcaktojnë shumat që raportohen apo informacionet që jepen në pasqyrat financiare të një entiteti. Disa ligje apo rregulla të tjera duhet të respektohen nga drejtimi, ose ato përmbajnë dispozita të cilat drejtojnë kryerjen e aktivitetit të tij, por nuk kanë një efekt të drejtpërdrejtë mbi pasqyrat financiare. Mos pajtueshmëria me ligjet dhe rregullat mund të rezultojë në dënimin me gjoba, hapjen e çështjeve gjyqësore apo në pasoja të tjera, të cilat mund të kenë një efekt material në pasqyrat financiare. Përgjegjësia për Pajtueshmërinë me Ligjet dhe Rregullat (Ref: Para. A1-A8) 3. Është përgjegjësi e drejtimit që, me mbikëqyrjen e personave të ngarkuar me qeverisjen, të sigurojë se veprimtaritë e entitetit realizohen në pajtim me dispozitat ligjore dhe rregullatore, përfshirë këtu ato dispozita që përcaktojnë shumat dhe informacionet që jepen në pasqyrat financiare të entitetit. Përgjegjësia e Audituesit 4. Rregullat e këtij standardi janë hartuar për të ndihmuar audituesin në identifikimin e anomalive

materiale në pasqyrat financiare që vijnë për shkak të papajtueshmërisë me ligjet dhe rregullat. Megjithatë, audituesi nuk është përgjegjës për parandalimin e papajtueshmërisë dhe nuk mund të parashikohet të zbulojë papajtueshmërinë me të gjitha ligjet dhe rregullat.

Ndikimi/Efekti: Mos pajtueshmëria me ligjet dhe rregullat mund të rezultojë në dënimin me gjoba, hapjen e çështjeve gjyqësore apo në pasoja të tjera, të cilat mund të kenë një efekt material në pasqyrat financiare.

Rëndësia: E mesme.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të marrin masa që në të ardhmen, audituesit ligjorë në auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë, të marrin në konsideratë dhe SNA 250 “Mbajtja Parasysh e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe administratori, në cilësinë të kërkuesve të shërbimit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare të shoqërisë.

Titulli i Gjetjes: Mos shqyrtimi dhe vlerësimi i vlerës së mbetur dhe jetës së dobishme të AAM-ve.

Situata:-Shoqëria nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë, veprime në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16.

- Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre, pika 103.

Kriteri: -Shoqëria nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë, veprime në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16, ku citohet:

“Vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e një aktivi do të rishihet të paktën çdo fund-viti financiar dhe nëse pritshmëria ndryshon nga parashikimet e mëparshme, ndryshimet do të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël në përputhje me SNK 8, Politikat kontabël, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet.”

-Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre, pika 103, ku citohet:

Kriteret për vlerësimin e Aktiveve 103. Vlerësimi i Aktiveve bëhet sipas këtyre kriterëve: a. kur është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohet; b. kur riparimi është i pamundur si pasojë e konsumit dhe kur nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër; c. kur thyhen ose dëmtohen në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit, d. kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm. e. kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formën tjetër; f. kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë; g. kur janë dëmtuar e janë bërë të papërdorshme, si pasojë e fuqisë madhore (tërmet, përmytje, zjarr etj.) ose ndodhivë të rastit; h. kur si pasojë e ndryshimit të kërkesave teknike, kushteve të punës, misionit të njësisë, objektivave afatmesme ose afatgjate nuk janë gjetur mundësitë e përdorimit për qëllimin e caktuar ose për qëllime të tjera, ashtu siç janë ose edhe me përshtatje.

Ndikimi/Efekti: Mos shqyrtimi dhe vlerësimi i vlerës së mbetur dhe jetës së dobishme të AAM-ve si dhe mos evidentimi i linjave të vjetra të dala jashtë përdorimit, ka si pasojë mos pasjen e saktë dhe objektive të situatës së Aktiveve Afatgjate Materiale, si dhe planifikimit të investimeve për periudhat e ardhshme.

Rëndësia: E mesme

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime: Nga drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe të Financës të merren masa për vlerësimet

e vlerës së mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë dhe evidentimin

Për sa më sipër mban përgjegjësi C K, në cilësinë e nëpunësit zbatues të shoqërisë.

Titulli i Gjetjes: Mos kryerja e ankandit për shitjen e materialit skrap të mbetur në magazina.

Situata:-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbajtur për inventarët e datës 31.12.2019 u konstatua se shoqëria ka gjendje 4069 pjesë materiale e artikuj të ndryshëm, të vlerësuar si jashtë përdorimit me vlerë kontabël të mbetur 179,436,025 lekë.

Nga administratori i shoqërisë janë iniciuar procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit pas vlerësimit të komisioneve të ngritura. Më datë 04.06.2018, eksperti i vlerësimit i caktuar nga MIE, ka dorëzuar raportin e vlerësimit, për shkarkimin nga librat kontabël vlerën e inventarit prej 179,436,025 lekë, dhe më datë 18.10.2018, me vendimin nr. 29, Këshilli Mbikëqyrës ka aprovuar raportin si dhe ka miratuar vlerën e inventarit 108,784,007 lekë të vlerësuar për tu shitur si skrap, sasinë 495,137 kg në vlerën 30,956,459 lekë, si dhe miratimin e vlerës së inventarit 70,593,018 lekë për tu asgjësuar.

Duke u nisur nga vonesa e krijuar në aprovimin e procedurës, shoqëria ka vlerësuar se çmimi i tregut ka ndryshuar në ulje dhe çmimi i miratuar nuk reflektonte situatën, duke i kërkuar Këshillit Mbikëqyrës një amendim të kontratës me ekspertin për rivlerësim të çmimit të ankandit.

Bazuar në relacionin e administratorit të shoqërisë për shtyrjen e afatit të ekspertes E T për rivlerësimin e artikujve të miratuar për tu shitur si skrap, pasi e ka aprovuar Këshilli Mbikëqyrës, me shkresën nr. 16029/8 Prot., datë 09.08.2019, i ka përcjellë për miratim aksionerit, MIE, vendimin nr. 23, datë 25.07.2019.

Me shkresën nr. 8472/1 Prot., datë 15.11.2019, aksioneri i shoqërisë e ka konsideruar të mbyllur misionin e ekspertit vlerësues dhe kontratën e lidhur me të dhe i kërkohej OSHEE, për zhvillimin e procedurës së ankandit publik për sasinë e materialeve skrap.

Shoqëria deri në përfundim të datës së auditimit, nuk ka iniciuar procedurat për hapjen e ankandit publik veprime që ngarkojnë me përgjegjësi administratorin e shoqërisë.

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 108 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike", i ndryshuar, ku citohet:

"108. Aktivet afatgjata që konsiderohen të panevojshme për njësinë në një periudhë të mëvonshme të funksionimit të saj (në rast mbylljeje/shkrirjeje të njësisë, ndryshimi të misionit apo objektivave afatgjate të njësisë), por që mbeten në gjendje përdorimi mund të jepen në rend shterues (nga a në b). a. transferohen pa pagese në një njësi tjetër publike brenda sektorit të qeverisjes së përgjithshme. Konfirmimi zyrtar nga njëzia përfituese vërteton përfundimin e transaksionit; b. shiten në formën e ankandit publik."

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja në kohë e ankandit sjell vështirësi logjistike, duke bllokuar hapësira magazinuese si dhe rrit rrishtun për dëmtime dhe zhvlerësime të mëtejshme të vlerës së aktiveve të vendosura për tu shitur.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime: Administratori i shoqërisë të marrë masa për hapjen e procedurës së ankandit publik për shitjen e materialeve skrap, bazuar në raportin e ekspertit vlerësues, duke realizuar në këtë mënyrë testimin real të tregut, dhe proceduar më pas në vijimësi sipas situatës.

Për sa më sipër mban përgjegjësi C K, në cilësinë e nëpunësit zbatues të shoqërisë.

Titulli i Gjetjes: Dorëzim me vonesë i faturave tatimore në Drejtorinë e Kontabilitetit duke sjellë vonesa në likuidimin e detyrimeve dhe pasaktësi në llogaritjen e shpenzimeve të amortizimit.

Situata:-Nga kontrolllet e kryera në librat e blerjes për deklarimet e faturave të blerjes në sistemin tatimor, u konstatua se kishte fatura që i përkisnin periudhave ushtrimore të mëparshme ose të lëshuara nga subjektet disa muaj më parë dhe që departamentit të financës, u ishin vënë në dispozicion në muajin e deklaruar.

Në librat e blerjeve të muajit mars 2018, u konstatua e deklaruar fatura nr. 04, nr. serial 43743705, me vlerë pa TVSH 149,812,588 lekë dhe vlera me TVSH 173,775,105 lekë e cila i përkiste datës 07.07.2017, pra e deklaruar 8 muaj me vonesë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në departamentin e kontabilitetit u konstatua se me shkresën nr. 17226/6 Prot., datë 20.03.2018, dërguar drejtorit të departamentit ekonomik C K, në vijim të shkresës me nr. 17226/2 Prot., datë 11.08.2017 e ardhur nga OE “\A M” për likuidimin e situacionit përfundimtar, dërgohet dokumentacioni i plotë, nga P L, drejtor i divizionit të shpërndarjes. Fatura tatimore është firmosur nga personi i caktuar për ndjekjen e kontratës E M.

-Në librat e blerjeve të muajit shtator 2018, u konstatua fatura me nr. 33, nr. Serial 40421633, me vlerë 29,287,167 lekë pa TVSH dhe 35,144,006 lekë me TVSH, e lëshuar nga A L, e cila i përkiste datës 24.10.2017,

Me shkresën nr. 14454/6 Prot., datë 07.09.2018, nga drejtori i divizionit të shpërndarjes P L, dhe referuar kërkesës për likuidim të situacionit përfundimtar të OE me datë 18.09.2018, me nr. 14494/2 Prot., i është dërguar drejtorisë së departamentit ekonomik, dosja e plotë bashkë me faturën tatimore.

Fatura tatimore është firmosur nga personi i caktuar për ndjekjen e kontratës M D dhe proces verbali i marrjes në dorëzim të punimeve është i datës 17.11.2017.

Në situatat e mësipërme vonesa e dërgimit të faturës tatimore në departamentin ekonomik, për kontabilizim dhe deklarim në librat e shitjes, sjell problematika të ndryshme:

-Në kontabilizimin e aktivitetit dhe përcaktimin e datës së hyrjes në përdorim.

Në Standardin Ndërkombëtar i Kontabilitetit 16, *Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)*, neni 55, përcaktohet se amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, pra pasi aktivi është marrë në dorëzim dhe është bërë pjesë e sistemeve përkatëse.

Ky veprim sjell shtrembërime në llogaritjen e saktë të amortizimit të aktiveve të shoqërisë duke ndikuar në rezultatin e shoqërisë.

Kriteri: Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 5, të SNK nr.16, Aktivet Afatgjata Materiale ku citohet:

55 Amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, d.m.th. kur ai është në vendin dhe kushtet e nevojshme për të që të ketë mundësi të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi. Amortizimi i aktivitetit ndërpritet në datën më të parë mes datës që aktivi klasifikohet si i mbajtur për shitje (ose përfshirë në një grup për t'u nxjerrë jashtë përdorimit që është klasifikuar i mbajtur për shitje) në përputhje me SNRF 5 dhe datës që aktivi çregjistrohet. Prandaj amortizimi nuk ndërpritet nëse aktivi bëhet i përdorshëm ose tërhiqet përdorimi aktiv përveçse kur aktiv është plotësisht i amortizuar. Megjithatë, sipas metodave të përdorimit për llogaritjen e amortizimit, amortizimi mund të jetë zero, ndërsa nuk ka prodhim.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, ku citohet:

Neni 4 Veprimet juridike ndërmjet sipërmarrjeve tregtare dhe autoriteteve publike. Në veprimet juridike tregtare, ku debitori është një ndërmarrje tregtare apo një autoritet publik, kreditori ka të drejtë që nga dita e nesërme, pas kalimit të afatit për kryerjen e pagesës, të përfitojë kamatëvonesë, pa qenë nevoja për t'i dërguar njoftim për vendosje në vonesë debitorit, në rastet kur: a) kreditori i ka përmbushur detyrimet sipas kontratës dhe ligjit dhe debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin; b) kreditori nuk e ka arkëtuar shumën për t'u paguar brenda afatit, me përjashtim të rastit kur përgjegjës për vonesën nuk është debitori.

Ndikimi/Efekti:-Vonesat në mos likuidimin e faturave, krijojnë mundësinë e krijimit të penalteteve nga Operatori Ekonomik, i cili ka kryer objektin e investimit, dhe në bazë të neneve të kontratës dhe Ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, nenit 4, OE i lind e drejta për të kërkuar kamatëvonesa.

Veprimet e mësipërme sjellin efekte dhe në raportin e TVSH-së kreditorë dhe debitorë, duke mos pasqyruar detyrimet e sakta në kohë të shoqërisë, për pagesat e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime: Nga administratori i shoqërisë të merren masa që procesi i firmosjes së faturës tatimore nga personat e autorizuar si një dokument zyrtar i shoqërisë, i pranimit të marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, të kryhet me përgjegjshmëri dhe në bashkëpunim me departamentin e financës.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin nr. 546/4 Prot, datë 19.11.2020 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.12149/12, datë 22.12.2020, vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH-së, më datë 28.12.2020.

Pretendimi i subjektit:

Në vijim të Projekt Raportit të Auditimit me Nr. 546/4 Prot., datë 19.11.2020, lutem gjeni bashkëlidhur komentet lidhur me konstatimet dhe gjetjet.

Me Akt- Konstatimin Nr. 7, protokolluar me Nr. 5842/36 prot, datë 18.09.2020, Audituesit e Autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit pranë OSHEE Group SHA, në faqen nr.11 të këtij akt-konstatimi, është konstatuar dërgimi i shkresës nr.1722616 Prot., datë 20.03.2018 pranë DEK, sqarojmë se fatura nr.04 me numër serie 43743705 është e datës 07.07.2017, date e cila është data e fundit e punimeve në objekt sipas ditarit te punimeve.

Ju informojmë se në këtë objekt punimet kanë përfunduar në datën 07.07.2017 sipas proces-verbalit të përfundimit të punimeve, date 07.07.2017. (dokumenti bashkëngjitur)

Objekti është marrë ne dorëzim me date 31.08.2017 sipas proces verbalit te marrjes ne dorëzim te punimeve nr. 17226/S Prot., datë 31.08.2017. (dokumenti bashkëngjitur). Nënvizoj se: Objekti nuk është marrë në dorëzim në datën 31.05.2020, datë e vendosur në këtë akt-konstatim.

Gjate periudhës nga ardhja e dosjes deri në dërgim të saj ne DEK, është plotësuar edhe me dokumentacion për akordimet e materialeve të demontuara dhe te hera hyrje ne magazine, te cilat janë pjesë e kësaj dosje. Konkretisht në periudhën e demontirnit po behej përditësimi i sistemit SAP për magazinat e OSHEE për aktivet e gjithë territorit te Shqipërisë, për këtë arsye ka pasur vonesa teknike te daljes dhe hyrjes se materialit ne magazinat tona. Gjithashtu për këtë Kontratë është marrë edhe konfirmimi i Bashkisë Tirane për kthimin e segmenteve rrugore ne gjendjen e mëparshme gjate kësaj periudhe. (dokumenti bashkëngjitur)

Në lidhje me vonesa për mos likuidimin e faturave, për këtë objekt (sidomos lidhur me këtë fature) OE "4" nuk ka parashtruar, asnjë kërkesë për kamatëvonesa lidhur me likuidimin e faturës. Pra, për rrjedhoje as amortizimi i veprës nuk është cenuar nga vonesat teknike te dosjes për në DEK, pasi vepra është realizuar brenda afateve si dhe është marrë ne dorëzim dhe vene ne operim ne përputhje me Kontratën Nr.15206/15 prot. Date 13.12.2016, si dhe brenda kufijve ligjor dhe afateve te parashikuar ne Ligjin 8402 date 10.09.1998 "Për mbikëqyrjen dhe disiplinimin e punimeve te ndërtimit" i ndryshuar, dhe në përputhje me Udhëzimin nr.3 dt 15.02.2001 te KM, me ndryshimet përkatëse të tij.

Paragrafi i parashtrimit te konkluzionit ne raportin tuaj, konfirmon sa kam listuar më sipër.

Për t'ju vërtetuar sa ju kemi parashtruar ne këtë observacion bashkëlidhur gjeni dokumentacionin e nevojshëm:

1 - PVB i përfundimit të punimeve dt. 07.07.2017

2 -PVB i marrjes ne dorëzim Nr. 17226/5 prot. Dt. 31.08.2017

3 -Kthim përgjigje per gjendjen e infrastrukturës rrugore nga Bashkia Tirane, Nr. 23505 prot. Dt. 23.10.2017.

Me Akt- Konstatimin Nr. 7, protokolluar me Nr. 5842/36 prot, date 18.09.2020, Audituesit e Autorizuar te Kontrollit te Larte te Shtetit pranë OSHEE Group SHA, ne faqen nr.11 te këtij akt-konstatimi, është konstatuar dërgimi i shkresës nr.14454/6 Prot., date 07.09.2018 pranë DEK, sqarojme se fatura nr.33 me numër serie 40421633 është e datës 24.10.2017, data e PVB te Marrjes në Dorëzime është 17.11.2017, me Nr. 23421/3 prot., sikundër përmendet edhe në relacionin tuaj. E cila është data efektive e vënies se asetit në operim dhe funksionim te OSHEE

Gjate periudhës nga ardhja e dosjes ke specialisti, deri ne dEm te saj ne DEK, eshte plotësuar edhe me dokumentacion për akordimet e materialeve te demontuara dhe te hera hyrje ne magazine, te cilat janë pjese e kësaj dosje. Konkretisht ne periudhën e demontimit po behej përditësimi i sistemit SAP për magazinat e OSHEE për aktivet e gjithë territorit te Shqipërisë, për këtë arsye ka pasur vonesa teknike te daljes dhe hyrjes se materialit ne magazinat tona.

OE A L, nuk ka ngritur asnjë pretendim për kamatëvonesa te pagesave te likujdueshme. Kontrata është respektuar sipas te gjithë parashtrimeve te arritjes se qëllimit te saj, dhe ne respektim te

afateve kontraktuale dhe Ligjore ne përputhje me procedurën e parashikuar ne: Ligjin 8402 date 10.09.1998 " Për mbikëqyrjen dhe disiplinimin e punimeve te ndërtimit" i ndryshuar, dhe në përputhje me Udhëzimin nr.3 dt 15.02.2001 te KM, me ndryshimet përkatës te tij. Paragrafi i parashtrimit te konkluzionit në raportin tuaj, konfirmon sa kam listuar më sipër.

Oëndrimi i Grupit të auditimit:

Observimet tuaja për amortizimin nuk qëndrojnë pasi në kontabilitet janë bërë hyrje në periudhat e mëpasshme. Lidhur me observimin se operatorët ekonomikë nuk kanë ngritur ankesa, justifikimi nuk qëndron si argument, pasi po ta kishin bërë diçka të tillë, do të ishte maturuar dëm ekonomik nga shoqërisë, por qëllimi është të shmangen situata të tilla. Ky koment nuk merret në konsideratë dhe trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa më sipër mban përgjegjësi P L, në cilësinë e drejtorit të divizionit të shpërndarjes, personat e caktuar për ndjekjen e kontratave M D e E M.

Titulli i Gjetjes: Mos kryerje me saktësi e llogaritjeve për sasi të artikujve të kërkuar për Buxhetin e vitit 2017.

Situata:-Gjatë procesit të inventarizimit fizik të vlerave materiale në magazinat e OSHEE-së, në zbatim të Urdhrit nr. 24506, datë 06.12.2019, “Për inventarizimin e vlerave materiale në magazinat e shoqërisë OSHEESHA”, nga komisionet përkatës, u evidentuan artikuj me qarkullim të ngadalshëm në këto magazina, me vlerë totale në 283,914,390 lekë, artikuj të bërë hyrje në periudha të mëparshme dhe në ato të fundit.

Nga filtrimi i informacionit për artikujt me qarkullim të ngadalshëm u konstatua se në inventarin e datës 31.12.2019, nga hyrjet e bëra në vitin 2017, kishte akoma gjendje artikuj në vlerën 60,755,110 lekë.

Në relacionin teknik drejtuar Drejtorisë Ekonomike, për nevojat e shoqërisë për bazë materiale për mirëmbajtje, për Buxhetin e vitit 2017, nga drejtori i Divizionit të Shpërndarjes, P L, janë hartuar dhe përlllogaritur në Planin e Mirëmbajtjes, sasi të vjetore të parashikuara.

Nga kjo drejtori nuk janë kryer me saktësi llogaritjet për sasi të artikujve të kërkuar për Buxhetin e vitit 2017, duke krijuar material stok, që përveç se ka impenjuar fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe eficient të burimeve financiare të shoqërisë.

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ku citohet:

“Neni 1 Objekti i ligjit Ky ligj përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin. Neni 2 Qëllimi i ligjit Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë.”

Ndikimi/Efekti: Përlllogaritja jo e saktë e sasive të artikujve të kërkuar për tu blerë, sjell riskun e krijimit të materialit stok, që përveç se impenjon fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe eficient të burimeve financiare të shoqërisë.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rekomandime: Nga administratori i shoqërisë të merren masa që në të ardhmen, strukturat e ngarkuara për planifikimin e bazës materiale për mirëmbajtje, të kryejnë kërkesat e tyre të bazuara në raporte të mirë argumentuara, të specifikuara dhe të detajuara, për shmangien e krijimit të materialeve stok dhe një menaxhim me efektivitet dhe eficient të burimeve financiare të shoqërisë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin nr. 546/4 Prot, datë 19.11.2020 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.12149/12, datë 22.12.2020, vënë në dispozicion grupit

të auditimit të KLSH-së, më datë 28.12.2020,

Pretendimi i subjektit:

Me Akt- Konstatimin Nr. 7, protokolluar me Nr. 5842/36 prot, date 18.09.2020, Audituesit e Autorizuar te Kontrollit te Larte te Shtetit pranë OSHEE Group SHA, ne faqen nr.13 te këtij akt-konstatimi, është konstatuar nga grupi auditues i KLSH qe: ne inventarin e datës 21.12.2019, nga hyrjet e hera ne vitin 2017, kishte akoma gjendje artikuj me vlerën 60,755,110 Leke. Ne relacionin teknik dërguar DEK për nevojat e shoqërisë për B.M për mirëmbajtje për buxhetin e vitit 2017 nga DVSH janë hartuar dhe përllogaritur ne planin e mirëmbajtjes sasitë vjetore te parashikuara, nga kjo drejtori nuk janë llogaritur me saktësi sasitë e artikujve te kërkuar për buxhetin e vitit 2017 duke krijuar material stok qe përveçse ka impenjuar fonde financiare te shoqërisë ka edhe riskun qe për arsye te zhvillimeve teknologjike te behën të papërdorshme ne periudhën pasardhëse duke sjelle zvogëlim te aktiveve te shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe eficient te burimeve financiare te shoqërisë.

Parashtroj se, lidhur me llogarinë e buxhetit te fondit për materialet qe nevojiten për mirëmbajtjen, parashikimi i tyre ne llogaritjen e sasisë qe shoqëria duhet të ketë gjendje për avaritë vjetore te sistemit, behet ne baze te analizave vjetore paraardhëse. Duhet nënvizuar se avaritë trajtohen ne situata te emergjencave dhe ne kushte te ngjarjeve te forcave madhore te cilat janë te paparashikueshme, sikundër edhe ka ndodhur gjate periudhës se vitit 2019. Mbajtja gjendje e këtyre materialeve për ndërhyrjet e riparimeve ne sistem është e domosdoshme për mbarëvajtjen e menaxhimit te ofrimit te furnizimit me energji pa shkaktuar ndërprerje afatgjata për abonentët.

Sa i përket citimit tuaj lidhur me avancimet e teknologjisë, stoku i këtyre materialeve, që janë blere sipas kriterëve te standardeve bashkëkohore, IEC, ASTM dhe ISO dhe Rregullores se Shfrytëzimit teknik në fuqi për operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrjetit elektro energjetik, si dhe në përputhje me kërkesat e teknologjisë se re të investuar nga OSHEE përgjatë periudhës 2013-2020 nga shoqëria, që i bën të domosdoshëm dhe janë të përdorshëm ne çdo moment kur do paraqiten emergjenca te rrjetit për mirëmbajtjen. Thënë sa me sipër si Inxhinier me eksperience në menaxhimin e veprave elektro energjetike, por dhe si specialist i kodeve dhe standardeve elektro energjetike, me duhet te nënvizoj se, avaritë dhe mirëmbajtja e rrjetit nuk presin dot, kohet e prokurimit te materialeve, gjë që e bën domosdoshmëri mbajtjen e një stoku rezerve për ndërhyrjet urgjente në raste dëmtimesh te rrjetit.

Parashtrimi i seksionit te konkluzioneve tuaja ne raport, konfirmon gjithashtu, për sa listoj më sipër.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë përsëri se fakti që produktet kanë ngelur stok për 3 vjet, në kohë që ju keni si detyrë të përllogarisni kërkesat vjetore dhe jo trevjeçare tregon pasaktësi në llogaritje, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa më sipër mban përgjegjësi z. P L në cilësinë e drejtorit të Divizionit të Shpërndarjes.

Si konkluzion: Në lidhje me mbajtjen e evidencës kontabël në njësinë qendrore dhe ato vartëse,sa më sipër, dhe në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e një opinionit të plotë dhe të saktë, grupi i auditimit, nuk ka qenë në gjendje të sigurojmë evidencë të nevojshme auditimi për të bazuar dhënien e një opinionit mbi pasqyrat financiare të vitit 2017 dhe 2018, pra grupi i auditimit ka bërë refuzim të dhënies së opinionit.

Titulli i gjetjes: Rritje e detyrimeve debitore të shoqërisë

Situata: Detyrimet e OSHEE ndaj KESH për blerje energjie, hua dhe interesa për periudhën 2017-2019,kuOSHEEi detyrohet KESH detyrime në vlerën 53.5 miliardë lekë deri në 31.12.2019. Nisur nga të dhënat shihet se, detyrimet e OSHEE ndaj KESH deri në vitin 2019 kanë pësuar një tkurrje po ta krahasojmë me vitin 2013, por niveli i detyrimeve ngelet relativisht i lartë. Nga viti 2016 deri në vitin 2017 detyrimet janë ulur me 2 %, nga viti 2017 deri në vitin 2018 detyrimet janë ulur me 4.8%. Këto shifra vijnë si rezultat i pagesave nga OSHEE për detyrimet kundrejt KESH. Pas vitit

2018 deri në 31.12.2019, OSHEE ka rritur detyrimin e saj ndaj KESH në masën 2.7 %, si pasojë e faturimit të penaliteteve për detyrime të papaguara para vitit 2015; si pasojë e rritjes së energjisë së blerë në tregun e lirë gjatë periudhës së fund vitit 2019 dhe afati i pagesës për këto detyrime u rrit nga 90 në 180 ditë me vendim të ERE. Po ashtu OSHEE ka hasur vështirësi me likuiditetin gjë që shkaktoi rritjen e detyrimeve për blerjen e materialeve për investimet me kontrata të lidhura në proces. Në total detyrimi neto i OSHEE ndaj KESH deri në datën 31.12.2019 është 52,520,479,453 lekë për blerje energjie, hua, interesa dhe detyrime për asete.

OSHEE ka krijuar detyrime të reja ndaj KESH, për periudhën 2019 në vlerën 944,117,000 lekë.

Mes shoqërive KESH dhe OSHEE është lidhur Marrëveshja më datë 06.04.2018 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*". Kjo marrëveshje erdhi si rrjedhojë e nevojës për njohje dhe ristrukturim të detyrimeve të prapambetura që ishin krijuar nga marrëdhëniet ndër vite mes shoqërive dhe si nevojë e shoqërisë KESH për të garantuar ndaj palëve të treta huadhënese për KESH, një stabilitet ligjor dhe ekonomik në raport me shoqërinë OSHEE. Marrëveshja e ripagimit të detyrimeve të prapambetura ndërmjet KESH dhe OSHEE ishte një nga kushtet e vendosura nga BERZH për bërjen efektive të huasë nga Marrëveshja e Huasë e datës 30.06.2016 ndërmjet KESH dhe BERZH projekti "*Shqipëria: Ristrukturimi i KESH*".

Mekanizmat e përdorur për të përmbushur këto qëllime të cilat parashikohen në marrëveshje, përmbledhen në disa dispozita rregulluese dhe disa dispozita sanksionuese. Konkretisht pjesë e kësaj marrëveshje është skeduli Ipagimit të detyrimeve të prapambetura nga shoqëria OSHEE skeduli i cili parashikon vetëm pagesat fikse që kjo shoqëri duhet të likuideojë për llogari të KESH. Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet dy shoqërive në vetvete ka prodhuar mos pagesa të kësteve në masën e përcaktuar në aneks-kontratë.

Pjesë e marrëveshjes së lidhur mes shoqërive KESH dhe OSHEE datë 06.04.2018 është edhe skeduli Ipagimit të detyrimeve të prapambetura nga shoqëria OSHEE skedul i cili parashikon pagesat fikse që kjo shoqëri duhet të likuideojë për llogari të KESH.

Për vitin 2019, vlera e programuar për tu paguar ishte 17,379,228 Euro, nga OSHEE është paguar vlera prej 9,783,789 Euro, duke mbetur diferenca prej 7,595,439 Euro.

-Detyrimet e OSHEE ndaj OST për transmetim energjie, hua dhe interesa për periudhën 2017-2019, ku OSHEE i detyrohet OST detyrime në vlerën 13,8 miliardë lekë deri në 31.12.2019. Nisur nga të dhënat e pasqyruara në tabelën dhe grafikun e pasqyruar më poshtë dhe nga interpretimi i tyre shohim se, detyrimet e OSHEE ndaj OST deri në vitin 2019 janë rritur me ritme të larta.

Nga viti 2016 deri në vitin 2017 detyrimet janë rritur me 6.4%, nga viti 2017 deri në vitin 2018 detyrimet janë rritur me 47.7%. Këto shifra të larta vijnë si rezultat i mos arkëtimeve të detyrimeve të prapambetura nga OSHEE për detyrimet kundrejt OST. Pas vitit 2018 deri në 31.12.2019, OSHEE ka reduktuar detyrimin e saj ndaj OST në masën 2.1%.

-Mbështetur në akt rakordimet përkatëse ndërmjet OSHEE dhe OST u konstatua se ndërmjet shoqërive ka problematika mbi mosnjohjen e detyrimeve dhe të drejtave reciproke midis tyre. Në akt rakordimin e datës 12.05.2020 që i korrespondon periudhës së vitit 31.12.2019 në balancat neto të shoqërive ka një mospërputhje. Më saktësisht në rakordimin e ekspozimeve ndërmjet OSHEE dhe OST sipas OSHEE, balanca neto është 10,479,843,512 lekë ndërsa sipas OST balanca neto është 12,993,121,526 lekë pra me një diferencë 2,513,278,014 lekë, vlera të cilat mund të ndikojnë në performancën financiare të shoqërisë.

-OSHEE, nga ana e saj përballet çdo vit me një situatë mjaft të vështirë sa i përket arkëtimit të faturave të energjisë elektrike, kryesisht nga shoqëritë e Ujësjellës Kanalizimeve detyrimi i të cilave më datë 31.12.2019, është në vlerën 15.61 miliardë lekë ose afërsisht 130 milion euro. Mos arkëtimi i këtyre faturave, ndërkohë që OSHEE duhet të paguajë detyrime fiskale për këtë energji të pa arkëtuar, si dhe duhet të paguajë çdo vit detyrime të prapambetura ndaj Tatimeve, KESH dhe OST, duke e vendosur shoqërinë OSHEE, në situatë të vështirë financiare.

Për të kryer pagesat e energjisë gjithashtu OSHEE ka marrë hua afatshkurtra nga viti 2017 deri në 7,078,820 mijë lekë në Over Drafte.

Raporti Korrent i shoqërisë paraqitet negativ duke qenë se detyrimet afatshkurtra i tejkalojnë aktivet afatshkurtra gjë e cila tregon që shoqëria OSHEE ka vështirësi financiare në përbalimin e

detyrimeve afatshkurtra.

Vështirësitë e shkaktuara në sistemin energjetik për arsye klimaterike, mungesa e reshjeve gjatë viteve 2017 dhe 2019, detyroi OSHEE të blinte energji elektrike në tregun e jashtëm me çmime jo të favorshme, duke kërkuar një pjesë e rëndësishme e arkëtimeve të shoqërisë.

Duke u nisur nga pozicioni që ka OSHEE në sistemin energjetik, si mbledhësja kryesore e arkëtimeve nga konsumatori fundor, ka bërë që mungesa e likuiditetit të ndikojë në pagesat e planifikuara ndaj KESH, OST, si dhe për detyrimet korentë.

Lidhur me sa më sipër është kryer Auditimi Performancës, “Problematika e detyrimeve të ndërsjella në shoqëritë publike të sistemit energjetik, për periudhën 2016-2019”.

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12, pika 3, shkronjat g dhe gj, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ku citohet:

“3. Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: g) garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të pa arkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mblidhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta; gj) garantimin që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mospagesë nga kreditorët, nëpunësi zbatues duhet t’ia shpjegojë rrethanat nëpunësit autorizues.”

Ndikimi/Efekti: Mos arkëtimi i borxheve sjell mungesë të likuiditetit dhe mospagesa e kreditorëve sjell penalitete.

Rëndësia: E lartë.

Shkaku: Vështirësitë e shkaktuara në sistemin energjetik për arsye klimaterike, mungesa e reshjeve gjatë viteve 2017 dhe 2019, kanë sjellë blerjen e energjisë elektrike në tregun e jashtëm me çmime jo të favorshme.

Rekomandime: Drejtimi i OSHEE-së të marrë masa për vlerësimin e situatës debitore dhe kreditore, duke përdorur masa shtrënguese për rritjen e arkëtimeve, përdorimin me efikasitet të fondeve për investime si dhe pagesat në kohë të debitorëve.

2.7. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Gjatë auditimit të kësaj çështjeje, grupi i auditimit të KLSH është fokusuar në ato kontrole që kanë të bëjnë me përpunimin e veprimtarisë së OSHEE SHA në fushën e prokurimeve publike me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar; Udhezimet e APP; Vendime të KPP; DST sipas procedurave të prokurimit të audituara, si dhe lidhja e zbatimi i kontratatave.

Grupi i auditimit ka proceduar me marrjen e regjistrave të parashikimit dhe më pas me ato të realizimit të prokurimeve dhe në vijim ka shqyrtuar në Sistemin e Prokurimit Elketronik (SPE) për secilën prej tyre (kryesisht duke u përqendruar në vlerat e larta të fondit limit), numrin e opteraorëve ekonomik (OE) pjesëmarrës, OE të skualifikuar bashkë me shkaqet e skualifikimit nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave (KVO). Më pas, në varësi të sa më lart janë shqyrtuar analitikisht procedurat e prokurimit të përzgjedhura në SPE për dokumentet e tenderit (DST) lidhur me veprimtarinë e KVO, si dhe sipas rastit është vazhduar dhe me dosjen e auditimit lidhur me përcaktimin e fondit limit dhe vendosjen e kriterëve të veçanta dhe specifikimeve teknike nga komisioniet e posaçme. Gjatë auditimit është mbajtur në konsideratë shqyrtimi i të gjitha llojeve të procedurave të prokurimit, me fokus kryesor vlerën dhe numrin e pjesëmarrësve.

Duhet theksuar, se procedurat e prokurimit dhe zbatimi i kontratave të fushës së teknologjisë së informacionit deri më 31.05.2020 janë audituar nga ekspertë të fushës të KLSH “Për auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në OSHEE SHA” në auditimin që ka përfunduar në terren më datë 20.07.2020.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e OSHEE SHA për periudhën 01.07.2017 deri më 30.06.2020, sipas shqyrtimit në SPE janë zhvilluar gjithsej 109 procedura prokurimi të ndryshme (pa përfshirë blerjet dinamike të biletave, dhe blerjet e vogla) si e hapur, kërkesë për propozim, me negociim, marrëveshje kuadër etj., për mallra, punime civile, shërbime, shërbime të konsulencës etj., si për investime ashtu edhe për shpenzime e nevojshme për kryerjen e aktivitetit të shoqërisë. Grupi i auditimit ka arritur të shqyrtojë mesatarisht 30.3 % të numrit të procedurave të prokurimit, të cilat përfaqësojnë rreth 41.4 % të fondit të kontraktuar dhe përafërsisht dhe të atij limit.

Tabela nr. 1 Të dhëna të përgjithshme për prokurimet 6 mujori i II 2017- 6 mujori i I 2020

Nr.	Emërtimi	6-muj II 2017	2018	2019	6-muj I 2020	Gjithsej
1	Numri i procedurave gjithsej	11	55	32	11	109
2	Numri i procedurave të audituara	5	14	10	4	33
3	Procedura të audituara në përqindje	45.5	25.5	31.3	36.4	30.3
4	Fondi limit gjithsej mijë lekë	306,210.8	5,241,668.7	2,195,423.3	157,754.3	7,901,057.1
5	Fondi limit i audituar mijë lekë	240,947.1	1,786,883.7	1,037,016.8	86,566.2	3,151,413.8
6	Fond limit i audituar në përqindje	78.7	34.1	47.2	54.9	39.9

Burimi: Të dhëna të OSHEE, të përpunuara nga grupi i auditimit.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit dhe kontratave të lidhura, në rastet në vijim janë konstatuar këto mospërpunime (problematika) me kuadrin rregullator përkatës:

- 1. Titulli i Gjetjes** Në procedurën e prokurimit “Blerje materiale të nevojshme për Arkivën Qendrore dhe Arkivat e Drejtorive Rajonale” 2019, KVO ka skualifikuar OE “D G” SHPK, me arsyetimin se ka detyrime ditën e hapjes së ofertave, në një kohë që sipas deklaratës përkatëse, në zbatim të kërkesave të DT, ky OE nuk ka detyrime në momentin e nënshkrimit të deklaratës, si edhe pas

Situata:

vërtetimit nga organet tatimore, *duke i shkaktuar efekt financiar negativ në përdorimin e fondeve të OSHEE SHA në vlerën 4,296,000 lekë.*

Në tenderin e zhvilluar me datë 27.05.2019 kanë marrë pjesë 5 OE: janë skualifikuar 4, nga të cilët njeri nuk ka paraqitur asnjë dokument dhe të tjerët për shkaqe të ndryshme të arsyetuara nga KVO. Është shpallur fitues OE “K” SHPK me ofertë ekonomike me vlerë 43,470,000 lekë pa TVSH, vlera e tretë nga ajo më e ulta. Fituesi është shpallur pas vendimit të KPP 537/2019 datë 14.08.2019, nga ankesa e BOE “I” SHPK “M D” SHPK me ofertë 43,387,666 lekë, e cila nuk është pranuar nga KPP.

Nga auditimi i kësaj procedure në SPE, konstatohet se KVO ka skualifikuar OE “D G” SHPK me ofertë 39,174,000 lekë, pasi sipas saj “Referuar vërtetimit të tatimeve Nr. T01107250, datë 28.05.2019, OE rezulton me detyrim tatimore ditën e hapjes së ofertave.

1. Sipas DT, shtojca 9, kreu I -Kriteret e përgjithshme, shkronja d) përcakton se operatori ekonomik kualifikohet në se: *“ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.”*, si dhe në vijim: *“Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetë-deklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.”* Në përmbushje të kësaj kërkesë OE “D G” SHPK ka paraqitur “Deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme”, të datës 27.05.2019, në paragrafin e parafundit të së cilës është cilësuar *“Operatori ekonomik “D G” SHPK ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.”* Në këtë mënyrë OE “D G” SHPK plotëson kriteret e parashikuara në DT dhe duhej kualifikuar.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, por KVO është jashtë kompetencave të veta dhe ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 58, paragrafi i fundit, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, i cili përcakton:

“Komisioni është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Komisioni duhet të zbatojë detyrat në pavarësi të plotë dhe nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.”

2. Sipas procesverbalit nr.3 datë 28.05.2019 të KVO mbi zhvillimin e kësaj procedure prokurimi, është mbledhur për të verifikuar gjendjen gjyqësore të organit administrative, drejtuesit, mbikëqyrësit etj., dhe në prezencë të personit që ka detyra përfaqësuese është kryer procedura e verifikimit, nga ku ka rezultuar që ortaku i vetëm i OE “K” SHPK z. K H, si dhe ortaku i vetëm OE “D G” SHPK z. I L, konstatohet se këta shtetas me këto emra janë të dënuar, të cilët pas verifikimit rezultojnë të padënuar. Gjithashtu, për OE “D G” SHPK cilësohet se nëpërmjet sistemit e-Albania ka gjeneruar formatin elektronik vërtetim (për pagim detyrimesh, nga ku rezulton se ky subjekt ka detyrime tatimore të papaguara, pa e cilësuar në se është detyrim tatimor, interes apo dhe gjobë. Të gjitha këto veprime të KVO janë në kundërshtim me nenit 58, paragrafi i fundit, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 të cituar më lart. Veç sa më sipër, me datë 30.05.2019, OSHEE i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë me shkresën nr. 12021 prot., datë 30.05.2019 për informacion mbi pagimin e detyrimeve tatimore të subjektit “D G” SHPK dhe në përgjigjen e datës

07.06.2019, ky institucion me shkresën nr. 30227 prot., kthen përgjigje se subjekti në fjalë nuk ka asnjë detyrim tatimor në datën 06.06.2019, bashkëlidhur vërtetimi Nr.T01130887, datë 06.06.2019. Megjithatë, sipas Raportit përmbledhës të KVO të datës 16.08.2019, të miratuar nga Titullari i AK për këtë procedurë prokurimi, OE “D G” SHPK me ofertën më të ulët 39,174,000 lekë është skualifikuar me arsyetimin se rezulton me detyrim tatimor ditën e hapjes së ofertave.

Një veprim i tillë i KVO është në kundërshtim me nenin 15, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, të ndryshuar, paragrafi i dytë i cili përcakton:

“Në rast se ka dyshime mbi vërtetësinë e këtij deklarimi, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme.”,

pasi edhe pas verifikimeve të AK ka rezultuar se OE “D G” SHPK me vlerën më të ulët i skualifikuar nuk ka detyrime tatimore.

Përveç sa më sipër, skualifikimi i një operatori ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi me argumentin se “ka detyrime tatimore të pashlyera në ditën e hapjes së ofertave”, kur me këto të fundit nënkuptohen edhe gjopa të cilat mund të jenë në proces ankimimi, nuk është në përputhje me frymën e legjislacionit për prokurimin publik, kjo edhe në funksion të nxitjes së pjesëmarrjes dhe të konkurrencës së operatorëve ekonomikë, në kuptim të rritjes së eficientës dhe efikasitetit të procedurave të prokurimit publik.

Në balancën mes përpjekjes për të siguruar pagesën e plotë të të gjithë elementëve të detyrimit tatimor, nga njëra anë, dhe mirpërdorimin e fondeve publike - që arrihet përpara së gjithash përmes një pjesëmarrje të gjerë e konkurruese të operatorëve ekonomikë, nga ana tjetër, vlerësohet se, nuk mund të arsyetohet se çfarë përfaqëson vlera e detyrimit tatimor, KVO nuk duhet ta skualifikonte këtë operator për detyrime tatimore të pasaktësuara për llojin dhe afatin.

Në këtë mënyrë, KVO e përbërë nga E B, J S dhe I H me veprimet dhe mosveprimet e tyre nga skualifikimi i padrejtë i OE “D G” SHPK i kanë shkaktuar efekt financiar negativ në përdorimin e fondeve të OSHEE SHA në vlerën 4,296,000 lekë.

- Kriteri:** - VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 15; neni 58;
- DT: Shtojca 8, shtojca 9, kreu I -Kriteret e përgjithshme, shkronja d);
- Ndikimi/Efekti:** Përdorim të fondeve të OSHEE SHA pa efektivitet në vlerën 4,296,000 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis OE të shpallur fitues dhe OE të skualifikuar.
- Shkaku:** Mungesë e njohjes dhe zbatimit të frymës së legjislacionit për prokurimin publik, në funksion të nxitjes së pjesëmarrjes dhe të konkurrencës së operatorëve ekonomikë, për rritje të eficientës dhe efikasitetit të procedurave të prokurimit publik.
- Rëndësia:** I lartë
- Rekomandime:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa për trajnime të specifikuar të zyrtarëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si dhe për raste të tilla të veçanta të kërkojë nga APP mendime paraprake për trajtimin e rasteve të tilla.

Si konkluzion, në procedurën e prokurimit “Blerje materiale të nevojshme për Arkivën Qendrore dhe Arkivat e Drejtorive Rajonale” 2019, KVO ka skualifikuar OE “D G” SHPK, me arsyetimin se ka detyrime ditën e hapjes së ofertave, në një kohë që sipas deklaratës përkatëse, në zbatim të kërkesave të DT, ky OE nuk ka detyrime në momentin e nënshkrimit të deklaratës, si edhe pas

vërtetimit nga organet tatimore, duke i shkaktuar efekt financiar negativ në përdorimin e fondeve të OSHEE SHA në vlerën 4,296,000 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis OE të shpallur fitues dhe OE të skualifikuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. E B, Z. AG dhe Z. I H, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën nr.12149/13 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

KVO, pasi përshkruan zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ofertave, cilëson se ka kryer verifikimin e vërtetimit tatimor Nr. T01107250, datë 28.05.2019 dhe ka rezultuar me detyrim tatimore ditën e hapjes së ofertave dhe në këtë mënyrë bazuar në nenin 48, pika 2, germa “dh” të LPP e ka skualifikuar OE “D G” SHPK.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e KVO dhe arrin në përfundimin e mëposhtëm:

KVO, ka skualifikuar OE, edhe pse në zbatim të nenit 15, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, të ndryshuar, paragrafi i dytë, AK i është drejtuar për verifikim Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë me shkresën nr. 12021 prot., datë 30.05.2019 për informacion mbi pagimin e detyrimeve tatimore të subjektit “D G” SHPK dhe në përgjigjen e datës 07.06.2019, ky institucion me shkresën nr. 30227 prot., ka kthyer përgjigje se subjekti në fjalë nuk ka asnjë detyrim tatimor, bashkëlidhur të të cilit është vërtetimi Nr.T01130887, datë 06.06.2019. Pra rezulton se në periudhën e shqyrtimit të ofertave OE nuk ka detyrime ndaj organeve tatimore dhe nuk ka arsye skualifikimi.

Bazuar në sa më sipër grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin në lidhje me mangësitë e evidentuara në këtë procedurë prokurimi, dhe për këtë arsye nuk e merr në konsideratë.

2. Titulli i Gjetjes Në procedurën e prokurimit: “E hapur shërbime, Marrëveshje Kuadër” me objekt: “Inspektimi dhe konformiteti për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në n/stacione, linjat 35 KV dhe kabina elektrike” nuk janë dokumentuar kriteret në të cilat është bazuar përlllogaritja e fond limit; është përfshirë në zërat e preventivit kontrolli vizual i pajisjeve, detyrë funksionale e OSHEE, si dhe nuk janë respektuar termat e referencës në zbatimin dhe dokumentimin e saj.

Situata: Nga auditimi në SPE konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 25.03.2019 kanë marrë pjesë dy OE: 1. “N C” SHPK me vlerën e shumatores së çmimeve për njësi të ofertuar: 29,820 lekë pa TVSH, dhe 2. BO T I I I C T D E S P SHPK, i cili është skualifikuar, pasi oferta nuk është përgatitur sipas kërkesave në DT, si dhe shumatorja e çmimeve është me e larte se ajo e fondit limit:

Me Urdhrin e brendshëm nr.3871/1 prot., datë 15.02.2019 është ngritur komisioni për hartimin e preventivit, fondit limit, kriterëve (kapaciteteve teknike) për kualifikim, specifikimeve teknike dhe termave të referencës me përbërje O D, E M, B H, A K, A B, S A dhe S K .

Në preventivat për njësi është parashikuar për të gjitha pajisjet (nënstacione -177, kabina-13158 dhe linja-712.58) zëri “Kontrolli vizual i pajisjeve” me çmim përkatësisht 1,000, 590 dhe 300 lekë për secilin prej tyre, të cilët në total kapin vlerën 8,153,994 lekë. Në fakt ky shërbim është detyrë e personit juridik (në këtë rast OSHEE SHA) i cili është përdorues i pajisjes dhe linjës elektrike, të përcaktuara në ligjin nr.8734, datë 1.2.2001 ”Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve

elektrike”, neni 6, pika 2, e cila përcakton:

“Personi juridik, që përdor pajisje ose instalime elektrike, merr të gjitha masat për të kryer kontrollin teknik periodik të çdo pajisjeje ose instalimi, sipas afateve të përcaktuara në rregulloret e sigurimit teknik për pajisjet dhe instalimet elektrike të miratuara nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.”

Në këtë mënyrë në fondin limit është përfshirë pagesa për një detyrë funksionale të OSHEE SHA, duke shkaktuar efekt negativ në përdorimin e fondeve në vlerën prej 8,153,994 lekë.

Në termat e referencës të përgatitura për kabinë shtyllore është përcaktuar se matjet e fushës elektrike dhe magnetike do të bëhen në 5 pika, për kabinat metalike dhe kabinat muraturë do të jenë secila nga 2 pika dhe pikat e tjera në përputhje me kërkesat OSHEE. Për nënstacionet elektrike janë parashikuar 19 pika matjeje, kurse për linjat me dy qarqe në 11 pika dhe me një qark në 9 pika.

Për hartimin e fondit limit janë paraqitur në dosje në aneksin 5 Preventivat për njësi, preventivat e prishme dhe preventivat total, si dhe në aneksin 6 – listë me të dhënat e rrjetit, në të cilën përfshihen sasia e tyre sipas llojeve dhe vjetërsisë.

Në dosje gjenden preventivat për çmimin njësi sipas llojit të pajisjes dhe shërbimeve që do të kryhen (parashikim i procesit të shërbimeve) dhe, bazuar në sasinë e pajisjeve që do të inspektohen është hartuar preventivi përmbledhës i shërbimeve në vlerën 118,738,119 lekë me TVSH dhe 98,948,432 lekë pa TVSH nga B H, O D, E M, S A , si dhe P L i cili ka nënshkruar vetëm në preventivin përmbledhës. Nga preventivat për çmimin njësi, shumatorja rezulton të jetë 33,236 lekë. Nuk ka asnjë dokument në lidhje me përcaktimin e çmimeve njësi të shërbimeve sipas pajisjes që inspektohet nga ana e komisionit si dhe në se këto janë për një vit apo për dy vjet. Një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 59, pika 2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, e cila përcakton:

“Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe c) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.”

Mbi këtë bazë ka dalë urdhri i prokurimit nr.3871/3 prot., datë 28.07.2019, për fondin limit 196,040,490 lekë dhe shumatore të çmimit 33,276 lekë.

Kontrata është lidhur më datë 02.05.2019 me OE të kualifikuar dhe të shpallur fitues N C SHPK, me vlerë të kontratës 196,040,490 lekë.

Sipas termave të referencës kontraktori duhet të përgatisë për secilin objekt: Raport inspektimi, Fletë pune, si dhe Certifikatë konformiteti, për ato objekte të cilat plotësojnë standardet e kërkuara të treguesve të matur dhe vlerësuar.

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës, në dokumentacionin fletë pune, konstatohet se:

- në datën 02.09.2019 dy inspektor të kontraktorit N C përkatësisht A R dhe J M kanë inspektuar 13 kabina elektrike muraturë, metalike dhe

shtyllore, që nis në orën 12.05, vazhdon me kabinën tjetër në 12.10, 12.20, 12.30, 12.25, 12.35, 12.40, 12.15, 14.15, 12.50, 13.00, 13.15 dhe 13.35, duke mbajtur në konsideratë që një pjesë e kabinave gjenden në qytetin e Burrelit, një pjesë në Klos Katund, Pra sipas fletëve të punës inspektimi ka nisur në 12.05 dhe ka përfunduar në 14.15 për 13 kabina, pra për 2 orë e 10 minuta, si dhe gjatë kësaj kohe është kryer kontrolli vizual, monitorimi i regjimit të ngarkesave, vlerësimi i ndotjes në mjedis, matja e rezistencës së tokëzimit të kabinës, si dhe përgatitja e raportit teknik për kabinën. Për muajin shtator 2019 për 8 ditë pune, këto dy inspektorë kanë plotësuar fletë pune për 116 kabina të llojeve të ndryshme, pra mesatarisht 14 kabina elektrike në ditë.

Të gjitha këto fletë pune janë nënshkruar, krahas inspektorëve dhe nga Drejtuesi teknik i kontraktorit A L, si dhe përfaqësuesit e OSHEE K/Inxhinieri i njësisë E K si dhe Administratori i kontratës O D.

Po në datën 02.09.2019 grupi i tjetër në zonën e Burrelit me përbërje inspektorët K S dhe R H ka fletë pune të plotësuara për 14 kabina, që fillojnë nga ora 9.15 dhe përfundojnë në orën 14.45, të nënshkruara krahas inspektorëve nga përfaqësuesi i OSHE E M, dhe nga Drejtuesi teknik i kontraktorit A L, si dhe Administratori i kontratës O D. Për muajin shtator 2019 ky grup inspektorësh ka plotësuar fletët e punës për 128 kabina për 10 ditë pune ose mesatarisht 13 kabina në ditë.

- Gjithashtu, rezulton se një pjesë e matjeve të kryera nuk janë në orën 12, në kundërshtim me termat e referencës për këtë kontratë (faqe 32), si dhe kryerja këtij shërbimi për secilën kabinë dhe gjatë një ditë pune, është fizikisht e pamundur nga një grup pune, e bën formal zbatimin e kësaj kontrate dhe pagesa të bazuara dhe të paargumentuara.

- Veç, kësaj, nuk është hartuar Raporti i inspektimit, kërkesë e termave të referencës, (me përjashtim të kabinave shtyllore) dhe pjesë e shpërblimit në zërin e preventivit "Përgatitja e raporteve teknik për kabinën me çmimin njësi 1,200 lekë.

- Po ashtu, sipas preventivit, megjithëse pikat e matjeve mbi atë normale duhet të bëhen sipas kërkesave të OSHE, nuk rezulton të ketë deri tani asnjë kërkesë të tillë, duke e vendosur kontraktori numrin pikave të matjes sipas dëshirës dhe në kundërshtim me preventivat përkatës, me pasoja financiare për kontratën, pasi çmimi i një pikë matjeje është nga 600 deri në 1600 lekë, gjë që mund të sjellë krahas të tjerave numër monitorimesh formale dhe arritjen e vlerës së kontratës dhe përfundimin e saj, pa u realizuar objektivat e autoritetit kontraktor për numrin e pajisjeve për inspektim dhe as për një herë në vit për 2 vjet.

Kriteri:

- Ligji nr.8734, datë 1.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike", neni 6, pika 2;

- VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenin 59, pika 2;

- Termat e referencës së kontratës së lidhur më datë 02.05.2019 me OE N C SHPK.

Ndikimi/Efekti:

Përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerën 8,153,994 lekë si rezultat i vendosjes në preventiv të zërit kontroll vizual i pajisjeve, si dhe zbatim dhe dokumentim jo në përputhje me termat e referencës.

Shkaku:

Konsiderimi nga ana e komisionit si një veprimtari teknike dhe mungesa e vëmendjes gjatë zbatimit dhe dokumentimit të kontratës

Rëndësia:

I lartë

- Rekomandime:**
1. Autoriteti kontraktor të marrë masat e nevojshme për të argumentuar dhe dokumentuar në çdo rast prokurimi përlllogaritjen e fondit limit.
 2. Administratori i OSHEE SHA të analizojë zbatimin e kësaj kontrate deri në këtë periudhë, duke nxjerrë përgjegjësitë për mangësitë e evidentuara, si dhe të rishikojë të gjithë dokumentacionin e zbatimit, duke zbritur ato zëra të situacionit të cilat janë përfshirë në preventiv por nuk janë kryer në përputhje me termat e referencës.

Si konkluzion:

- Në përlllogaritjen e fondit limit për këtë prokurim është përfshirë zëri “Kontrolli vizual i pajisjeve” e cila është detyrë ligjore dhe funksionale të OSHEE SHA, duke sjellë për pasojë përdorimin pa efektivitet të vlerës 8,153,994 lekë, të destinuar për këtë qëllim në fondet e kësaj kontrate.

- Në përlllogaritjen e fondit limit nuk janë dokumentuar kriteret ligjore në përcaktimin e çmimeve njësi sipas llojit të pajisjes dhe shërbimeve që do të kryhen (parashikim i procesit të shërbimeve) dhe, si dhe në se këto janë për një vit apo për dy vjet.

- Gjatë zbatimit të kontratës për inspektimin e kabinave, në bazë të fletëve të punës të plotësuara dhe të paguara nga OSHEE SHA rezulton se nuk janë respektuar koha e matjeve, plotësimi i të gjithë dokumentacionit, OSHEE SHA nuk ka bërë asnjë kërkesë për matje shtesë, si dhe numri i kabinave gjatë një dite pune dhe koha e regjistruar për inspektimin e një kabine, sipas këtyre dokumenteve është formal, pasi praktikisht është e pamundur që të kryhet inspektimi dhe të plotësohet dokumentacioni për 14-16 kabina gjatë një dite pune.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: 1) Z. O D në cilësinë e anëtarit të komisionit për hartimin e preventivit, fondit limit, kriterëve (kapaciteteve teknike) për kualifikim, specifikimeve teknike dhe termave të referencës, si dhe të Administratorit të kontratës; 2) Zj.E M, 3) Zj. B H, 4) Zj. A K, 5) Z. A B, 6) Zj.S A , dhe 7) Zj.S K , në cilësinë e anëtarëve të komisionit për hartimin e preventivit, fondit limit, kriterëve (kapaciteteve teknike) për kualifikim, specifikimeve teknike dhe termave të referencës.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën nr.12149/14 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

Subjekti i audituar cilëson se Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike nuk është organ i akredituar, dhe për pasojë veprimtaria e inspektimit kryhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”.

- Vendosija në preventiv e zërit “Kontroll vizual i pajisjeve” është bërë në përputhje me kriteret e ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 dhe janë ligjërisht të pamundura të kryhen nga OSHEE SHA në rolin e personit juridik, pasi në të kundërt inspektimi nuk do të ishte i plotë.

- Për llogaritjen e fondit limit sqarohet se është mbështetur në kontratën e ngjashme nr.7439/9, datë 12.12.2016 ‘Mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në nënstacione dhe kabina elektrike’.

- Lidhur me zbatimin e kësaj kontrate është cilësuar procedura që ndiqet, punonjësit që i kanë shoqëruar, ndikimi i aparaturave të avancuara, si dhe fakti që dokumentacioni është kryer një muaj më pas.

- Janë trajtuar teknikisht pikat e matjes së fushës elektromagnetike në nënstacione, si dhe përcaktimi i numrit në termat e referencës.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e subjektit të audituar dhe arrin në përfundimet e mëposhme:

- Lidhur me vendosjen në preventiv të zërit “Kontroll vizual i pajisjeve”, sqarojmë dhe theksojmë se është pjesë (operacion) e një procesi pune siç është inspektimi, pasi shërbimi i inspektimit nuk mund të kuptohet pa kontrollin vizual të pajisjes, si dhe një veprimtari e tillë e karakterit bazë dhe formal është detyrë funksionale e OSHEE SHA, për të cilën, midis të tjerave, paguhen punonjësit e

shoqërisë të këtij sektori.

- Lidhur me përllogaritjen e fondit limit, ritheksojmë se në dosjen e auditimit nuk ka asgjë të dokumentuar, si dhe referenca e juaj në kontratën e mëparshme të vitit 2016 është e kufizuar vetëm në mbikëqyrjen e fushës elektromagnetike dhe nuk përfshin inspektimin, zhurmat, mjedisin, monitorimin e ngarkesave etj., dhe as linjat elektrike, prandaj nuk mund të shërbejë si referencë në përllogaritjen e fondit limit.

- Zbatimin me mangësi i kontratës kundrejt termave të referencës lidhur me kohën e kryerjes dhe kohën e harxhuar për një inspektim nuk e justifikon as sqarimi i procedurës, as përdorimi i pajisjeve të avancuara, pasi ata kanë qenë pjesë e kritereve të veçanta për kualifikim, si dhe as përgatitja e dokumentacionit një muaj më pas, duke e bërë formal zbatimin e kësaj kontrate.

- Pikat e matjes së fushës magnetike të cilësuar në akt-konstatim i referohen kabinave shtyllore dhe jo nënstacioneve.

Bazuar në sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin në lidhje me mangësitë e evidentuara në procedurën dhe zbatimin e kësaj kontrate, dhe për këtë arsye nuk e merr në konsideratë.

3. Titulli i Gjetjes Në tenderin me objekt “Blerje uniforma dhe pajisje sigurie për punonjësit e OSHEE” KVO, si rezultat e veprimeve dhe mosveprimeve të KVO, duke skualifikuar padrejtësisht BOE “M A K” SHPK ***i kanë shkaktuar OSHEE SHA një efekt financiar negativ në përdorimin e fondeve prej 22,374,000 lekë.***

Situata: Procedura e prokurimit: “E hapur- mallra” me objekt prokurimi “Blerje uniforma dhe pajisje sigurie për punonjësit e OSHEE”, ka qenë me fondin limit 198,150,000 lekë pa TVSH dhe me afat realizimi 27 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në tenderin e zhvilluar më datë 17.12.2018 kanë marrë pjesë 4 OE:

- BO “M A M S” SHPK, i cili ka paraqitur ofertë ekonomike me vlerë 190,530,000 lekë pa tvsh;

- BO “M A K” SHPK i cili ka paraqitur ofertë ekonomike me vlerë 168,156,000 lekë pa tvsh;

- BO “D E K” SHPK i cili ka paraqitur ofertë ekonomike me vlerë 158,010,000 lekë pa tvsh.

- OE “M” SHPK ska paraqitur ofertë

Janë skualifikuar nga KVO ofertuesit: “M” SHPK, pasi nuk ka paraqitur ofertë; BO “D E K” SHPK, në zbatim të vendimit të KPP nr. 181/2019 datë 29.03.2019, si dhe BO “M A K” SHPK, sipas tyre për shkaqet në vijim.

Sipas Proceseverbalit nr.4, datë 28.01.2019, KVO ka skualifikuar OE “M” SHPK pasi nuk ka paraqitur ofertë, si dhe BO “M A K” SHPK, pasi:

a. Lidhur me Certifikaten OEKO-TEX të paraqitur, mbajtësi i saj ka autorizuar vetëm OE A K, ndërkohë që referuar marrëveshjes së bashkepunimit të BO rezulton se ata janë pjesëmarrës në pjesë ideale 20% M dhe 80% A K.

b. Lidhur me certifikatën e konformitetit të kepecëve mbrojtëse, BO nuk paraqet asnjë dokument provues që të vertetojë lidhjen me mbajtësin e saj D P.

c. OE M në përmbushje të kritereve të përgjithshme, ka dorëzuar vetë deklarin sipas shtojcës 8 me datë 17.12.2018. KVO, referuar kthim përgjigjes Nr. 492/1 prot, datë 23.01.2019 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, rezulton se M SHPK ka gjobë në tatimin mbi fitimin për periudhën Nëntor 2018 në vlerën 2,447 lekë e kontabilizuar me datë 16.11.2018. Sa më sipër, M rezulton debitor

pranë Drejtorisë Tatimore në datën e hapjes së ofertave 17.12.2018.

- a Sipas DT, Shtojca 9, kreu 2-Kriteret e veçanta të kualifikimit, lidhur me kapacitetin teknik, në pikën 2.3.3 është përcaktuar: *“Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën OEKO-tex Step ose (ekuivalente me të) të vlefshme të tij ose të prodhuesit/distributorit që duhet të aplikohet në fushën e veprimtarisë. Në rast se operatori ekonomik do të paraqesë certifikatën OEKO-tex Step të prodhuesit/distributorit duhet të provojë edhe lidhjen me këtë të fundit”*. Në plotësim të këtij kriteri BO “M A K” SHPK ka paraqitur certifikatën e shoqërisë C.B.F B SPA të dhënë nga OEKO-TEX® për të përdorur markën OEKO-TEX® pasi i plotëson të gjitha kërkesat SteP nga OEKO-TEX®. Për të provuar lidhjen midis C.B.F B SPA dhe OE, BO “M A K” SHPK, ka paraqitur kontratën e bashkëpunimit të datës 03.02.2017 të “Arisa Konfeksion” SHPK për kryerjen e fazave prodhuese të produkteve të furnizuara gjysëm të gatshme me C.B.F B SPA. Në këtë mënyrë rezulton se BO “M A K” SHPK e kanë plotësuar këtë kriter të veçantë kualifikimi, pasi në DT (pika 2.3.3) e konsideron të mirëqenë paraqitjen e dokumentacionit në formë të tillë, pasi DT për pajisjen me certifikatë ISO (pika 2.3.2) e cilëson: Në rast se OE janë pjesëmarrës në tender si bashkim operatorësh, secili anëtar duhet të paraqesë ISO në përputhje me zërat që do të marrë përsipër të furnizojë. Veç kësaj, në zbatim të nenit 27, pika 3 presupozohet se AK ka përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Bazuar në sa më sipër KVO e përbërë nga E B, AG dhe A Z ka tejkalluar kompetencat e veta duke interpretuar kriteret e veçanta të kualifikimit dhe ka skualifikuar padrejtësisht BO “M A K” SHPK.

- Sipas DT, Shtojca 9, kreu 2-Kriteret e veçanta të kualifikimit, në pikën 5 është përcaktuar që OE pjesëmarrës në tender duhet të paraqesë: *“Certifikatë e një laboratorit të akredituar që tregon konformitetin e këpucës mbrojtëse sipas normativës EN ISO 20345:2011 S3 SRC.”* Në plotësim të këtij kriteri BO “M A K” SHPK ka paraqitur Deklaratën e konformitetit të subjektit D P, që deklaron se këpucët janë në përputhje me EN ISO 20345:2011 S3 SRC. Në këtë mënyrë BO “M A K” SHPK ka plotësuar këtë kriter kualifikimi sipas kërkesave në dokumentet e tenderit. Bazuar në sa më sipër KVO e përbërë nga E B, AG dhe A Z ka tejkalluar kompetencat e veta duke interpretuar kriteret e veçanta të kualifikimit dhe ka skualifikuar padrejtësisht BO “M A K” SHPK, pasi në DT nuk është kërkuar asnjë dokument provues që të vërtetojë lidhjen e OE me mbajtësin e saj, siç cilësohet në rastin e certifikatës OEKO-tex Step.

- Në shkronjën “d” të Kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të shtojcës 9 të DT është përcaktuar që ofertuesi duhet të deklarojë se: *“ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.”* Në plotësim të këtij kriteri “M” SHPK ka dorëzuar vetë deklarin e datës 17.12.2018, në paragrafin e parafundit të të cilit është përcaktuar: *“Operatori ekonomik “M” SHPK ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.”* Pra në këtë mënyrë “Operatori ekonomik “M” SHPK, në cilësinë e pjesëtarit të BOE ka plotësuar këtë kriter kualifikimi. Megjithatë, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër. Nga auditimi në sistem, konstatohet se AK i ka kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale Tatimore

Tiranë dhe sipas përgjigjes me nr. 492/1 prot., datë 23.01.2019 rezulton se “M” SHPK ka gjobë në tatimin mbi fitimin për periudhën Nëntor 2018 e kontabilizuar me datë 16.11.2018. Sipas KVO, në këto kushte M rezulton debitor pranë Drejtorisë Tatimore në datën e hapjes se ofertave 17.12.2018, pa e cilësuar vlerën e gjobës.

Lidhur me klasifikimin subjekt debitor të në rastin e OE “M” SHPK, KVO ka kryer një interpretim të gabuar të legjislacionit tatimor të fushës. Në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenin 107 përcaktohet se:

“1. Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që bashkë me ankesën të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor ose të vendosë garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore.

2. Shuma e pagueshme ose shuma e vënë si garanci bankare, sipas pikës 1 të këtij neni, përjashton gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.

3. Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është objekt i ankimit, ose ka paraqitur dokumentin bankar që vërteton vendosjen e garancisë, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2 të këtij neni.”

Gjithashtu, në Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 të Ministrit të Financave përcaktohet se:

“Shuma e detyrimit për t'u paguar përfshin vetëm shumën e tatimit dhe interesin, nëse ka, në aktin administrativ që ankimohet, që është i pagueshëm në momentin e ankimit, duke përjashtuar gjobat e përfshira në aktin administrativ objekt ankimi”.

Bazuar në sa më sipër, arrihet në përfundimin se, skualifikimi prej autoritetit kontraktor i një operatori ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi me argumentin se “ka detyrime tatimore të pashlyera”, kur me këto të fundit nënkuptohen gjoba në vlerën 2,447 lekë, nuk është në përputhje me frymën e legjislacionit për prokurimin publik. Detyrimet për pagimin e tatimeve të parashikuar nga neni 45, pika 2, germa “dh” e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, duhen parë dhe zbatuar në funksion të një prej qëllimeve të këtij ligji, që është nxitja e pjesëmarrjes dhe e konkurrencës së operatorëve ekonomikë, në kuptim të rritjes së efikasitetit të procedurave të prokurimit publik.

Në balancën mes përpjekjes për të siguruar pagesën e plotë të të gjithë elementëve të detyrimit tatimor, nga njëra anë, dhe mirpërdorimin e fondeve publike - që arrihet përpara së gjithash përmes një pjesëmarrje të gjerë e konkurruese të operatorëve ekonomikë, nga ana tjetër, në ato raste kur nga operatori pjesëmarrës në procedurën e prokurimit është paguar tatimi përkatës, ndërkohë që ka gjoba për të paguar, autoriteti kontraktor nuk duhet ta skualifikojë këtë operator në lidhje me mospagimin e gjobës.

Pas njoftimit të klasifikimit të bërë më datë 01.04.2019, kanë paraqitur ankesë:

1. BO “M A M S” SHPK ankesë në AK dhe në KPP. Për këtë KPP me vendimin nr. 181/2019 datë 29.03.2019 ka vendosur pranimin e ankesës së BO dhe ka vendosur që AK të anulohet vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e BOE “D E” SHPK & “K” SHPK duke e skualifikuar këtë operator ekonomik. Duhet theksuar se KPP nuk ka shqyrtuar zhvillimin e

procedurës prokurimit, por vetëm ankesën e BO “M A M S” SHPK kundrejt kualifikimit nga KVO të BOE “D E” SHPK & “K” SHPK

2. BO “M” SHPK & “Arisa Konfeksion” SHPK ka paraqitur ankesë në AK me datë 02.04.2019. Në ankesë BO sqaron se në lidhje me certifikatën OEKO-tex nuk është kërkuar për secilin anëtar të BO, po ashtu dhe për certifikatën e konformitetit të këpucëve. Në lidhje me gjobën BO ankimon se gjoba nuk është titull ekzekutiv dhe si e tillë gjendja në kontabilitet nuk përbën detyrim tatimor. Ankesa është shoqëruar dhe me kopjen e certifikatës së OEKO-tex edhe për OE “M” SHPK, si dhe vërtetimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, të datës 04.02.2019, se në datën 16.11.2018 është regjistruar në sistem gjobë inspektori në vlerën 2,447 lekë për pagesë të vonuar të kësteve të tatim-fitimit për vitin 2018, e cila është paguar më datë 29.01.2019.

- Për shqyrtimin e ankesës është ngarkuar B K i cili në raportin e datës 08.02.2019 për shqyrtimin e ankesës drejtuar Administratorit të OSHEE, hedh poshtë plotësimin e ankesës për plotësimin me certifikatën OEKO-tex me pretendimin se nuk është shprehur në prokurë; për certifikatën e konformitetit të këpucëve nuk ka paraqitur dokumente për të provuar lidhjen si dhe konsideron detyrim tatimor në datën e hapjes së tenderit, përgjigje kjo e kthyer në të njëjtën datë.

KVO, me procesverbalin nr.5, datë 01.04.2019 ka bërë rivlerësimin e procedurës në bazë të vendimit të KPP nr. 181/2019 date 29.03.2019 duke vendosur në vend të parë BO “M A M S” SHPK.

BO “M” SHPK & “Arisa Konfeksion” SHPK ka bërë ankimim tek AK me datë 05.04.2019 për refuzimin e ofertës dhe kërkon rivlerësimin e ofertës tyre. Shqyrtimi i kërkesës për rivlerësimi është kryer nga E C, protokolluar me nr. 8022/2, datë 11.04.2019 raportin dërguar administratorit, në të cilin nuk legjitimohet paraqitja e një ankesë të dytë, si dhe cilëson detyrimin debitor ditën e hapjes së ofertave të gjobës në sistem, përgjigje kthyer po në këtë datë.

- Kriteri:**
- Ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenin 107,
 - Udhëzimi nr.24, datë 02.09.2008 të Ministrit të Financave;
 - DT, Shtojca 9, kreu 2-Kriteret e veçanta të kualifikimit, lidhur me kapacitetin teknik, pika 2.3.3;
- Ndikimi/Efekti:** Si pasojë e veprimeve dhe e mosveprimeve të KVO, i është shkaktuar OSHEE SHA një efekt financiar negativ prej 23,374,000 lekë
- Shkaku:** Nga kuptimi dhe zbatimi i njëanshëm i kuadrit rregullator për prokurimin publik
- Rëndësia:** I lartë
- Rekomandime:** 1. Autoriteti Kontraktor të marrë masa për trajnime të specifikuar të zyrtarëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si dhe për raste të tilla të veçanta të kërkojë nga APP mendime paraprake për trajtimin e rasteve të tilla.

Si konkluzion: Në tenderin “Blerje uniforma dhe pajisje sigurie për punonjësit e OSHEE” KVO, si dhe zyrtari i marrë me shqyrtimin e ankesës me veprimet dhe mos veprimet e tyre duke skualifikuar padrejtësisht BO “M A K” SHPK me ofertën më të ulët se OE i kualifikuar dhe i shpallur fitues pas vendimit të KPP181/2019 datë 29.03.2019, i kanë shkaktuar OSHEE SHA një efekt financiar negativ në përdorimin e fondeve prej 22,374,000 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis BO të shpallur fitues dhe BO të skualifikuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi 1) Z. E B, 2) Z A G, 3) Z.

A Z, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, dhe Z. B K në cilësinë e zyrtarit të shqyrtimit të ankesave.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën nr.12149/15 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

Pasi është përshkruar procedura e ndjekur për vlerësim, KVO ka kryer verifikimin e të gjithë ofertuesve në lidhje me deklaratën për përmbushjen e kritereve të përgjithshme, ku për OE “M SHPK, referuar vërtetimit T00751664 të datës 26.12.2018 ka detyrime tatimore të papaguara, dhe për këtë i është drejtuar me shkresë DRT Tiranë. DRT Tiranë ka marrë përgjigje me datë 23.01.2019 se OE ka gjobë të kontabilizuar më datë 16.11.2018 dhe referuar legjislacionit tatimor, në momentin e nënshkrimit të deklaratës rezulton me detyrime tatimore, duke e skualifikuar.

Në observacion cilësohet se nuk është propozuar nga KVO shpallja fitues e OE me vlerën më të lartë, që të rezultojë efekt financiar negativ vlera prej 22,374,000 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis BO të shpallur fitues dhe BO të skualifikuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e subjektit të audituar dhe dokumentacionin bashkëlidhur, duke arritur në përfundimin e mëposhtëm:

BOE “M A K” SHPK është skualifikuar nga KVO për një gjobë të pa njoftuar në sistemin tatimor në vlerën 2,447 lekë, dhe kjo nuk është në përputhje me frymën e legjislacionit për prokurimin publik. Ashtu siç ka rezultuar dhe nga vendimi administrativ i APP nr.59, datë 26.08.2019, OE “M SHPK nuk ka pasur dijeni për gjobën, si dhe mos përfshirja e gjobës në vlerë ankimimi në organet tatimore për t’u krijuar mundësi pjesëmarrjeje OE në procedurat e prokurimit, duke shtuar këtu dhe faktin e vlerës së papërfillshme të gjobës bën që KVO me veprimet dhe mos veprimet e saj të kufizojë numrin e pjesëmarrësve dhe për pasojë të ulë efektivitetin, eficiencën dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve publike, i cili është qëllimi kryesor i kuadrit ligjor të prokurimit publik.

Bazuar në sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin në lidhje me mangësitë e evidentuara në procedurën e prokurimit dhe për këtë arsye nuk e merr në konsideratë.

4. Titulli i Gjetjes Në procedurën e prokurimit ”Furnizim me vaj transformatori i pa përdorur për nevoja të Drejtorisë së Tensionit të Lartë dhe për nevojat të tjera të OSHEE SHA” datë 07.06.2018 është kualifikuar OE fitues në mungesë të plotësisimit të të gjitha kriteret e vendosura nga AK.

Situata: Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 7 OE dhe janë skualifikuar 6 prej tyre për arsye të ndryshme, por kryesisht për shkak se në skedën teknike të paraqitur nuk plotësohen specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, dhe është shpallur fitues “L” SHA me ofertë 37,635,000 lekë pa TVSH, i renditur i gjashti, nisur nga vlera më e ulët e ofertave prej 32,110,000 lekë.

Nga auditimi në SPE i kësaj procedure prokurimi, konstatohet se OE i kualifikuar dhe i shpallur fitues “L” SHA, në skedën teknike të paraqitur i mungojnë specifikimet teknike për 7 tregues nga 21 të kërkuar në specifikimet teknike, si dhe treguesi i viskozitetit në 40° është jashtë specifikimeve teknike nga 9 mm²/S e kërkuar në 10 e ofertuar; pika e flakërimit nga 145° në specifikimet teknike në 140° në ofertë etj.

Në këto kushte KVO e përbërë nga A M, D X dhe K N ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenin 53, pika 5/c, në të cilën përcaktohet:

“Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë: kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 54 të këtij ligji;

pasi nuk i përmbush të gjitha kriteret dhe tenderi duhej anuluar. Gjithashtu, KVO ka vepruar me dy standarde në vlerësim, pasi për të njëjtat kriteret ka skualifikuar dhe ka kualifikuar OE.

- Kriteri:** - Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenin 53, pika 5/c,
- Ndikimi/Efekti:** Kualifikimi, shpallja fitues, lidhja e kontratës me OE në kushtet e mosplotësimin të kriterëve, në një kohë që procedura duhej anuluar.
- Shkaku:** Mangësi të zyrtarëve të KVO në njohjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor për prokurimet.
- Rëndësia:** I mesëm
- Rekomandime:** Autoriteti kontraktor të marrë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procedurat e prokurimit publik, që krahas ekspertëve të fushës të mundësohet trajnimi i tyre.

Si konkluzion: Në procedurën e prokurimit “Furnizim me vaj transformatori i pa përdorur për nevoja të Drejtorisë së Tensionit të Lartë dhe për nevojat të tjera të OSHEE SHA”, KVO ka kualifikuar OE L SHA në mungesë të specifikimeve teknike për 7 tregues nga 21 të kërkuar në specifikimet teknike, si dhe jashtë parametrave të kërkesave të specifikimeve teknike për disa tregues të paraqitur.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: 1) Z. A M, 2) Z. D X, 3) Z. K N, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën nr.12149/16 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

KVO në observacionin e paraqitur shkaqet e skualifikimit të operatorëve të tjerë, duke e konsideruar kualifikimin e ofertës së “L” SHA në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 53, të LPP, me Rregullat e Prokurimit Publik dhe DST.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e KVO, dhe në të nuk gjendet asnjë argument lidhur me treguesit e specifikimeve teknike të ofertuar nga “L” SHA jashtë kërkesave në DT. Nga ana jonë nuk është kontestuar skualifikimi i operatorëve të tjerë ekonomikë, por kualifikimi në kushtet e mosplotësimin të specifikimeve të ofertës së shpallur fituese.

Bazuar në sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin në lidhje me mangësitë e evidentuara në procedurën e prokurimit dhe për këtë arsye nuk e merr në konsideratë.

5. Titulli i Gjetjes Mungesë penalizimi për dorëzim me vonesë të produkteve të kontratës së shërbimit, dhe ulje të performancës së saj.

Situata: Procedura e prokurimit “Inventarizimi dhe vlerësimi i Aktiveve Materiale Afatgjata të OSHEE SHA, si dhe ngritja e sistemit të administrimit dhe përgatitja e procedurave të brendshme të menaxhimit të tyre” është me fond limit 347,400,000 lekë pa TVSH, me kohëzgjatje kontrate 18 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Kontrata me nr.16545/11 prot., datë 23.01.2019 është lidhur me BOE “D A H S A me objekt inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve Materiale

Afatgjata të OSHEE SHA, si dhe ngritja e sistemit të administrimit dhe përgatitja e procedurave të brendshme të menaxhimit të tyre” me vlerë 337,000,000 lekë, me afat 18 muaj.

Me Urdhrin e administratorit nr.16545/13 prot., datë 04.02.2019 janë ngritur komisionet e marrjes në dorëzim të shërbimit sipas fazave.

- Komisioni marrjes në dorëzim të fazës së dytë: D S, M I, S D, J S, B K, S D dhe A G, me datë 15.08.2019 kanë përgatitur relacion mbi shtyrjen e afatit të zbatimit të kontratës ndikuar nga faza e hartimit të Raportit të metodologjisë së procesit të inventarizimit. Midis të tjerave, cilësohet se me datë 21.03.2019 nga përfaqësuesi i OE është dërguar me email tek përfaqësuesi i AK raporti i metodologjisë së inventarizimit (draft), sipas tyre brenda afatit të përcaktuar në grafikun e realizimit të kontratës. Sipas tyre, diskutimi ka zgjatur për një kohë më të gjatë se 10 ditë, nga afati i përcaktuar në paragrafin e dytë në “Plani i realizimit dhe grafiku i kohëzgjatjes”, kohë gjatë së cilës janë shkëmbyer 39 email-e dhe takime në zyra nga data 28.03.2019 deri më 09.08.2019 dhe ka zgjatur 141 ditë kalendarike. Grupi i punës e përcakton këtë si periudhë objektive pasi Raporti final nuk mund të sillej pa vërejtjet dhe sugjerimet e autoritetit kontraktor, duke kërkuar zgjatjen e afatit me 131 ditë kalendarike pas afatit 18 muaj të kontratës. Me datën 03.09.2019 me nr. 16545/15 prot., është nënshkruar amendamenti për kontratën bazë për zgjatjen e afatit me 131 ditë.

Referuar termave të referencës, në kreun -Detyra të veçanta të kontraktorit për inventarizimet, në lidhje me Përcaktimin e metodologjisë për procesin e inventarizimit janë parashikuar takime me Departamentin ekonomik, me Divizionin e Shpërndarjes, përcaktimin e hapave që do të ndiqen, procedurës për evidentimin dhe formës së SEMA, çka do të thotë se veprimtaria e kontraktorit sipas relacionit nuk është në përputhje me termat e referencës, pasi kjo veprimtari duhej kryer para përgatitjes së dokumentit. Edhe në propozimin teknik të BOE, faqe 9 është cilësuar që në përfundim të hapit parë brenda 2 muajsh nga nënshkrimi kontratës, kontraktori do të përgatisë dhe paraqesë raportin e metodologjisë së procesit të inventarizimit...”.

Edhe në raportimin e rezultateve pika “ii” është përcaktuar paraqitja e raportit të metodologjisë së procesit të inventarizimit dhe jo të draftit, i cili me miratimin nga OSHEE SHA do të zbatohet gjatë procesit të inventarizimit fizik të aseteve. E njëjta gjë dhe në grafikun e realizimit e pasqyruar në pikën 2 me afatin deri në 2 muaj.

- Sipas praktikës së pagesës për shërbimin e kryer konstatohet se:

Sipas kontratës nr.16545/11 prot., datë 23.01.2019 pika 7.4 pagesa për shërbimet duhet bërë sipas skedulit të mëposhtëm: 1. Përgatitja e raportit të vlerësimit paraprak deri në 1 muaj dhe do të paguhet 10 % e vlerës së kontratës. Sipas dokumenteve D e ka dorëzuar këtë raport në afat, brenda datës 21.02.2019, por që është marrë në dorëzim nga komisioni me përbërje D S, M I, S D, J S, B K, S D dhe AG me datë 06.05.2019, pas komenteve të bëra nga komisioni për këtë fazë, pra 130 ditë me vonesë. Kjo tregon se kontraktori nuk ka vepruar në afat sipas termave të referencës, pasi ky raport duhej të shoqërohej me një prezantim pranë personave përgjegjës të OSHEE prej ku do të merreshin dhe vendimet përkatëse, për më tepër i konsideruar dhe nga ana e tyre “draft”, cilësuar në paragrafin më lart.

Dorëzimi i një dokumenti në përputhje me termat e referencës është i lidhur

me marrjen në dorëzim, dhe jo me dorëzimin e dokumentit për të respektuar formalisht afatet kontraktore sipas fazave. Kështu, kontraktori “D A H S A duhej të penalizohej me tarifën ditore me 1/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi i kontratës, sipas nenit 20.1/c, që do të thotë tarifë ditore 33,700 lekë (1/1000 e 33,700,000 lekë, pra e 10 % të kësaj faze) x 130 ditë= 4,381,000 lekë penalitet për dorëzim raporti me vonesë.

Grupi i marrjes në dorëzim të “Raportit mbi strukturën që do të ngrihet mbi zbatimin elektronik të menaxhimit të aseteve (SEMA)” me përbërje S P, I H, M A, T K dhe G M me datë 09.07.2019 ka marrë në dorëzim këtë raport të dorëzuar nga kontraktori me datë 23.04.2019, pra pas afër 4 muaj pa dhënë shpjegime përse ka ndodhur një vonesë e tillë gjë që i ngarkon me përgjegjësi për moszbatim në afat të detyrave të ngarkuara me Urdhrin nr.16545/13 prot., datë 04.02.2019 për komisionet e marrjes në dorëzim të shërbimit sipas fazave, si dhe duke ulur ndjeshëm performancën e kësaj kontrate.

- Kriteri:** - Kontrata me nr.16545/11 prot., datë 23.01.2019, pika 7.4; neni 20.1/c
- Ndikimi/Efekti:** Ulje të performancës së zbatimit të kontratës si rezultat i vonesave në dorëzimin e produkteve, si dhe dëm ekonomik në të ardhurat nga burimet e tjera për penalizim në vlerën e 4,381,000 lekë.
- Shkaku:** Njohje dhe zbatim i gabuar i termave të referencës dhe kushteve të kontratës së shërbimit nga grupi i marrjes në dorëzim.
- Rëndësia:** I lartë
- Rekomandime:** 1. Autoriteti kontraktor të mbajë në konsideratë caktimin e zyrtarëve jo vetëm ekspertë të fushës, por dhe njohës dhe zbatues të termave të referencës e kushteve kontraktore në kontratat e shërbimeve, duke i paraprirë me trajnime të kësaj fushe specifike.
2. Administratori i shoqërisë OSHEE SHA të marrë të gjitha masat *për arkëtimin e vlerës prej 4,381,000 lekë për penalitet të pambajtur kontraktorit “D A H S A dorëzim raporti me 110 ditë vonesë*

Si konkluzion: Dorëzimi i dokumenteve draft nga ana e kontraktorit, si dhe diskutimet dhe komunikimet e më pastajme me përfaqësues të AK, tregon se “D A H S A ka qenë në shkelje të afateve të dorëzimit të raportit të vlerësimit paraprak për 110 ditë, dhe kontraktori për këtë duhej të penalizohej me 4,381,000 lekë për dorëzim raporti me vonesë, të cilat janë të ardhura të munguara për OSHEE SHA nga burimet e tjera, pra dëm ekonomik.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: 1) Z. D S, 2) Zj. M I, 3) Zj. S D, 4) Z. J S, 5) Z. B K, 6) Zj. S D, 7) Z. A G, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit për këtë fazë.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën nr.12149/17 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

Komisioni i marrjes në dorëzim i fazës së dytë në observacionin e paraqitur, fillimisht ka cilësuar kohën dhe afatin e observacioneve, dhe në vijim konkluzionin dhe rekomandimin e grupit të auditimit të KLSH, duke shprehur qëndrimin e mbajtur për akt-konstatimin. Në atë observacion është cilësuar se grupi i marrjes në dorëzim ka përcjellë metodologjinë për opinion në strukturat përkatëse përfaqësuese, për të cilën është dashur koha e nevojshme për finalizimin e plotë. Në vijim cilësohet se komisioni ka gjykuar që të konsumohet më shumë kohë për të pasur një metodologji të përhershme dhe të pakontestueshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e Komisionit të marrjes në dorëzim

të fazës së dytë, dhe konstaton se në kushtet e nënshkrimit të kontratës, detyrimet kontraktore, përfshirë dhe termat e referencës si pjesë e saj, marrin fuqinë e ligjit, dhe vonesat nuk justifikohen as me dëshirën e mire për diskutime dhe as për sigurimin e një metodologjie të përhershme dhe të pakontestueshme, pasi pikërisht këtë ka marrë përsipër kontraktori.

Bazuar në sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin në lidhje me vonesat dhe mungesën e penalizimit dhe për këtë arsye nuk e merr në konsideratë.

6. Titulli i Gjetjes Është kualifikuar OE me detyrime të papaguara të sigurimeve shoqërore, në kundërshtim me kriteret ligjore dhe ato të vendosura në DT

Situata: Për procedurën e prokurimit “E hapur- punë”, me objekt “Investimi për sistemin SCADA”, me fondin total 199,405,302 lekë pa TVSH dhe me afat realizimi 2 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, në datën e zhvillimit të tenderit 14.05.2018, kanë marrë pjesë 4 OE: - OE “P S” SHPK me ofertë me vlerë 157,250,000 lekë pa TVSH, - OE “G” SHPK me ofertë me vlerë 194,985,000 leke pa TVSH, - OE “A” SHPK me oferte me vlerë 198,256,894 lekë PA TVSH, - OE “B” SHPK nuk ka paraqitur ofertë. Janë skualifikuar 3 OE, nga të cilët njëri nuk ka paraqitur ofertë dhe është shpallur fitues OE “G” SHPK me ofertë ekonomike me vlerë 194,985,000 lekë pa TVSH.

- Nga auditimi në sistem i kësaj procedure prokurimi, rezulton se OE i shpallur fitues “G” SHPK, në vërtetimin e sigurimeve shoqërore nr. T00258668, datë 23.04.2018 ka detyrime të pashlyera prej 569,992 lekë, në këto kushte KVO me përbërje E B, J S dhe M B, duhej ta kishin skualifikuar, pasi nuk plotëson kriterin 1/d të kreut I të shtojcës 12 të DT, i cili përcakton:

“d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi”,

dhe në bazë të nenit 53/3 të LPP-së në të cilin përcaktohet se:

“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.”,

OE duhej skualifikuar dhe procedura duhej anuluar për mungesë të OE të kualifikuar.

Në mungesë të kualifikimit të OE pjesëmarrës, AK duhej të kishte anuluar procedurën e prokurimit, në zbatim të kërkesave të nenit 24, pika 1, germa “ç” të LPP e cila përcakton:

“Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit;”

Kriteri: - LPP nenit 24, pika 1, germa “ç”;

- Kriteri 1/d të kreut I të shtojcës 12 të DT;

Ndikimi/Efekti: Në këtë procedurë prokurimi nuk duhej kualifikuar asnjë OE për mosplotësim të kriterëve të vendosura nga AK dhe tenderi duhej të anulohet.

Shkaku: Nga interpretimi i gabuar i trajtimit të njëlojtë të detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe atyre tatimore.

Rëndësia: I lartë

Rekomandime: Autoriteti kontraktor OSHEE SHA të analizojë në mënyrë të veçantë zhvillimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe të marrë masa për të siguruar përzgjedhjen dhe trajnimin e zyrtarëve të përfshirë në procedurat e prokurimit, në ato drejtime ku shfaqen mangësi të njohjes dhe zbatimit të kriterëve dhe kushteve të përgjithshme e të veçanta të vendosura prej tij.

Si konkluzion: Në tenderin e zhvilluar me datë 14.05.2018 me objekt “Investimi për sistemin SCADA”, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “G” SHPK, në një kohë që nuk plotëson kriteret, pasi ka detyrime të pashlyera për sigurimet shoqërore në vlerën 569,992 lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: 1) Z. E B, 2) Z. J S dhe 3) Z. M B në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën nr.12149/18 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

KVO në observacionin e paraqitur ka cilësuar se është e vërtetë se subjekti ka detyrime të pashlyera sipas vërtetimit të datës 14.05.2018, por në dokumentet e ngarkuara nga OE në SPE është vërtetimi i tatimeve nr.T000269289, datë 27.04.2018 sipas të cilit nuk ka detyrime tatimore të pashlyera, dhe meqenëse është i një date të mëvonshme janë konsideruar detyrime të shlyera edhe për sigurimet shoqërore

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e KVO dhe konstaton se në mënyrë të gabuar KVO kontributet e sigurimeve shoqërore i ka konsideruar brenda detyrimeve tatimore.

Bazuar në sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin në lidhje me likuidimin e detyrimeve për sigurimet shoqërore, nëpërmjet vërtetimit për pagimin e tatimeve dhe nuk e merr në konsideratë.

7. Titulli i Gjetjes Zbatimi i kontratës “Marrje me qira operationale të makinave për NJOS” për vitet 2017, 2018 dhe 2019 është shoqëruar me mangësi lidhur me normën e kombinuar të konsumit në fakt të karburantit për 100 km, krahasuar me atë të ofertuar në specifikimet teknike, duke sjellë si pasojë mospërputhje të tyre, dhe përdorim të fondeve pa efektivitet për blerjen e karburantit në vlerën 8,156,551 lekë për vitet 2017, 2018 dhe 2019.

Situata: Në zbatimin e kësaj kontrate “Marrje me qira operationale te makina per NJOS” sipas viteve rezulton si më poshtë:

I. Për vitin 2017 në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim - mallra”, me objekt “Marrje me qira operationale të makinave për NJOS”, me fond limit 2,979,000 lekë pa TVSH është lidhur kontrata me vlerë 3,574,800 lekë (me TVSH), me datë 18.08.2017 me afat 4-muaj e 15 ditë deri më datë 31.12.2017 me OE të vetëm pjesëmarrës, të kualifikuar dhe të shpallur fitues “T A” SHPK.

Sipas DT (shtojca 1) merren me qira 8 mjete pick-up, 1 mjet Sedan dhe 2 auto vetura, gjithsej 11 mjete. Referuar ofertës dhe dokumenteve të OE të shpallur fitues (në vijim kontraktorit) në specifikimet teknike të tij të datës 04.08.2017 është cilësuar midis të tjerave, se konsumi i karburantit do të jetë 8 litra për 100 km për secilin prej 10 automjeteve Pick-up Mitsubishi L200 dhe për automjetin Sedan Hyndai, ndërsa për mjetin auto veturë Hyndai IX35 konsumi do të jetë 6.5 litra për 100 km. Këto tregues janë brenda përcaktimeve të kriterit të vendosur nga AK në DT, shtojca 9, për të pasur një konsum përkatësisht 8-10 litra/100 km për dy të parat dhe 6-8 litra, për këtë të fundit. Lidhur me sa më sipër, përfaqësuesi i ofertuesit fitues “T A” SHPK ka nënshkruar kontratën mbi përmbushjen e

specifikimeve teknike të përcaktuara në DT dhe e vërteton këtë me certifikata dhe dokumente të dorëzuara bashkë me këtë deklaratë.

- Sipas të dhënave të OSHEE SHA, për konsumin e karburantit dhe kilometrat e përshkuara për automjetet faktike të vëna në dispozicion nga kontraktori dhe krahasimit me mjetet e ofertuara (targat dhe dokumentacionin përkatës) rezulton se nga ana e kontraktorit, nuk janë ofruar 5 mjete të cilët janë zëvendësuar me mjete të tjera në kundërshtim me kushtet kontraktore, për të cilat ngarkohet me përgjegjësi administratori i kontratës Q L.

- Nga 11 mjete të marra me qira, rezultojnë se 9 prej tyre janë ngarkuar me konsumin e 13 610 litrave karburant (të regjistruar) ose 58 %, me vlerë 2,405,431 lekë (llogaritur me çmimin mesatar 2017-2019 prej 176.74 lekë) e sasisë gjithsej prej 23 360 litra karburant, të cilat nuk kanë asnjë km të përshkuar të regjistruar, gjë për të cilën ngarkohet me përgjegjësi administratori i kontratës Q L. Gjithashtu në 2 rastet e tjera janë regjistruar sasi karburanti dhe km të përshkuara, të cilave ju përket një normë konsumi që shkon nga 55 dhe 102 litra për 100 km. Mungesa e mbajtjes së rregullt dhe të dokumentuar të shpenzimeve për karburant dhe km të përshkuara ngarkon me përgjegjësi krahas administratorit të kontratës edhe titullarin e NJOS për këtë periudhë z. D M dhe zj. A S në vijim të cilët kanë vepruar në kundërshtim me pikën 35, shkronja “b” të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

“Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në: b) Dokumente vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikuese shpenzimi.”

Këto veprime kanë sjellë për pasojë dhe pamundësinë e vërtetimit në praktikë në se mjetet e sjella nga kontraktori me qira janë në përputhje me specifikimet teknike të deklaruar prej tij lidhur me konsumin e karburantit për 100 km.

II. Për vitin 2018, në procedurën “Kërkesë për propozim-mallra”, me objekt “Marrje me qira operationale të makinave për NJOS”, me fond limit 6,516,000 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata me vlerë 7,812,000 lekë (me TVSH), e lidhur me datë 23.04.2018 me afat 9-muaj deri më datë 31.12.2018 me OE të vetëm të kualifikuar dhe të shpallur fitues “T A” SHPK.

Referuar ofertës dhe dokumenteve të kontraktorit në specifikimet teknike të paraqitura me datë 03.04.2018 është cilësuar midis të tjerave, se konsumi i karburantit do të jetë 8 litra për 100 km për secilin prej 10 automjeteve Pick-up Mitsubishi L200, ndërsa për automjetin SUV Hyndai Tucson, si dhe për mjetin auto veturë Hyndai do të jetë 6.5 litra për 100 km, në përputhje me kërkesat e AK në DT (shtojca 9) për të pasur një konsum përkatësisht 8-10 litra/100 km për dy të parat dhe 6-8 litra për këtë të fundit.

Lidhur me sa më sipër, përfaqësuesi i ofertuesit fitues “T A” SHPK ka nënshkruar kontratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe e vërteton këtë me certifikata dhe

dokumente të dorëzuara bashkë me këtë deklaratë.

Nga të dhënat e OSHEE SHA, rezulton se në vitin 2018 të gjitha automjetet kanë qenë me konsum mesatar nga 10.6 në 20.6 litra për 100 km.

Tabela nr.2 Krahasimi i konsumit të karburantit në fakt dhe sipas ofertës së kontraktorit 2018

Nr.	Mjeti	Targa	l/100 km sipas sp. teknike	l/100 km në fakt	Diferenca Fakt - Sp. (l/100 km)	Sasia e karburantit mbi sp. teknike për km e përshkuara (litra)
1	MITSUBISHI	AA 103 LA	8	11.2	3.2	484
2	MITSUBISHI	AA 104 LA	8	13.4	5.4	527
3	MITSUBISHI	AA 105 LA	8	10.9	2.9	553
4	MITSUBISHI	AA 107 LA	8	12.2	4.2	364
5	MITSUBISHI	AA 341 LA	8	15.6	7.6	731
6	MITSUBISHI	AA 342 LA	8	11.2	3.2	505
7	MITSUBISHI	AA 346 LA	8	10.6	2.6	511
8	MITSUBISHI	AA 596 KY	8	10.6	2.6	423
9	MITSUBISHI	AA 663 KY	8	10.7	2.7	438
10	MITSUBISHI	AA 674 KY	8	10.9	2.9	529
11	Huundai Tucson	AA 774 NE	8	20.6	12.6	1164
12	Huundai IX 36	AA 432 GC	6.5	12.7	6.2	1272
	Gjithsej					7501

Burimi: Të dhëna të OSHEE SHA të përpunuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Nga sa më sipër konstatohet se, OSHEE SHA nga zbatimi i kësaj kontrate janë shpenzuar pa efektivitet 7 501 litra karburant, e cila përfaqëson 35 % të sasisë gjithsej të shpenzuar në këtë vit prej 21 500 litra, me vlerë 3,799,910 lekë (llogaritur me çmimin mesatar 2017-2019 prej 176.74 lekë), duke ju referuar krahasimit të normës së konsumit në fakt të karburantit dhe asaj të ofruara nga kontraktori sipas llojit të mjeteve në DT, duke ngarkuar me përgjegjësi administratorin e kontratës z. L M për mospërputhjen e specifikimeve teknike për konsumin e karburantit të automjeteve të ofertuara, si dhe Titullarin e NJOS z. L B, si dhe përgjegjësin e financës zj. A S deri me datën 05.02.2018 për moszbatim të pikës 35, shkronja “b” të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 i ndryshuar

III. Marrje me qira operationale të makinave për NJOSE për vitin 2019, me fond limit 10,284,000 lekë pa TVSH dhe vlerë totale përfundimtare të kontratës 12,336,000 lekë me TVSH, me datë të lidhjes së kontratës 15.01.2019 me kontraktorin “T A” SHPK.

Në plotësim të kërkesave të tenderit për 10 automjete pick-up dhe 2 automjete SUV, me konsum të kombinuar karburanti maksimumi 10 litra për 100 km për 10 pick-up dhe 1 SUV ndërsa për një SUV për administratën maksimumi 12 l/100 km, “T A” SHPK ka sjellë specifikimet teknike më datë 04.01.2019, në të cilën përcakton midis të tjerave se automjetet pick-up do të jenë Mitsubishi L200 dhe se konsumi i karburantit do të jetë 8 litra për 100 km, si dhe njëri nga mjetet SUV është me konsum

6.5 litra për 100 km.

Grupi i auditimit shqyrtoi të dhënat për shpenzimet në lekë dhe sasisë së karburantit, si dhe të km të përshkuara (regjistruara) sipas targave të mjeteve për vitin 2019, nga të cilat konstatohet se për një automjet (AA 432 GC) i janë ngarkuar 2400 litra karburant ndërkohë që nuk ka përshkuar (regjistruar) asnjë km.

Nga krahasimi i normës së konsumit të karburantit për 100 km të ofertës fituese të kontraktorit sipas llojit të mjetit dhe asaj në fakt, llogaritur mbi bazën e sasisë së karburantit të regjistruar (harxhuar) për secilën prej tyre dhe km të përshkuara (të regjistruara), rezultojnë diferenca të konsumit më tepër nga 1 në 6.2 litra në 11 nga 12 mjetet e ofertuara, gjë që tregon se autoveturat e paraqitura nuk kanë qenë sipas specifikimeve teknike të ofertuara.

Tabela nr.3 Krahasimi i konsumit të karburantit në fakt dhe sipas ofertës së kontraktorit 2019

Nr.	Mjeti	Targa	l/100 km sipas sp. teknike	l/100 km ne fakt	Diferenca Fakt – Sp. l/100 km	Sasia e karburantit mbi sp. teknike për km e përshkuara (litra)
1	MITSUBISHI	AA 103 LA	8	11.4	3.4	1,043
2	MITSUBISHI	AA 104 LA	8	11.2	3.2	918
3	MITSUBISHI	AA 105 LA	8	10.1	2.1	500
4	MITSUBISHI	AA 107 LA	8	12.0	4.0	1,207
5	MITSUBISHI	AA 341 LA	8	9.0	1.0	199
6	MITSUBISHI	AA 342 LA	8	11.6	3.6	1,063
7	MITSUBISHI	AA 346 LA	8	12.8	4.8	947
8	MITSUBISHI	AA 596 KY	8	9.9	1.9	664
9	MITSUBISHI	AA 663 KY	8	10.1	2.1	589
10	MITSUBISHI	AA 674 KY	8	10.3	2.3	609
11	Huundai Tucson	AA 774 NE	8	7.7	-0.3	
12	Huundai IX 36	AA 432 GC	6.5	12.7	6.2	3300
	Gjithsej					11040

Burimi: Të dhëna të OSHEE SHA të përpunuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Nga sa më sipër konstatohet se, OSHEE SHA nga zbatimi i kësaj kontrate gjatë vitit 2019 janë shpenzuar pa efektivitet 11 040 litra karburant (61,5 % e sasisë totale të karburantit të këtij viti prej 34950 litra) me vlerë 1,951,210 lekë (llogaritur me çmimin mesatar 2017-2019 prej 176.74 lekë), duke ju referuar krahasimit të normës së konsumit në fakt të karburantit dhe asaj të ofruara nga kontraktori sipas llojit të mjeteve në DT, dhe ngarkon me përgjegjësi administratorin e kontratës z. L M për mospërputhjen e specifikimeve teknike për konsumin e karburantit të automjeteve të ofertuara, për moszbatim të pikës 35, shkronja “b” të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 i ndryshuar.

Kriteri:

- Procedurat e prokurimit sipas viteve 2017, 2018 dhe 2019;
- Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, pika 35, shkronja “b”;
- Të dhënat e OSHEE SHA për sasinë e karburantit të konsumuar dhe km e përshkuara.

- Ndikimi/Efekti:** Pasoja të konsiderueshme në rritjen e shpenzimeve operative për blerje karburanti të OSHEE SHA në vlerën 8,156,551 lekë.
- Shkaku:** Mбивlerësim i rolit të vet nga NJOS, qenia si institucion në mbështetje të Task-Forcës dhe me financim të shpenzimeve nga OSHEE SHA, si dhe mangësi në njohjen dhe zbatimin detyrave përkatëse të zyrtarëve të përfshirë në zbatimin e kësaj kontrate.
- Rëndësia:** I lartë
- Rekomandime:** Autoriteti kontraktor OSHEE SHA të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë në zbatimin e këtyre kontratave për periudhën 2017-2019, si dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e kontratave në përputhje me specifikimet teknike të OE ofertues fitues, duke saktësuar dhe qartësuar detyrat e zyrtarëve të përfshirë në zbatimin e kontratave të mallrave të kësaj natyre, me qëllim që të eliminohen efektet negative të konstatuara dhe menaxhimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike.

Si konkluzion:

- Zbatimi i kontratës “Marrje me qira operationale të makinave për NJOS” për vitet 2017, 2018 dhe 2019 është shoqëruar me mangësi lidhur me normën e kombinuar të konsumit në fakt të karburantit për 100 km, krahasuar me atë të ofertuar në specifikimet teknike, duke sjellë si pasojë mospërputhje të tyre, me pasoja në koston e përdorimit të tyre.

- Nga zbatimi i këtyre kontratave të shërbimit, si rezultat i normave më të larta të konsumit të kombinuar për 100 km, ka sjellë për pasojë përdorim të fondeve pa efektivitet për blerjen e karburantit në vlerën 8,156,551 lekë për vitet 2017, 2018 dhe 2019

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: 1) Z. D M, në cilësinë e titullarit të NJOS deri më datë 01.02.2018, 2) Z. L B, në cilësinë e titullarit të NJOS deri më datë 28.01.2019, 3) Z. Q L, në cilësinë e administratorit të kontratës deri më 31.12.2017, 4) Z. L M, në cilësinë e administratorit të kontratës deri më 16.01.2020, dhe 5) Zj. A S, në detyrën e përgjegjës të financës deri më 05.02.2018.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacionet për Projekt raportin me shkresën nr.12149/19 prot.; nr.12149/20 prot.; nr.12149/21 prot. të datës 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

1. Në observacionin e z. D M cilësohet se kryerja e detyrave funksionale kryhej në bazë të planeve të punës, duke menaxhuar sasinë e karburantit në dispozicion, më cilësinë e institucionit zbatues. Në vijim cilësohet se procedura e prokurimit është zhvilluar në përputhje të plotë me ligjin për prokurimin publik. Gjithashtu, cilësohet se në asnjë rast audituesi nuk ka mundur të llogarisë në se karburanti i harxhuar është në disproporcion me km e përshkuara, por me specifikimet teknike, për të cilat nuk bëhet testim se sa harxhon mjete.

Lidhur me mungesën e dokumentacionit cilësohet se në momentin e largimit, dokumentacioni i është dorëzuar z. L B.

2. Në observacionin e z. L M cilësohet se administratori i kontratave ka pasur si detyrë konfirmimin mujor të situacionit për mjetet motorike që kanë qenë në dispozicion të NJOSE dhe në gjendje teknike për t’u përdorur.

Lidhur me paraqitjen e mjeteve të tjera në zbatimin e kontratës së vitit 2017, cilësohet se mjete e vëna në dispozicion kanë të njëjtën tipologji me mjetet që kanë zëvendësuar, si dhe nisur në mënyrën e organizimit të NJOSE, OSHEE SHA nuk ka asnjë tagër të kontrollojë konsumin e karburantit. Të njëjtat argumente sillen dhe për mangësitë e konstatuara në vitin 2018, duke shtuar kërkesën e NJOS për mosgjurmim të lëvizjeve, duke i konsideruar të dhënat indikativë që nuk paraqesin realitetin.

Për vitin 2019, theksohet se mjetet e kaluara NJOSE, tashmë në varësi të OSHEE, kanë qenë në përdorim më parë nga OSHEE dhe kanë patur normë konsumi 12 l/100 km, si dhe diferencat midis vlerave të nxjerra nga testet laboratorike dhe atyre të marra nga drejtimi i mjetit në kushte terreni

reale shkon deri në 25-30 %, shifër e cila duhet t'i shtohet konsumit zyrtar për të dalë në konsumin real. Për sa i përket konsumit të automjetit AA432G i cili është furnizuar në 2019 me një sasi prej 3100 litra, gabimisht formula e ka llogaritur me 0 km, pasi u kontrollua rezultoi me 31571 km të regjistruara në sistemin GPS. Gjithashtu vihet në dukje se konsumi i mjetit varet në një masë të madhe edhe nga mënyra se si përdoruesi e drejton atë.

Në mbyllje të observacionit cilësohet se zbatimi i kontratës së vitit 2019, vlerat statistikore janë në proporcion me punën e bërë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionet e ish-drejtuesve të NJOS dhe konstaton se:

Referuar VKM nr.914, nenit 77, pikave 1 dhe 3, gjatë zbatimit të kontratave, AK mbikëqyrin zbatimin e tyre, si dhe për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, gjë që në këtë rast duhet ta bëjë administratori i kontratës. Edhe fakti i nënshkrimit të situacionit mujor për mjetet në dispozicion, tregon se administratori i kontratës, njeh kontratën dhe specifikimet teknike të saj, të cilat duhet të zbatohen, krahas zyrtarëve të subjektit të cilit i shërbehet.

Nuk përbën justifikim paraqitja e mjeteve të tjera me të njëjtat karakteristika, pasi ofertuesi i shpallur fitues duhet detyrimisht të paraqesë në fillim mjetet në ofertë, dhe në rast defekti zëvendësimin e tyre.

Gjithashtu, as kërkimi më i detajuar mbi dokumentet e mbajtura nga vetë ajo strukturë, nuk ndryshojnë sasinë e karburantit të konsumuar dhe km e përshkuara për secilin prej tyre. Theksojmë se nga ana e OSHEE janë kontrolluar dhe rikontrolluar të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH.

Sipas situatës së kësaj kontrate, në procedurë, sipas ofertës së paraqitur nga OE fitues, norma e konsumit është e kombinuar, çka do të thotë se merr në konsideratë pikërisht të gjitha tipet e rrugëve, si dhe OE është i vetëdijshëm për qëllimin e përdorimit nga OSHEE, për derisa ka nënshkruar vërtetimet përkatëse për normën e konsumit.

Për shkak të rrezikut që ekziston në lidhje me regjistrimin e të dhënave janë ngarkuar me përgjegjësi dhe titullari i NJOS pasi është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve të njësisë publike.

Bazuar në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, është përgjegjësi e titullarit të njësisë publike që përgjegjësitë për menaxhimin e aktiveve duhet të shpërndahen nga nëpunësi autorizues në njësinë publike nëpërmjet një sistemi delegimesh dhe ndarje funksionesh me rregulla të qarta dhe të dokumentuara (pika 6).

Bazuar në sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH, nuk i gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionet në lidhje me zbatimin e kontratës së marrjes së automjeteve me qira për NJOS në vitet 2017, 2018 dhe 2019 dhe për këtë arsye nuk i merr në konsideratë, me përjashtim të observacionit të z. A Z.

8. Titulli i Gjetjes Në zbatimin e kontratës "Marrjen me qira operationale të automjeteve për nevojat e OSHEE SHA" mjetet e ofruara nga kontraktori nuk kanë rezultuar sipas specifikimeve teknike të ofertuara dhe të nënshkruara, duke i shkaktuar OSHEE një kosto shtesë për shpenzimet për sasinë e karburantit në vlerën 6,002,659 lekë.

Situata: Vlera totale përfundimtare e kontratës është 520,800,000 lekë me TVSH dhe datë të lidhjes së kontratës 29.03.2017 me kontraktorin "T A" SHPK, me kohë zgjatje 36 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës për afatin e qirasë së mjeteve: 15 copë SUV (Crossover) dhe 125 copë Pick-Up, gjithsej 140 copë.

Referuar DT, shtojca 10 -Specifikimet teknike, midis të tjerave është kërkuar që për mjetet SUV dhe Pick-Up konsumi i kombinuar për 100 km të jetë max 10 litra/100km.

Kontraktori "T A" SHPK në ofertën teknike të paraqitur dhe nënshkruar prej tij, cilëson se ofron Mitsubishi L200 Pick-up me 0 km, vit prodhimi 2017, 2.4 DID Naftë, si dhe krahas të tjerave me konsum të kombinuar 6.4 litra për 100 km; si dhe Hyundai Tucson, modeli 2.0 CRDI, diesel, me kilometrazh zero, si dhe midis të tjerave me konsum të kombinuar 5.9 litra për 100 km. Veç kësaj, kontraktori, në ofertën e paraqitur ka të nënshkruar deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, si dhe deklaratën se automjetet e ofruara janë sipas normave dhe standardeve të Bashkimit Evropian.

Meqenëse kontrata është nënshkruar me datë 29.03.2017 dhe afati lëvrimin ka qenë 90 ditë, për të shmangur pasaktësitë e mundshme në regjistrimin e konsumit të karburantit dhe km të përshkuara në vitin 2017, është marrë nën auditim zbatimi i kontratës për vitin 2018 dhe 2019.

Sipas të dhënave të OSHEE SHA për këto mjete të marra me qira, sipas regjistrimit për karburantin e konsumuar dhe km e përshkuara për periudhën e kontraktuar 2018-2019, rezulton se mesatarisht janë konsumuar 10.4 litra për 100 km nga mesatarja prej 6.4 litra për të gjitha llojet e mjeteve të ofertuara. Nga kjo rezulton se mjetet e ofruara nga kontraktori nuk kanë rezultuar sipas specifikimeve teknike të ofertuara dhe të nënshkruara, duke i shkaktuar OSHEE një kosto shtesë për shpenzimet për sasinë e karburantit. Fakti që konsumi i karburantit rezulton mbi normen mesatare të konsumit të kombinuar për 100 km me 0.4 litra ka sjellë si pasojë kosto shtesë mbi parashikimin për 33 963 litra karburant $[(8\,490\,804\text{ km} \times 10.4/100) - (8\,490\,804\text{ km} \times 10.0/100)]$ me vlerë mesatare prej 6,002,659 lekë $(33\,963 \times 176.74)$.

Kriteri:

- Dokumentet e tenderit;
- Të dhënat e OSHEE SHA për sasinë e karburantit të konsumuar dhe km e përshkuara.

Ndikimi/Efekti:

Si pasojë e normës më të lartë të konsumit të kombinuar karburantit në fakt në krahasim me atë të parashikuar dhe të specifikimeve teknike të ofertuesit prej 0,4 litra/100 km është rritur kosto e për blerjen e karburantit në vlerën 6,002,659 lekë për vitet 2018 dhe 2019.

Shkaku:

sasiore dhe cilësorë (pra shkelje me ndikim financiar ose jo)
Mungesa e vëmendjes të zbatimit të kontratës për të krahasuar në praktikë normat e konsumit të karburantit me ato të ofruara në tender.

Rëndësia:

I lartë

Rekomandime:

Autoriteti kontraktor OSHEE SHA të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë në zbatimin e këtyre kontratave për periudhën 2017-2019, si dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e kontratave në përputhje me specifikimet teknike të OE ofertues fitues, duke saktësuar dhe qartësuar detyrat e zyrtarëve të përfshirë në zbatimin e kontratave të mallrave të kësaj natyre, me qëllim që të eliminohen efektet negative të konstatuara dhe të sigurohet menaxhimi me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike.

Si konkluzion: Gjatë zbatimit të kontratës "Marrje me qira operacionale të automjeteve për nevojat e OSHEE SHA" për vitet 2017, 2018 dhe 2019 është shoqëruar me mangësi lidhur me normën e kombinuar të konsumit të karburantit në fakt për 100 km, krahasuar me atë të ofertuar duke shkaktuar rritjen e saj, dhe për pasojë përdorim të fondeve pa efektivitet për blerjen e karburantit në

vlerën 6,002,659 lekë për vitet 2018 dhe 2019.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Z. A G, në cilësinë e administratorit të kontratës.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën nr.12149/22 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

Në observacionin e z. AG cilësohet se parametrat e konsumit të mjeteve janë indikativë më shumë se reale, si dhe sqarohet teknikisht ndryshimi midis normës zyrtare dhe asaj reale të konsumit të karburantit dhe kilometrave të përshkuara të llogaritura nga GPS dhe kilometrave reale të kryera nga mjeti, shoqëruar me referencat dhe dokumentacionin përkatës, në funksion të justifikimit të normës së konsumit në fakt në 10.4 litra/100 km nga 10 e parashikuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e Administratorit të kontratës dhe konstaton se: Referuar VKM nr.914, nenit 77, pikave 1 dhe 3, gjatë zbatimit të kontratave, AK mbikëqyrin zbatimin e tyre, si dhe për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, si dhe autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, gjë që në këtë rast duhet ta bëjë administratori i kontratës. Duhet theksuar se normat e konsumit të karburantit janë paraqitur të kombinuara, çka do të thotë se janë marrë në konsideratë tipet e rrugëve, si dhe ofertuesi fitues e ka pasur në konsideratë natyrën e punëve të OSHEE, duke shtuar këtu faktin se jo për të gjithë km e përshkuara mund të ketë devijime nga regjistrimi në GPS.

Bazuar në sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin në lidhje me zbatimin e kontratës së marrjes së automjeteve me qira për OSHEE 2017 - 2019 dhe për këtë arsye nuk e merr në konsideratë.

9. Titulli i Gjetjes Mungesë argumentimi teknik dhe ligjor i kriterëve të veçanta të kualifikimit; kualifikim OE me detyrime për sigurimet shoqërore, si dhe skualifikim OE me vlerën më të ulët për mungesë konsiderimi devijime të vogla nga KVO.

Situata: Procedurë “E hapur- shërbime”, me objekt prokurimi “Pajisja me kartela të sigurimit teknik për punonjësit e OSHEE”, me fondin total 14,960,000 lekë pa TVSH dhe me afat realizimi 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në tenderin e zhvilluar më datë 22.04.2019 kanë qenë pjesëmarrës dy OE “A ” SHPK me ofertë ekonomike me vlerë 11,744,000 lekë pa TVSH dhe OE “H” SHPK i cili ka paraqitur një ofertë ekonomike me vlerë 14,712,400 lekë pa TVSH.

Nga KVO është skualifikuar OE “A” SHPK, pasi referuar shtojcës 8, kriteret e veçanta për kualifikim, pika 5 kërkohet një numër mesatar prej jo me pak se 8 punonjës. Referuar vërtetimit Nr. T00984294, datë 15.04.2019, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, rezulton se OE A SHPK ka një punësim mesatar prej 7,25 punonjësish për periudhën prill 2018-Mars 2019, duke mos përmbushur në këtë mënyrë kriterin e sipërcituar.

- Në relacionin për hartimin e termave të referencës në përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, nuk argumentohet teknikisht numri i punonjësve dhe periudha e punësimit, pasi është cilësuar: *“Çdo grup inspektimi duhet të përbëhet të paktën nga dy anëtarë komisioni të testimit, të cilët duhet të kenë diplomim në fushën e inxhinierisë elektrike. Duke qenë se shtrirja e këtij shërbimi është në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ku ushtron aktivitetin OSHEE SHA si dhe numri i punonjësve*

që do të testohen është relativisht i madh, kërkohet një numër minimal punonjësish për realizimin e këtij shërbimi. Shërbimi do të ofrohet në mënyrë periodike në bazë të mbarimit të afatit 1 vjeçar të kartelave ekzistuese”, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, neni 61, paragrafi i dytë i pikës 2 i cili përcakton:

“Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.”

Në këtë mënyrë, Komisioni i përgatitjes së specifikimeve teknike i përbërë nga A Z, E A dhe S V me veprimet dhe mosveprimet e tij ka sjellë për pasojë kufizimin e konkurrencës së pjesëmarrësve në tender e në fund fundit uljen e efektivitetit në përdorimin e fondeve publike.

Sipas DT, shtojca 8, kreu 2 –Kriteret e veçanta të kualifikimit, tek Kapaciteti teknik, pika 5 është përcaktuar: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë për 12 muajt fundit, të siguruar një numër mesatar prej jo më pak se 8 punonjës”. Vendosja e një kriteri të tillë për një numër mesatar prej 8 punonjësish nuk është argumentuar në përcaktimin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pajisja me kartela sigurimi të punonjësve të OSHE. Veç kësaj vendosja e kriterit të periudhës 12 mujore për numrin e punonjësve, nuk ka asnjë lloj lidhjeje për t’i shërbyer AK për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të OE pjesëmarrës në garantimin e realizimit me sukses të kontratës. Në këtë mënyrë Komisioni i përgatitjes së specifikimeve teknike i përbërë nga A Z, E A dhe S V ka vepruar në kundërshtim me VKM nr.914 të ndryshuar, neni 28, pika 2, e cila midis të tjerave përcakton:

“Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”.

- a) Nga auditimi në SPE të kësaj procedure prokurimi, rezulton se OE i skualifikuar “A ” SHPK, për 12 muajt e fundit ka mesatarisht 7.25 punonjës, pra këtë tregues e ka realizuar 91%. Duhet theksuar se, në tre muajt e fundit “A ” SHPK ka pasur 8 punonjës, si dhe nisur nga fakti se ky OE e plotëson kushtin e veçantë që 4 pjesëtarë në stafin e tij, që do të angazhohen për marrjen në provimin e sigurimit teknik të personelit, kanë diplomim në fushën e Inxhinierisë Elektrike, përcaktuar në pikën 6.1 të shtojcës 8 në DT, KVO me përbërje: O D, E T dhe E C duhet ta kishin konsideruar si devijim të vogël, në përputhje me pasi jo vetëm që nuk preket thelbi i ofertës, AK nuk do ta humbiste garancinë e realizimit me sukses të kontratës, KVO do të vepronte brenda tagrit vet ligjor, por do të rriste efektivitetin e përdorimit të fondeve publike në OSHE. Një veprim i tillë i KVO është në kundërshtim me nenin 53, pika 4 të LPP, i cili përcakton:

“Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.”

- b) Nga ana tjetër, KVO ka kualifikuar OE “H” SHPK, në një kohë që sipas vërtetimit të tatimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore me nr. T00998301, datë 20.04.2019, ky operator ka detyrime

të papaguara për muajin mars 2019 në vlerën prej 333,929 lekë. Ky është një detyrim pagese pasi, në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 11, germa “a”, afatin e pagesës e ka pasur deri në këtë datë (20) të muajit pas ardhës (prill). Ndërkohë, në deklaratën e nënshkruar nga përfaqësuesi i ofertuesit “A” SHPK me datë 23.04.2019, sipas shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit, paragrafi i parafundit, përcakton: *Operatori ekonomik “H” SHPK ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi*”. Në këtë mënyrë, KVO ka vepruar në kundërshtim me nenin 54, pika 2, shkronja “d” në të cilën përcaktohet: *“Çdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë, në rastet kur: d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;”*

- Kriteri:** - LPP, neni 53, pika 4;
- VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, neni 61, paragrafi i dytë i pikës 2; neni 28, pika 2;
- Ndikimi/Efekti:** Efekt negativ financiar në përdorimin e fondeve pa eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet në vlerën prej 2,968,400 lekë.
- Shkaku:** Mungesë e njohjes, zbatimit dhe e vlerësimit të detyrave të zyrtarëve të përfshirë në procedurat e prokurimit publik.
- Rëndësia:** I ulët/i mesëm /i lartë
- Rekomandime:** Autoriteti kontraktor të marrë masa për të përzgjedhur dhe trajnuar zyrtarët e përfshirë në procedurat e prokurimit publik, me qëllim që të rritet eficientia, efektiviteti dhe ekonomikiteti i fondeve publike.

Si konkluzion:

- Komisioni i përgatitjes së specifikimeve teknike ka vendosur kriterin e numrit të punonjësve dhe të kohëzgjatjes së tyre, të paargumentuara teknikisht dhe ligjërish, si dhe jo në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”.

- KVO duke mos konsideruar devijim të vogël mosrealizimin prej mesatarisht 0.75 % të numrit të fuqisë punëtore të OE të skualifikuar, si dhe duke kualifikuar OE me detyrime për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, i kanë shkaktuar ***OSHE SHA efekt negativ financiar në përdorimin e fondeve pa eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet në vlerën prej 2,968,400 lekë, e cila përfaqëson diferenca midis OE të shpallur fitues edhe në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kualifikimit dhe atij të skualifikuar për shkaqe që mund të konsideroheshin devijime të vogla.***

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: 1) Z. A Z, 2) Z. E A dhe 3) Zj. S V në cilësinë e anëtarëve të përgatitjes së specifikimeve teknike; 4) Z. O D, 5) Z. E T, dhe 6) Z. E C në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën nr.12149/23 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

Në observacionin e anëtarëve të përgatitjes së specifikimeve teknike cilësohet standardi S SH EN ISO/IEC 17024:2012 në bazë të të cilit kryhet procesi i pajisjes së punonjësve me kartela sigurimi, si dhe grupet përkatëse të punës, duke përcaktuar vendosjen e minimalisht 8 punonjësve.

Në observacionin e anëtarëve të KVO cilësohet se me datë 23.04.2019, ditën e hapjes së ofertave, OE “H” SHPK ka depozituar vërtetimin nr.867 prot., datë 23.04.2019 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Shkodër sipas të cilit nuk ka detyrime kontributive dhe tatimore të papaguara, dhe në këtë mënyrë kualifikimi është i rregullt.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e anëtarëve të përgatitjes së specifikimeve teknike dhe konstaton se, hartimi dhe përcaktimi i numrit të 8 punonjësve nuk është i argumentohet teknikisht, sipas kërkesave të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, neni 61, paragrafi i dytë i pikës 2

Grupi i auditimit riverifikoi dokumentacionin e ngarkuar në sistem nga operatori ekonomik “H” SHPK dhe rezultoi se në periudhën 18-22.04.2019, nuk është një dokument i tillë në SPE. Referuar VKM nr.918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, pika 1, përcakton: “*Të gjitha procedurat e prokurimit zhvillohen me mjete elektronike*”, dhe është në kundërshtim me këtë VKM depozitimi i çfarëdo lloji dokumenti shkresor. Bazuar në sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin në lidhje me hartimi dhe përcaktimi i numrit të 8 punonjësve, si dhe vërtetimin e për shlyerjen e detyrimeve kontributive dhe tatimore të depozituar ditën e zhvillimit të tenderit dhe për këtë arsye nuk e merr në konsideratë.

10. Titulli i Gjetjes Në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion i kabinave elektrike muraturë, Fiderat A6, A7, A11, A12, A14, A15 NST Rajonal Tiranë 220/20 kV”, nga skualifikimi i padrejtë i OE “B” SHPK me ofertën më të ulët, i kanë shkaktuar OSHEE SHA përdorim të fondeve pa efektivitet në vlerën 406,588 lekë.

Situata: Procedura e prokurimit është “E hapur- punë” me objekt “Rikonstruksion i kabinave elektrike muraturë, Fiderat A6, A7, A11, A12, A14, A15 NST Rajonal Tiranë 220/20 kV”, me fondin limit 120,257,060 lekë pa TVSH dhe me afat realizimi 4 muaj nga data e dorëzimit të sheshit nga mbikëqyrësi.

Në tenderin e zhvilluar me datë 22.10.2018 kanë marrë pjesë tre OE:

- OE “B” SHPK, me ofertë me vlerë 112,025,143 lekë pa TVSH,
- OE “S I” SHPK, me ofertë me vlerë 112,431,731 lekë pa TVSH,
- OE “E” SHPK, me ofertë me vlerë 114,299,847 lekë pa TVSH.

KVO me përbërje E K, A G dhe A K, pas tërheqjes së OE “E” SHPK, kanë skualifikuar OE “B” SHPK me ofertën më të ulët, dhe kanë shpallur fitues OE “S I” SHPK, me ofertë në vlerën 112,431,731 lekë pa TVSH.

KVO e ka arsyetuar si më poshtë skualifikimin e OE “B” SHPK:

1. Në DST, Shtojca 12, “Kriteret e veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1 për “Kapacitetin Teknik dhe Profesional, pika c, ku Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin teknik (autorizim prodhuesi/distributori, Teste, katalog) të kërkuar për listën e materialeve. Nga kontrolli i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se, për artikujt: Cela të motorizuara, Cele transformatori, Cele linje dhe Kabllo XLPE i gjithë dokumentacioni teknik i paraqitur nga OE me përjashtim të Autorizimit të Prodhuarit është në gjuhë të huaj, duke qenë në kundërshtim me kërkesat e DST ku gjuha e përdorur në oferte duhet të jetë gjuha shqipe.

2. Makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, rezultojnë të njëjtat me makineritë e angazhuara në kontratën me objekt “Ndërtimi Fiderit 20 KV C19 të Nënstacionit 110/20/6 KV Traktora Kabina të reja dhe kabina rikonstruksion, si dhe Linja TU me Kabëll ABC (Punëtori)” të lidhur me Autoriteti Kontraktor Drejtoria Rajonale Tiranë OSHEE SHA.

3. Referuar ekstraktit QKB të OE rezultoi se ky i fundit ka ushtruar aktivitet tregtar në Urën Vajgurore Berat përgjatë vitit 2018, por nuk dorëzon vërtetim për taksat vendore pranë kësaj njësie Administrative.

4. Referuar kontratës individuale të punës të punëmarrësit I K (drejtues teknik i deklaruar për këtë objekt), paga e tij bruto rezultoi 50.000 lekë në muaj, ndërsa referuar listë pagesës së 12 muajve të fundit, paga e tij bruto

rezulton në 40,000 lekë në muaj.

Nga auditimi në SPE, lidhur me kriteret të cilat sipas KVO nuk janë plotësuar rezulton se:

1. Në plotësim të kërkesave të DST, Shtojca 12, pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të Kualifikimit”, për “Kapacitetin Teknik dhe Profesional, pika “c”, OE për artikujt: Cela të motorizuara, Cele transformatori, Cele linje dhe Kabllo XLPE ka paraqitur dokumentacion teknik në gjuhë angleze, me përjashtim të Autorizimit të Prodhuesit i cili është në shqip. Në fakt, në këtë kriter në DT nuk përcaktohet që të jenë në gjuhën shqipe, megjithatë KVO, meqenëse një mangësi e tillë nuk e ndryshon thelbin e ofertës, janë në gjuhën angleze që në pjesën më të madhe është gjuhë teknike me specifikat e kontratave të kësaj fushe, si dhe në referencë të nenit 53, pika 4 të LPP, i cili përcakton:

“Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”,

duhej ta kishte konsideruar këtë kriter të përmbushur.

2. Lidhur me faktin se makineritë e deklaruara në këtë procedure prokurimi, rezultojnë të njëjtat me makineritë e angazhuara në kontratën me objekt “Ndërtimi Fiderit 20 KV C19 të Nënstacionit 110/20/6 KV Traktora Kabina të reja dhe kabina rikonstruksion si dhe Linja TU me Kabëll ABC (Punëtori)” të lidhur me Autoriteti Kontraktor Drejtorja Rajonale Tiranë OSHEE SHA, në kushtet që nuk ka të dhëna mbi fazën në të cilën ndodhet zbatimi kësaj kontrate, si dhe nuk është analizuar në zbatim të nenit 26 të VKM 914 datë 29.12.2014 të ndryshuar, që OE brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufiit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent, ky fakt nuk është i argumentuar dhe nuk duhej të përbënte pengesë në kualifikimin e këtij OE.

3. Në plotësim të kriterëve të veçanta për kualifikim, pika 2.2/d , për aktivitetin e ushtruar në Urën Vajgurore Berat përgjatë vitit 2018, në referencë të ekstraktit QKB, OE ka dorëzuar vërtetimin për taksat vendore me nr.1908 prot., datë 14.08.2018, që ky OE ka paguar detyrimet për taksat dhe tarifatat lokale për vitin 2018, pra nuk ka detyrime ndaj kësaj bashkie.

4. Referuar mospërputhjes së pagës bruto të punëmarrësit I K(drejtues teknik i deklaruar për këtë objekt) në kontratën individuale të punës nga 50,000 lekë në muaj në 40.000 lekë në muaj, të cilën KVO e ka përdorur në mënyrë të gabuar si një prej shkaqeve për skualifikimin e këtij OE, është një marrëdhënie private midis drejtuesit teknik dhe administratorëve të firmës, gjë për të cilën nuk mund të ndërhyjnë institucionet apo shoqëritë publike. Për më tepër as në DT nuk kërkohet një gjë e tillë, por vetëm: “Për inxhinierët pjesë e stafit të cilët duhet detyrimisht të jene të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën e mësipërme, duhet të paraqitet kontratë noteriale pune (me kohë të plotë) me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt edhe diplomë profesionale.

Operatori Ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i Shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt (me përvojë mbi 5 vjet) të përfshirë me licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryen

punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: Diplomë profesionale, CV përkatëse dhe Kontratë pune e vlefshme”, të cilat i ka plotësuar OE. Me këtë konstatim KVO është në shkelje të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 58, paragrafi i fundit:

“Komisioni është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Komisioni duhet të zbatojë detyrat në pavarësi të plotë dhe nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla”

Bazuar në sa më sipër, KVO duhej ta kishte kualifikuar OE “B” SHPK me ofertën më të ulët.

- Kriteri:** - VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 58, paragrafi i fundit;
- DST, Shtojca 12, pika 2.3.1;
- Dokumentacioni në SPE i ofertuesve.
- Ndikimi/Efekti:** Nga skualifikimi i padrejtë i OE“B” SHPK me ofertën më të ulët, ***i kanë shkaktuar OSHEE SHA përdorim të fondeve pa efektivitet në vlerën 406,588 lekë.***
- Shkaku:** Nga mungesa e njohjes dhe zbatimit të plotë të kuadrit ligjor dhe rregullator të prokurimeve, në frymën e LPP për rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike.
- Rëndësia:** I lartë
- Rekomandime:** AK të marrë masa për të përzgjedhur ekspertë dhe trajnuar zyrtarët që përfshihen në procedurat e prokurimit publik, me qëllim rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike.

Si konkluzion: Në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion i kabinave elektrike muraturë, Fiderat A6, A7, A11, A12, A14, A15 NST Rajonal Tiranë 220/20 kV” 2018, KVO duke skualifikuar OE “B” SHPK me ofertën më të ulët, ***i kanë shkaktuar OSHEE SHA përdorim të fondeve pa efektivitet në vlerën 406,588 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis ofertës të shpallur fituese dhe asaj më të ulët të skualifikuar.***

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: 1) Zj. E K, 2) Z. A G dhe 3) Z. A K, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën nr.12149/24 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

Në observacionin e anëtarëve të KVO cilësohet se mungesa e përkthimit në gjuhën shqipe është vlerësuar kriter skualifikues, për shkak se sipas qëndrimeve të APP, gjuha e ofertës është një kriter thelbësor dhe nuk mund të konsiderohet si devijim i vogël.

Lidhur me skualifikimin për makineritë e deklaruar në këtë procedurë prokurimi janë të njëjta me ato të një kontrate tjetër në Drejtori Rajonale të OSHEE SHA, konsiderohet si shkelje e kriterit të veçantë në DT, për të cilën nuk duhet të ketë të angazhuara në kontrata të tjera.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e anëtarëve të KVO dhe arrin në konkluzionin se, gjuha e ofertës është pjesërisht në anglisht vetëm për 4 artikuj; OSHEE në cilësinë e AK ka mjaftë raste në të cilat e ka vendosur në kriteret e veçanta të kualifikimit gjuhën anglisht të specifikimeve teknike të mallrave; paraqitja në gjuhën angleze nuk i ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit; qëndrimi i APP i referohet nenit 14 të VKM nr.914 për gjuhën, por nuk është se e trajton si kriter thelbësor, si dhe

KVO duhet të mbajë në konsideratë frymën e LPP për rritjen e eficiencës, ekonomikitetit dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

Lidhur me faktin se makineritë e deklaruar në këtë procedurë prokurimi të OE të skualifikuar, rezultojnë të njëjtat me makineritë e angazhuara në kontratën tjetër me OSHEE, në kushtet që nuk ka të dhëna mbi fazën në të cilën ndodhet zbatimi kësaj kontrate, si dhe në mungesë të analizës së nenit 26 të VKM 914 datë 29.12.2014 të ndryshuar, që OE brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufiit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent, ky fakt nuk është i argumentuar dhe i bazuar.

Bazuar në sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin e KVO dhe për këtë arsye nuk e merr në konsideratë.

11. Titulli i Gjetjes Në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion ne rrjetin TM - TU në Zonën e Thumanës – Borizan – F.14 N/ST F. Krujë” me fond limit 160,468,450 lekë është kualifikuar BO T S E SHPK me ofertë 158,498,502 lekë pa TVSH, në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kuadrit ligjor dhe rregullativ përkatës.

Situata: Procedura e prokurimit është e Hapur - Pune, me objekt “Rikonstruksion ne rrjetin TM - TU në Zonën e Thumanës – Borizan – F.14 N/ST F. Krujë” me fond limit 160,468,450 lekë dhe me afat kohor për ekzekutim 8 (tetë) muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit,

Në tenderin e zhvilluar më datë 17.10.2018 kanë marrë pjesë dy OE: E SHPK, i cili nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion tjetër kualifikues sipas kërkesave në DT, si dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues Bashkimi i Operatorëve (BO): T S E SHPK me ofertë 158,498,502 lekë pa TVSH.

Nga auditimi në SPE, rezulton se, BO ka paraqitur marrëveshjen e datës 10.10.2018, në nenin 2 të së cilës, pika 2.10 ka përcaktuar realizimin e punës sipas kuotave:

- T E SHPK merr përsipër të realizojë 30.85 %, furnizimin e materialeve dhe koordinimin e punimeve;
- S E SHPK 30.85 %, referuar tabelës së punimeve;
- E SHPK 24.25 % referuar tabelës së punimeve; dhe
- E SHPK 14.05 % referuar tabelës së punimeve.

- Para së gjithash, një ndarje e tillë e përqindjes së pjesëmarrjes duke veçuar furnizimin e materialeve, është në kundërshtim me llojin e kontratës. Kjo pasi, kontrata është e llojit punë dhe nuk është kontratë mallrash që të realizohet një ndarje e tillë, për më tepër që nuk përputhet me vlerën përkatëse të zërave të preventivave të punimeve. Kjo pasi materialet e kësaj kontrate janë parashikuar furnizim dhe vendosje dhe nuk ndarje në preventiv dhe as kuptim që furnizimin e kryen njëri nga pjesëtarët e BO, dhe vendosjen e kryen një operator tjetër i saj. Veç këtyre, kjo është e lidhur dhe me krijimin e përvojave në fushën e punimeve të OE që kryejnë furnizime mallrash për të marrë pjesë në tendera për punime.

- Nga auditimi në SPE konstatohet se në ofertën e paraqitur nga BO T S E SHPK nuk përcaktohet pjesa e punës që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 74, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton:

“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili

nga anëtarët e këtij bashkimi.”

Në këtë mënyrë oferta e përgatitur nga BO nuk është në përputhje me kriteret ligjore të mësipërme, për më tepër që kjo do të sjellë pamundësinë e vlerësimit nga KVO të kriterëve të veçanta të kualifikimit për shkak të pamundësisë së përputhjes së licencave dhe certifikatave me pjesën e punës në përqindje që duhet të kryejnë sipas marrëveshjes.

- Referuar pikës 3 të nenit 74 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcaktohet:

“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”

konstatohet se:

1. OE T E SHPK nuk plotëson numrin e punonjësve, pasi sipas % së pjesëmarrjes dhe kërkesave të DT, pika 2.3.1 Kapaciteti teknik dhe profesional shkronja “d” duhet të ketë së paku 28 punonjës (30.85 % x 90), ndërsa sipas vërtetimit të tatimeve Nr. T00570072, datë 22.09.2018 ka 3 punonjës.

Po kështu dhe OE S E SHPK sipas vërtetimit të tatimeve T00577832, datë 26.09.2018 ka mesatarisht 3 punonjës kur sipas përqindjes së punonjësve duhet të ketë së paku 28 punonjës.

2. Meqenëse OE pjesëtarë të BO nuk e kanë ndarë në ofertë pjesën e punës së secilit prej tyre ju mungojnë licencat si më poshtë:

- T E SHPK: Kategoria NP-11 Klasifikimi D; NP-1; NP-5; NS-8; NS-18; Në këtë mënyrë, ky OE zotëron licencën NP-11 Klasifikimi A, për punime nga 0-20 milion lekë, dhe jo atë D për vlera të punimeve 101-200 milion lekë sipas kërkesave në DT;

- S E SHPK: NP-1; NP-5; NS-8; NS-18, në një kohë që i mbeten licencat e punimeve NP -11 D, por që nuk ka asnjë autorizim prodhues/distributori për këtë pjesë të punëve, pasi i ka T, si dhe impiante te brendshme, elektrike që nuk mund të përfaqësojnë 30.85% të punëve ose rreth 49 milion lekë të ofertës.

- E SHPK: NP-11; NS-14 dhe NS-18, pra këtij subjekti i ngelet pjesa e punimeve të gërmimit dhe atyre nëntokësore, si dhe ndërtimet parafabrikate beton arme, të cilat, në preventivat e ofertës nuk përbëjnë 24.25 % të vëllimit të punimeve ose mbi 38 milion lekë punime të kësaj natyre.

Referuar kërkesës së germës “c”, të pikës 2.3.1 Kapacitetet teknike dhe profesionale të shtojcës 12 të DT, midis të tjerave, për Panel TU Operatori ekonomik duhet të paraqesë: “Autorizim të prodhuesit/ve/distributor/ve për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qarte që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që

vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista më sipër e materialeve) me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara. “

Për këtë OE T E SHPK ka paraqitur për autorizim prodhuesi, katalog dhe dëshmi të testimeve zyrtare nga subjekti “R”. Nga ana e tjetër në SPE nga BO është paraqitur dhe dokumenti pa datë Autorizim furnitori nga “A” që e furnizon me produkte marke subjektin “Rjepaj Elektromekanika” SHPK. Në këtë mënyrë Autorizimi i prodhuesit i paraqitur nga OE T E SHPK, pjesë e BO nuk plotëson kushtet e autorizimit të prodhuesit për Panel TU, sipas kërkesave në DT.

Bazuar në sa më sipër oferta e paraqitur nga BO T S E SHPK duhej refuzuar pasi, nuk i plotëson kërkesat e kuadrit ligjor për ndarjen sipas përqindjes së kryerjes së punëve, si dhe duhej skualifikuar për shkak se OE nuk plotësojnë kriteret teknike dhe profesionale për numrin e punonjësve dhe llojet e licencave që duhet të zotërojnë sipas përqindjes së punëve në marrëveshje. KVO i përbërë nga M B, Z D dhe E B, me veprimet dhe mosveprimet e tij ka kualifikuar BO në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve për kualifikim, duke vepruar në kundërshtim me nenin 46, pika 1, shkronja “a” dhe “b” të LPP të ndryshuar, i cili përcakton:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhe, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshtatur nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Në këto kushte në zbatim të nenit 24, pika 1, germa “ç”, të LPP (i ndryshuar) i cili përcakton:

“Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.”,

ky tender duhej anuluar.

Kriteri:

- LPP i ndryshuar, neni 46, pika 1, shkronja “a” dhe “b”; neni 24, pika 1, germa “ç”;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar nenin 74, pika 1; pika 3 e nenit 74;
- Shtojca 12 e DT, pika 2.3.1 Kapacitetet teknike dhe profesionale, germa “ç”.

Ndikimi/Efekti:

Në mungesë të OE të kualifikuar procedura e prokurimit duhej anuluar.

Shkaku:

Nga mungesa e kuptimit dhe zbatimit të plotë të zyrtarëve të kuadrit ligjor dhe rregullativ i procedurave të prokurimit.

Rëndësia:

I mesëm.

Rekomandime:

AK të marrë masa për të përzgjedhur ekspertë dhe trajnuar zyrtarët që përfshihen në procedurat e prokurimit publik, me qëllim rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve

publike.

Si konkluzion: Në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion ne rrjetin TM - TU në Zonën e Thumanës – Borizan – F.14 N/ST F. Krujë” 2018, KVO ka kualifikuar BO T S ESHPK në një kohë që oferta e paraqitur nga ana e tyre duhej refuzuar pasi, nuk i plotëson kërkesat e kaudrit ligjor për ndarjen sipas përqindjes së kryerjes së punëve, si dhe duhej skualifikuar për shkak se OE nuk plotësojnë kriteret teknike dhe profesionale për numrin e punonjësve dhe llojet e licencave që duhet të zotërojnë sipas përqindjes së punëve në marrëveshje.

Meqenëse, asnjë nga ofertat e paraqitura nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në DT, tenderi duhej anuluar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: 1) Z. E B, 2) Zj. M B, dhe 3) Z. Z D, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën nr.12149/25 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

Në observacionin e anëtarëve të KVO cilësohet se referuar dokumentacionit ekonomiko-teknik të dorëzuar në SPE, rezulton se BOE i ka të gjitha kapacitetet teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës, sipas edhe vendimeve të KPP, të cilët shpjegojnë qëllimin e vendosjes kriterëve të kualifikimit.

Lidhur me autorizimin e prodhuesit “R E” SHPK, KVO shpjegon teknikisht panelin TU, për të justifikuar vlefshmërinë e autorizimit të prodhuesit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e anëtarëve të KVO dhe arrin në konkluzionin se, ashtu siç theksohet prej tyre që është e vërtet se në këtë marrëveshje palët nuk kanë përcaktuar saktësisht elementët konkretë që do të kryejë secili OE, është kriteri i mjaftueshëm që oferta e BO T S ESHPK nuk është në përputhje me kërkesat e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 74, pika 1 dhe 3 dhe për këtë arsye BO duhej skualifikuar.

Bazuar në sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin e KVO dhe për këtë arsye nuk e merr në konsideratë.

12. Titulli i Gjetjes

Në procedurën e prokurimit “Realizimi i shërbimit të riparimit të transformatorëve të fuqisë TM/TU me fuqi deri në 1.8 MVA”, është skualifikuar OE me shumatore të çmimeve më të ulët për çështje të diskutueshme, duke ulur efektivitetin e përdorimit të fondeve në vlerën prej 15,889,715 lekë.

Situata:

Prokurimi “Realizimi i shërbimit të riparimit të transformatorëve të fuqisë TM/TU me fuqi deri në 1.8 MVA”, është me fond limit 200,000,000 lekë pa TVSH dhe shumatore të çmimit total të zërave për njësi është 15,356,420 lekë pa TVSH me afat 12 muaj.

Në tenderin e zhvilluar me datë 13.05.2019 kanë marrë pjesë dy OE, të cilët sipas KVO, shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara janë si në vijim:

1. OE “E” SHPK me shumatore të çmimit total të zërave për njësi është 15,243,420 lekë pa TVSH, dhe 2. OE: “R” SHA ka paraqitur formularin e ofertës ekonomike me vlerë 150,000,000 lekë pa TVSH, duke skualifikuar për shkak të vlerës në formularin e ofertës.

Në këto kushte KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “E” SHPK.

Sipas auditimit në SPE dhe dokumenteve në dosjen e auditimit,

konkretisht, të procesverbalit nr.3, datë 22.05.2019 të KVO me përbërje R D, E A dhe E G, ka vendosur të skualifikojë OE “R” SHA, pasi sipas saj “vlera totale e çmimeve /njësi do të përbëjë ofertën e OE për fazën e konkurrimit, e cila nuk duhet të jetë më e madhe se shumatorja e çmimit /njësi të shpallur nga AK. Në vijim, KVO për këtë OE ka arsyetuar:

1. Referuar Dokumenteve të tenderit, Njoftimi i Kontratës, pika 2.6, në të cilën parashikohet se: *“Vlera totale e çmimeve /njësi do të përbëjë ofertën e OE për fazën e konkurrimit, e cila nuk duhet të jetë më e madhe se shumatorja e çmimit /njësi të shpallur nga AK. Vlera e kontratës do të jete ajo e Fondit Limit. Me mbarimin e Fondit Limit përfundon dhe kontrata.*

Gjithashtu në pikën 2.8.2 parashikohet se: *shumatorja e çmimeve për njësi është: 15,356,420 lekë.* Referuar sa më lartë oferta e OE “R” SHA me vlerë 150,000,000 lekë, është mbi fondin limit të dhënë në seksionin 1, pika 2.6, të dokumenteve të tenderit.

2. OE “R” SHA, nuk plotëson kërkesën e dhënë në pikën 3.3.4 të Shtojcës 8, pasi nuk ka paraqitur listë pagesën e muajit prill 2019, si dhe nuk ka vërtetuar me anë të liste pagesës se ka të punësuar 1 (një) inxhinier elektrik për muajin prill 2019.

3. OE “R” SHA nuk plotëson kërkesën e dhënë në pikën 3.3.5, pasi me deklaratën noteriale datë 10.05.2019 nuk vërteton se disponon "Tronkatrice për prerjen e nukleve 45 gradë", por thjesht në fotot bashkëlidhur kësaj deklarate, deklaron se disponon "Pajisje për prerjen e nukleve", pra jo pajisje për prerjen e nukleve 45 gradë.

Nga auditimi në SPE i dokumenteve të paraqitura në sistem nga OE “R” rezulton se:

1. Ka paraqitur ofertën ekonomike me shumatore të çmimeve 14,032,352 lekë dhe fond limit 150,000,000 lekë, pra më të vogël se oferta e paraqitur në DST për shumatoren që është 15,356,420 lekë dhe fondin limit 200,000,000 lekë.

OE i është përmbajtur në mënyrë eksplicite formularit të ofertës ekonomike sipas shtojcës 1 të DT, bashkëlidhur të të cilit ka paraqitur preventivat me çmimin për njësi të shërbimit sipas zërave të shërbimit dhe llojit të transformatorit, nga ku shumatorja e çmimeve rezulton më e ulët se ajo e shpallur në DT dhe ajo OE të shpallur fitues, me një vlerë prej 1,211,068 lekë.

Referuar VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 3, paragrafi i dytë, i cili përcakton:

“Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal”,

KVO i ka pasur të gjitha mundësitë ligjore për saktësimin e ndonjë paqartësie në lidhje me ofertën e paraqitur prej këtij OE.

2. Mungesa e listë-pagesës për muajin prill 2019, dhe rrjedhimisht dhe e inxhinierit në të nuk e prek thelbin e ofertës, si dhe nuk cenon garancinë e realizimit të saj, pasi në listë-pagesat e tjera ndodhet inxhinieri; në dokumentin vërtetim për kontributet të datës 08.05.2019, të Drejtorisë Rajonale tatimore Elbasan me nr. T01051911, është cilësuar se për periudhën tatimore 04.2019 numri i kontribuuesve është 23 aq sa ka qenë dhe një muaj më parë. Në këtë mënyrë, KVO duhej ta konsideronte si devijim të vogël, pasi nuk cenon thelbin e ofertës si dhe nuk cenon garancinë e realizimit me sukses të kontratës, duke shtuar këtu dhe përvojat

e mëparshëm në këtë fushë të vetë OSHEE SHA që ka në zbatimin e kontratave të tilla me këtë OE.

3. Në deklaratën noteriale të datës 10.05.2019, OE “R”, në faqen e parë me nr.10 deklaroi se ka Tronkatrice për prerjen e nukleve 45 gradë, të shoqëruara dhe me 2 fotografi për makineri për prerjen e nukleve. Një dokument i tillë është në përputhje me kërkesën në DST, faqe 68-69: *“Operatori ekonomik duhet të vërtetojë pronësinë e makinerive/pajisjeve të mësipërme nëpërmjet faturave tatimore të blerjes, kontrate blerje, kontratë dhurimi apo çdo forme tjetër e fitimit të pronësisë sipas kodit civil, ose nëpërmjet deklaratës noteriale të shoqëruar me fotografitë e makinerive/pajisjeve, ose nëpërmjet kontratës së qirasë për makineritë/pajisjet e marra me qira, e cila duhet të shoqërohet me aktin e pronësisë mbi makineritë/pajisjet që merren me qira.”* Në këtë mënyrë nga një vlerësimi i tillë i KVO është lidhur kontratë me një operator ekonomik, shumatorja e çmimeve të të cilit në ofertë është 1,211,068 lekë më e madhe se oferta e OE të skualifikuar (15,243,420 -14,032,352), duke vepruar në kundërshtim me LPP, neni 55, pika 1, germa “a”:

“1. Oferta fituese duhet të jetë: a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët;”

Në këtë mënyrë KVO e përbërë nga KVO me përbërje E G, E A dhe R D, duke skualifikuar OE me shumatore të çmimeve më të ulët kanë vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë neni 45, pika 2:

“Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të nenit 55, të LPP-së. Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi.”

- Kriteri:**
- LPP neni 45, pika 2; neni 55, pika 1, germa “a”;
 - VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 3, paragrafi i dytë;
 - Shtojca 1 të DT.
- Ndikimi/Efekti:** OSHEE SHA i është shkaktuar rritje te koston për njësi në vlerën 1,211,068 lekë, duke ulur efektivitetin e përdorimit të fondeve në vlerën prej 15,889,715 lekë (7.9 % e fondit limit).
- Shkaku:** Mangësi në kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit në rastin e marrëveshjeve kuadër nga zyrtarët e përfshirë në procedurat e prokurimit publik.
- Rëndësia:** I lartë
- Rekomandime:** AK të marrë masa për të përzgjedhur ekspertë dhe trajnuar zyrtarët që përfshihen në procedurat e prokurimit publik, veçanërisht në rastin e marrëveshjeve kuadër, me qëllim rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike.

Si konkluzion: Në procedurën e prokurimit “Realizimi i shërbimit të riparimit të transformatorëve të fuqisë TM/TU me fuqi deri në 1.8 MVA”, KVO ka skualifikuar OE me shumatoren e çmimeve më të ulët, në përmbajtje të ofertës së të cilit ka devijime të vogla, **duke i shkaktuar OSHEE SHA rritje te koston për njësi në vlerën 1,211,068 lekë, duke ulur efektivitetin e përdorimit të fondeve në vlerën prej 15,889,715 lekë (7.9 % e fondit limit).**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: 1) Z. E G, 2) Z. E A, dhe 3) Z. R D në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën

nr.12149/26 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

Në observacionin e anëtarëve të KVO, pas vendosjes së referencave në LPP dhe Shtojcën 8 të DT, duke demonstruar që kriter kryesor kualifikues është dorëzimi i ofertës sipas formularit përkatës sipas shtojcës 1, pjesë e dokumenteve të tenderit të modifikuar, për të cilën OE "R" nuk e ka plotësuar, si dhe çmimi në total është në kundërshtim me përcaktimin e dhënë në dokumentet e tenderit.

Lidhur me mungesën e inxhinierit një muaj, KVO referon aktet ligjore në lidhje me këtë mangësi, dhe cilëson mos përmbushje të kriterëve.

Gjithashtu, KVO ka theksuar se në fotografitë e paraqitura në asnjë prej tyre nuk është pajisja e kërkuar për prerjen e nukleve 45 gradë, duke mos e plotësuar këtë kriter, dhe sipas KVO duhej skualifikuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e anëtarëve të KVO dhe arrin në konkluzionin se:

- Në SPE nuk ka asnjë shtojcë që ndryshon Shtojcën 1-Formulari i ofertës në DT, e cila është plotësuar nga OE. Çmimi total prej 150,000,000 lekë pa TVSH nuk është në kundërshtim me përcaktimin e dhënë në DT, por nuk është në përputhje me udhëzimet në DT. Kjo pasi duhej të ishte 200,000,000 lekë aq sa është fondi limit, por oferta është më e vogël dhe duhej të ishte më e madhe që të ishte në kundërshtim me to. Ndërsa vlera e çmimeve njësi, në vijim të çmimit total të ofertës, është 14,032,352 lekë, i plotësuar sipas kërkesës së shtojcës 1 të DT. Në këto kushte që shumatorja e çmimit njësi është më e vogël se OE tjetër, por çmimin total e ka më të vogël KVO, duhej të kishte kërkuar sqarime nga ofertuesi, në përputhje me VKM nr.914, neni 66, pika 3, paragrafi i dytë, i cili është për të gjitha situatat.

Bazuar në sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin e KVO dhe për këtë arsye nuk e merr në konsideratë.

- Lidhur me mungesën e inxhinierit një muaj, ritheksojmë se nuk e prek thelbin e ofertës, si dhe nuk cenon garancinë e realizimit të saj, pasi në listë-pagesat e tjera ndodhet inxhinieri; në asnjë muaj nuk ka ndryshuar numri i punonjësve, si dhe bazuar në përvojat e mëparshëm në këtë fushë të vetë AK OSHEE SHA që ka në zbatimin e kontratave të tilla me këtë OE, nuk duhej të vlerësohej si kriter skualifikues, për më tepër të ofertës më të ulët të shumatores së çmimeve.

- Pajisja për prerjen e nukleve 45 gradë ndodhet në deklaratën noteriale të datës 10.05.2019, OE "R", në faqen e parë me nr.10, e shoqëruar me 2 fotografi për makineri për prerjen e nukleve.

Bazuar në sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin e KVO dhe për këtë arsye nuk e merr në konsideratë.

13. Titulli i Gjetjes Në procedurën e prokurimit "Shërbimi i internetit" 2017, janë vendosur kriteret për numrin e punonjësve (70) që nuk është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, sjellë për pasojë përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerën 2,879,820 lekë.

Situata: Procedura e prokurimit: kërkesë për propozime me objekt "Shërbimi i internetit", me fond limit prej 6,553,333 lekë pa TVSH, me afat realizimi 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në tenderin e zhvilluar me datë 07.08.2017 kanë marrë pjesë dy OE:

1. OE "A" SHPK me ofertë me vlerë prej 5,890,000 lekë pa TVSH, dhe

2. OE "AB" SHPK me ofertë me vlerë prej 3,010,180 lekë pa TVSH. Është shpallur fitues shoqëria "A" SHPK me një vlerë të përgjithshme të ofertës prej 5,890,000 lekë pa TVSH dhe është skualifikuar OE me ofertën më të ulët, midis të tjerave dhe kryesisht për shkak të kriterit për numrin e stafit të realizimit të projektit/shërbimit prej jo më pak se 35

inxhinierë/ekspertë, të diplomuar në shkenca kompjuterike, si dhe për shkak se nuk janë të certifikuar sipas roleve.

Nga auditimi në SPE i kësaj procedure prokurimi, konstatohet se në DT në shtojcën 6, në kreun 2. Kriteret e veçanta, pika 2.3/b ka përcaktuar “Të ketë të punësuar minimalisht 70 persona gjatë 6 muajve të fundit (qershor 2016 – maj 2017) e vërtetuar me vërtetimin e sigurimeve shoqërore dhe me listë pagesat e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore”. Po ashtu në pikën “c” është përcaktuar: “Operatori Ekonomik (ose bashkimi i operatoreve) duhet të ketë në stafin e realizimit të projektit/shërbimit jo më pak se 35 (tridhjetë e pesë) inxhinierë/ekspertë diplomuar në Shkenca Kompjuterike, Telekomunikacion, Ing. Elektronik për Kompjuter (ose ekuivalent)” dhe “d” Operatori Ekonomik (ose bashkimi i operatoreve) duhet të ketë në stafin e realizimit të projektit/shërbimit minimumi 35 ku duhen të jenë të certifikuar sipas roleve...”.

Vendosja e kriterëve të tilla pjesëmarrëse është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 28, pika 2, e cila përcakton:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”,

pasi një numër punonjësish kaq i lartë (70) dhe me një numër kaq të madh të inxhinierëve/ekspertëve (35), për një periudhë një vjeçare, me një kontratë një vjeçare, me objekt në territorin e Tiranës dhe vlerën limit e kontratës prej mbi 6.5 milion lekë nuk është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet, si dhe janë diskriminuese, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi komisioni për hartimin e “Termave të referencës”, përcaktimin e “Fondit limit” dhe “Kritereve të kualifikimit” i përbërë nga E B, P G dhe L R.

Në këtë mënyrë nga vendosja e këtij kriteri, OSHEE SHA ka sjellë për pasojë përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerën 2,879,820 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis ofertës më të ulët të skualifikuar për shkak të kriterit të numrit të punonjësve që nuk është në raport me objektin e kontratës dhe ofertës të kualifikuar dhe shpallur fituese.

Kriteri: - VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 28, pika 2.

Ndikimi/Efekti: Nga vendosja e kriterit të numrit të punonjësve që nuk është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, ka sjellë për pasojë përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerën 2,879,820 lekë

Shkaku: Mangësi në njohjen dhe zbatimin e kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullativ për argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandime: AK të marrë masa për të përzgjedhur ekspertë dhe për të trajnuar zyrtarët që përfshihen në procedurat e prokurimit publik, veçanërisht në rastin e vendosjes së kriterëve të veçanta për kualifikim, me qëllim rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike.

Si konkluzion:

- Në procedurën e prokurimit “Shërbimi i internetit”, vendosja në DT e kritereve specifike për numrin e fuqisë punëtore (70) nga të cilët inxhinierëve/ekspertëve (35) nuk është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Si rezultat i vendosjes së këtij kriteri jo në përputhje me natyrën e vlerën e kontratës është skualifikuar OE me vlerën më të ulët, duke sjellë për pasojë përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerën 2,779,820 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis OE të kualifikuar dhe atij të skualifikuar për vendosje të kritereve të ekzagjeruara në DT.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: 1) Z. E B, 2) Z. P G dhe 3) Z. L R, në cilësinë e komisionit për hartimin e “Termave të referencës”, përcaktimin e “Fondit limit” dhe “Kritereve të kualifikimit”.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën nr.12149/27 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

Në observacionin e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, cilësohet se përcaktimi i “Termave të referencës”, “Fondit limit” dhe “Kritereve të kualifikimit” është bërë nga komisioni përkatës i ngritur me Urdhrin e brendshëm nr.16134/1 prot., datë 27.06.2017, dhe jo nga Njësia e Prokurimit

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe arrin në konkluzionin se ka mbështetje ligjore, duke e marrë në konsideratë, e cila gjen pasqyrim në trajtimin e mësipërm.

14. Titulli i Gjetjes Mos respektim i afateve në dorëzimin e projekt-idesë në shërbimin e konsulencës “Studimi i zhvillimit të rrjetit inxhinierik për furnizimin me energji elektrike në qendër të Tiranës në përputhje me zhvillimin urban të Bashkisë së Tiranë”, si dhe mos penalizim në vlerën 819,670 lekë.

Situata: Sipas kontratës së datës 16.10.2019 midis OSHEE SHA dhe BOE “I” SHPK & ”A” SHPK, do të realizohet shërbimi i konsulencës “Studimi i zhvillimit të Rrjetit inxhinierik për furnizimin me energji elektrike në qendër të Tiranës në përputhje me zhvillimin urban të Bashkisë së Tiranë” me vlerë 51,229,400 lekë për një periudhë 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Nga auditimi i dokumenteve të pagesës, rezulton se me datë 30.12.2019, me faturën nr.15, është paguar vlera 20,491,760 lekë (pa TVSH) për fazën e parë, faturë e nënshkruar nga mbikëqyrësi i kontratës Z. B T, sipas kërkesave të kapitullit të II të kontratës -Kushtet e veçanta të kontratës, neni 6 - Kushtet e pagesës, pika 6.1 a): Faza e parë 40%: pagesa për projekt ide e cila realizohet brenda 45 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Sipas dokumenteve në dosjen e realizimit të kësaj kontrate dorëzimi i projekt idesë është bërë me datë 11.12.2019, pra 10 ditë me vonesë (16.10.2019 + 45 ditë = 30.11.2019; 11.12.2019 - 30.11.2019 =10 ditë). Sipas nenit 20 të kontratës, pika 20.1/a tarifa ditore e dëmeve të likuidueshme për kryerjen e vonuar të shërbimeve për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, do të jetë 4/1000 e vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës. Në këto kushte kontraktori duhej të ishte penalizuar në vlerën 819,670 lekë (20,491,760 lekë x4/1000 x10=819,670 lekë), e cila përbën dëm ekonomik për mungesën e të ardhurave nga burime të tjera për OSHEE SHA.

- Në dosjen e zbatimit ndodhet dokumenti me nr.197 prot., datë 16.01.2020 për dorëzimin e studimit, gjë që korrespondon me afatin e përfundimit të

kontratës. Sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim të shërbimeve të konsulencës nr.197/2 prot., datë 17.02.2020 i nënshkruar nga V L, L M dhe B T projekti i studimit merret në dorëzim pasi është në përputhje me termat e referencës, si dhe me shënimin që BOE duhet të aplikojë për lejen e ndërtimit sipas kushteve në termat e referencës të përcaktuara në faqen 16, kapitulli V.2-Vlerësimet teknike dhe hartimi i projektit arkitektonik, pika 3 “Çështjet që lidhen me hapësirat e nevojshme për fuqizimin e nënstacioneve ekzistuese dhe ndërtimin e nënstacionit të ri Qendër, kërkesat e shpronësimit të tokës dhe marrja e lejeve të ndërtimit”. Një cilësim i tillë, tregon se kontrata nuk është zbatuar plotësisht në afat dhe BOE të kontraktuar duhet të penalizohen për këtë mangësi, sipas kërkesave të nenit 6.1/a të kapitullit të dytë të kontratës.

- Kriteri:** - Kontrata e datës 16.10.2019 midis OSHEE SHA dhe BOE “I” SHPK & ”A” SHPK, neni 20, pika 20.1/a.
- Ndikimi/Efekti:** Dorëzim me vonesë produkti dhe mungesë penalizimi i kontraktorit në vlerën 819,670 lekë.
- Shkaku:** Mungesë vlerësimi e afateve të dorëzimit të produkteve të kontratës së shërbimit, si dhe situata kaotike e tërmetit, e cila përkon me afatin e dorëzimit të një pjese të shërbimit.
- Rëndësia:** I mesëm.
- Rekomandime:** OSHEE SHA, në cilësinë e AK të marrë masa për respektimin e kushteve kontraktore të nënshkruara, duke evidentuar dhe ngarkuar me përgjegjësi zyrtarët përkatës dhe kontraktorët për vonesat e krijuara, me qëllim arritjen e performancës së projektuar me zbatimin e kontratave.

Si konkluzion:

- BOE “I” SHPK & ”A” SHPK ka dorëzuar me 10 ditë vonesë njërin nga dokumentet e studimit (projekt-ide), për të cilën **duhet të penalizohet me 819,670 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për mungesën e të ardhurave nga burime të tjera për OSHEE SHA.**

- Studimi është dorëzuar në afat nga BOE “I” SHPK & ”A” SHPK, por nuk ka aplikuar për lejen e ndërtimit sipas kërkesave dhe kushteve në termat e referencës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Z. B T, në cilësinë e administratorit të kontratës.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën nr.12149/28 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

Në observacionin e administratorit të kontratës, cilësohet se projekt-ideja është dorëzuar në afat nga kontraktori, por për shkak të pasigurisë së pas-lëkundjeve të tërmetit, si dhe komunikimit verbal me kontraktorin protokollimi i këtij dokumenti është bërë me vonesë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e administratorit të kontratës dhe arrin në konkluzionin se mungesa e argumentimit me dokumentacion të vonesës në dorëzimin e projekt-idesë, nuk ka mbështetje ligjore, dhe për këtë arsye nuk merret në konsideratë.

15. Titulli i Gjetjes Mungesë respektimi i kriterëve për përlllogaritjen e fondit limit, pasi është shpallur fitues OE me ofertë prej 47.5 % të fondit limit.

Situata: Procedura e prokurimit është “E hapur- mallra” me objekt “Blerje videowall për godinën e OSHEE SHA”, me fondin total 54,781,955 lekë pa TVSH dhe me afat realizimi 45 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në tenderin e zhvilluar më datë 30.11.2017 kanë marrë pjesë dy OE: “B” SHPK i cili nuk ka paraqitur ofertë dhe BO: “A C” SHPK, dhe “R C”

SHPK kualifikuar dhe shpallur fitues me ofertë ekonomike me vlerë 26,000,000 lekë pa TVSH.

Me Urdhrin e brendshëm të Administratorit nr.22297/1 prot., datë 03.10.2017 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, kriterëve për kualifikim dhe vlerësim dhe përcaktimin e fondit limit me përbërje D K, L D dhe V X. Sipas relacionit përkatës të datës 13.10.2017, komisioni për përllogaritjen e fondit limit ka kryer testimin e tregut, në të cilin janë marrë tre oferta nga “S” SHPK, “R C” SHPK dhe “B” SHPK, duke llogaritur për fond limit çmimin mesatar të ofruar prej 54,781,955 lekë. Në dosjen e kësaj procedure ndodhen dokumentet nga këto subjekte të cilët nuk kanë datë dhe nuk kanë kërkesë mbi mallrat dhe sasinë që nevojiten. Në këtë mënyrë nuk është ezauruar plotësisht dhe në mënyrë të rregullt në përputhje me nenin 59, pika 2, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, e cila përcakton:

“Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
a) çmimet e tregut; ose/dhe
b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
c) çmimet ndërkombëtare,”

duke ngarkuar me përgjegjësi grupin e punës.

Krahas kësaj, në kriteret për kualifikim dhe vlerësim, kanë përcaktuar në pikën 9, midis të tjerave: “Për secilin nga produktet e kërkuara duhet të paraqiten katalogu/datasheet në gjuhën angleze ose në rast se është një gjuhë tjetër, i përkthyer dhe i noterizuar, ku të jenë paraqitur qartë përshkrimi i pajisjeve programeve të ofertuara si dhe çdo specifikim i kërkuar në specifikimet teknike”. Një përcaktim i tillë jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 14 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, në të cilën përcaktohet se në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetar, gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe pikën 4.6 të Kreut të parë të DST, e cila përcakton: “Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X Anglisht □ Tjetër“, por shkakton probleme në vlerësimin e ofertave nga komisioni përkatës, pasi nuk mjafton vetëm njohja e gjuhës angleze, por duhet njohja zyrtare e përkthyesit në raste të tilla.

Kriteri: - VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, neni 59, pika 2; neni 14

- DST, Kreu parë, pika 4.6 ;

Ndikimi/Efekti: Përllogaritje e gabuar e fondit limit, krahasuar me OE të kualifikuar dhe shpallur fitues me ofertë sa 47.5 % e fondit limit.

Shkaku: Mangësi një njohjen dhe zbatimin e përcaktimeve në kuadrin ligjor dhe rregullativ të prokurimeve për përllogaritjen e fondit limit dhe përcaktimin e kriterëve, si dhe mungesë serioziteti nga ana e zyrtarëve të përfshirë në procedurat e prokurimit.

Rëndësia: I ulët

Rekomandime: AK të marrë masa për të përzgjedhur ekspertë dhe për të trajnuar zyrtarët që përfshihen në procedurat e prokurimit publik, veçanërisht në rastin e vendosjes së kritereve të veçanta për kualifikim, me qëllim rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike.

Si konkluzion: Në tenderin “Blerje videowall për godinën e OSHEE SHA”, është llogaritur fondi limit 54,781,955 lekë pa TVSH” jo në përputhje me përcaktimet ligjore, mangësi të cilat janë reflektuar në kualifikimin dhe shpalljen e fituesit me vlerën 26,000,000 lekë ose 47.5 % e fondit limit, si dhe kanë vendosur në kriteret e kualifikimit paraqitjen e katalogut në gjuhën angleze, në kundërshtim me përcaktimet e DST.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: 1) Z. D K, 2) Z. L D, dhe 3) Z. V X, në cilësinë e anëtarëve të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, kritereve për kualifikim dhe vlerësim dhe përcaktimin e fondit limit.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën nr.12149/29 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

Në observacionin e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, cilësohet se oferta e “R C” SHPK gjendet bashkëlidhur relacionit. Lidhur me kriterin e vendosjes së gjuhës angleze justifikohet me të qenit mallra importi, me të dhëna teknike që nuk kanë nevojë për ndonjë njohje të veçantë të kësaj gjuhe, si dhe lehtëson përgatitjen e ofertës nga operatorët ekonomik

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, kritereve për kualifikim dhe vlerësim dhe përcaktimin e fondit limit dhe arrin në konkluzionin se vetëm fakti që oferta fituese është sa 47.5 % e fondit limit, tregon mangësitë dhe anën formale të përdorur në këtë rast.

Ndërsa lidhur me vendosjen e kriterit të gjuhës angleze, mjafton të sjellim në vëmendje, se një përcaktim i tillë është në kundërshtim me nenin 14 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.

Bazuar në sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin e grupit të punës dhe për këtë arsye nuk e merr në konsideratë.

16. Titulli i Gjetjes Në procedurën e prokurimit “Blerje ndarësa, izolatorë fishekë siguresse TM për DR, morseta detaje etj. për DTL” është shpallur fitues operatori ekonomik i vetëm pjesëmarrës në kushtet e mosplotësimit të kritereve të kualifikimit.

Situata: Procedura e prokurimit është “E hapur- mallra” me objekt “Blerje ndarësa, izolatorë fishekë siguresse TM për DR, morseta detaje etj. për DTL”, me fond limit 102,794,350 lekë pa TVSH dhe afat zbatimit 2 muaj nga lidhja e kontratës.

Në tenderin e zhvilluar më datë 04.05.2017 ka marrë pjesë dhe është shpallur fitues një OE: E SHPK me vlerë oferte 98,004,300 lekë pa TVSH, dhe kontrata është nënshkruar më 04.07.2017.

- Nga auditimi në SPE rezulton se në DT, seksioni 4, pika 4.6 është përcaktuar: *Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X; Anglisht □; Tjetër*” ndërsa tek shtojca 8, pika 2.3/5 cilësohet: *“Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit/ve në gjuhën angleze për materialet e preventivit, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen”*. Në këtë mënyrë, me përcaktimin e gjuhës angleze për krahasimin e ofertës me pajtueshmërinë

me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, kur gjuha e kontratës për hartimin e ofertave është shqip, jo vetëm që është kontradiktore në DT, por ka ndikuar në uljen e konkurrencës së pjesëmarrjes së OE dhe i ka shkaktuar vështirësi KVO në veprimtarinë e tij. Anëtarët e KVO duke mos qenë përkthyes të njohur zyrtarisht të gjuhës angleze, krijojnë mundësi për vlerësime të gabuara me pasoja ekonomike dhe financiare për OSHEE SHA. Për këtë mangësi ngarkohet me përgjegjësi Njësia e prokurimit me përbërje E B, V K dhe D M, të cilët janë përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit, në zbatim të pikës 1, të nenit 61 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Nga auditimi në SPE, rezulton se në kundërshtim me kërkesat e DT, pika 2.2, germa “a” e Shtojcës 8 e cila përcakton: *“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik duhet të dorëzojë: a) Kopje të vërtetuar të bilanceve, të audituara nga ekspertët kontabël të licencuar, të konfirmuara me vule pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të fundit.”*, Bilanci i vitit 2016 i OE të vetëm pjesëmarrës dhe të shpallur fitues E SHPK nuk është i konfirmuar nga organet tatimore, duke mos plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit për kapacitetin ekonomik dhe financiar. Në këto kushte, meqenëse OE nuk plotëson kriteret e kualifikimit, KVO e përbërë nga , K Ndhe A G ka vepruar në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”*.

- Veç kësaj, në kundërshtim me kërkesat e DT, pika 2.3-Kapaciteti teknike, 5. *“Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit/ve në gjuhën angleze për materialet e preventivit, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.”*, OE i shpallur fitues ka paraqitur gjithsej 635 faqe katalogë, përfshirë dhe testet si dhe specifikimet teknike, pa specifikuar qartë materialet që do të ofrojnë ky subjekt.

Bazuar në sa më sipër, procedura e prokurimit duhej anuluar, pasi nuk ka OE që plotëson kriteret e kualifikimit, në përputhje me kërkesat e nenit 24, pika 1/ç të LPP:

“Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit;”

Kriteri:

- LPP, neni 53/3; neni 24, pika 1/ç;
- VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 1;
- DT, seksioni 4, pika 4.6; Shtojca 8, pika 2.2, germa “a”; pika 2.3-Kapaciteti teknik, 5.

Ndikimi/Efekti:

Kualifikim dhe shpallje fitues të OE që nuk plotëson kriteret për kualifikim në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator të prokurimeve.

Shkaku:

Mangësi në njohje dhe zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator të prokurimeve, si dhe mungesë serioziteti nga ana e zyrtarëve të përfshirë në procedurat e prokurimit publik.

Rëndësia:

I mesëm.

Rekomandime: AK të marrë masa për të përzgjedhur ekspertë dhe për të trajnuar zyrtarët që përfshihen në procedurat e prokurimit publik, veçanërisht në rastin e vendosjes së kriterëve të veçanta për kualifikim, me qëllim rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike.

Si konkluzion:

- Në procedurën e prokurimit “Blerje ndarësa, izolatorë fishekë siguresse TM për DR, morseta detaje etj. për DTL”, në DT për specifikimet teknike është vendosur kërkesa për paraqitje në gjuhën angleze, kur gjuha e ofertës është përcaktuar në gjuhën shqipe;

- OE i vetëm pjesëmarrës E SHPK është kualifikuar në kushtet kur nuk ka plotësuar kërkesën për kopje të certifikuara të bilancit për vitin 2016, si dhe ka sjellë 635 faqe katalogë dhe fragmente katalogësh, pa treguar dhe specifikuar qartë materialet që do të ofrohen.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: 1) Z. E B, 2) Zj.V K, 3) Z. D M, në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit; 4) Z. Z K, 5) Z. K N, 6) Z. A G, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën nr.12149/28 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

Në observacionin e njësisë së prokurimit dhe KVO, cilësohet se meqenëse kemi të bëjmë me mallra importi dhe të dhënat që kërkohen janë të dhëna teknike që njihen nga specialistët e fushës nuk ka nevojë për ndonjë njohje të veçantë të gjuhës angleze.

KVO e ka trajtuar si devijim të vogël, mungesën e bilancit të certifikuar nga organet tatimore të vitit 2016, të cilën e ka sjellë në fazën e lidhjes së kontratës.

KVO gjatë 14 ditëve të vlerësimit të ofertës ka kontrolluar çdo zë të preventivit për 635 faqe katalogë dhe fragmente katalogësh, megjithëse OE nuk ka specifikuar qartë materialet që ofron.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e njësisë së prokurimit dhe KVO dhe arrin në konkluzionin se gjuha e ofertës nuk lidhet me objektin e saj (mallra importi dhe të dhënat teknike), por me kriteret në DT dhe kuadrin rregullator e ligjor.

Në kushtet kur kemi vetëm një pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, trajtimi i mosplotësimit të kriterëve të kualifikimit (bilanci i pakonfirmuar në organet tatimore, si dhe fakti i dorëzimit në fazën e lidhjes së kontratës) si devijim i vogël, si dhe KVO në vlerësim nuk bën parashikime, sjellin për pasojë uljen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

Mungesa e përcaktimit të qartë në katalog e materialeve që ofrohen me një vëllim të konsiderueshëm prej 635 faqe, për më tepër në gjuhën angleze, rrezikon për vlerësime të gabuara nga KVO, me pasoja në uljen efektivitetin e fondeve publike.

Bazuar në sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin e njësisë së prokurimit dhe KVO dhe për këtë arsye nuk e merr në konsideratë.

Procedura prokurimi në Drejtoritë Rajonale dhe zbatime të kontratave të punimeve.

1-Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion kabinash elektrike dhe ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC, linjë TM, qyteti Selenicë” me fond limit 41,924,896 lek, nga auditimi i dokumentacioni teknik në SEP dhe verifikimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik të kualifikuar dhe skualifikuar u konstatua se:

Ky operator ekonomik ka marrë pjesë si BO sipas marrëveshjes nr. 997 rep. 977 kol. datë 22.05.2017 midis operatoreve “M” SHPK dhe “A” SHPK ndarë me përqindje 57 % M dhe 43 % A SHPK.

Në referencë të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 74 bashkimi i operatorëve duhet ti plotësoj kriteret e vendosura në DST si më

poshtë:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës **dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës**. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit /furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, **kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.**

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

- Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

6. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Sipas DST

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të realizuar (**Përvoja të mëparshme**)

Për përmbushjen e këtij kriteri në reference të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, neni 74 pika 3 duhet ta përmbushi anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.

Për plotësimin e këtij kriteri BO ekonomik fitues me përfaqësues “M” si lider ka paraqitur si punë të ngjashme kontratën me KESH SHA “Furnizim vendosje gjeneratori”. Ku operatori ekonomik “M” sipas kontratës së bashkëpunimit 1073 rep 873 kol datë 14.05.2016 merr përsipër të kryej 20% të kontratës, pra 10,027,200 lekë mallra, dhe pjesa tjetër prej 80% kryhet nga A.

Me këtë kontrata bashkëpunimi dhe situacionet bashkangjitur KVO e ka kualifikuar këtë operator ekonomik duke e konsideruar si punë të ngjashme, sipas KVO Furnizim vendosja e mallit është e njëjtë me punimet, edhe në kushtet e një pune të ngjashme të saktë me këtë përqindje operatori ekonomik i kualifikuar M nuk e përmbush kriterin 2.3.1 **“Punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të vogël se 20,000,000 lekë.**

Praktikisht jemi në dy situata krejt të ndryshme, ndaj dhe ligjvënësi ka hartuar dhe miratuar dy tipe të ndryshme DST, atë për **blerje mallrash** dhe atë **për punë**, praktikisht operatori ekonomik apo BO në cilësinë e liderit “M” dhe në reference të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 74 pika 3 punën e ngjashme e kërkon nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim, pra nga “M” që praktikisht pikën 2.3 të kapacitetit teknik nuk e disponon (punë të ngjashme) nuk kërkohet furnizime të ngjashme por punë të ngjashme.

Gjithashtu dhe kontrata për punë të ngjashme nga anëtari tjetër i bashkimit të operatorëve nuk e përmbush këtë kriter, në këtë autoritet kontraktor për kualifikimin dhe skualifikimin e operatorëve ekonomik nuk merret në konsideratë, ligji përkatës, VKM në zbatim të tij, DST e miratuar por vlen

një marrëveshje bashkëpunimi e hartuar dhe e ndarë sipas nevojave të operatorëve ekonomik dhe e noterizuar nga Noteri, pra vetëm me këtë dokument kriteri 2.3.1 kapaciteti teknik në këtë AK mund të plotësohet nga kush do, me apo pa eksperiencë me apo pa licencë siç është vepruar në këtë rast për BO ‘M’ dhe ‘A’.

Për sa i përket pikës 2.3.2 Kapaciteti teknik dhe profesional

- Anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim nuk zotëron licencat profesionale NP-2 klasifikimi A, NP-11 Klasifikimi A, NS-14 Klasifikimi A.

- Anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim nuk zotëron certifikatat si më poshtë:

ISO 9001-2008 për menaxhimin e cilësisë

ISO 14001-2004 për menaxhimin e mjedisit

OHSAS 18001-2007 për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë

ISO 50001-2011 Për sistemin e menaxhimit të energjisë

Këto çertifikime duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, operatori ekonomik këto çertifikimi i ka në fushën e furnizimit.

-d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi nga administrate tatimore (Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave) për punësimin mesatar jo më pak se 20 punonjeshish per periudhen prill 2016 – Mars 2017, ku përfshihen edhe stafi menaxherial i drejtuesve teknik.

Për përmbushjen e e këtij kriteri në reference të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; neni 74 pika 3 duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi i operatorëve sipas %, “*Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*

Nga sa më sipër operatori lider duhet të ketë një fuqi punëtore mesatare prej 57% x 20 (persona) = 11 punonjës dhe 9 punonjës duhet ti disponoj operatori tjetër I BOE “A” SHPK.

Fuqia mesatare për operatorin ekonomik “M” sipas listë-pagesave është 2 punonjës pra 9 punonjës më pak se detyrimi ligjorë minimal për kualifikim.

3. Konkluzion:

Pra për sa më sipër kualifikimi me mangësitë e sipërcituara ngarkon me përgjegjësi KVO për kualifikimin e këtij operatori ekonomik dhe titullarin e AK për Shpalljen fitues. *Veprime në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik nr. 9643 LIGJI Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/201, Neni 46 pika 1 dhe neni 53 pika 3 si dhe me Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; neni 74 pika 3 si dhe Dokumentet standarde të tenderit Pika 2.3.1.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1) Z. E B me detyrë, Drejtor i drejtorisë së prokurimeve në cilësinë e kryetarit të KVO

3) Z. F D me detyrë specialiste në cilësinë e anëtarit të KVO

4) Z. Z D me detyrë specialiste në cilësinë e anëtarit të KVO

Titulli i gjetjes: Kualifikim i padrejtë

Situata:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion kabinash elektrike dhe ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC, linjë TM, qyteti Selenicë” me fond limit 41,924,896 lekë, nga ana e KVO është kualifikuar BO ekonomik “M. ltd” SHPK dhe “A.” SHPK në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe dokumentat e tenderit të hartuar sipas DST të miratuar.

Kriteri:

Ligjin e prokurimit publik nr. 9643 LIGJI Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë

26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/201., Neni 46 pika 1 dhe neni 53 pika 3 si dhe me Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; neni 74 pika 3, 3 si dhe Dokumentet standarde të tenderit Pika 2.3.1.

Ndikimi: Mundësia e punimeve jo cilësore
Shkaku: Interpretim i gabuar i ligjit
Rëndësia: E mesme.
Rekomandimi: OSHEE SHA të marri masa që në të ardhmen të kryej vlerësim sa më objektiv duke ruajtur paanshmërinë në procedurat që vlerësohet qofshin ato me ofertë më të ulët apo më të lartë. Pasja në vëmendje plotësimin e të gjitha kriterëve për kualifikim në respekt të frymës së ligjit.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me projekt raportin e auditimit, OSHEE SHA ka paraqitur objeksionet e saj me shkresën nr. 12149/32 prot., datë 22.12.2020 administruar nga grupi i auditimit më 28.12.2020 me pretendimet e saj si më poshtë:

Referuar nenit 74 të VKM 914, ndër të tjera citon: 2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

- Sa më sipër OE ka përmbushur kërkesat e pikës 2 të nenit 74, duke deklaruar përqindjen e pjesëmarrjes në këtë BOE si edhe kanë përcaktuar qartë elementet konkret, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi duke ju referuar preventivit të ofertuar nga an e tyre dhe duke e bërë këtë të fundit pjesë të marrëveshjes së sipërpërmendur. Referuar gjithmonë kësaj marrëveshje, në nenin e titulluar “pjesëmarrja”, OE siç përmendem pak më lart përcaktojnë elementet konkret, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Konkretisht OE “M.” Ltd merr përsipër vetëm furnizimin e pajisjeve sipas zërave të preventivit, ndërsa OE “A.” SHPK merr përsipër vetëm kryerjen e punimeve dhe vendosjen sipas zërave të preventivit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Sa më sipër siç jemi shprehur dhe në akt-konstatim ky interpretim i ligjit vlen vetëm për Ju si AK. Ligjvënësi dhe në përgatitjen e dokumenteve standarde të tenderit ka përgatitur 3 tipe të ndryshme, për punime, mallra e konsulencë, pra praktikisht këto procedura janë të ndara që në gjeneze. Ju apo kushdo AK tjetër nuk mund të niset vetëm nga një kontratë bashkëpunimi para noterit ku deklarojnë secili ca duhet të bëjë dhe të ndani procedurën (më vete furnizimi më vete punimet) atëherë dhe neve na lind e drejta t’ju themi ndani dhe procedure një herë bëni blerje mallrash ta fitoi “M.” Ltd dhe pastaj bëni procedurë për vendosjen e këtyre mallrave e ta fitoi “A.”.

- Gjithashtu grupi i auditimit po të njëjtit nen ju ka referuar por pikës 3... *Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.*

Prapë për sa i përket këtij specifikimi të shprehur qartë Ju merrni në konsideratë ndarjet e bëra para noterit, noteri harton akte brenda parashikimeve ligjore dhe çfarë i kërkohet por kurrsesi nuk merr përsipër të vendos fatet e procedurës.

Për sa më sipër ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2- Në procedurën e prokurimit me objekt “**Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC në zonën e Peqinit**” me vlerë të preventivuar 156,150,918 lekë, nga auditimi i dokumentacioni teknik në sistemin SEP dhe verifikimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik të kualifikuar dhe skualifikuar u konstatua se:

-Nga analizimi i shkresës datë 16.05.2017 procesverbali i hartimit të dokumenteve të tenderit.

Në licencat profesionale të kërkuara nga NJP e përbërë nga A. H., M. D. dhe A. M. kërkohet licencë N.P – 12 D (Punime të inxhinierisë së mjedisit) pra NJP e AK Elbasan kërkon licencë të nivelit D punimet (101,000,000-200,000,000 lek) në inxhinierin e mjedisit ndërkohë që këtu kemi punime të karakterit N.P 11.

Për vendosjen e këtij kriteri mban përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga A. H., M. D.dhe A. M. veprime në kundërshtim me *Veprim në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik nr. 9643 LIGJI Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12 pika c dhe Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016;) neni 57 pika 2, neni 61 pika 2*

Titulli i gjetjes: **Kriter i pa argumentuar**

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me “Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC në zonën e Peqinit” me fond limit 156,150,918 lek, nga ana e Njesisë së prokurimit me shkresën datë 16.05.2017 janë hartuar dokumentet e tenderit ku për sa i përket pikës 2.3 Kapaciteti teknik është kërkuar licencë N.P – 12 –D (Punime të inxhinierisë së mjedisit), kriter pa nevojshëm në këtë nivel licencë për punime në vlerë (101,000,000-200,000,000 lek) do ishte më se e mjaftueshme kategoria A apo dhe inxhinier mjedisi në stafin e Operatorëve ekonomik.

Kriteri: *LIGJI Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12 pika c dhe Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016;) neni 57 pika 2, neni 61 pika 2*

Ndikimi: Zvogëlim i operatorëve pjesëmarrës

Shkaku: Interpretim i gabuar i ligjit

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: OSHEE SHA të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të saj si dhe njësit e prokurimit të marrë masa që në të ardhmen të vendosin kriteret konkurruese sa më të pranueshme duke mos cenuar realizimin e kontratës zvogëlimin e konkurrencës dhe rritjen e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit.

Nga auditimi i ofertës teknike dhe dokumentacionit në sistemin SEP u konstatua se:

Nga auditimi i dokumentacioni teknik në sistemin SEP dhe verifikimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik të kualifikuar dhe skualifikuar u konstatua se:

Operatori ekonomik i kualifikuar shpallur fitues dhe lidhur kontratë BOE “B. N SHPK dhe B. SHPK” nuk plotëson kriteret e më poshtme:

Ky operator ekonomik ka marrë pjesë si BO sipas marrveshjes nr. 2606 rep. datë 16.06.2017 midis operatoreve B. N SHPK dhe B. SHPK ndare me përqindje 64.49% B. N SHPK dhe 35.51% B. SHPK.

Në referencë të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; nr.797, datë 29.12.2017; nr.80, datë 14.2.2018) neni 74 bashkimi i operatorëve duhet ti plotësoj kriteret e vendosura në DST si më poshtë:

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

- Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për sa i përket pikës 2.3.2 Kapaciteti teknik dhe profesional

D) Listë pagesat sipas formularëve standarde për sigurimet, për periudhën Janar 2016 – Prill 2017, ku numri i punonjësve të jete minimum **100** persona.

Për përmbushjen e këtij kriteri në reference të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; nr.797, datë 29.12.2017; nr.80, datë 14.2.2018) neni 74 pika 3 duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi i operatorëve sipas %, “Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”

Nga sa më sipër operatori lider duhet të ketë një fuqi punëtore mesatare prej 65% x 100 (persona) = 65 punonjës dhe 35 punonjës duhet t’i disponoj operatori tjetër i BOE “B. N” SHPK.

Fuqia mesatare për operatorin ekonomik “B.” sipas listë pagesave është 65 duke e plotësuar këtë element në këtë fazë të procesit.

-Pas nënshkrimit të kontratë Operatori ekonomik pjesëmarrës në BOE B. N SHPK paraqet deklaratën për tërheqje nga kjo procedurë mbështetur në VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 74 pika 5 deklaron tërheqjen dhe Jep miratimin e saj që pjesa takuese e punimeve që ishin marrë përsipër nga shoqëria Jonë të realizohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve , shoqërinë B. SHPK.

Në referencë të nenit të përmendur nga ana e “ OE B. N” citohet: Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, anëtar të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti kontraktor zgjidh kontratën. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, atëherë detyrimet e operatorit të tërhequr ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i bashkimit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.

I ndodhur në këto kushte dhe duke marrë në konsideratë të dhënat teknike të zonës ku parashikohet investimi Fiderat 2,3 dhe 4 ku për vitin 2016 humbjet paraqiten me 41.15% dhe aktualisht janë në masën e 17.6% titullari i AK ka vendosur në miratimin e amendimit të kontratës duke marrë në konsideratë nivelin e humbjeve në këtë zonë dhe kohën që do duhej për zgjidhjen e kontratës , mundësinë e ankimit të saj në organet e tjera, rilidhjen përsëri apo në rastin tjetër rihapjen procedurës në sistem do shkon mbi 6 muaj në rastin më të mirë. Duke shmangur rrishtet e kërkit të kostove të krijuara ndaj OE apo dhe fitimit të munguar varet nga interpretimi i gjykatës.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me projekt raportin e auditimit subjekti OSHEE SHA ka paraqitur objeksionet e saj me shkresën nr. 12149/35 prot., datë 22.12.2020, administruar nga grupi i auditimit më 28.12.2020 me pretendimet e saj si më poshtë;

Përfaqësuesit e OSSH, Drejtoria Rajonale Elbasan të cilëve ju është drejtuar pjesa e Projektraportit marrë me shkresën nr. 953 prot. Datë 07.12.2020 B. M., L. R., M. M., N. C., K. S., E. V., A. H. M. D., A. M., K. B. kanë dërguar objeksionet e tyre;

OSSH, Drejtoria Rajonale Elbasan ka zhvilluar tenderin me objekt "Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetëmbajtje ABC ne zonën e Peqinit

- ...Në të gjitha rastet e investimeve me vlerë të konsiderueshme duke parë dhe natyrën dhe vlerën e tyre OSSH Elbasan ka vendosur kriteret e nivelit që Ju permendni, kjo për arsye e krijimit të

besimit të arsyeshëm të realizimit të kontratës me sukses... rezultatit i uljes së humbjeve nga 41% në 17.9 % e tregon këtë...

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me kete gjetje të KLSH, sqarojme se në asnjë moment grupi i aditimit nuk është shprehur për punë të dobët apo pa eficiencë, por kur flasim për prokurimet publike, baza është fryma e ligjit nr. 9643 “Për prukurimin publik” i ndryshuar, i cili shprehet se, kërkesat kualifikuese duhet të jenë në proporcion të drejtë me natyrën dhe vlerën e kontratës, për rrjedhojë pretendimi nuk qëndron.

3- Në procedurën e prokurimit me objekt “**Ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC për 26 kabina Elbasan-Cërrik**” me vlerë të preventivuar 106,963,866 lek, nga auditimi i dokumentacioni teknik në SEP dhe verifikimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik të kualifikuar dhe skualifikuar u konstatua se:

Ky bashkim operatorësh është krijuare në bazë të akt-marrëveshjes nr. 8177 rep. 4029 kol., datë 23.11.2018 ku operatori ekonomik “E. SHPK” do të kryej 88.16% të punimeve dhe operatori ekonomik “E.” do kryej 11.84% të punimeve.

Për përmbushjen e këtij kriteri secili operator ekonomik duhet të plotësoj kriteret e kërkuara në referencë për përmbushjen e këtij kriteri në reference të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; nr.797, datë 29.12.2017; nr.80, datë 14.2.2018) neni 74 pika 3 duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi i operatorëve sipas %, “Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”

Për sa i përket pikës 2.3.2 Kapaciteti teknik dhe profesional

D) Listë pagesat sipas formularëve standarde për sigurimet, *për periudhën Janar 2018 – Tetor 2018*, ku numri i punonjësve të jete minimum **100** persona.

Nga sa më sipër operatori lider duhet të ketë një fuqi punëtore mesatare prej $88.16\% \times 100$ (persona) = 88 punonjës dhe 12 punonjës duhet ti disponoj operatori tjetër i BOE “E.” SHPK.

Numri mesatar i punonjësve sipas listë pagesës për OE E..shpk është 12 , pra jemi në kushtet e kundërta të marrëveshjes, kriter që nuk përmbushet nga OE E. SHPK.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me projekt raportin e auditimit subjekti OSHEE SHA ka paraqitur objeksionet e saj me shkresën nr. 12149/35 prot., datë 22.12.2020, administruar nga grupi i auditimit më 28.12.2020 me pretendimet e saj si më poshtë:

Përfaqësuesit e OSSH, Drejtoria Rajonale Elbasan te cilëve ju është drejtuar pjesa e Projekt raportit marrë me shkresën nr. 953 prot., datë 07.12.2020 B. M., L.R., M. M., N. C., K. S., E. V., A. H. M. D., A. M., K. B. kanë dërguar objeksionet e tyre; OSSH, Drejtoria Rajonale Korçë ka zhvilluar tenderin me objekt “Ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC për 26 kabina Elbasan-Cërrik”- *...Gjithashtu në ndarjen e punimeve sipas akt marrëveshjes konstatohet se punimet ku nevojiten elektrikist janë në masën më të madhe për punime të marra përsipër nga anëtari i BOE E. SHPK. ...*

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me këtë gjetje te KLSH, sqarojmë se, për sa i përket fuqisë punëtore pretendimet nuk qëndrojnë dhe nuk merret në konsideratë observacioni, ndërsa për sa i përket punonjësve elektrikist, observacioni merret në konsideratë dhe është reflektuar në hartimin e Raportit Përfundimtarë të Auditimit.

4- Në procedurën e prokurimit me objekt “**Ndërtim kabina Ajrore dhe Rrjet TU me ABC**” me vlerë të preventivuar 103,264,887 lekë, nga auditimi i dokumentacioni teknik në sistemin SEP dhe verifikimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik të kualifikuar dhe skualifikuar u konstatua se: Ky bashkim operatorësh është krijuar në bazë të aktmarrëveshjes nr. 901 rep., datë 19.02.2019 ku

operatori ekonomik "D. SHPK" do kryej 53.15% të punimeve dhe operatori ekonomik "B. SHPK" do kryej 46.85% të punimeve.

Për përmbushjen e këtij kriteri secili operator ekonomik duhet të plotësoj kriteret e kërkuara në referencë për përmbushjen e këtij kriteri në reference të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; nr.797, datë 29.12.2017; nr.80, datë 14.2.2018) neni 74 pika 3 duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi i operatorëve sipas %, "Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje"

Për sa i përket pikës 2.3.2 Kapaciteti teknik dhe profesional

D)Listë pagesat sipas formularëve standarde për sigurimet, për periudhën Janar 2017 -Dhjetor 2018, ku numri i punonjësve të jetë minimum mesatarisht **120** persona.

Nga sa më sipër operatori lider duhet të ketë një fuqi punëtore mesatare prej 53.15% x 120 (persona) = 63 punonjës dhe 57 punonjës duhet ti disponoj operatori tjetër i BOE "B." SHPK.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me projekt raportin e auditimit subjekti OSHEE SHA ka paraqitur objeksionet e saj me shkresën nr. 12149/35 prot., datë 22.12.2020, administruar nga grupi i auditimit më 28.12.2020 me pretendimet e saj si më poshtë:

Përfaqësuesit e OSSH, Drejtoria Rajonale Elbasan te cilëve ju është drejtuar pjesa e Projektraportit marrë me shkresën nr. 953 prot., datë 07.12.2020 B. M., L. R., M. M., N. C., K. S., E. V., A. H. M. D., A. M., K. B. kanë dërguar objeksionet e tyre; OSSH, Drejtoria Rajonale Elbasan ka zhvilluar tenderin me objekt "Ndërtim kabina Ajrore dhe Rrjet TU me ABC"- *Ndryshim të DST*

Ishte: ...numri i punonjësve të jetë minimumi mesatarisht 150 persona.

Bëhet: ... numri i punonjësve të jetë minimumi mesatarisht 120 persona.

Rekomndim i APP për ndryshimin e punonjësve të lirë për punë nga 120 bëhet 90etj.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me këtë gjetje të KLSH, sqarojme se, për sa i përket fuqisë puntore, si dhe stafit të lirë grupi i adutimit nuk i ka vënë re ndryshimet sipas shtojcave përkatëse të DST sipas rekomandimeve të APP, e për rrjedhojë është shprehur në gjetje, në hartimin e këtij Raporti përfundimtarë observacioni merret në konsideratë.

5- Në procedurën e prokurimit me objekt "**Rikonstruksion i rrjetit TU me kabëll me vetëmbajtje ABC në Agjencinë Burrel (Loti II)**" me vlerë të preventivuar 50,797,989 lekë, nga auditimi i dokumentacioni teknik në SEP dhe verifikimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik të kualifikuar dhe skualifikuar u konstatua se:

- Njësia e prokurimit e përbërë nga B. A. L., E. V. A., E. Q. G. ka hartuar specifike teknike dhe kriteret për kualifikim jo në përputhje dhe proporcion të drejtë me vlerat e kontratës e cila është përlllogaritur 50,797,989 lekë.

Në licencat profesionale të kërkuara nga NJP kërkohet licencë:

N.P – 1 –B (Punime Gjermimi në tokë) në bazë të preventivit kjo procedurë konsiston kryesisht në punime elektrike Tu pra në ajër jo në tok, mjaftonte NP-1-A kjo e krahasuar dhe në procedura të tjera të këtij AK me vlerë të përafërt.

N.P – 2- D (Punime civile dhe industriale) absurde si nivel licence, ku e gjithë vlera e kontratës është përlllogaritur në vlerën 50,797,989 lek, ndërkohë që licenca e kërkuar kërkohet në nivele punimesh 101-200 milion.

N.P – 12- C (Punime të inxhinierisë së mjedisit) absurde si nivel licencë, ku e gjithë vlera e kontratës është përlllogaritur në vlerën 50,797,989 lek, ndërkohë që licenca e kërkuar kërkohet në nivele punimesh 51-100 milion.

N.S -8-B (Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri) e pa kuptimit ndërkohë që ke kërkuar N.P.2 mjafto një për zërat e punimeve që ka ky preventiv.

N.S -14-D (Impiante të brendshme, Elektrike, Telefoni, TV et) absurde si nivel licencë, ku e gjithë

vlera e kontratës është përlllogaritur në vlerën 50,797,989 lek, ndërkohë që licenca e kërkuar kërkohet në nivele punimesh 101-200 milion.

N.S -18-B në bazë të preventivit kjo procedurë konsiston kryesisht në punime elektrike Tu pra në ajër jo në tok, mjaftonte NP-1-A ose një inxhinier mjedisi në staf, nuk kemi asnjë zë punime të natyrës mjedisore.

- Nga sa më sipër vendosja e kriterëve të licencave në këto nivel dikton në kufizimin e operatorëve pjesëmarrës dhe orientimin e procedurës në operatorin fitues.

- **Në procedurën e prokurimit** “Rikonstruksion i fiderit ekzistues Klos, N/Stacioni Suç” me vlerë të preventivuar **59 423 085** lekë. Siç vihet re jemi në kushte të ngjashme dhe licencat e kërkuara janë në proporcion me vlerën e kontratës.

Për këtë procedurë është audituar sistemi elektronik i prokurimit, kriteret për kualifikim dhe procedura e vlerësimit.

Licëse profesionale e shoqërisë e vlefshme në kategoritë:

- **Kategoria NP-1** (Punime gjermimi në tokë) – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NP-2** (Ndërtim civile dhe industriale) – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NP-11** (Ndërtim për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja të TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.) – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-14** (Impiante të brendshme, Elektrike, Telefoni, TV etj.) – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-18** (Punime Topogjeodezike) – **Klasifikimi A,**

Për vendosjen e këtij kriteri mban përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga Bashkim Lala, Elisa Gjasta dhe Eduart Abazi veprime në kundërshtim me *Veprim në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik nr. 9643 LIGJI Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/2014 Neni 12 pika c dhe Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016;) neni 57 pika 2, neni 61 pika 2.*

Titulli i gjetjes: **Kriter i pa argumentuar**

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me “Rikonstruksion i rrjetit TU me kabëll me vetëmbajtje ABC në Agjencinë Burrel (Loti II)” me fond limit 50,797,989 lekë, nga ana e Njesisë së prokurimit janë hartuar dokumentet e tenderit ku për sa I përket pikës 2.3 Kapaciteti teknik është kërkuar licenca, N.P – 1 –B (Punime Gjermimi në tokë), N.P – 2- D (Punime civile dhe industriale) N.P – 12- C (Punime të inxhinierisë së mjedisit) N.S -14-D (Impiante të brendshme, Elektrike, Telefoni, TV et) kriteret të pa nevojshëm në këtë nivel licence për punime në vlerë (D =101,000,000-200,000,000 lek) do ishte më se e mjaftueshme kategoria A a.

Kriteri: *LIGJI Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12 pika c dhe Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016;) neni 57 pika 2, neni 61 pika 2.*

Ndikimi: Zvogëlim i operatorëve pjesëmarrës

Shkaku: Interpretim i gabuar i ligjit

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: OSHEE SHA të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të saj si dhe njësit e prokurimit të marri masa që në të ardhmen të vendosin kriteret konkurruese sa më të pranueshme duke mos cenuar realizimin e kontratës zvogëlimin e konkurrencës dhe rritjen e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me projekt raportin e auditimit subjekti OSHEE SHA ka paraqitur objeksionet e saj me shkresën nr. 12149/36 prot., datë 22.12.2020 me pretendimet e saj si më poshtë:

Përfaqësuesit e OSSH, Drejtoria Rajonale Burrel te cilëve ju është drejtuar kjo pjesë e projekt raportit; B. L., E. Gj., E. A.;

OSSH, Drejtoria Rajonale Burrel ka zhvilluar tenderin me objekt **“Rikonstruksion i rrjetit TU me kabëll me vetëmbajtje ABC në Agjencinë Burrel (Loti II)”**

Në lidhje me vendosjen e licensave në kategoritë e kërkuara

I-Në observacioni tonë ndaj akt-konstatimit Tuaj (cituar me lart), **ju kemi parashtruar faktet dhe analizën ligjore** se përse konstatimet Tuaja nuk qëndrojnë referuar natyrës së punimeve objekt prokurimi të zhvilluar dhe interpretimin ligjor dhe nënligjor që rregullon kërkesat e Autoritetit Kontraktor (Njësisë së Prokurimit) në lidhje me kërkesat për kualifikim që vendos, dhe përcaktimet nënligjore që rregullojnë në mënyrë specifike kërkesat për kualifikim, **siç është ajo e kërkesës për kategoritë e licensave në punime zbatimi të ndërtimit, ku më hollësisht ju kemi parashtruar kundërshtimet tona, si më poshtë, citojmë:**

“I.2 Në lidhje me konstatimet e kryera nga ana Juaj, ish-Njësia e Prokurimit vlerëson se, konkludimet e Juaja nuk janë të bazuara në legjislacionin e prokurimit publik dhe në aktet nënligjore të rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, ku më hollësisht parashtrojmë, faktet dhe analizën ligjore ku vërtetohet se njësia e prokurimit nuk ka kryer asnjë shkelje ligjore apo nënligjore.

Ne dokumentet Standarde të tenderit për këtë procedure prokurimi në **germën "a" të pikës 2.3.2 Kapacitete teknike dhe profesionale/ Kriteret e Veçanta të kualifikimi**, është kërkuar:

a) Licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, sipas modelit të lëshuar nga MPPT:

Licence profesionale e shoqërisë e vlefshme në kategoritë:

Kategoria NP-1 (Punime gërmimi në tokë) - **Klasifikimi B,**

Kategoria NP-2 (Ndërrime civile dhe industriale) - **Klasifikimi D**

Kategoria NP-11 (Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja të TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.) - **Klasifikimi B**

Kategoria NP-12 (Punime të inxhinierisë së Mjedisit) – **Klasifikimi C,**

Kategoria NS-8 (Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri) - **Klasifikimi B**

Kategoria NS-14 (Impiante të brendshme, Elektrike, Telefoni, TV etj.) - **Klasifikimi D**

Kategoria NS-18 (Punime Topogjeodezike) - **Klasifikimi B,**

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Vlera e preventivuar e procedurës është **50,797,989 lekë**

Për sa i përket pretendimit të vendosjes së licensave nga ana juaj është i drejt dhe grupi i auditimit ska asnjë bazë ligjore mbështetëse, për argumentimin e këtij pretendimi. Ju bëjmë me dije se Vendimi i KPP nr. 892/2016 në një rast të ngjashëm por dukshëm më të lehtë në problematikë se Ju shprehet:

“Komisioni i Prokurimit Publik në lidhje me pretendimin e ankimuesit për ndryshimin e kategorisë, gjykon se për sa i takon nivelit të klasifikimit të punimeve sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi kjo lidhet ngushtë me vlerën e llogaritur të objektit të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se referuar fondit limit të përlogaritur nga autoriteti kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit, i cili është 45,854,152 lekë (pa përfshirë vlerën e TVSH-së).), evidentohet qartë se niveli i klasifikimit “C”, për vlerë punimesh 51-100 milion lekë, nuk është në përputhje me vlerën e punimeve {ndërkohë që Ju vendosni kategorinë D} kërkonti më shumë siguri me sa duket për realizimin e kontratës. Sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm, duke parashikuar një kategori të licensës së kërkuar NS-19 në përputhje me volumin e kontratës.”

Sa më sipër pretendimi Juaj nuk merret në konsideratë.

6- Në procedurën e prokurimit me objekt “**Ndërtim i fiderit të ri Klos Nr.2, N/Stacioni Suç**” me vlerë të preventivuar **31 979 787** lekë, nga auditimi i dokumentacioni teknik në sistemin SEP dhe verifikimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik ku nuk u konstatuan problematika.

7- Në procedurën e prokurimit me objekt “**Spostimi i fiderave në N/Stacionin 110/35/10 Korçë**” me vlerë të preventivuar **18,843,813** lekë, nga auditimi i dokumentacioni teknik në sistemin SEP dhe verifikimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik ku nuk u konstatuan problematika.

- Me procesverbalin nr. 2359/4 prot., datë 08.02.2019 mbi llogaritjen e ofertës anomalisht të ulët ku rezultoi se janë kualifikuar:

I. me vlerë oferte 15,463,056 lek

M. ltd me vlerë oferte 18,751,843.95 lek

KVO shprehet se OE kalojnë për kuotim në sistem.

Oferta e operatorit ekonomik “Xh.” SHPK me vlerë 15,873,077 lek është refuzuar.

Me shkresën nr. 99 datë 18.02.2019 operatori ekonomik “M.” ltd ka paraqitur një ankesë në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “I.” & A. SHPK duke pretenduar “...me anë të një kontrolli të thjesht në QKB del qartë se nuk kanë të përfshirë në objekt e veprimtarisë së tyre objektin e prokuruar në këtë kontratë...” “...absurditeti më i madh qëndron në faktin se, duke mos e pasur fare në objekt veprimtarie kontratë prokurimi atëherë rrjedhimisht nuk ka si të kenë dhe kontrata të ngjashme...”

Pretendimi tjetër i ‘M. ltd’ është “Nëse AK/KVO ishte e vendosur që tenderi t’i jepet shoqërisë I. SHPK nuk e kuptojmë pse procedura u prokurua dhe nuk u bë me negociim mes palëve...”

Pretendimi tjetër është se asnjë nga palët nuk dispono licencën NP 11

Këto janë pretendimet e “M. ltd” administratores së saj A. M..

- Me shkresën nr. 99/1 datë 18.02.2019 AK A. Q. ka nxjerr urdhrin për pezullimin e procedurës së prokurimit ku në pikën 3 të shkresës citon: Ngarkohet titullari i AK për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “M. ltd” SHPK.

Veprim në kundërshtim me Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; nr.797, datë 29.12.2017; nr.80, datë 14.2.2018) kreu X neni 78

6. Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:

a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përrjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm i cili duhet të jetë ekspert fushe. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. A. Q.

Titulli i gjetjes: Përvetësim kompetencash

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “**Spostimi i fiderave në N/Stacionin 110/35/10 Korçë**” me fond limit 18,843,813 lek, nga ana e titullarit të AK pas ardhjes së ankesës është nxjerr shkresa nr. 99/1 datë 18.02.2019 për ngritjen e komisionit për shqyrtim ankese duke emëruar në këtë pozicion veten e tij.

Kriteri: Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; nr.797, datë 29.12.2017; nr.80, datë 14.2.2018) kreu X neni 78 pika 6, shkronja a

Ndikimi: Cenimi i paanshmërisë në vendimmarrje

Shkaku: Interpretim i gabuar i ligjit

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: OSHEE SHA të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të saj si dhe

emërimin në postet e titullarit të AK staf të kualifikuar dhe me integritet me qëllim marrjen e vendimeve në proporcion të drejt me situatën dhe legjislacionin në fuqi.

-Me shkresën nr. 99/2 prot., datë 18.02.2019 i kthehet përgjigje ankuesit shoqërisë “M.” ltd “...Autoriteti kontraktor do të rishqyrtoj dhe një herë përmbushjen e kriterit nga OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. Kontrata të ngjashme konsiderohen të vlefshme nëse kanë zëra kryesorë të punimeve kanë volume të konsiderueshme të ngjashme krahasimore të përcaktuara në këtë prokurim.”

- Me shkresën nr. 99/3 datë 18.02.2019 A. Q. nxjerr urdhëron për rivlerësim.

- Me shkresën nr. 99/4 prot., datë 18.02.2019 procesverbal i mbajtur nga KVO shprehet se: “Në datë 18.02.2019 KVO rivlerësoi këtë procedurë ku vendosi se ankimimi i kryer nga OE M.ltd duhet pranuar dhe vendos anulimin e vendimit të KVO për kualifikimin e operatorit ekonomik “I.” SHPK duke e skualifikuar këtë operator nga procedura e prokurimit”

- Akt absolutisht i pavlefshëm pasi KVO e ka marrë vendimin me shkresën 2359/4 datë 08.02.2019 , veprimi në kundërshtim me Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; nr.797, datë 29.12.2017; nr.80, datë 14.2.2018) kreu X neni 78

6. Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:

a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përfundimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm i cili duhet të jetë ekspert fushë. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. **Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa.**

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK A. Q.

Titulli i gjetjes: Caktimi i stafit në detyra jo në përputhje me ligjin

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “**Spostimi i fiderave në N/Stacionin 110/35/10 Korçë**” me fond limit 18,843,813 lek, nga ana e titullarit të AK pas kthimi të përgjigjes së ankesës ricakton dhe një herë KVO të marrë një vendim tjetër pas shqyrtimit të ankesës nga ana e tij.

Kriteri: *Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; nr.797, datë 29.12.2017; nr.80, datë 14.2.2018) kreu X neni 78 pika 6, shkronja a*

Ndikimi: Cenimi i paanshmërisë në vendimmarrje

Shkaku: Interpretim i gabuar i ligjit

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: OSHEE SHA të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të saj si dhe emërimin në postet e titullarit të AK staf të kualifikuar dhe me integritet me qëllim marrjen e vendimeve në proporcion të drejt me situatën dhe legjislacionin në fuqi.

- Me shkresën nr. 2359/5 prot., datë 18.02.2019 KVO tashmë pa kompetencat e KVO nxjerrë procesverbalin për ofertat e kualifikuara ku rezulton vetëm “M.” ltd.

- Me shkresën nr. 2359/6 prot., datë 18.02.2019 KVO harton procesverbalin sipas standardeve për ngarkim në sistemin elektronik të prokurimit.

Pra e gjithë kjo etapë, pranimit të ankesës, ngarkimi i personit përgjegjës, vlerësimi i saj, skualifikimi

i OE I. SHPK, rivlerësimi hartimi i procesverbaleve është bërë me datë 18.02.2019.

- Vetë elementi shqyrtim ankese kërkon një përgjegjësi të madhe pasi i ndryshon rrjedhën ngjarjeve duke cenuar interesat e palëve.

Nga auditimi i dokumentacioni teknik në SEP dhe verifikimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik të kualifikuar dhe skualifikuar u konstatua se:

Operatori ekonomik i kualifikuar shpallur fitues dhe lidhur kontratë “M.” ltd nuk plotëson kriteret e më poshtme:

Ky operator ekonomik ka marrë pjesë si BO Sipas marrveshjes nr. 256 rep. 131 kol datë 24.01.2019 midis operatoreve M. ltd SHPK dhe A. SHPK ndarë me përqindje 57 % M. ltd dhe 43 % A. SHPK.

Në referencë të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” të ndryshuar, neni 74 bashkimi i operatorëve duhet t’i plotësoj kriteret e vendosura në DST si më poshtë:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës **dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës.** Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit /furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, **kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.**

3. **Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit.**

Neni 45

- Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Sipas marrveshjes nr. 256 rep. 131 kol datë 24.01.2019 midis operatoreve M. ltd SHPK dhe A. SHPK ndare me përqindje **57% M. ltd dhe 43%A. SHPK.**

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

6. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Sipas DST

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.2 Punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të realizuar (**Përvoja të mëparshme**)

Për përmbushjen e këtij kriteri në reference të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; nr.797, datë 29.12.2017; nr.80, datë 14.2.2018) neni 74 pika 3 duhet ta përmbushi anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.

Për plotësimin e këtij kriteri BO ekonomik fitues me përfaqësues “M. ltd” si lider ka paraqitur si punë të ngjashme kontratën me OSHEE SHA “Rikonstruksion kabinash elektrike dhe ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC, linjë TM, Qyteti Selenicë”. Ku operatori ekonomik “M. Ltd”

sipas kontratës së bashkëpunimit 997 rep 977 kol datë 22.05.2017 lidhur para noterit publik Alket B. Skendaj merr përsipër të kryej 57% të kontratës ku në paragrafin 3 të faqes 2 nga noteri publik I cili në kë rast merr autoritetin e KVO cilësohet, “Shoqëria ‘M. ltd’ SHPK si operator i specializuar në fushën e furnizimeve përfshirë këtu eksperiencat e mëparshme të ngjashme të realizuara me sukses të pasqyruara dhe në xhiron e shoqërisë, stafi I reduktuar dhe mungesa e licencave profesionale përkatëse e bën operatorin të kualifikohet vetëm për pjesën e furnizimit ndaj shoqëria M. ltd SHPK merr përsipër furnizimin e pajisjeve ...”

Me këtë kontrata bashkëpunimi dhe situacionet bashkangjitur KVO e ka kualifikuar këtë operator ekonomik duke e konsideruar si punë të ngjashme.

Praktikisht jemi në dy situata krejt të ndryshme, ndaj dhe ligjvënësi ka hartuar dhe miratuar dy tipe të ndryshme DST, atë për **blerje mallrash** dhe atë **për punë**, praktikisht operatori ekonomik apo BO në cilësinë e liderit “M. ltd” dhe në reference të VKM 914 datë , datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 74 pika 3 punën e ngjashme e kërkon nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim, pra nga ‘Muhoplus ltd’ që praktikisht pikën 2.3 të kapacitetit teknik nuk e disponon (punë të ngjashme) nuk kërkohet furnizime të ngjashme por punë të ngjashme.

Gjithashtu dhe kontrata për punë të ngjashme nga anëtari tjetër i bashkimit të operatorëve nuk e përmbush këtë kriter.

Për sa i përket pikës 2.3.2 Kapaciteti teknik dhe profesional

-Anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim nuk zotëron certifikatë si më poshtë:

ISO 9001-2008 për menaxhimin e cilësisë

ISO 14001-2004 për menaxhimin e mjedisit

OHSAS 18001-2007 për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë

ISO 50001-2011 Për sistemin e menaxhimit të energjisë

Këto çertifikime duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, operatori ekonomik këto çertifikimi I ka në fushën e furnizimit.

-d) Operatori ekonomik duhet te paraqesi nje deshmi nga administrate tatimore (Drejoria Rajonale e Tatim Taksave) per punesimin mesatar jo me pak se 20 punonjesish per periudhen Janar 2018 – Nentor 2018, ku perfshihen edhe stafi menaxherial i drejtuesve teknik.

Për përmbushjen e këtij kriteri në reference të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; nr.797, datë 29.12.2017; nr.80, datë 14.2.2018) neni 74 pika 3 duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi i operatorëve sipas %, “Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”

Nga sa më sipër operatori lider duhet të ketë një fuqi punëtore mesatare prej 57 % x 20 (persona) = 11 punonjës dhe 9 punonjës duhet ti disponoj operatori tjetër i BOE “A.” SHPK.

Fuqia mesatare për operatorin ekonomik “M. ltd” sipas listë pagesave është 8 punonjës pra 3 punonjës më pak se detyrimi ligjorë minimal për kualifikim.

3. Konkluzion:

Pra për sa më sipër kualifikimi me mangësitë e sipërcituara ngarkon me përgjegjësi KVO për kualifikimin e këtij operatori me procesverbalin nr. 2359/4 prot., datë 08.02.2019 dhe për skualifikimin e operatorit ekonomik “I. SHPK” me pretendimin e punëve të ngjashme, (kërkohen punë të ngjashme jo të njëjta) ngarkon me përgjegjësi titullarin e AK z. A. Q. duke sjellë si pasojë **një efekt financiarë negativ për shoqërinë në vlerën 3,288,787 lekë.**

Veprime në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik nr. 9643 LIGJI Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/2014 dhe Ligjin Nr. 47/2017, Ligjin Nr.103/2018. Neni 46 pika 1 dhe neni 53 pika 3 si dhe

me Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; nr.797, datë 29.12.2017; nr.80, datë 14.2.2018) neni 74 pika 3.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Z. A. Q. me detyrë, titullar i Autoritetit Kontraktor në cilësinë e anëtarit të shqyrtimit të ankesës
- 2) Z. G. D. me detyrë, shëf dege teknike në cilësinë e kryetarit të KVO
- 3) Zj. A. B. me detyrë specialiste në cilësinë e anëtarit të KVO
- 4) Z. M. H. me detyrë specialiste në cilësinë e anëtarit të KVO

Titulli i gjetjes: Kualifikim i padrejtë

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Spostimi i fiderave në N/Stacionin 110/35/10 Korçë” me fond limit 18,843,813 lekë, nga ana e KVO është kualifikuar BO ekonomik “M. ltd dhe A. SHPK” në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe dokumentat e tenderit të hartuar sipas DST të miratuar.

Kriteri: *Ligjin e prokurimit publik nr. 9643 LIGJI Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/201., Neni 46 pika 1 dhe neni 53 pika 3 si dhe me Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; neni 74 pika 3, 3 si dhe Dokumentet standarde të tenderit Pika 2.3*

Ndikimi: Mundësia e punimeve jo cilësore

Shkaku: Interpretim i gabuar i ligjit

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: OSHEE SHA të marri masa që në të ardhmen të kryej vlerësim sa më objektiv duke ruajtur paanshmërinë në procedurat që vlerësohet qofshin ato me ofertë më të ulët apo më të lartë. Pasja në vëmendje plotësimin e të gjitha kriterëve për kualifikim në respekt të frymës së ligjit.

Titulli i gjetjes: Efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Spostimi i fiderave në N/Stacionin 110/35/10 Korçë” me fond limit 18,843,813 lek, nga ana e KVO është kualifikuar BO ekonomik “M. ltd dhe A. SHPK” dhe “I. SHPK& A.”. Pas paraqitjes së akësës së pa drejt nga ana e BOE “M. ltd dhe A. SHPK” dhe provokimin e një situatë konfuze në këtë autoritet kontraktor të vogël në staf, titullari i AK shqyrton padrejtësiht ankesën dhe i jep të drejt ankuesit pa qenë specialist fushe duke mundësuar kushtet e një efekti financiar negativ për buxhetin e shoqërisë në vlerën **3,288,787 lekë**.

Kriteri: *Ligjin e prokurimit publik nr. 9643 LIGJI Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/201., Neni 46 pika 1 dhe neni 53 pika 3 si dhe me Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; kreu X neni 78 , neni 74 pika 3, si dhe Dokumentet standarde të tenderit, pika 2.3*

Ndikimi: Mungesa e stafit

Shkaku: Interpretim i gabuar i ligjit
Rëndësia: E lartë.
Rekomandimi: OSHEE SHA të marri masa në trajnimin e vazhdueshëm të stafit drejtues dhe teknik të saj, me qëllim eliminimin e rasteve të ngjashme si dhe përdorimin sa më me efikasitet të fondeve të shoqërisë.

Zbatimi i kontratës.

1-Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit në investimin “Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC në zonën e Peqinit” me operatorë fitues dhe zbatues të punimeve “B.” SHPK, nga verifikimet në terren i grupit të auditimit në prezencë të ing. të drejtorisë Elbasan L. R. pasi u morën në analizë zërat e mëposhtëm; Qafore abonenti dhe linje, tirantues linje, shtresë monolite betoni C 16/20 së bashku me transport etj., u konstatuan disa zëra punimesh të cilat nuk janë në cilësinë dhe sasinë e prokuruar, ndërkohë që në situacionin përfundimtar janë deklaruar të realizuara dhe shlyer nga autoriteti kontraktorë.

Strukturë monolite betoni C 16/20

Ky zë punimesh nuk është kryer në sasinë e ofertuar, situacionuar dhe likuiduar, nga matjet faktike struktura e betonit e dukshme paraqitet mesatarisht nga 65x65 deri në maksimalisht 70x70 në një thellsi grope prej 1.7 metra maksimalisht në kushte ideale të ngjarjes $0.7m \times 0.7 \times 1.7 = 0.83 m^3$ për shtyllë duke i zbritur $0.1 m^3$ që zen volumi i shtyllës 9/6kn mbetet $0.73 m^3$ për shtyllë nga 1.15 që situacionohet dhe paguhet për shtyllat 9/6kn dhe nga 1.95 që situacionohet dhe paguhet për shtyllat 9/15 kn. Gjithashtu nga mos vendosje e volumit të betonit të plot edhe transporti i dheut me makin nuk është i njëjtë pasi një pjesë është përdorur për mbushjen e gropës së shtyllës, ndërkohë të paraqitur nga operatori ekonomik “B.” SHPK si zbatues punimesh paraqitet i plotë në sasi, si dhe të pranuar dhe nënshkruar nga mbikqyrësi i punimeve A. P. me nr. Lic MK. 2674 i emëruar me shkresën nr. 1738 prot datë 11.07.2017 nga titullari i autoritetit kontraktorë.

Nga verifikimi në kabinën Pajovë qendër dhe përllogaritjet janë vendosur 42 shtylla 9/6kn (ku ka dhe rivendosje shtyllash ekzistuese) dhe 8 shtylla 9/15kn për të cilat është situacionuar $66.5 m^3$ beton gjithsej sipas standardit.

Nga verifikimi dhe përllogaritjet për shtyllat 9/6 operatori ekonomik B. SHPK ka vendosur $42 \times 0.75 m^3 = 31.5 m^3$ beton gjithsej dhe për shtyllat 9/15kn $266 \times 1.5 m^3 = 12 m^3$ beton gjithsej pra në total janë vendosur $43.5 m^3$ nga $66.5 m^3$ beton të situacionuar ose e **përkthyer në përfitim të pa drejt dëm ekonomik $23m^3 \times 7,406 \text{ lek} = 170,338 \text{ lek}$.**

Për nënshkrimin dhe vulosjen e situacioneve përfundimtarë me mangësi në realizimin në terren në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit i ndryshuar, neni 7 dhe 12, si dhe Udhëzimit nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikqyrjen e punimeve të ndërtimit” mban përgjegjësi ing. A. P. në cilësinë e mbikqyrësit të punimeve me lic. MK.3049.

Titulli i gjetjes: Përfitim i padrejtë

Situata: Nga auditimi i zbatimit të kontratës të punimeve për procedurë e prokurimit me objekt Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC në zonën e Peqinit” me fond limit 156,150,918 lek, me operatorë fitues dhe zbatues të punimeve “B.” SHPK, nga verifikimet në terren i grupit të auditimit në prezencë të ing. të drejtorisë Elbasan L. R. pasi u morën në analizë zërat e mëposhtëm: qafore abonenti dhe linje, tirantues linje, shtresë monolite betoni C 16/20 së bashku me transport etj., u konstatua se zëri **shtresë monolite betoni C 16/20** nuk është në cilësinë dhe sasinë e prokuruar duke e likuiduar padrejtësisht në sasinë totale me një diferenc nga realizimi faktik prej **170,338 lek e cila konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet dëmshpërblehet nga përfituesi.**

Kriteri: Ligjin nr.8402, date 10.9.1998 për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit i ndryshuar, neni 7 dhe 12, si dhe udhëzimit nr. 3 datë

15.02.2001 "Për mbikqyrjen e punimeve të ndërtimit" kontrata nr. 1773
prot datë 13.07.2017.

Ndikimi: Punime jo cilësore
Shkaku: Pamundësi monitorimi të plot
Rëndësia: E lartë.
Rekomandimi: OSHEE SHA të marri masa që t'i kërkojë kontraktorit "B. SHPK", duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës **170,338** lekë, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.
OSHEE SHA, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për verifikimin e të gjitha kabinave të kontratës dhe të informoj KLSH për sasishtë dhe cilësitë e punimeve të kryera.

Pretendimet e subjektit

Në lidhje me projekt raportin e auditimit subjekti OSHEE SHA ka paraqitur objeksionet e saj me shkresën nr. 12149/35 prot., datë 22.12.2020, si dhe 12149/34 prot., datë 22.12.2020, administruar nga grupi i auditimit më 28.12.2020 me pretendimet e saj si më poshtë:

Sic u cilësua dhe më lart, ky objekt ka 50 kabina dhe jo vetëm një kabin që është inspektuar.

- Nuk jemi dakort me pretendimin për sasishtë e betonit , në totalin e objektit betoni është sipas situacionit përfundimtarë.

Strukturë monolite betoni C 16/20

Struktura monolite betoni C16/20 në analizën tuaj i referohet pjesës së dukshme të betonit e cila rezulton me dimensione 0.65x0.65 dhe 0.7x0.7 me thellësi 1.7m. Faktikisht thellësia e montimit të shtyllave referuar projektit dhe specifikimeve teknike të OSHEE SHA varion nga 1.6-2m në varësi të shtyllës dhe kategorisë së dheut. Ndërsa pjesa sipër është pjesa estetike të betonuar në sipërfaqe të tokës e cila për arsye mos pengimi të rrugës apo arsye të tjera caktuar nga projektuesi 0.6x0.6 me dimensione më të vogla se pjesa e bazamentit në thellësi. (Skica sipas specifikimeve teknike faqe 20-22). Teknikisht betoni i shtyllës kryhet me dy faza ku pjesa e poshtme në projekt tonë është me dimensione 0.9x0.9x1.6m për shtyllat 9/6kn dhe 1.1x1.1 për shtylla 9/15...

Nisur nga sa më sipër gjykojnë se vlera prej 4,354,728 lekë e vlerësuar nga grupi dëm ekonomik nuk përbën dëm ekonomik...

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër grupi i auditimit shprehet se, -Për sa i përket kabinave që ju cilësoni janë 50 dhe jo 1, kjo është e vërtet dhe është marrë në konsideratë në hartimin e Raportit përfundimtar të auditimit, ndërsa për sa i përket llogaritjeve dhe pretendimeve tuaja që grupi i auditimit ka llogaritur vetëm konturin e betonit apo anën estetike, kjo nuk merret në konsideratë, pasi nga ana jonë jemi referuar në disa nga shtyllat të cilat gjendeshin në terrene të pjerrëta, ku erozioni kishte bërë të mundur, verifikimin e saktë të betonit. Gjithashtu për këtë element nga ana juaj nuk është sjellë ndonjë provë apo fakt shtesë bindës, vetëm argumentim teknik. Ky argumentim në thelb qëndron dhe në teori gjithashtu por jo në terren. Gjithashtu nga ana Juaj nuk u sollën prova të reja dokumentuese si (fotot) e mbushjes së gropës me beton gjatë punës në terren si mbikëqyrëse dhe vërtetimin e faktit të pretenduar. Sa më sipër pretendimi nuk merret në konsideratë.

Zbatimi i kontratës:

2-Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit në objekt "Ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC për 26 kabina Elbasan-Cërrik" me vlerë të preventivuar 106,963,866 lek me operatorë fitues dhe zbatues të punimeve "E." SHPK, nga verifikimet në terren i grupit të auditimit në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve z. A. H. me lic. MK.3049 dhe inxhinierit të drejtorisë Elbasan L. R. pasi u morën në analizë zërat e mëposhtëm: Qafore abonenti dhe linje, tirantues linje, shtresë monolite betoni C 16/20 së bashku me transport etj., u konstatuan disa zëra punimesh të cilat nuk janë në cilësinë dhe sasinë e prokuruar, ndërkohë që në situacionin përfundimtar janë deklaruar të realizuara dhe shlyer nga autoriteti kontraktor.

F.V Aksesori shtyllë (qafore) abonenti D=150, 220 mm dhe linje D =150, 220:

Ky aksesori nuk është vendosur në sasinë e ofertuar dhe situacionuar në Kabinën e inspektuar në terren edhe pse situacioni përfundimtarë të paraqitur nga operatori ekonomik "E." SHPK si zbatues punimesh paraqitet i plotë në sasi, si dhe të pranuar dhe nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve A. H. me nr. Licence MK. 3046 i emëruar me shkresën nr. 63 prot., datë 11.01.2019 nga titullari i autoritetit kontraktorë.

Ky zë i kontratës për kabinën objekt verifikimi është situacionuar me një diferencë prej 12 qafore më shumë se FV në terren duke sjellë si pasojë **dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë në vlerën 15,000 lek (12 x 1,250 = 15,000)**, nga 59 qafore abonenti janë vendosur 47, 12 nuk janë vendosur por situacionuar dhe paguar nga OSHEE SHA.

Strukturë monolite betoni C 16/20

Ky zë punimesh nuk është kryer në sasinë e ofertuar, situacionuar dhe likuiduar, nga matjet faktike struktura e betonit e dukshme paraqitet mesatarisht nga 65x65 deri në maksimalisht 70x70 në një thellësi grope prej 1.7 metra maksimalisht në kushte ideale të ngjarjes $0.7m \times 0.7 \times 1.7 = 0.83 m^3$ për shtyllë duke i zbritur $0.1 m^3$ që zen volumi i shtyllës 9/6kn mbetet $0.73 m^3$ për shtyllë nga 1.15 që situacionohet dhe paguhet për shtyllat 9/6kn dhe nga 2.5 që situacionohet dhe paguhet për shtyllat 9/15 kn. Gjithashtu nga mos vendosje e volumit të betonit të plot edhe transporti i dheut me makinë nuk është i njëjtë pasi një pjesë është përdorur për mbushjen e gropës së shtyllës, ndërkohë të paraqitur nga operatori ekonomik "E." SHPK si zbatues punimesh paraqitet i plotë në sasi, si dhe të pranuar dhe nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve A. H. me nr. Licencë MK. 3046 i emëruar me shkresën nr. 63 prot., datë 11.01.2019 nga titullari i autoritetit kontraktor.

Nga verifikimi dhe përlogaritjet janë vendosur 383 shtylla 9/6kn dhe 226 shtylla 9/15kn për të cilat është situacionuar $61.51 m^3$ beton për shtyllat 9/6kn dhe 9/15kn sipas standardit, për kabinën e verifikuar në terren.

Nga verifikimi dhe përlogaritjet për shtyllat 9/6 operatori ekonomik E. SHPK ka vendosur $26 \times 0.75 m^3 = 19.5 m^3$ beton gjithsej dhe për shtyllat 9/15kn $12 \times 1.5 m^3 = 18 m^3$ beton gjithsej pra në total janë vendosur $37.5 m^3$ nga $61.51 m^3$ sipas standardit ose **e përkthyer në përfitim të pa drejt dëm ekonomik $24 m^3 \times 7,500$ lekë = 180,075 lekë.**

F.V Kabull Cu 4x10mm me izolacion PVC 0.6/1 kv abonenti Kabina Kuqan 4

Nga verifikimi në terren i këtij zëri u konstato se janë vendosur vetëm 600 ml kabull nga 1,020ml që është situacionuar pranuar dhe likuiduar nga ana e OSHEE SHA.

Ky zë i kontratës është situacionuar me më shumë se FV në terren duke sjellë si pasojë **dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë në vlerën 504,000 lekë**, nga 1020 kabull CU 4x10 mm janë vendosur 600 ml x 1,200 lekë = 504,000 lekë.

Për nënshkrimin dhe vulosjen e situacioneve përfundimtarë me mangësi në realizimin në terren në kundërshtim me ligjin nr.8402, date 10.9.1998 për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit i ndryshuar, neni 7 dhe 12, si dhe udhëzimit nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit" mban përgjegjësi ing. A. H. në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve me licencë MK.3049.

Titulli i gjetjes: Përfitim i padrejtë

Situata:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës të punimeve për procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC për 26 kabina Elbasan-Cërrik" me vlerë të preventivuar 106,963,866 lek" dhe zbatues të punimeve "E." SHPK, nga verifikimet në terren i grupit të auditimit në prezencë të ing. të drejtorisë Elbasan L. R. pasi u morën në analizë zërat e mëposhtëm: qafore abonenti dhe linje, tirantues linje, shtresë monolite betoni C 16/20 së bashku me transport etj., u konstatua disa zëra punimesh jo në përputhje me sasinë e kontraktuar. Vlera e përfituar padrejtësisht për punime të pa kryera është **699,075 lekë e cila konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet dëmshpërblehet nga përfituesi.**

Kriteri:

Ligjin nr.8402, date 10.9.1998 për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të

*ndertimit i ndryshuar, neni 7 dhe 12, si dhe udhëzimit nr. 3 datë 15.02.2001
“Për mbikqyrjen e punimeve të ndërtimit” kontrata nr. 9/7 datë 08.01.2019.*

Ndikimi: Punime jo cilësore
Shkaku: Pamundësi monitorimi të plot
Rëndësia: E lartë.
Rekomandimi: OSHEE SHA të marri masa që t’i kërkojë kontraktorit “E. SHPK”, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **699,075** lekë, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.
OSHEE SHA, Drejtoria rajonale Elbasan të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për verifikimin e të gjitha kabinave të kontratës dhe të informoj KLSH për sasinë dhe cilësitë e punimeve të kryera.

Zbatimi i kontratës:

3-Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit në investimin **“Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC në njësinë Lushnje”** me operatorë fitues dhe zbatues të punimeve “V.K &R” SHPK, nga verifikimet në terren i grupit të auditimit në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve z. G.r Kamberi dhe administratorin e kontratës E. H. pasi u morën në analizë zërat e më poshtëm: qafore abonenti dhe linje, tirantues linje, shtresë monolite betoni C 16/20 së bashku me transport etj., u konstatuan disa zëra punimesh të cilat nuk janë në cilësinë dhe sasinë e prokuruar, ndërkohë që në situacionin përfundimtar janë deklaruar të realizuara dhe shlyer nga autoriteti kontraktorë.

F.V Aksesori shtyllë (qafore) abonenti D=150, 220 mm dhe linje D =150, 220:

Ky aksesori nuk është vendosur në sasinë e ofertuar dhe situacionuar në asnjë nga zonat e zbatimit të kontratës edhe pse në çdo situacion përfundimtarë të paraqitur nga operatori ekonomik “V. K.” SHPK si zbatues punimesh paraqitet i plotë në sasi, si dhe të pranuar dhe nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve G. K..

Ky zë i kontratës për kabinën objekt verifikimi është situacionuar me një diferencë prej 22 qafore më shumë se FV në terren duke sjellë si pasojë **dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë në vlerën 15,000 lek (22 x 1,250 = 27,500)**, 22 nuk janë vendosur por situacionuar dhe paguar nga OSHEE SHA.

F.V Kabull koaksial TU CU 2x6 mm2 (dhe pjeset përbërse)

Nga verifikimi në terren u konstatua se në segmentin e audituar janë lidhur në rrjet 45 abonenti për të cilat nga rregulloret teknike të miratuara duhet të furnizohen me 45 x 50ml kabull koaksial = 2,250 ml ndërkohë që ky zë është situacionuar 2600 ml pra 10 % më shumë. Ky zë i kontratës për kabinën objekt verifikimi është situacionuar me një diferencë prej 350 ml më shumë se FV në terren duke sjellë si pasojë **dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë në vlerën 115,500 lekë (350 x 330 = 115,500 lekë)**, 350 ml nuk janë vendosur por situacionuar dhe paguar nga OSHEE SHA.

- Fv tirantues abonenti 132 cop (një abonent ka nevojë për 2 të tillë) 50 x 2 = 100 tirantues janë situacionuar 25% më tepër. Ky zë i kontratës për kabinën objekt verifikimi është situacionuar me një diferencë prej 32 tirantues më shumë se FV në terren duke sjellë si pasojë **dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë në vlerën 28,800 lekë (32 x 900 = 27,500)**, 32 nuk janë vendosur por situacionuar dhe paguar nga OSHEE SHA.

Strukturë monolite betoni C 16/20

Ky zë punimesh nuk është kryer në sasinë e ofertuar, situacionuar dhe likuiduar, nga matjet faktike struktura e betonit e dukshme paraqitet mesatarisht nga 65x65 deri në maksimalisht 70x70 në një thellsi grope prej 1.6m për shtullat 9/6kn dhe 2m për shtyllat 9/15kn, maksimalisht në kushte ideale të ngjarjes 0.7m x 0.7 x 1.7 = 0.784 m³ për shtyllë duke i zbritur 0.1 m³ që zë volumi i shtyllës 9/6kn mbetet 0.68 m³ për shtyllë nga 1.19 që situacionohet dhe paguhet për shtyllat 9/6kn dhe nga 2.22m³ që situacionohet dhe paguhet për shtyllat 9/15 kn vendoset 0.8 x 0.8 x 2=1.28 m³ beton. Gjithashtu nga mos vendosje e volumit të betonit të plot edhe transporti i dheut me makinë nuk është i njëjtë pasi një pjesë është përdorur për mbushje gropeve së shtyllës, ndërkohë të paraqitur nga

operatori ekonomik "V. K." SHPK si zbatues punimesh paraqitet i plotë në sasi, si dhe të pranuar dhe nënshkruar nga mbikqyrësi i punimeve G. K..

Nga verifikimi i kabinës Senez në terren dhe përlllogaritjet janë vendosur 45 shtylla 9/6kn dhe 18 shtylla 9/15kn për të cilat është situacionuar 53.5 m³ beton për shtyllat 9/6kn sipas standardit dhe 40.1 m³ beton për shtyllat 9/15kn sipas standardit.

Nga verifikimi dhe përlllogaritjet për shtyllat 9/6 operatori ekonomik ka vendosur 45 x 0.68 m³ = 30.6 m³ beton gjithsej dhe për shtyllat 9/15kn 18 x 1.28 m³ = 23 m³ beton gjithsej pra në total janë vendosur 53.6 m³ nga 93.6 m³ sipa standardit ose **e përkthyer në përfitim të pa drejt dëm ekonomik 40 m³ x 7,000 lekë = 280,000 lekë.**

Për nënshkrimin dhe vulosjen e situacioneve përfundimtarë me mangësi në realizimin në terren në kundërshtim me ligjin nr.8402, date 10.9.1998 për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit i ndryshuar, neni 7 dhe 12, si dhe Udhëzimit nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikqyrjen e punimeve të ndërtimit" mban përgjegjësi ing . G. K..

Titulli i gjetjes: Përfitim i padrejtë

Situata: Nga auditimi i zbatimit të kontratës të punimeve për procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC në njësinë Lushnje" me zbatues të punimeve "V. K." SHPK, nga verifikimet në terren i grupit të auditimit në prezencë të ing. Mbikqyrës G. K. pasi u morën në analizë zërat e mëposhtëm: qafore abonenti dhe linje, tirantues linje, shtresë monolite betoni C 16/20 së bashku me transport etj., u konstatua disa zëra punimesh jo në përputhje me sasinë e kontraktuar. Vlera e përfituar padrejtësisht për punime të pa kryera është **450,500 lekë e cila konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet dëmshpërblehet nga përfituesi.**

Kriteri: *Ligjin nr.8402, date 10.9.1998 për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit i ndryshuar, neni 7 dhe 12, si dhe udhëzimit nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikqyrjen e punimeve të ndërtimit" kontrata nr.21214/9 datë 18.01.2018.*

Ndikimi: Punime jo sasinë dhe cilësinë e kërkuar

Shkaku: Pamundësi monitorimi të plot

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: OSHEE SHA të marrë masa që t'i kërkojë kontraktorit "JV V. K. & R. SHPK", duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës **450,500 lekë**, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.
OSHEE SHA, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për verifikimin e të gjitha kabinave të kontratës dhe të informoj KLSH për sasinë dhe cilësinë e punimeve të kryera.

4-Zbatim kontrate nr. 1822/9 datë 10.05.2018 me objekt "Ndërtim i dy fiderave të rinj 20kv, F-9, 20kv-Karbanar dhe Fideri 10,20KV, drejtim spitalit Lushnje n/st Plasmasi 110/20/6 KV, kalimi nga 6KV në 20 Kv I kabinave të fiderave 6KV (Puntoria), lidhur me Autoritetin Kontraktor OSHEE SHA dhe Kontraktuesin "A." SHPK.

Me shkresën date 13.06.2018 OE "A." SHPK i kërkon mbikqyrësit të punimeve zj. A. Xh. dhe Administratorit të kontratës z. T. Sh. për tërheqjen e bazës materiale.

Nga verifikimi në terren së bashku me përfaqësuesit e Autoriteti Kontraktor u konstatua se: në përgjithësi punimet kanë respektuar standardet e kërkuara si në anën cilësore ashtu dhe atë sasiore.

Nga verifikimi në terren u konstatua mangësi në tokëzimin përsëritjen e neutrit dhe aksesoret e tij ku nga ana e OE "A." SHPK është aplikuar vendosje e tokëzimit vetëm në shtyllën fillestare të kabinës ndërkohë që sipas projektit të miratuar tokëzimi parashikohet dhe në shtyllat fundore të daljeve sipas gjatësisë së linjës.

Në dy kabina që u verifikuan u konstatua mangësi e vendosjes së tokëzimit në shtyllat fundore, por

që janë situacionuar dhe paguar si të plota në një vlerë prej 18,276 lekë më tepër.

OE ekonomik ka tërhequr sasi të e mallrave si më poshtë, por ka vendosur vetëm një pjesë të tyre:

Titulli i gjetjes: Përfitim i padrejtë

Situata: Nga auditimi i zbatimit të kontratës të punimeve për procedurë e prokurimit me objekt “Ndërtim i dy fiderave të rinj 20kv, F-9, 20kv-Karburnar dhe Fideri 10,20KV, drejtim spitalit Lushnje n/st Plasmasi 110/20/6 KV, kalimi nga 6KV në 20 Kv i kabinave të fiderave 6KV (Puntoria), lidhur me Autoritetin Kontraktor OSHEE SHA dhe Kontraktuesin “A.” SHPK., nga verifikimet në terren i grupit të auditimit në prezencë të ing. Mbikqyrës G. K. u konstatua se zëri i punimeve tokëzues linje dhe elementët e tij nuk është në përputhje me sasi të e kontraktuara. Vlera e përfituar padrejtësisht për punime të pa kryera është **18,276 lekë e cila konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet dëmshpërblehet nga përfituesi.**

Kriteri: *Ligjin nr.8402, date 10.9.1998 per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit i ndryshuar, neni 7 dhe 12, si dhe udhezimit nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikqyrjen e punimeve të ndërtimit” kontrata nr. 1822/9 datë 10.05.2018*

Ndikimi: Punime jo sasinë dhe cilësinë e kërkuar

Shkaku: Pamundësi monitorimi të plot

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: OSHEE SHA të marrë masa që t’i kërkojë kontraktorit “A.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **18,276 lekë**, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.

Pretendimet e subjektit

Në lidhje me projekt raportin subjekti OSHEE SHA ka paraqitur objeksionet e saj me shkresën nr. 12149/33 prot., date 22.12.2020 administruar nga grupi i auditimit më 28.12.2020 me pretendimet e saj si më poshtë;

- Nga auditimi i investimit “Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC në njësinë Lushnje” në terren i grupit të auditimit ka rezultuar se për kabinën Senez e re janë konstatuar mangësitë në:

Strukturë monolite betoni C 16/20

Struktura monolite betoni C16/20 në analizën tuaj i referohet pjesës së dukshme të betonit e cila rezulton me dimensione 0.65x0.65 dhe 0.7x0.7 me thellësi 1.7m. Faktikisht thellësia e montimit të shtyllave referuar projektit dhe specifikimeve teknike të OSHEE SHA varion nga 1.6-2m në varësi të shtyllës dhe kategorisë së dheut. Ndërsa pjesa sipër është me dimensione më të vogla se pjesa e bazamentit në thellësi. (Skica sipas specifikimeve teknike faqe 21). Teknikisht betoni i shtyllës kryhet me dy faza ku pjesa e poshtme në projektin tone është me dimensione 0.9x0.9x1.6m për shtyllat 9/6kn...

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër grupi i auditimit shprehet se, është e vërtetë që nga ana jonë është inspektuar vetëm kabina Senez (të cilën nuk e përcaktuam ne por ju) dhe për sa i përket verifikimit në terren të asaj kabine nuk merret në konsideratë asgjë, për arsye se: çdo kabinë ka situacionin e saj dhe mbikqyrësi mban përgjegjësi për çka nënshkruan dhe jeni ju që certifikoni zërat e punimeve në cilësinë dhe sasinë e likuiduar.

- Së dyti për kabulli koaksial, grupi i auditimi është nisur në numër abonentësh jo numërim metra linear pasi ka dhe objekte poshtë shtylle ku nuk nevojit me shumë se 25 ml, dhe në asnjë rast OSHEE SHA nuk vendos më shumë se 50ml për abonentë pa pagesë shtesë sipas vendimeve të ERE.

- Së treti për sa i përket pretendimit se ka diferenca midis projektit dhe terrenit është e vërtetë se ka por nga inspektimi i asaj kabine u vu re se nga ana Juaj nuk është marrë asnjë masë për ndryshime dhe përmirësime në projekt por janë vendosur 3 shtylla 9/6 së bashku me kabullin ABC 4x25 pa

asnjë abonent (pa funksion) fakt që e rrëzon pretendimin tuaj për lidhjen e të gjithë abonentëve është shpenzuar më shumë kabull se projekti.

- Për sa i përket strukturës së betonin po e vërtet që në faqen 21 të specifikimeve teknike ndodhet ajo paraqitje grafike e mbushjes së gropës së shtyllës por në rastin konkret në këtë kabinë nuk qëndron pasi disa nga shtyllat paraqiten me beton të çarë çka tregon se thellësia apo gjerësia e pretenduar nga Ju nuk është zbatuar në fakt.

Pretendimet e subjektit

-Nga auditimi i investimit “Ndërtim i dy fiderave të rinj 20kv, F-9, 20kv-Karbunar dhe Fideri 10,20KV, drejtim spitalit Lushnje n/st Plasmasi 110/20/6 KV, kalimi nga 6KV në 20 Kv i kabinave të fiderave 6KV (Puntoria) në terren i grupit të auditimit ka rezultuar se:

Bazuar ne verifikimin tuaj, Së pari: Inspektimi është kryer vetëm në këto dy kabina ku keni konstatuar mangësi në vendosjen e tokëzimit në shtyllat fundore; Së dyti nuk mund të qëndrojë prezumimi i mungesës së instalimit të materialit tokëzues, i shumëfishuar për 60 shkëputës tokëzimi, për të cilët ju nuk keni bere inspektimin përkatës në terren. Se treti, për arsye se në tabelën kalkuluese keni llogaritur tokëzim etj., për 4 daljet, që i takojnë këtyre dy kabinave po për 60 dalje, ku vlera për 4 daljet e tokëzimeve për këto dy kabina është 18,276 lekë, ndërkohë që vlera e llogaritur nga ana juaj është 274,130 Leke,.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Është e vërtet se nga ana jonë janë verifikuar vetëm 2 kabina në prezencën tuaj, dhe si rrjedhojë është reflektuar në hartimin e Raportit përfundimtar të auditimit.

2.8. Mbi zbatimin rregullave dhe procedurave të shitje-blerjes të energjisë elektrike

Gjatë auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Kontrata e shit-blerjes mes KESH SHA dhe OSHEE SHA, furnizimi me energjisë sipas kushteve të kontratës e skeduar në fasha orare dhe ngarkesa sipas kërkesës.

- Me zgjedhje kontratat e blerjes së energjisë nga importi për plotësimin e sasi së energjisë për humbjet si dhe realizimi i importit nga operatorët fitues nëpërmjet skedulimit orar sipas kontratës mes palëve bandë apo pik.

- Shitja e energjisë abonentëve filtrimi dhe identifikimi I debitorëve, marrja e informacionit për abonentët debitorë të ndarë në vite dhe rajone (për të pare efektshmërinë e investimeve të kryera).

Në lidhje për kë janë marrë të dhënat nga drejtoria e blerjes së energjisë si nga Furnizuesit e kualifikuar, Hec-et Private dhe me koncesion ashtu dhe nga Importi, gjithashtu nga drejtoria e shitjes janë marrë të dhënat për shitjen e energjisë për të gjithë klientët, si ato familjarë dhe jo familjarë.

Për periudhën objekt auditimi nga ana e OSHEE janë kryer për çdo muaj procedura blerje energjie elektrike **nga importi** për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, këto sasi për periudhën 1.07.2017-31.12.2017 paraqiten në shumën 1,890,358 MWh energji elektrike kjo e blerë në profilin bandë dhe pik sipas nevojës. Për vitin 2018 kjo sasi paraqitet 850,480 MWh dukshëm me e reduktuar si pasojë e rendimentit me te mire nga KESH SHA duke u furnizuar nga ky i fundit për klientët dhe mbulimin e humbjes. Për vitin 2019 sasia e blerjes së energjisë nga importi paraqitet tejet e lartë **2,171,583 MWh** si rezultat i një viti të thatë duke shtuar rritjen e blerjes në import të energjisë elektrike në një treg të pa rregulluar ku çmimi mesatarë për secilin vit paraqitet si vijon; 6 mujori II viti 2017 70.77Euro/MWh, viti 2018 77.4 Euro/MWh, viti 2019 70.89Euro/MWh.

Për 6 mujorin e dytë të vitit 2017 OSHEE SHA ka shpenzuar 133,787,443 euro, për vitin 2018 janë shpenzuar 65,867,193 euro, për vitin 2019 kjo shifër arrin në 153,943,501 euro duke renduar bilancin financiarë të shoqërisë.

Janë audituar procedurat e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes me zgjedhje aktualisht për muajt Nëntor , dhjetor 2017 me një sasi energjie totale energjie prej 688,832 MWh dhe vlerë prej 54,878,054 Euro.

- Për 6 mujorin e dytë 2017 u konstatua se niveli I humbjeve paraqitet tej I çrregullt dhe I pa ekuilibruar duke varjuar nga 20% humbje në muajin shtator në 28% humbje në muajin dhjetor duke treguar se niveli I humbjeve rritet në përputhje me konsumin, çka tregon se humbjet teknike apo ato në rrjet janë shumë të mëdha, në periudhën me fluks të lartë energjetik ngarkesa e rrjetit përtej kapaciteteve sjell rritjen e humbjeve dhe mos eficientë të shoqërisë duke rënduar bilancet ekonomike të saj.

- Për muajin nëntor 2017 janë blerë 298,800 MWh energji dhe janë furnizuar 292, 937 MWh energji me vlerë 22,903,931 euro nga e cila 72,000MWh në bandë profili I furnizimit 24 orë dhe 198,000MWh në pik profile i furnizimit 7:00-22:00 si pasojë e ngarkesës më të madhe në sistemin e furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë.

- Nga auditimi i skedulimeve orare të furnizimit me energji nga operatorët e kontraktuar u konstatua se për ditët nga 22.11.2017 deri më 30.12.2017 në furnizimin në profilin pik në oraret 08:00-10:00 dhe 14:00-21:00 furnitori E. Ag nuk ka furnizuar me energji elektrike sipas kontratës duke cenuar sistemin energjetik dhe vënë në vështirësi OSHEE SHA për sasinë e energjisë prej 5,839MWh për të cilën OSHEE SHA ka hartuar faturën e penalitetit në vlerën prej 10,506 euro.

- Për muajin dhjetor 2017 janë blerë 445,904 MWh energji dhe janë furnizuar 395,895MWh energji me vlerë 31,974,123 euro.

-Gjithashtu nga auditimi i sasive të furnizuar në përputhje me kontratën dhe skedulim e tyre në profilet e kërkuara u konstatua se nga furnitorët nuk respektohen kushtet e kontratës por mbështeten në nenin 5.2 i cili thotë: **Në rast se ndryshojnë programet javore sipas paragrafit më lart**, programet ditore të lëvrimin do të konsiderohen të përmbushura me tolerance ditore maksimale të +/- 10% me profil 24 orësh,

Pra jemi në kushtet e mos respektimit të neneve 1 deri në 4 dhe nenit 5.1 të kushteve të kontratës, si më poshtë neni 1 thotë: Palët bien dakord të shesin dhe lëvrojnë, dhe blejnë dhe pranojnë, energjinë elektrike ..., siç vijon:

neni 3.2 thotë: Blerësi **do të pranoj dhe paguaj** për energjinë elektrike të lëvruar nga shitësi sipas **Nenit 1** të kontratës.

neni 4 specifikon oraret dhe fuqinë sipas kontratës.

6 mujori II viti 2017

- Për muajin nëntor 2017 kompania G. T. për 12 ditë të ndryshme të muajit nuk ka furnizuar me energji në përputhje me kushtet e sipërpërmendura të kontratës por ka furnizuar me një diferencë prej 10% në profilin pik kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës është në sasinë 2700MWh dhe vlerën 182,250euro ndërsa në profilin band në sasinë 864MWh dhe vlerë 57,974 euro. Kjo sasi energjie e pa lëvruar sipas kushteve të kontratës është furnizuar në ditë të tjera të muajit. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e këtij devijimi, është në vlerën **prej (240,224euro x 124euro/lek datë 18.09.2020) = 29,787,776 lek.**

- Për muajin nëntor 2017 kompania E. AG për 2 ditë të ndryshme të muajit nuk ka furnizuar me energji në përputhje me kushtet e sipërpërmendura të kontratës por ka furnizuar me një diferencë prej 10% në profilin pik kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës është në sasinë 466MWh dhe vlerën 18,823euro. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e këtij devijimi, është në vlerën **prej 18,823 euro.** Për këtë kompani është kalkuluar dhe një penalitet në vlerën prej 10,506 euro si rezultat i një sasie prej 5,839 MWh pa furnizuar fare.

- muajin nëntor 2017 kompania G. SHPK për të gjithë muajin nuk ka furnizuar me energji në përputhje me kushtet e sipërpërmendura të kontratës por ka furnizuar me një diferencë prej 10% në profilin pik kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës është 650MWh dhe vlerën 55,575 euro ndërsa në profilin band në sasinë 1032MWh dhe vlerë 58,411 euro. Kjo sasi energjie e pa lëvruar sipas kushteve të kontratës është furnizuar në ditë të tjera të muajit. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e këtij devijimi, është në vlerën **prej 113,986 euro.**

Neni 5.1 thotë: ...Programet **ditore do të përcaktohen mes palëve me anë të programeve javore**, p.sh. çdo të enjte deri në orën 12 :00, programet ditore do të deklarohen dhe përcaktohen për javën

pasardhëse, nga e hëna deri të dielën.

Ne rast se ndryshojnë programet javore për të cilat është rënë dakord, palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën deri në 12:00...

Programi i lëvrimit do të dakordësohet mes palëve me anë të konfirmimeve reciproke.

Titulli i gjetjes: Mos respektimi i kushteve të kontratës

Situata:

Nga auditimi i kontratave të blerjes së energjisë nga importi për vitin 2017 u konstatua se nga ana e furnitorëve të energjisë elektrike për sasinë e energjisë së blerë në import për mbulimin e humbjeve nuk respektohen kushtet e kontratës nenet 1-5 të saj duke operuar sipas mundësisë dhe dëshirës së tyre. Edhe pse në këto kushte ku furnitorët e energjisë furnizojnë pa dakordësi mes palëve në sasi energjie +/- 10% nga fuqia orare e kërkuar nga ana e OSHEE SHA është konsideruar si furnizim i plotë dhe në përputhje me kontratën. Edhe pse në total sasia e furnizuar është e plotë kushtet e furnizimit nga ana e furnitorëve janë në devijime e +/-10% pa u plotësuar kushtet e këtij devijimi. Për vitin 2017 nga muajt e marrë në auditim u konstatua një sasi energjie prej 5,712 MWh e furnizuar me devijim +/-10% me kontratën nga furnitorët G. T. për sasinë 3,564 MWh, G. SHPK për sasinë 1,682 MWh dhe E. AG për sasinë 466MWh. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e këtij devijimi, është në vlerën prej **(373,033euro x 124euro/lek datë 18.09.2020) = 46,256,092 lekë.**

Kriteri:

*Kontrata e shitje-blerjes së energjisë nenet 1-5, specifikisht pika 5.2 e nenit 5 I cili thotë: **Në rast se ndryshojnë programet javore sipas paragrafit më lart, programet ditore të lëvrimit do të konsiderohen të përmbushura me tolerance ditore maksimale të +/- 10% me profil 24 oraresh, ...***

*Pra jemi në kushtet e mos respektimit të neneve 1 deri në 4 dhe nenit 5.1 të kushteve të kontratës, si më poshtë neni i thotë: **Palët bien dakord të shesin dhe lëvrojnë, dhe blejnë dhe pranojnë, energjinë elektrike ..., siç vijon:***

neni 3.2 thotë: Blerësi do të pranojë dhe paguajë për energjinë elektrike të lëvruar nga shitësi sipas Nenit 1 të kontratës.

neni 4 specifikon oraret dhe fuqinë sipas kontratës.

Shkaku:

Mungesë monitorimi dhe evidentimi të zbatimit të kushteve të kontratës.

Rëndësia:

E lartë.

Rekomandimi:

OSHEE SHA të marri masa që në të ardhmen të kryej një monitorim të plotë të sasive të furnizuara dhe respektimit të kushteve të hartuara pranuar dhe nënshkruara nga palët me kontratat respektive me qëllim realizimin e një furnizimi me energji në rritje për përmbushjen e nevojave të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Viti 2018

- Për muajin tetor 2018 kompania G. T. për 3 ditë të ndryshme të muajit nuk ka furnizuar me energji në përputhje me kushtet e sipërpërmendura të kontratës por ka furnizuar me një diferencë pre 10% në profilin pik kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës nr. 19307/26 date 19.10.2018 është në sasinë 672MWh dhe vlerën 50,998 euro ndërsa në kontratën nr. 18327/24 datë 08.10.2018 është në sasinë 432MWh dhe vlerën 33,393 euro profilin band në sasinë 288MWh dhe vlerë 26,668 euro. Kjo sasi energjie e pa lëvruar sipas kushteve të kontratës është furnizuar në ditë të tjera të muajit. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e devijimit, është në vlerën **prej 111,059.**

- Për muajin tetor 2018 kompania G. SHPK për 4 ditë të ndryshme të muajit nuk ka furnizuar me

energji në përputhje me kushtet e sipërpërmendura të kontratës nr. 18327/22 datë 08.10.2018 por ka furnizuar me një diferencë prej 10% në profilin pik kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës është në sasinë 600MWh dhe vlerën 46,500 euro profiling band në sasinë 320MWh dhe vlerë 29,568 euro. Kjo sasi energjie e pa lëvruar sipas kushteve të kontratës është furnizuar në ditë të tjera të muajit. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e devijimit, është në vlerën **prej 76,068 euro**.

- Për muajin nëntor 2018 kompania G.T. për 3 ditë të ndryshme të muajit nuk ka furnizuar me energji në përputhje me kushtet e sipërpërmendura të kontratës por ka furnizuar me një diferencë pre 10% në profilin band kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës është në sasinë 148MWh dhe vlerën 11,233 euro ndërsa Kjo sasi energjie e pa lëvruar sipas kushteve të kontratës është furnizuar në ditë të tjera të muajit. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e devijimit, është në vlerën **prej 11,233 euro**.

-Për muajin nëntor 2018 kompania E. AG për ditë të ndryshme të muajit nuk ka furnizuar me energji në përputhje me kushtet e sipërpërmendura të kontratës por ka furnizuar me një diferencë pre 10% në profilin pik kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës është në sasinë 1020MWh dhe vlerën 88,964 euro ndërsa në profilin band kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës është 768 MWh dhe vlerën 55,941 euro. Kjo sasi energjie e pa lëvruar sipas kushteve të kontratës është furnizuar në ditë të tjera të muajit. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e devijimit, është në vlerën **prej 144,905 euro**.

- Për muajin nëntor 2018 kompania G. SHPK për 6 ditë të ndryshme të muajit nuk ka furnizuar me energji në përputhje me kushtet e sipërpërmendura të kontratës por ka furnizuar me një diferencë prej 10% në profilin band kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës është në sasinë 264Wh dhe vlerën 19,509 euro. Kjo sasi energjie e pa lëvruar sipas kushteve të kontratës është furnizuar në ditë të tjera të muajit. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e devijimit, është në vlerën **prej 19,509 euro**.

- Për muajin nëntor 2018 kompania N. E. për 13 ditë të ndryshme të muajit nuk ka furnizuar me energji në përputhje me kushtet e sipërpërmendura të kontratës por ka furnizuar me një diferencë prej 10% në profilin pik, kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës është në sasinë 503MWh dhe vlerën 5,633 euro. Kjo sasi energjie e pa lëvruar sipas kushteve të kontratës është furnizuar në ditë të tjera të muajit por në profilin bandë me një diferencë çmimi prej 11.2 euro/MWh. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e devijimit, është në vlerën **prej 5,633 euro përbën** dëm ekonomik dhe duhet dëmshpërblehet nga përfituesi.

Çmimi i kontratës në pik 84.85Euro/MWh çmimi i kontratës në band 73.65 euro/MWh, diferenca 84.85-73.65 =11.2 euro.

Titulli i gjetjes: Mos respektimi i kushteve të kontratës

Situata: Nga auditimi i kontratave të blerjes së energjisë nga importi për vitin 2018 u konstatua se nga ana e furnitorëve të energjisë elektrike për sasinë e energjisë së blerë në import për mbulimin e humbjeve nuk respektohen kushtet e kontratës nenet 1-5 të saj duke operuar sipas mundësisë dhe dëshirës së tyre. Edhe pse në këto kushte ku furnitorët e energjisë furnizojnë pa dakordësi mes palëve në sasi energjie +/- 10% nga fuqia orare e kërkuar nga ana e OSHEE SHA është konsideruar si furnizim i plotë dhe në përputhje me kontratën. Edhe pse në total sasia e furnizuar është e plotë kushtet e furnizimit nga ana e furnitorëve nuk janë në përputhje me kontratën. Për vitin 2018 nga muajt e marrë në auditim u konstatua një sasi energjie prej 4,512 MWh e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e devijimit +/-10% të sasisë ditore me kontratën nga furnitorët G. T. për sasinë 1,540 MWh, G. SHPK për sasinë 1,184MWh dhe E. AG për sasinë 1,788MWh. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e devijimit, është në vlerën prej **(362,905euro x 124euro/lek datë 18.09.2020)= 45,000,220 lek.**

Kriteri: *Kontrata e shitje-blerjes së energjisë nenet 1-5, specifikisht pika 5.2 e nenit 5 i*

cili thotë: Në rast se ndryshojnë programet javore sipas paragrafit më lart, programet ditore të lëvrimit do te konsiderohen te përmbushura me tolerance ditore maksimale te +/- 10% me profil 24 oraresh, ...

Pra jemi në kushtet e mos respektimit të neneve 1 deri në 4 dhe nenit 5. Itë të kushteve të kontratës, si më poshtë neni thotë: Palët bien dakord te shesin dhe lëvrojnë, dhe blejnë dhe pranojnë, energjinë elektrike ..., siç vijon:

neni 3.2 thotë: Blerësi do të pranojë dhe paguajë për energjinë elektrike të lëvruar nga shitësi sipas Nenit 1 të kontratës.

neni 4 specifikon oraret dhe fuqinë sipas kontratës.

Shkaku: Mungesë monitorimi dhe evidentimi të zbatimit të kushteve të kontratës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: OSHEE SHA të marri masa që në të ardhmen të kryej një monitorim të plotë të sasive të furnizuara dhe respektimit të kushteve të hartuara pranuar dhe nënshkruara nga palët me kontratat respektive me qëllim realizimin e një furnizimi me energji në rrjet për përmbushjen e nevojave të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Titulli i gjetjes: Mos respektimi i kushteve të kontratës

Situata: Nga auditimi i kontratës të blerjes së energjisë nga importi për muajin nëntor 2018 me furnitorin N. E. u konstatua se nga ana e furnitorit të energjisë elektrike për sasinë e energjisë së blerë në import për mbulimin e humbjeve nuk janë respektuar kushtet e kontratës nenet 1-5. Edhe pse në këto kushte ku furnitorët e energjisë furnizojnë pa dakordësi mes palëve në sasi energjie +/- 10% nga fuqia orare e kërkuar nga ana e OSHEE SHA është konsideruar si furnizim i plotë dhe në përputhje me kontratën. Për këtë muaj ky operator ka nënshkruar dy kontrata shit-blerje energjie, një për profilin bandë me një çmim prej 73.65Euro MW/h dhe atë në profilin pik me çmim 84.85 Euro MW/h.

Edhe pse në total sasia e furnizuar është e plotë kushtet e furnizimit nga ana e furnitorëve nuk janë në përputhje me kontratën. Ky operator për 13 ditë të ndryshme ka furnizuar në profilin pik me një diferencë më pak prej 503 MWh energji, të cilën e ka furnizuar në profiling bandë i cili ka një diferencë çmimi prej 11.2 euro MWh. Vlera prej **(5,633 euro x 124euro/lek datë 18.09.2020) = 698,492 lek si diferencë midis çmimit të blerjes së energjisë në profilin bandë dhe pik përbën dëm ekonomik dhe duhet dëmshpërblehet nga përfituesi.**

Kriteri: *Kontrata e shitje-blerjes së energjisë nenet 1-5, specifikisht pika 5.2 e nenit 5 i cili thotë: Në rast se ndryshojnë programet javore sipas paragrafit më lart, programet ditore të lëvrimit do te konsiderohen te përmbushura me tolerance ditore maksimale te +/- 10% me profil 24 oraresh, ...*

Pra jemi në kushtet e mos respektimit të neneve 1 deri në 4 dhe nenit 5. Itë të kushteve të kontratës, si më poshtë neni thotë: Palët bien dakord te shesin dhe lëvrojnë, dhe blejnë dhe pranojnë, energjinë elektrike ..., siç vijon:

neni 3.2 thotë: Blerësi do të pranojë dhe paguajë për energjinë elektrike të lëvruar nga shitësi sipas Nenit 1 të kontratës.

neni 4 specifikon oraret dhe fuqinë sipas kontratës.

Ndikimi: Vënie në vështirësi të palës blerëse

Shkaku: Mungesë monitorimi dhe evidentimi të zbatimit të kushteve të kontratës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: OSHEE SHA të marri masa për kërkimin e vlerës prej 5,633 euro së përfituar padrejtësisht nga furnitori N. E. nga kontratat e shitblerjes së energjisë elektrike midis OSHEE SHA dhe N. E. për muajin nëntor 2018, duke e

kërkuar në rrugë administrative dhe ligjore arkëtimin e shumës.

Viti 2019

-Për muajin mars 2019 kompania G. T. për datat 26 - 29 mars nuk ka furnizuar me energji në përputhje me kushtet e sipërpërmendura të kontratës por ka furnizuar me një diferencë prej 10% në profilin pik kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës është në sasinë 768MWh dhe vlerën 53,521 euro. Kjo sasi energjie e pa lëvruar sipas kushteve të kontratës është furnizuar në ditë të tjera të muajit. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e devijimit, është në vlerën **prej 53,521 euro**.

-Për muajin mars 2019 kompania E. AG për datat 26-29 mars nuk ka furnizuar me energji në përputhje me kushtet e sipërpërmendura të kontratës por ka furnizuar me një diferencë prej 10%, në profilin pik kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës është në sasinë 128MWh dhe vlerën 9,086 euro ndërsa në profilin band kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës është 864MWh dhe vlerën 52,695 euro. Kjo sasi energjie e pa lëvruar sipas kushteve të kontratës është furnizuar në ditë të tjera të muajit. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e devijimit, është në vlerën **prej 61,781 euro**.

Titulli i gjetjes: Mos respektimi i kushteve të kontratës

Situata: Nga auditimi i kontratave të blerjes së energjisë nga importi për vitin 2019 u konstatua se nga ana e furnitorëve të energjisë elektrike për sasinë e energjisë së blerë në import për mbulimin e humbjeve nuk respektohen kushtet e kontratës nenet 1-5 të saj duke operuar sipas mundësisë së tyre. Edhe pse në këto kushte ku furnitorët e energjisë furnizojnë pa dakordësi mes palëve në sasi energjie +/- 10% nga fuqia orare e kërkuar nga ana e OSHEE SHA është konsideruar si furnizim i plotë dhe në përputhje me kontratën. Edhe pse në total sasia e furnizuar është e plotë kushtet e furnizimit nga ana e furnitorëve nuk janë në përputhje me kontratën. Për vitin 2019 nga muajt e marrë në auditim u konstatua një sasi energjie prej 1,760 MWh e furnizuar me një devijim +/- 10% nga programi ditor i kontratës nga furnitorët G. T. për sasinë 768 MWh dhe E. AG për sasinë 992MWh. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e devijimit, është në vlerën **prej (115,302euro x 124euro/lek datë 18.09.2020) = 14,297,448 lek**.

Kriteri: *Kontrata e shitje-blerjes së energjisë nenet 1-5, specifikisht pika 5.2 e nenit 5 i cili thotë: Në rast se ndryshojnë programet javore sipas paragrafit më lart, programet ditore të lëvrimin do të konsiderohen të përmbushura me tolerance ditore maksimale të +/- 10% me profil 24 orarësh, ...*

Pra jemi në kushtet e mos respektimit të neneve 1 deri në 4 dhe nenit 5. Itë të kushteve të kontratës, si më poshtë neni thotë: Palët bien dakord te shesin dhe lëvrojnë, dhe blejnë dhe pranojnë, energjinë elektrike ..., siç vijon:

neni 3.2 thotë: Blerësi do të pranojë dhe paguajë për energjinë elektrike të lëvruar nga shitësi sipas Nenit 1 të kontratës.

neni 4 specifikon oraret dhe fuqinë sipas kontratës.

Shkaku: Mungesë monitorimi dhe evidentimi të zbatimit të kushteve të kontratës.

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandimi: OSHEE SHA të marrë masa që në të ardhmen të kryej një monitorim të plotë të sasive të furnizuara dhe respektimit të kushteve të hartuara pranuar dhe nënshkruara nga palët me kontratat respektive me qëllim realizimin e një furnizimi me energji në rrjet për përmbushjen e nevojave të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Viti 2020

- Për muajin mars 2020 kompania G. SHPK nuk ka furnizuar me energji në përputhje me kushtet e sipërpërmendura të kontratës për periudhën e furnizimit 1-8 mars 2020 por ka furnizuar me një

diferencë prej 10% në profilin pik kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës është në sasinë 630MWh dhe vlerën 27,720 euro. Kjo sasi energjie e pa lëvruar sipas kushteve të kontratës është furnizuar në ditë të tjera të muajit. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e devijimit, është në vlerën **prej 27,720 euro**.

- Për muajin mars 2020 kompania E. AG nuk ka furnizuar me energji në përputhje me kushtet e sipërpërmendura të kontratës për periudhën e furnizimit 16-22 mars 2020 por ka furnizuar me një diferencë prej 10% në profilin pik kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës është në sasinë 252MWh dhe vlerën 13,104 euro. Kjo sasi energjie e pa lëvruar sipas kushteve të kontratës është furnizuar në ditë të tjera të muajit. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e devijimit, është në vlerën **prej 13,104 euro**.

- Për muajin mars 2020 kompania G. SHPK nuk ka furnizuar me energji në përputhje me kushtet e sipërpërmendura të kontratës për periudhën e furnizimit 16-22 mars 2020 por ka furnizuar me një diferencë prej 10% në profilin band kjo sasi energjie e pa furnizuar sipas kushteve të kontratës është në sasinë 480MWh dhe vlerën 21,960 euro. Kjo sasi energjie e pa lëvruar sipas kushteve të kontratës është furnizuar në ditë të tjera të muajit. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e devijimit, është në vlerën **prej 21,960 euro**.

Titulli i gjetjes: Mos respektimi i kushteve të kontratës

Situata: Nga auditimi i kontratave të blerjes së energjisë nga importi për vitin 2020 u konstatua se nga ana e furnitorëve të energjisë elektrike për sasinë e energjisë së blerë në import për mbulimin e humbjeve nuk respektohen kushtet e kontratës nenet 1-5 të saj duke operuar sipas mundësisë dhe dëshirës së tyre. Edhe pse në këto kushte ku furnitorët e energjisë furnizojnë pa dakordësi mes palëve në sasi energjie +/- 10% nga fuqia orare e kërkuar nga ana e OSHEE SHA është konsideruar si furnizim i plotë dhe në përputhje me kontratën. Edhe pse në total sasia e furnizuar është e plotë kushtet e furnizimit nga ana e furnitorëve nuk janë në përputhje me kontratën. Për vitin 2020 nga muajt e marrë në auditim u konstatua një sasi energjie prej 1,362 MWh e furnizuar me një devijim +/-10% nga programi ditor i kontratës, nga furnitorët G. SHPK për sasinë 1,110MWh dhe E. AG për sasinë 252MWh. Sasia e furnizuar pa u plotësuar plotësisht kushtet e devijimit, është në vlerën **prej (62,784euro x 124euro/lek datë 18.09.20200 = 7,785,216 lek**.

Kriteri: *Kontrata e shitje-blerjes së energjisë nenet 1-5, specifikisht pika 5.2 e nenit 5 i cili thotë: **Në rast se ndryshojnë programet javore sipas paragrafit më lart, programet ditore të lëvrimin do të konsiderohen të përmbushura me tolerance ditore maksimale të +/- 10% me profil 24 orësh, ...***

*Pra jemi në kushtet e mos respektimit të neneve 1 deri në 4 dhe nenit 5. Itë të kushteve të kontratës, si më poshtë neni thotë: **Palët bien dakord te shesin dhe lëvrujnë, dhe blejnë dhe pranojnë, energjinë elektrike ..., siç vijon:***

neni 3.2 thotë: Blerësi do të pranojë dhe paguajë për energjinë elektrike të lëvruar nga shitësi sipas Nenit 1 të kontratës.

neni 4 specifikon oraret dhe fuqinë sipas kontratës.

Shkaku: Mungesë monitorimi dhe evidentimi të zbatimit të kushteve të kontratës.

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandimi: OSHEE SHA të marrë masa që në të ardhmen të kryej një monitorim të plotë të sasive të furnizuara dhe respektimit të kushteve të hartuara pranuar dhe nënshkruara nga palët me kontratat respektive me qëllim realizimin e një furnizimi me energji në rrjet për përmbushjen e nevojave të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Për sa i përket abonentëve debitorë nga lista e abonentëve në sistemin billing janë ekstraktuar në exel ku u konstatua se debitorë në shlyerjen e faturave të energjisë elektrike paraqiten rreth 600,000 abonentë debitorë përfshirë këtu; buxhetorë, shoqëri publike (kryesisht Albpetrol dhe Ujësjellësi),

private, familjarë e jo familjarë, me një vlerë totale debie prej 114,708,322,425 lekë nga të cilat 71,251,235,763 lekë principal dhe 43,440,702,370 penalitete.

Rreth 95% e tyre janë debitorë të mbartur kryesisht të periudhës së ish-CEZ shpërndarja.

Për periudhën objekt auditimi janë identifikuar në listën e debitorëve 21,277 abonentë debitorë nga të cilët vetëm 142 abonentë paraqiten me statusin me ankesë pjesa tjetër janë mbartur deri më 2017 dhe të krijuar apo shtuar debinë rishtaz në vitet 2018-2020.

Më poshtë në formë tabelore po paraqesim të dhënat për debitorë për periudhën objekt auditimit.

Tabela nr.4 Të dhëna për debitorët 2017-2020

Detyrimet e abonentëve 2017-2020			
	Principali	Kamat vonesa	Total detyrimi
Detyrime deri më 31.12.2017	11,849,023,588	12,254,556,684	24,103,580,271
Viti 2018	2,626,529,820	1,805,908,488	4,432,438,308
Viti 2019	3,122,212,168	1,036,693,392	4,158,905,560
Viti 2020	1,469,541,752	99,417,529	1,568,959
Total Detyrime	19,067,307,329	15,196,576,092	34,263,883,421
Detyrime 2018-2020	7,218,283,741	2,942,019,409	10,160,303,150

Burimi: Të dhëna të OSHEE SHA, përpunuar nga grupi i auditimit

Kjo vlerë e lartë debie apo faturash pa paguar ndër vite nëse përkthehet në sasi energjie me një çmim mesatare 9 lek me TVSh pasi çmimi në faturë paraqitet me TVSh, lind dyshimi i arsyeshëm i një faturimi afërsisht në 250,000 MWh në vit në abonentë të cilët praktikisht ekzistojnë në sistemin Billing të shoqërisë OSHEE SHA, faturim i cili ndryshon nivelin e humbjeve dhe sasive të energjisë të blera me çmim të rregulluar.

Në vlerën e debisë prej 7,218,283,741 lekë të krijuar rishtaz për periudhën 2018-2020 pa përfshirë vitin 2017 e cila mbart debitorë dhe nga periudhat e mëparshme, 4,998,582,915 lek ose 70% e përbëjnë debitorë Buxhetor e Jo buxhetor si (ujësjellës dhe Albpetrol) të cilët sipas sqarimeve të dërguara me observacionin nr. 5842/81 datë 25.09.2020 dhe raporteve të punës së kryer nga drejtoria e mbledhjes së borxheve, nuk mund ti shkohet në masat ekstreme dhe ti ndërpritet energjia si rezultat i ndërmarrjeve me rëndësi të veçantë që kanë ndërsa pjesën tjetër të energjisë e përbëjnë familjare e biznese privat konkretisht 30% të debisë të krijuar rishtaz por në numër abonentësh mbetet tejti i lart ose konkretisht në 19,474 abonent.

Faturimi për një kohë të gjatë i rreth 21,277 abonentëve në kundërshtim me parashikimet ligjore ku parashikohet se, në rast mos pagese detyrimi prej 30 ditësh kalendarike OSHEE SHA i lind detyrimi për njoftimin me shkrim për ndërprerje energjie dhe në rast mos përgjigje nga abonenti brenda një kohe prej 60 ditësh OSHEE SHA është e detyruar ti ndërpresë furnizimin me energji.

Nga sa më sipër nga ana e OSHEE SHA masat e ndërmarrja nuk janë të plota dhe gjithëpërfshirëse sipas rajoneve pasi kemi një shpërndarje të çrregullt të debitorëve ku pjesën më të madhe e mban rajoni i Durrësit pastaj vijnë Shkodra e Kukësi. Nga ana e OSHEE SHA për rajonet e Durrësit, Shkodrës dhe Kukësit puna për përmirësimin e situatës nuk ka dhënë rezultate pozitive, nisur dhe nga fakti i lënies të lidhur këto abonentë dhe duke sjellë efekte pozitive dhe negative shoqërinë. Nga ana e OSHEE SHA duhet të ndërmerren të gjitha hapat për identifikimin e këtyre abonentëve dhe gjetjen e zgjidhjes për vjeljen e debisë me qëllim pasqyrimin e situatës reale dhe përmirësimin e saj.

Nga opinioni auditues kjo situatë sjell shtrembërim të treguesve si më poshtë:

1-Uljen e humbjeve

2-Përfitim të sasisë së energjisë me çmim të rregulluar prej 1.5 lek

3-Efektin bumerang që mund të ketë nëse identifikohet saktë dhe verifikohet për çdo rast (ku për disa pompa vaditje apo puse naftë nuk ka të dhëna të sakta për ekzistencën dhe faturimin e saktë të tyre).

4-Pa efektshmërinë e strukturës taksforcë për mbledhjen e detyrimeve në disa rajone

5-Krijimin e debitorëve të ri dhe shtimin e llogarive të arkëtueshme

Humbja përlogaritet si rezultat i diferencës së energjisë së injektuar në sistemin e shpërndarjes me sasinë e energjisë të faturuar në abonentët e OSHEE-së. Pra me rritjen e faturimit praktikisht humbja ulet, gjithmonë nëse faturimi kryhet në përputhje me kushtet e parashikuara në Ligj, VKM përkatëse dhe kontratën midis palëve.

- Gjithashtu nga auditimi i blerjes së energjisë elektrike nga KESH SHA sipas normave të miratuara nga ERE dhe kontratës së hartuar dhe nënshkruar vetëm nga OSHEE SHA dhe jo nga pala tjetër kontraktuese KESH SHA për furnizimin me energji elektrike me çmim të rregulluar prej 1.5 lekë/Kwh për sasinë e energjisë prej 3,950GWh në vit bazuar në mesataren vjetore shumëvjeçare të llogaritur nga ERE për kaskadën gjeneruese të Drinit.

Për periudhën objekt auditimi shoqëria OSHEE SHA ka lëshuar 3 fatura penaliteti për mos performacë në vlerën 5,465,003,331lekë datë 31.12.2017 e klasifikuar si (Të ardhura Penalitete KESH për mosrealizim Kontrate 2017), në vlerën 158,364,092 lekë datë 31.12.2018 e klasifikuar si (Të ardhura Penalitete KESH për mosrealizim Kontrate 2018) dhe në vlerën 1,275,921,000 lekë e klasifikuar si (Të ardhura Penalitete KESH për mosrealizim Kontrate 2019). *Në total shoqëria OSHEE SHA ka lëshuar 3 fatura penaliteti ndaj shoqërisë KESH SHA për vitet 2017-2019 në vlerën 6,899,288,423 lekë të klasifikuara si të ardhura në bilancin e saj, fatura të cilat janë të bazuara mbi një kontratë të pa nënshkruar dhe gjithashtu dhe fatuarat janë të pa pranuar dhe nënshkruara nga shoqëria KESH SHA si të tilla në bazë të ligjit për tatim-taksat një faturë quhet e pranuar dhe e rregullt kur nënshkruhet nga të dy palët. Sa më sipër lëshimi i faturave (të pa pranuar) dhe klasifikimi i vlerës si të ardhura për shoqërinë OSHEE SHA sjellë ndryshim në rezultatin financiarë të shoqërisë.*

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Neni 80 Kontrata e furnizimit me energji elektrike, Neni 82 Të drejtat e furnizuesit Furnizuesit, përveç të drejtave të përcaktuara në kontratë, sipas nenit 80, të këtij ligji, kanë këto të drejta: c) të kërkojnë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, kur klienti nuk përmbush detyrimet kontraktore, dhe rilidhjen e energjisë elektrike, kur klienti ka përmbushur detyrimet, të cilat shkaktuan ndërprerjen e furnizimit.

Neni 84 Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit si detyrim i shërbimit publik; ç) të njoftojë klientin për marrjen e masave për ekzekutimin e detyrueshëm për detyrimet e papaguara;

Neni 92

Masat e ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve të papaguara

Për të siguruar ekzekutimin e detyrimit të papaguar furnizuesi, në përputhje me parashikimet e kontratës, merr masat e mëposhtme:

a) fillon procedurën e ndërprerjes së energjisë elektrike;

b) fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, duke kërkuar lëshimin e urdhrat të ekzekutimit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 8662, datë 18.9.2000, “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, të ndryshuar;

c) vendos barrën hipotekore mbi pasurinë e paluajtshme që furnizohet me energji elektrike, në rast se detyrimi i papaguar, që rrjedh nga një kontratë furnizimi energjie elektrike, është mbi 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për klientin jofamiljar.

Vendimi 203 i ere datë Datë 18.12.2017 “Për miratimin e “kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”

Neni 6 Pezullimi dhe Përfundimi i Kontratës

6.1.1 Me iniciativën e Furnizuesit, në rast të shkeljes nga ana e Klientit të detyrimeve thelbësore të kontratës, ku do të konsiderohen shkelje thelbësore të kushteve të kontratës nga ana e Klientit, rastet si më poshtë:

a- Nëse Klienti nuk paguan detyrimet e energjisë elektrike duke përfshirë edhe

kamatëvonesën, brenda 1 muaji nga ndërprerja e energjisë elektrike, si pasojë e mospagesës së energjisë elektrike.

Edhe pse në këto kushte ku në sistemin billing ekzistojnë mbi 21,277 abonentë OSHEE SHA, nga drejtoria e borxhit masat e marra nuk kanë qenë efektive për identifikimin e abonentë, inicimin e procedurave për shlyerje e detyrimeve, detyrime për këto abonent vetëm për periudhën objekt auditimi kapin vlerën e 7,218,283,741 lekë pa kamat vonesa dhe 2,942,019,409 lek kamatëvonesa, në total detyrimi kap vlerën e 10,160,303,150 lekë.

Titulli i gjetjes: Shtimi i debisë koherente

Situata: Nga auditimi i sistemit billing u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë identifikuar 21,277 abonentë të cilët vetëm për periudhën 2018-2020 kanë krijuar një borxh në vlerën 7,218,283,741 lekë dhe 2,942,019,409 lek kamatëvonesa. Kjo vlerë për OSHEE SHA konsiderohet si llogari të arkëtueshme ose (të ardhura të munguara).

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” Neni 80 Kontrata e furnizimit me energji elektrike, neni 82 Të drejtat e furnizuesit, përveç të drejtave të përcaktuara në kontratë, sipas nenit 80, të këtij ligji, kanë këto të drejta: c) të kërkojnë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, kur klienti nuk përmbush detyrimet kontraktore, dhe rilidhjen e energjisë elektrike, kur klienti ka përmbushur detyrimet, të cilat shkaktojnë ndërprerjen e furnizimit. Neni 84 Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit si detyrim i shërbimit publik; ç) të njoftojë klientin për marrjen e masave për ekzekutimin e detyrueshëm për detyrimet e papaguara; neni 92.

Ndikimi: Uljen e nivelit të të ardhurave dhe investimeve

Shkaku: Masat e ndërmarra nuk janë të plota dhe gjithëpërfshirëse sipas rajoneve

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: OSHEE SHA të marrë masa të menjëhershme për identifikimin e abonentëve problematik, qofshin këto buxhetorë apo Jo buxhetorë, njoftimin e tyre për detyrimin e krijuar, trajtimin rast pas rasti duke u nisur dhe nga natyre e secilit dhe gjetjen e një zgjidhje sa më efikase për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura dhe shmangien e krijimit të debitorëve të rinj.

Tabela nr.5 Humbjet në sistemin e shpërndarjes për periudhën objekt auditimi

	Energji ne rrjet	Faturuar Abonentëve	Humbje total	%	%	Teknike	Jo teknike	%
Humbje TOTALE 2019	6,805,811,162	5,322,849,652	1,482,961,510	21.79%	14.02%	954,300,218	528,661,293	7.77%
Humbje TOTALE 2018	6,436,911,035	4,883,783,502	1,538,503,084	23.90%	16.67%	1,070,560,216	467,942,868	7.29%
Humbje TOTALE 2017	6,498,514,678	4,781,998,131	1,716,516,547	26.41%	19.20%	1,247,714,818	468,801,729	7.21%

Burimi: Të dhëna të OSHEE, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

- Sic vihet re dhe nga tabela humbjet kanë pësuar rënie nga viti në vit, por kemi një lidhje të zhdrejtë për vitin 2019 për sa i përket humbjeve jo teknike në raport me faturimin dhe vitet e mëparshme. Në këtë vit humbja Jo teknike ka pësuar një rritje prej 12% krahasimisht me vitin 2018 ndërkohë që humbja teknike ka pësuar një ulje me 11% çka tregon për të dhëna të pa qarta për sa i përket humbjeve. Humbja teknike konsiston në humbjen e realizuar nga amortizimi i rrjetit të shpërndarjes ndërsa humbja jo teknike konsiston në abuzimin me energjinë nga abonentët (vjedhja). Rritja e humbjes Jo teknike për vitin 2019 nuk e arsyeton punën e OSHEE SHA nëse e marrim të

mirqenë uljen e 11% të humbjes Teknike, e cila në vetvete tregon në një performancë të mirë të investimeve të kryera në sistemin e OSHEE SHA, marrë shkas dhe nga të dhënat reciproke për vitet 2017 dhe 2018, ku humbja teknike dhe ajo Jo teknike paraqiten në trend të ngjashëm.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me projekt raportin e auditimit nga ana e OSHEE SHA është paraqitur observacioni me nr. 12149/37 prot., datë 22.12.2020 administruar nga grupi i auditimit më 28.12.2020 nga E. S., E. R., I. Q. dhe E. Gj..

Subjekti paraqet pretendimin e tij për sa i përket zbatimit të kontratave të furnizimit me një diferencë lëvrimi +/- 10% :

Fleksibiliteti/tolerance +/- 10% e parashikuar në kontratë në nenin 5 të kontratës, ushtrohet nga shitësi përkundrejt kapacitetit dhe sasisë së kontraktuar, të përcaktuar në nenin 1 të kontratës, dhe jo mbi programin javor të kontratës. Në të kundërt, do të ndodheshim përpara pamundësisë për të respektuar kapacitetin dhe profiling e lëvrimit të përcaktuar në kontratë. Kjo tolerancë prej 10% ushtrohet nga furnitorët, vetëm me kushtin që sasi totale e rënë dakord në kontratë të jetë 100% e realizuar.

Qëndrimi i gripit të auditimi:

Në asnjë rast nga ana e grupit të auditimit nuk është thënë që nuk lejohet toleranca +/-10% sipas nenit 5 të kontratës , por është interpretuar i gjithë neni 5 je vetëm pika ku ju referoheni.

Kontrata tip e hartuar dhe e miratuar që nga koha e ish ÇEZ vazhdon të jetë në fuqi edhe sot edhe pse kemi një ligj të ri për sektorin energjetik, së dyti në pikën 5.2 nenit ku ju i referoheni citohet fare qartë: “**Në rast se ndryshojnë programet javore sipas paragrafit më lart**, programet ditore të lëvrimit do të konsiderohen të përmbushura me tolerancë ditore maksimale te +- 10% me profil 24 orësh...”, pra është e shprehur në mënyre tejet të qartë kur mund të furnizohet me tolerance +/- 10%, si i tillë pretendimi nuk merret në konsideratë.

- Për sa i përket ndikimi, mundësi për disbalanca, është marrë në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:

- OSHEE paraqet objeksione ne lidhje me 21,277 abonentët e krijuar debitorë për periudhën objekt auditimi duke pretenduar se këto abonentë kanë kryer pagesa por për periudhat e mëparshme. Gjithashtu OSHEE SHA pretendon se 70% e tyre janë abonentë buxhetore (ujësjellës, Albpetrol etj.) si të tillë nuk mund të shkohet në masa ekstreme. Kjo dhe se këto shoqëri janë strategjike dhe jetike, madje për ujësjellësit subvencioni i akorduar nga buxheti i shtetit për pagesat e faturave të energjisë elektrike ka ardhur në rënie për çdo vit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa i përket peshës që zënë abonentët buxhetore e jo buxhetor në sasinë e debisë së krijuar është e vërtet që 70% të saj e zënë (ujësjellës, Albpetrol etj.) por numri më i madh vazhdon e mbeten familjarët apo privatët. Nga ana jonë është reflektuar për sa i përket kësaj peshe në hartimin e këtij Raporti auditimi, por mbetet shqetësues fakti i numrit të madh të abonentëve privat që mbeten problematik edhe pse nga raportet e punës të sjella në observacion mbeten shqetësues rajonet e Durrësit, Shkodrës dhe Kukësit.

Kjo problematikë kërkon zgjidhje të menjëhershme edhe për faktin se nga DEK operohet me provizionim të llogarive të arkëtueshme, duke lindur mundësinë e shuarjes në çdo vit të sasisë së debisë së akumuluar.

2. 9. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.

Në zbatim të pikës 9 të programit të auditimit “Nr.546/1, datë 23.06.2020”,u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Kontratat e qiramarrjes,
- 2) Kontratat e qiradhënies.

1. Titulli i gjetjes : Procedurat e qiramarrjes dhe qiradhënies.

Situata: -Nga auditimi i procedurave të qirave, rezulton se OSHEE SHA nuk ka ndjekur ndonjë procedurë të hapur apo me buletine në gazetata kombëtare apo mediat e shkruara, për ofrimin e ambienteve sa më të përshtatshme dhe me çmim konkurrues, por është nisur dhe ka vazhduar procedurat me propozimet e ardhura nga njësitë respektive sipas rretheve, më tej ka ndjekur një procedurë negociimi çmimi, sipërfaqeje, kushtet e duhura, etj.

-Shoqëria OSHEE SHA shpenzon mesatarisht në muaj 23,446,215 lekë për pagesat e qirave, një shumë kjo e konsiderueshme, nisur dhe nga fakti se shërbimin e arkëtimit për shoqërinë, prej disa vitesh e ofrojnë edhe bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e licencuara për operacione financiare, etj.

Ky shpenzim në vit kap vlerën prej 281,354,580 lekë.

- Nga auditimi i praktikave të ndjekura për marrje me qira të ambienteve, çmimet e lidhjes së kontratave në proporcion me sipërfaqen dhe krahasimi me çmimet e tregut në faqet web të agjencive imobiliare apo gazetata që operojnë në këtë fushë, u konstatua se çmimet e negociuara nga OSHEE SHA për lidhje kontratash qiraje, janë më të larta se çmimet e tregut.

- Nga auditimi i kontratave të qirasë konstatohet se në kontratat e qiramarrjes, parashikohet në nenin 5.3 mbajtja e penalitetit, konkretisht: “nëse ndonjë nga pagesat e qerasë mujore ose ndonjë pagesë tjetër sipas kësaj kontrate mbetet e papaguar pas 15 ditësh nga afati i pagesës së saj, ndaj qiramarrësit do të aplikohet një penalitet në masën 0.05% të shumës së prapambetur. Penaliteti do të fillojë aplikohet pas ditës të 15-të nga momenti i përfundimit të afatit të pagesës.”. Në kontratën e qiradhënies nuk parashikohet një nen i tillë, dhe për pasojë shoqëria OSHEE SHA nuk mund të mbajë penalitete lidhur me vonesat në pagesë të cilat shkojnë në vlerën 452,205 lekë.

- Në kontratat e qiradhënies neni 11, pika 1 parashikohet se “...qiradhënësi mund të zgjidhë kontratën e qirasë nëse qiramarrësi nuk ka kryer pagesën brenda një muaji nga data e pagesës së përcaktuar...”, por kjo pikë, e cila sa më sipër është detyrim që rrjedh nga kontrata e qirasë, nuk është zbatuar nga ana e OSHEE SHA.

Kriteri: Kontratat e qirave.

Ndikimi/Efekti: Mos zbatimi i neneve të kontratave të qirave sjell vonesa dhe parregullsi në pagesat e detyrimeve nga ana e qiramarrësve.

Shkaku: Mos zbatimi i përcaktimeve dhe parashikime të kontratave të qiradhënies.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 1: Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse për ndjekjen e procedurave të hapura apo me buletine në gazetata kombëtare apo mediat e shkruara, për ofrimin e ambienteve sa më të përshtatshme dhe me çmime konkurruese.

Rekomandimi 2: Administratori i OSHEE SHA në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse të analizojnë situatën mundësinë e reduktimit të kostove lidhur me ambientet e marra me qira, duke u nisur nga fakti se shërbimin e arkëtimit për shoqërinë, prej disa vitesh e ofrojnë edhe bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e licencuara për operacione financiare, etj.

Rekomandimi 3: Departamenti Ligjor në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa për shtimin e pikës të penaliteteve në kontratat e qiradhënies nga ana e OSHEE SHA, dhe sanksionimin e subjekteve debitore nga kontratat e shmangien e krijimit të detyrimeve.

Konkluzione:

1. Qiramarrja në OSHEE SHA kryhet për të siguruar ambiente për akomodimin e punonjësve kryesisht të qendrave të kujdesit ndaj klientit, punonjësit e administratës qendrore dhe lokale të

drejtorive rajonale dhe njërive përkatëse, por edhe ambiente për të magazinuar materialet e mirëmbajtjes dhe të investimeve.

2. Nga auditimi i kontratave të qirasë konstatohet se në kontratat e qiramarrjes, parashikohet në nenin 5.3 mbajtja e penaltetit, konkretisht: “*nëse ndonjë nga pagesat e qerasë mujore ose ndonjë pagesë tjetër sipas kësaj kontrate mbetet e papaguar pas 15 ditësh nga afati i pagesës së saj, ndaj qiramarrësit do të aplikohet një penaltet në masën 0.05% të shumës së prapambetur. Penalteti do të fillojë aplikohet pas ditës të 15-të nga momenti i përfundimit të afatit të pagesës.*”. Në kontratën e qiradhënies nuk parashikohet një nen i tillë, dhe për pasojë shoqëria OSHEE SHA nuk mund të mbajë penaltete lidhur me vonesat në pagesë të cilat shkojnë në vlerën 452,205 lekë.

3. Në kontratat e qiradhënies neni 1, pika 1 parashikohet se “*...qiramarrësi nuk ka kryer pagesën brenda një muaji nga data e pagesës së përcaktuar...*”, por kjo pikë nuk është zbatuar asnjëherë nga ana e OSHEE SHA.

4. Nga auditimi i procedurave të qirave, rezulton se OSHEE SHA nuk ka ndjekur ndonjë procedurë të hapur apo me buletine në gazetatat kombëtare apo mediat e shkruara, për ofrimin e ambienteve sa më të përshtatshme dhe me çmim konkurrues, por është nisur dhe ka vazhduar procedurat me propozimet e ardhura nga njësitë respektive sipas rretheve, më tej ka ndjekur një procedurë negociimi çmimi, sipërfaqeje, kushtet e duhura, etj.

5. Shoqëria OSHEE SHA shpenzon mesatarisht në muaj 23,446,215 lekë për pagesat e qirave, një shumë kjo e konsiderueshme, nisur dhe nga fakti se shërbimin e arkëtimit për shoqërinë, prej disa vitesh e ofrojnë edhe bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e licencuara për operacione financiare, etj. Ky shpenzim në vit kap vlerën prej 281,354,580 lekë.

6. Nga auditimi i praktikave të ndjekura për marrje me qira të ambienteve, çmimet e lidhjes së kontratave në proporcion me sipërfaqen dhe krahasimi me çmimet e tregut në faqet web të agjencive imobiliare apo gazetatat që operojnë në këtë fushë, u konstatua se çmimet e negociuara nga OSHEE SHA për lidhje kontratash qiraje, janë më të larta se çmimet e tregut.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi A. G. në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për vlerësimin e ambienteve me qira dhe L. M. në cilësinë e kryetarit të grupit të punës për vlerësimin e ambienteve me qira.

Pretendimet e subjektit:

Në observacionin e dërguar me nr.12149/38, datë 22.12.2020, nga z. L. M. dhe z. A. G. në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion të grupit të auditimit në datë 28.12.2020, në të cilin citohet se:

1-“...për të mbështetur argumentin tonë kërkuam nga 3 agjenci imobilare të na jepnin të dhënat e tyre për çmimet mesatare në kryeqytet. Duke bërë krahasimet relevante, rezulton se qiramarrja në OSHEE SHA ka kosto më të ulëta se çmimet e tregut...”

2-“...sugjerimi i grupit të auditimit se OSHEE për nevojat e qiramarrjes duhet të publikojë njoftime në buletine, media të shkruara etj., për të rritur gamën e ofertës teorikisht është i drejtë por në praktikë pothuaj i porealizueshëm...”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1-Lidhur me observacionin tuaj, momenti në cilin ju keni marrë të dhënat për çmimet mesatare, është pas akt konstatimit nga ana jonë, dhe po ashtu pas faktit të konstatuar. Për rrjedhojë, observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

2- Lidhur me observacionin tuaj, ju nuk shprehni arsye dhe ku jeni bazuar për këtë konkluzion. Për rrjedhojë, observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

2.10. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Nga grupi i auditimit të KLSH-së në zbatim të ligjit të MFK-së nr.10296, datë 8.07.2010, i është përcjellë me email pyetësi për vetëvlerësimin të komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në OSHEE, Drejtorit të Departamentit të Zhvillimit të Biznesit nga ku është konstatuar se në zbatim të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), ligjit Nr. Nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjit Nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, Urdhrit i Ministrit të Financave Nr.8980 dt.15.07.2010 “Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Standartit ISO 31000 për administrimin e riskut, Sektori i Administrimit të Riskut Operacional, në Drejtorinë e Qeverisjes së Korporatës pranë Departamentit të Zhvillimit të Biznesit, ka miratuar Udhëzimet e Administrimit të Riskut versionin 1.1, Nr. 1061 Prot., dt 4/4/2017 dhe Politikën e Administrimit të Riskut versionin 1.1, Nr. 27917 Prot., dt 24/11/2016, në bazë të cilave cdo vit kryen identifikimin, analizën dhe mitigimin e risqeve në OSHEE SHA. Gjithashtu në këto dy drafte të miratuara janë të përcaktuara përgjegjësitë e menaxherëve për zbatimin e objektivave të njësisë publike dhe menaxhimit të riskut. -Sipas anekseve të Udhëzimit e Administrimit të Riskut versionin 1.1, Nr. 1061 Prot., dt 4/4/2017 në hartën e procesit dhe regjistrin të riskut, analizohen risqet që lidhen me funksionet dhe kompetencat e deleguara për cdo aktivitet të identifikuar që përmban risk.

-Referuar përgjigjeve në pyetësin e MFK nga Grupi i KLSH-së, drejtuar Drejtorisë së Zhvillimit të Biznesit në OSHEE, thuhet se në hartimin e proceseve nga OSHEE SHA po merren masa që të përcaktohen nivelet e përgjegjësisë dhe të aksesit në informacion, si dhe lënia e gjurmëve në sisteme. Gjithashtu është në proces rishikimi i Politikës së miratuar të Luftës Kundër Mashtrimit brenda OSHEE SHA, në të cilën do të përfshihet VKM për sinjalizuesin gjithashtu OSHEE SHA është duke rishikuar Politikën dhe Udhëzimet e Administrimit të Riskut duke bërë ndryshimet përkatëse edhe në urdhrin e ngritjes së komitetit të riskut sipas ndryshimeve të fundit të organigramës së OSHEE SHA., referuar Aneks 4- Komiteti i Riskut të Politika e Administrimit të Riskut versionin 1.1.

Vlerësimi i risqeve kryhet në bazë të Udhëzimeve të Punës së Administrimit të Riskut në OSHEE SHA., me Nr. 1061 Prot., datë 04/04/2017, pika 1.1 “ Në çdo Njësi, caktohet një person, i/e cili/a do të ketë si detyrë funksionale, përgjegjësinë për ndjekjen e Regjistrin të Riskut, Zotëruesi i Riskut, brenda njësisë organizative të tij/saj. Zotëruesi i Riskut sugjerohet të mbajë pozicionin e Shefit të Sektorit apo Drejtor Drejtorie”.

Pyetjes së pyetësit për vetëvlerësimin për MFK referuar faktit “A e kryen njësi publike periodikisht një vlerësim të ekspozimit të saj ndaj veprimtarisë mashtruese dhe si mund të ndikohen veprimtaritë e saj? A përfshin ky vlerësim secilën nga njësitë e vartësisë? , Drejtoria e Zhvillimi të Biznesit në OSHEE SHA, i është përgjigjur me dokumentin e Politikës së Administrimit të Riskut në OSHEE SHA ,versionin 1.1, Nr. 27917 Prot., dt 24/11/2016.

Nga përgjigjet e pyetësorit dhe nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, për periudhën objekt auditimi:

-Nuk evidentohen hartimi periodik i regjistrin të risqeve të shoqërisë “OSHEE” SHA nga menaxhimi i lartë, duke mos evidentuar risqet e mundshme si dhe mundësinë e ndodhjes së tyre;

-Drejtoritë Rajonale nuk kanë një program ekonomik financiar të miratuar, por veprojnë mbi bazën e targeteve mujore të dërguara nga Divizionet dhe Departamentet e “OSHEE” SHA;

-Shoqëria OSHEE SHA, nuk ka një rregullore të miratuar në Këshillin Mbikqyrës, të funksionimit të Drejtorive/Njësive në vartësi të shoqërisë dhe në qendër.

-Shoqëria OSHEE SHA, nuk ka ndërtuar gjurmën e auditimit për proceset kryesore të punës;

-Shoqëria OSHEE SHA, nuk ka hartuar plane të kontrollit të brendshëm (Plani lokal);

-Referuar politikës së riskut , versioni 14.09.2016, konkretisht aneksi 4 , pika 3/g përcaktohet se “Komiteti i Riskut të paktën një herë në vit të rishikojë dhe miratojë politikën e menaxhimit të riskut”, ndërkohë nga auditimi konstatohet se kjo politika nuk janë ndryshuar periodikisht edhe pse mund të jenë në proces amendimi, sepse OSHEE SHA aktualisht punon me Udhëzimet e

Administrimit të Riskut versionin 1.1, Nr. 1061 Prot., dt 4/4/2017 dhe Politikën e Administrimit të Riskut versionin 1.1, Nr. 27917 Prot., dt 24/11/2016 dhe me dokumentin e Politikës së Administrimit të Riskut në OSHEE SHA ,versionin 1.1, Nr. 27917 Prot., dt 24/11/2016, ***pra OSHEE SHA, ka rreth 3 vjet pa amenduar politikat dhe udhëzimet e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në shoqëri , në kundërshtim me ligjin Nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, Urdhrit i Ministrit të Financave Nr.8980 dt.15.07.2010 “Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”***

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. I. M. në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Zhvillimit të Biznesit dhe z. A. C. në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë. Përsa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr.33, datë 18.09.2020.

Për sa është trajtuar në Projektraportin e Auditimit nr.546/4, datë 19.11.2020 protokolluar në OSHEE SHA me nr.12149, datë 23.11.2020, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.12149/39, datë 22.12.2020, nga znj.I. M. vënë në dispozicion grupit të auditimit më datë 28.12.2020, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

-Për qëndrimin e grupit të auditimit në lidhje me evidentimin e moSHArtimit periodik të regjistrat të risqeve të shoqërisë OSHEE SHA nga menaxhimi i lartë, nuk pranohet pasi janë rregjistrat e riskut për gjithë strukturat e OSHEE SHA që i është bërë analiza e riskut për periudhën 2018-2019, ndërkohë stafi i Drejtorisë së Zhvillimit të Biznesit po punon për trajnimin e rajoneve /njësive të OSHEE SHA që ato t'i kryejnë vetë analizat e riskut, përgjatë kësaj periudhe është punuar për politikën e së riskut.

- Mospranimin e gjetjes për moshartimin e një programi ekonomiko-financiar nga Drejtoritë Rajonale të OSHEE SHA dhe adresimin e pasaktë me arsyen se nuk ka lidhje me verprimtarinë dhe detyrat funksionale të DZHB.

- Mospranimin e gjetjes për mos hartimin e një rregulloreje të brendshme për OSHEE SHA dhe fillimin e procesit të vendimarrjes

- Mospranimin e mos hartimit të gjurmës së auditimit

- Mospranimin e mos hartimit e planeve të kontroleve të brendshme me komentin se shoqëria nuk ka strukture për kontrollin e brendshëm

- Mospranimin e mos amendimit të politikave të riskut prej 3 vjetësh me justifikimin se po amendohen nga konsulenca e huaj meqë shoqëria po ristrukturohet.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

-Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se në lidhje me dokumentacionin bashkëlidhur observacioneve tuaja nuk evidentohet pasqyrim i plotë i hartimit të risqeve në nivel qëndror dhe rajonal i shoqërisë OSHEE SHA për periudhën objekt auditimi pasqyruar kjo madje edhe në rekomandimet e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm pranë OSHEE SHA që nuk janë zbatuar për periudhën 2017-2019 kanë qenë :1.Përgatitja e rregulloreve të brendshme të funksionimit të Drejtorive/Njësive në vartësi të OSHEE SHA dhe në qëndër; 2.Ndërtimi i gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës;3.Hartimi i regjistrat të riskut; 4.Hartimi i planeve të kontrollit të brendshëm (Plani lokal);Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar neni 9/pika 1 në të cilën citohet” Nëpunësi autorizues i njësive publike është përgjegjës dhe i raporton titullarit të njësive publike për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitet, strukturat,programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tij, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës”, **prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe trajtohet në materialin e auditimit.**

- Në lidhje me mospranimin e gjetjes për moSHArtimin e një programi ekonomiko-financiar nga Drejtoritë Rajonale të OSHEE SHA dhe adresimin e pasaktë me arsyen se nuk ka lidhje me verprimtarinë dhe detyrat funksionale të DZHB, ju sqarojmë se në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 3

citohet “Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësive të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo ***mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë***”, në rastin konkret për periudhën 1.07.2017-30.06.2020, kjo shoqëri nuk ka hartuar program ekonomik në Drejtoritë Rajonale të OSHEE SHA, **prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe trajtohet në materialin e auditimit.**

- Në lidhje me **mos hartimin e një rregulloreje të brëndshme** për OSHEE SHA dhe fillimin e procesit të vendimarrjes në rastin konkret për periudhën 1.07.2017-30.06.2020 kjo shoqëri ka funksionuar pa rregullore të brendshme dhe referuar përgjegjësive të DZHB ju sqarojmë se në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 3 citohet “Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësive të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe ***të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia***, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë”, në rastin konkret për periudhën 1.07.2017-30.06.2020, **prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe trajtohet në materialin e auditimit.**

- Në lidhje me mospranimin e **moshartimit të gjurmës së auditimit** referuar përgjigjeve në pyetësorin e MFK nga Grupi i KLSH-së, drejtuar Drejtorisë së Zhvillimit të Biznesit në OSHEE, në përgjigjet e DZHB thuhet se në hartimin e proceseve nga OSHEE SHA po merren masa që të përcaktohen nivelet e përgjegjësive dhe të aksesit në informacion, si dhe lënia e gjurmëve në sisteme. Gjithashtu është në proces rishikimi i Politikës së miratuar të Luftës Kundër Mashtrimit brenda OSHEE SHA, në të cilën përfshihet VKM për sinjalizuesin gjithashtu OSHEE SHA është duke rishikuar Politikën dhe Udhëzimet e Administrimit të Riskut duke bërë ndryshimet përkatëse edhe në urdhrin e ngritjes së komitetit të riskut sipas ndryshimeve të fundit të organigramës së OSHEE SHA., referuar Aneks 4- Komiteti i Riskut të Politika e Administrimit të Riskut versionin 1.1. Në proceset e punës që keni sjellë me dokumentacionet justifikuese referuar edhe faktit që OSHEE SHA ka funksionuar ***për rreth tre vjet pa rregullore të brendshme nuk janë unifikuar pozicionet sipas funksioneve që mbulojnë dhe kompetencave*** gjithashtu referuar faktit se shoqëria është në proces strukturimi nuk është e qartë si ka ndikuar ky fakt në kuadrin rregullator të shoqërisë referuar unifikimit të kompetencave dhe hartimit të gjurmës audituese, veprime në kundërshtim të Ligjit Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar Neni 4/ pika 19 "Gjurma e auditimit" përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve”, **prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe trajtohet në materialin e auditimit.**

-Në lidhje me **mos hartimin e planeve të kontrolleve të brëndshme** për OSHEE SHA në rastin konkret për periudhën 1.07.2017-30.06.2020 kjo shoqëri nuk ka hartuar plane kontrollesh të brendshme dhe referuar përgjegjësive të DZHB ju sqarojmë se referuar Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar Neni 4/ pika 3 "Kontroll i brendshëm" është procesi integral i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe i auditimit të brendshëm, i vendosur nga titullari i njësisë publike, brenda objektivave të tij qeverisës, për të ndihmuar në kryerjen e veprimtarive të njësisë publike, me ekonomi, efektivitet dhe efçencë, **prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe trajtohet në materialin e auditimit.**

-Në lidhje me mospranimin të gjetjes mbi mosamendimin e politikave dhe udhëzimeve të

Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nga OSHEE SHA prej 3 vitesh më konkretisht për periudhën 1.07.2017-30.06.2020 ju sqarojmë se politikat dhe udhëzimet e Menaxhimit Financiar në OSHEE SHA janë të periudhës 2015-2017 pra për periudhën objekt auditimi nuk kanë pasur asnjë amendim duke pasur parasysh edhe faktin që shoqëria ishte para ngjarjes së një ristrukturimi dhe për rrjedhojë pa rregullore të brendshme, pa plane kontrolli të brendshëm në kundërshtim me Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar Neni 21 Menaxhimi i riskut

1. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

2. Për t'i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të Mjedisit të riskut. ***Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollin që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.***

3. Për të minimizuar riskun e mashtrimit dhe të parregullsive, nëpunësit autorizues të njësisë Publike regjistrojnë dhe raportojnë masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive, **prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe trajtohet në materialin e auditimit.**

1. Titulli i Gjetjes Për periudhën objekt auditimi nga shoqëria OSHEE SHA nuk janë hartuar rregjistrat e riskut nga menaxhimi i lartë, në nivel qendror dhe rajonal, Shoqëria OSHEE SHA, nuk ka një rregullore të miratuar në Këshillin Mbikqyrës, të funksionimit të Drejtorive/Njësive në vartësi të shoqërisë dhe në qendër, Drejtoritë Rajonale nuk kanë një program ekonomik financiar të miratuar, por veprojnë mbi bazën e targeteve mujore të dërguara nga Divizionet dhe Departamentet e "OSHEE" SHA, Shoqëria OSHEE SHA nuk ka ndërtuar gjurmën e auditimit për proceset kryesore të punës (nivel qendror dhe rajonal), s'ka hartuar plane të kontrollit të brendshëm (Plani lokal), nuk ka ndërtuar gjurmën e auditimit për proceset kryesore të punës gjithashtu OSHEE SHA, ka rreth 3 vjet pa amenduar politikat dhe udhëzimet e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në shoqëri, në kundërshtim me ligjin Nr.10296 dt.08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", Urdhërit i Ministrisë të Financave Nr.8980 dt.15.07.2010 "Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin"

Situata: Nga grupi i auditimit të KLSH-së në zbatim të ligjit të MFK-së nr.10296, datë 8.07.2010, i është përcjellë me email pyetësori për vetëvlerësimin të komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në OSHEE, Drejtorit të Departamentit të Zhvillimit të Biznesit nga ku është konstatuar se në zbatim të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), ligjit Nr. Nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", ligjit Nr.10296 dt.08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", Urdhërit i Ministrisë të Financave Nr.8980 dt.15.07.2010 "Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Standartit ISO 31000 për administrimin e riskut, Sektori i Administrimit të Riskut Operacional, në Drejtorinë e Qeverisjes së Korporatës pranë Departamentit të Zhvillimit të Biznesit, ka miratuar Udhëzimet e Administrimit të Riskut versionin 1.1, Nr. 1061 Prot., dt 4/4/2017 dhe Politikën e Administrimit të Riskut versionin 1.1, Nr. 27917 Prot., dt 24/11/2016, në bazë të cilave çdo vit kryen identifikimin, analizën dhe mitigimin e risqeve në OSHEE SHA. Gjithashtu në këto dy drafte të miratuara janë të përcaktuara përgjegjësitë e menaxherëve për zbatimin e objektivave të njësisë publike dhe menaxhimit të riskut.

-Sipas anekseve të Udhëzimit e Administrimit të Riskut versionin 1.1, Nr.

1061 Prot., dt 4/4/2017 në hartën e procesit dhe rregjistrin të riskut, analizohen risqet që lidhen me funksionet dhe kompetencat e deleguara për çdo aktivitet të identifikuar që përmban risk.

-Referuar përgjigjeve në pyetësorin e MFK nga Grupi i KLSH-së, drejtuar Drejtorisë së Zhvillimit të Biznesit në OSHEE, thuhet se në hartimin e proceseve nga OSHEE SHA po merren masa që të përcaktohen nivelet e përgjegjësisë dhe të aksesit në informacion, si dhe lënia e gjurmëve në sisteme. Gjithashtu është në proces rishikimi i Politikës së miratuar të Luftës Kundër Mashtrimit brenda OSHEE SHA, në të cilën do të përfshihet VKM për sinjalizuesin gjithashtu OSHEE SHA është duke rishikuar Politikën dhe Udhëzimet e Administrimit të Riskut duke bërë ndryshimet përkatëse edhe në urdhrin e ngritjes së komitetit të riskut sipas ndryshimeve të fundit të organigramës së OSHEE SHA., referuar Aneks 4- Komiteti i Riskut të Politika e Administrimit të Riskut versionin 1.1.

Vlerësimi i risqeve kryhet në bazë të Udhëzimeve të Punës së Administrimit të Riskut në OSHEE SHA., me Nr. 1061 Prot., datë 04/04/2017, pika 1.1 “ Në çdo Njësi, caktohet një person, i/e cili/a do të ketë si detyrë funksionale, përgjegjësinë për ndjekjen e Regjistrin të Riskut, Zotëruesi i Riskut, brenda njësisë organizative të tij/saj. Zotëruesi i Riskut sugjerohet të mbajë pozicionin e Shefit të Sektorit apo Drejtor Drejtorie”.

Pyetjes së pyetësorit për vetëvlerësimin për MFK referuar faktit “A e kryen njësia publike periodikisht një vlerësim të ekspozimit të saj ndaj veprimtarisë mashtruese dhe si mund të ndikohen veprimtaritë e saj? A përfshin ky vlerësim secilën nga njësitë e vartësisë? , Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit në OSHEE SHA, i është përgjigjur me dokumentin e Politikës së Administrimit të Riskut në OSHEE SHA ,versionin 1.1, Nr. 27917 Prot., dt 24/11/2016.

Nga përgjigjet e pyetësorit dhe nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, për periudhën objekt auditimi:

-Nuk evidentohen hartimi periodik i regjistrin të risqeve të shoqërisë “OSHEE” SHA nga menaxhimi i lartë, duke mos evidentuar risqet e mundshme si dhe mundësinë e ndodhjes së tyre;

-Drejtoritë Rajonale nuk kanë një program ekonomik financiar të miratuar, por veprojnë mbi bazën e targeteve mujore të dërguara nga Divizionet dhe Departamentet e “OSHEE” SHA;

-Shoqëria OSHEE SHA, nuk ka një rregullore të miratuar në Këshillin Mbikqyrës,të funksionimit të Drejtorive/Njësive në vartësi të shoqërisë dhe në qëndër.

-Shoqëria OSHEE SHA, nuk ka ndërtuar gjurmën e auditimit për proceset kryesore të punës;

-Shoqëria OSHEE SHA, nuk ka hartuar plane të kontrollit të brendshëm (Plani lokal);

-Referuar politikës së riskut , versioni 14.09.2016, konkretisht aneksi 4 , pika 3/g përcaktohet se “Komiteti i Riskut të paktën një herë në vit të rishikojë dhe miratojë politikën e menaxhimit të riskut” , ndërkohë nga auditimi konstatohet se kjo politika nuk janë ndryshuar periodikisht edhe pse mund të jenë në proces amendimi, ***sepse OSHEE SHA aktualisht punon*** me Udhëzimet e Administrimit të Riskut versionin 1.1, Nr. 1061 Prot., dt 4/4/2017 dhe Politikën e Administrimit të Riskut versionin 1.1, Nr. 27917 Prot., dt 24/11/2016 dhe me dokumentin e Politikës së Administrimit të Riskut në OSHEE SHA ,versionin 1.1, Nr. 27917 Prot., dt 24/11/2016, ***pra OSHEE SHA, ka rreth 3 vjet pa amenduar politikën dhe udhëzimet e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në shoqëri , në kundërshtim me ligjin Nr.10296***

dt.08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", Urdhërit i Ministrisë të Financave Nr.8980 dt.15.07.2010 "Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin"

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi 1.znj. I. M. në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Zhvillimit të Biznesit dhe 2. z.A. C. në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë.

Kriteri:

-Ligjin Nr.10296 dt.08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", Urdhërit i Ministrisë të Financave Nr.8980 dt.15.07.2010 "Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin"

-Neni 4/ pika 3 "Kontroll i brendshëm" është procesi integral i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe i auditimit të brendshëm, i vendosur nga titullari i njësisë publike, brenda objektivave të tij qeverisë, për të ndihmuar në kryerjen e veprimtarive të njësisë publike, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet

-Neni 4/ pika 19 "Gjurma e auditimit" përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve"

-Neni 21 Menaxhimi i riskut

1. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

2. Për t'i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të

Mjedisit të riskut. ***Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollin që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.***

-neni 9 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues", pika 3 citohet "Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësive të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe ***të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësi,*** masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë",

-Udhëzimet e Administrimit të Riskut versionin 1.1, Nr. 1061 Prot., dt 4/4/2017 dhe Politikën e Administrimit të Riskut versionin 1.1, Nr. 27917 Prot., dt 24/11/2016 dhe me dokumentin e Politikës së Administrimit të Riskut në OSHEE SHA ,versionin 1.1, Nr. 27917 Prot., dt 24/11/2016 dhe

Ndikimi/Efekti:

Nga OSHEE SHA mos hartimi i programit ekonomik financiar të miratuar për drejtoritë rajonale, mos hartimi i një rregullore të brendshme të funksionimit të Drejtorive/Njësive në vartësi të shoqërisë dhe në qendër dhe mos ndërtimi i gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës Drejtorive/Njësive në vartësi të shoqërisë dhe në qendër sipas detyrave funksionale dhe mos hartimi i planeve të kontrollit të brendshëm (Plani lokal) ka ndikuar në mos identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike.

Shkaku:

Mosvlerësimi i duhur në nivel menaxherial i shoqërisë dhe nga Drejtoria e

Zhvillimit të Biznesit për evidentimin e problematikave që rrjedhin si pasojë e mos hartimit të kuadrit rregullator dhe të biznesit të shoqërisë gjithashtu mungesa e analizës dhe përditësimi i kontrolleve që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.

Rëndësia:

I lartë

Rekomandime:

1.1 Rekomandimi: Nga shoqëria OSHEE SHA, të merren masa që të përditësohet kuadri rregullator për proceset kryesore të punës Drejtorive/Njësive në vartësi të shoqërisë dhe në qendër referuar ndryshimeve strukturore që ka pësuar shoqëria nga ndarja e saj në shoqëri (mëma dhe bija), sipas detyrave funksionale duke përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

1.2 Rekomandimi: Nga shoqëria OSHEE SHA dhe Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit, të merren masa për monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të shoqërisë në nivel qendror dhe rajonal sipas shkallës së përgjegjësisë gjithashtu të raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga shoqëria, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë.

1.3 Rekomandimi: Nga shoqëria OSHEE SHA dhe Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit, të merren masa për amendimin e politikave të riskut referuar ndryshimeve strukturore që ka pësuar shoqëria nga ndarja e saj në shoqëri (mëma dhe bija) duke përditësuar politikat dhe monitorimin e objektivave" të shoqërisë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

2.11. Mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm

Organizimi i DAB në OSHEE SHA.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të “OSHEE” SHA, është krijuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.12, datë 06.02.2015, është e organizuar në rang Drejtorie me katër sektorë përkatësisht sektori i sigurimit të cilësisë së auditimit dhe trajnimeve, sektori ekonomik, sektori i ekspertizës teknike dhe sektori i auditimit të performancës dhe operacioneve mbështetëse. DAB është në varësi të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, në përputhje me statutin e shoqërisë, neni 16.3, germa k dhe ka në përbërjen e saj 22 punonjës (Drejtor + 21 punonjës), nga këto 18 punonjës janë të certifikuar nga Njësia e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave si Auditues të Brendshëm, ndërsa 4 punonjës janë të pa certifikuar.

Karta e auditimit të brendshëm dhe rregullorja e brendshme e funksionimit të departamentit të auditimit të brendshëm në OSHEE SHA, janë dy dokumentet bazë që rregullojnë veprimtarinë e DAB, të cilat janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë me vendimin nr.27, datë 07.07.2016. Këto dokumente janë amenduar me vendimin nr.24, datë 02.07.2020 të Këshillit Mbikëqyrës.

Personeli i DAB

Personeli i DAB-së nuk është pajisur i tëri me Certifikatën e Audituesit të Brendshëm si dhe ka në përbërjen e vet vetëm një auditues që është inxhinier i fushës së energjisë, një inxhinier i teknologjisë së informacionit (IT) dhe një Inxhinier Fizike. *Kjo problematikë krijon vështirësi në formimin e grupeve të punës, në misione komplekse auditimi, referuar edhe sistemeve dixhitale të faturimit SAAP, Billing, me të cilat operon OSHEE SHA.* Audituesit e DAB, kanë një vjetërsi pune në profesion që varion nga 2 deri 33 vjet ndërsa në auditim nga 0 deri në 13 vjet.

Veprimtaria e DAB në OSHE për periudhën objekt auditimi

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të “OSHEE” SHA, ka hartuar planin vjetor 2017 dhe planin strategjik 2017-2021 të objekteve për tu audituar në OSHEE SHA, miratuar me vendimin nr.47, datë 10.10.2016 të Këshillit Mbikëqyrës.

Llojet e auditimeve të planifikuara për periudhën 2017-2021 nga DAB janë:

Angazhime auditimi për shërbimet e sigurisë nga të cilat, Auditime përputhshmërie, Auditime financiare, Auditim performance, Auditim i teknologjisë dhe Informacionit dhe Auditim për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve.

Referuar planifikimit dhe realizimit të auditimeve nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm pranë OSHEE SHA për çdo vit objekt auditimi, konstatohet se:

-Për vitin 2017 DAB ka hartuar planin vjetor 2017, të objekteve për tu audituar në OSHEE SHA, i cili është miratuar me vendimin nr.47, datë 10.10.2016 të Këshillit Mbikëqyrës në të cilin janë planifikuar 25 auditime dhe janë realizuar 18 auditime, nuk janë realizuar 6 auditime, 1 prej të cilëve për mungesë Inxhinieri IT në DAB, më hollësisht e detajuar si më poshtë si vijon:

Tabela nr. 6 Auditime të planifikuara dhe të realizuara në vitin 2017

Nr	Objekte për tu audituar	Lloji i auditimit FuSHA e auditimit	Numri i auditimeve	
			Plan	Fakt
1	Drejtoria Rajonale Tiranë	I Plotë	1	1
2	Drejtoria Rajonale Fier	I Plotë	1	1
3	Drejtoria Rajonale Berat	I Plotë	1	1
4	Drejtoria Rajonale Burrel	I Plotë	1	1
5	Drejtoria Rajonale Shkodër	I Plotë	1	1
6	Njësia/Tens. të Lartë/Qëndër	I Plotë	1	1
7	Njësia/Tens. të Lartë/Lindje	I Plotë	1	1
8	Departamenti i Burimeve Njerëzore	Sistemi i burimeve njerëzore	1	1
9	Drejtoria Ligjore	Çështjet gjyqësore	1	1
10	Departamenti Ekonomik	Tematik	2	-

11	Njësia/Tens. të Lartë/Perëndim	I Plotë	1	1
12	Drejtoria Rajonale Gjirokastrë	Sistemi i Fat të Energjisë	1	1
13	Njësia Vlorë	Sistemi i Fat të Energjisë	1	1
14	Drejtoria Rajonale Shkodër	Sistemi i Fat të Energjisë	1	1
15	Drejtoria Rajonale Durrës	Sistemi i Fat të Energjisë	1	1
16	Depart i marrëdhënieve me klientin	Sistemi i kujdesit klientëve	1	-
17	Drejtoria Rajonale Elbasan	Sistemi i Fat të Energjisë	1	-
18	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	I Plotë	1	-
19	Drejtoria e TI	Sistemet e Informacionit	1	-
20	Dep i Mena dhe Zhvillimit të Aseteve	I Plotë	1	-
21	Drejtoria Rajonale, Divizionet, Departamentet dhe Drejtoritë në qendër	Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve	4	4
TOTALI			25	18

Burimi: Të dhëna të OSHEE, përpunuar nga grupi i auditimit

-Për vitin 2018 Departamenti i Auditimit të Brendshëm të “OSHEE” SHA, ka hartuar planin vjetor 2018, të objekteve për tu audituar në OSHEE SHA, miratuar me vendimin nr.55, datë 10.10.2017 të Këshillit Mbikëqyrës, në të cilin janë planifikuar 16 auditime dhe janë realizuar 14 të tilla, 2 *auditime nuk janë realizuar*, ndërkohë janë përfunduar 3 auditime që janë mbartur nga viti 2017, më hollësisht e detajuar si më poshtë si vijon:

Tabela nr. 7 Auditime të planifikuara dhe të realizuara në vitin 2017

Nr	Objekte për tu audituar	Lloji i auditimit FuSHA e auditimit	Numri i auditimeve	
			Plan	Fakt
1	Departamenti Ekonomik (Divizioni Ad.Korporatës)	Kreditë dhe Overdraftet	1	1
2	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (Divizioni Ad.Korporatës)	I Plotë	1	1
3	Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit	Auditim Tematik	1	1
4	Departamenti i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Aseteve (Divizioni i Shpërndarjes)	Lidhjet e reja	1	1
5	Departamenti i Bilancit të Matjes (Divizioni i Shpërndarjes)	Menaxhimi i Matjes	1	1
6	Drejtoria e Tensionit të Lartë (NjTL)	I Plotë	1	1
7	Drejtoria Rajonale Tiranë	Sistemi i Faturimit	1	1
8	Drejtoria Rajonale Elbasan	Sistemi i Faturimit	1	1
9	Drejtoria Rajonale Korçë	Sistemi i Faturimit	1	1
10	Drejtoria Rajonale Fier	Sistemi i Faturimit	1	1
11	Drejtoria Rajonale Berat	Sistemi i Faturimit	1	1
12	Drejtoria Rajonale Burrel	Sistemi i Faturimit	1	1
13	Departamenti i Faturimit dhe Arkëtimit	Kontratat TM Prim	1	1
14	Drejtoria Rajonale Shkodër	I Plotë	1	1
15	Drejtoria Rajonale Durrës		1	-
16	Departamenti i Tregtimit të Energjisë Elektrike		1	-
TOTALI			16	14

Burimi: Të dhëna të OSHEE, përpunuar nga grupi i auditimit

-Për vitin 2019 Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të “OSHEE” SHA, ka hartuar programin vjetor 2019, të objekteve për t’u audituar në OSHEE SHA, miratuar me vendimin nr.27, datë 18.10.2018 të Këshillit Mbikqyrës në të cilin janë planifikuar 16 auditime ndërkohë janë realizuar 14 të tilla dhe 2 auditime nuk janë realizuar për shkak të mos planifikimit të duhur të faktorit kohë që duhet për realizimin e tyre nga DAB, më hollësisht e detajuar si më poshtë si vijon .

Tabela nr. 8 Auditime të planifikuara dhe të realizuara në vitin 2017

Nr	Objekte për tu audituar	Lloji i auditimit Fusha e auditimit	Numri i auditimeve	
			Plan	Fakt
1	Departamenti Menaxhimit të Rrjetit dhe Asistencës Teknike /Drejtoria e Riparimit të Transformatorëve dhe Avarive	Menaxhimi i lëvizjes dhe riparimit të transformatorëve	1	1
2	Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse /Dep.Ekonomik	Procesi i Inventarizimit të Magazinave	1	1
3	Departamenti i Shitjes dhe Arkëtimit	Procesi i arkëtimit	1	1
4	Drejtoria e Tensionit të Lartë (NjTL)	Lidhjet e reja	1	1
5	Drejtoria Ligjore	Regjistrimi i pasurive të paluajtshme	1	1
6	Drejtoria Rajonale Gjirokastrë	I kombinuar mbi bazë sistemi	1	1
7	Drejtoria Rajonale Durrës	I kombinuar mbi bazë sistemi	1	1
8	Drejtoria Rajonale Fier	I kombinuar mbi bazë sistemi	1	1
9	Drejtoria Rajonale Korçë	I kombinuar mbi bazë sistemi	1	1
10	Drejtoria Rajonale Berat	I kombinuar mbi bazë sistemi	1	1
11	Drejtoria Rajonale Elbasan	I kombinuar mbi bazë sistemi	1	1
12	Drejtoria Rajonale Shkodër	I kombinuar mbi bazë sistemi	1	1
13	Njësia Vlorë	I kombinuar mbi bazë sistemi	1	1
14	Njësia Kukës	I kombinuar mbi bazë sistemi	1	1
15	Departamenti i Marrëdhënieve me Klientin	I kombinuar	1	-
16	Departamenti i Tregtimit të Energjisë	Përputhshmërie	1	-
TOTALI			16	14

Burimi: Të dhëna të OSHEE, përpunuar nga grupi i auditimit.

-Për vitin 2020 janë planifikuar të zhvillohen rreth 16 angazhime auditimi, numër i njëjtë me vitin 2019 megjithatë aktualisht janë përfunduar rreth 6 auditime. Gjate 6-mujorit të parë të vitit 2020, Departamenti i Auditimit të Brendshëm në "OSHEE" SHA, ka ushtruar veprimtarinë e tij referuar planit vjetor të auditimit për vitin 2020, miratuar nga Këshilli Mbikqyrës me vendimin Nr.33, datë 22.10.2019. Auditimet të cilat kanë përfunduar janë :Angazhimi i auditimit në Drejtorinë e Sigurimit Teknik në "OSSH" SHA; Angazhimi i auditimit në Drejtorinë Rajonale Berat në "OSSH" SHA; Angazhimi i auditimit në Drejtorinë Rajonale Fier në "OSSH" SHA; Angazhimi i auditimit në Drejtorinë Rajonale Burrel në "OSSH" SHA; Angazhimi i auditimit në Drejtorinë Rajonale Vlorë në "OSSH" SHA; Angazhimi i auditimit në Drejtorinë Rajonale Vlorë në "FSHU" SHA;

Sipas raportit të DAB për veprimtarinë e 6 mujorit të parë 2020 (raport i cili nuk është paraqitur në

Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë), auditimet për vitin 2020 nuk kanë nisur më shpejt se muaji Maj 2020 për shkak të ristrukturimit të shoqërisë OSHEE SHA dhe pandemisë Covid 2019. Vlen të theksojmë se auditimet e DAB për vitin 2020, nuk kanë iniciuar që në muajin Janar 2020 periudhë në të cilën nuk gjendeshim përpara faktit të situatës së pazakontë, si pasojë e Covid -19.

Plani vjetor i auditimit për vitin 2020 është miratuar që në muajin tetor 2019 dhe DAB ende ka pasur auditime të mbartura nga viti 2019 të porealizuara. Riskstrukturimi i shoqërisë si shkak i përmendur nga DAB për mosfillimin e auditimeve të planifikuara për vitin 2020, nuk është bërë objekt relacioni apo diskutimi nga Drejtoria e DAB në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë. Këto veprime janë në kundërshtim me kartën e auditimit të brendshëm dhe rregulloren e brendshme e funksionimit të departamentit të auditimit të brendshëm në OSHEE SHA, të ndryshuar. Më hollësisht tabela e subjekteve të planifikuara për t'u audituar gjatë vitit 2020, si më poshtë vijon dhe fakti i realizimit për 6 mujorin e parë 2020 :

Tabela nr. 9 Auditime të planifikuara dhe të realizuara në vitin 2017

N r	Objekte për tu audituar	Lloji i auditimit Fusha e auditimit	Numri i auditimeve	
			Plan	Fakt
1	Departamenti i Burimeve Njerëzore	I Kombinuar	1	-
2	Departamenti Ekonomik	Financiar	1	-
3	Departamenti i Leximit, Menaxhimit të Matjes dhe Bilancit Energjistik	I Kombinuar	1	-
4	Drejtoria e Sigurimit Teknik		1	1
5	Departamenti i Menaxhimit të Rrjetit dhe Asistencës Teknike	Përputhshmërie	1	-
6	Departamenti i Marrëdhënieve me Klientin	Përputhshmërie	1	-
7	Departamenti i Shitjes dhe Arkëtimit	Përputhshmërie	1	-
8	Departamenti i Tregëtimit të Energjisë	I Kombinuar	1	-
9	Drejtoria Rajonale Tiranë	I Kombinuar	1	1
10	Drejtoria Rajonale Burrel	I Kombinuar	1	-
11	Drejtoria Rajonale Durrës	I Kombinuar	1	-
12	Drejtoria Rajonale Fier	I Kombinuar	1	1
13	Drejtoria Rajonale Berat	I Kombinuar	1	1
14	Njësia Vlorë	I Kombinuar	1	1
15	Drejtoria Rajonale Vlorë	I Kombinuar	1	1
16	Departamente/Drejtori në Qëndër dhe Rajone		1	-
TOTALI			16	6

Burimi: Të dhëna të OSHEE, përpunuar nga grupi i auditimit

Për periudhën 2017-2019, gjendja e zbatimit të rekomandimeve nga strukturat e OSHEE SHA , në total janë dhënë nga DAB rreth 292 rekomandime nga të cilat 292 rekomandime janë pranuar nga menaxhimi, janë zbatuar 236 rekomandime, në proces janë 34 rekomandime dhe pa zbatuar janë 22 rekomandime.

Ndër rekomandimet kryesore që kanë mbetur pa u realizuar brenda afateve të përcaktuara janë ato që kanë lidhje me :

- Përgatitjen e rregulloreve të brendshme të funksionimit të Drejtorive/Njësive në vartësi të OSHEE SHA dhe në qendër;
- Ndërtimi i gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës;
- Hartimi i regjistrit të riskut;
- Hartimi i planeve të kontrollit të brendshëm (Plani lokal);
- Përmirësimi i kushteve të ruajtjes së aktiveve në magazina, në drejtim të kryerjes së investimeve, riparimeve, sistemimit të mallrave etj.
- Ndryshimi i sistemit të matjes nga matësa induktiv në matësa elektronik;

-Ndryshimi dhe sistemimi në sistem apo terren i fuqisë së kërkuara dhe fuqisë së instaluar;
-Ndryshimi i kategorisë për të gjithë abonentët e evidentuar gjatë auditimeve me kategori të ndryshme nga ajo e cila faturoheshin;
-Rekomandimet e natyrës disiplinore dhe zhdëmtuese janë zbatuar pjesërisht , sepse ka ndikuar bashkëveprimi ndërmjet strukturave në bazë dhe qendër.

Për sa më lart grupi i auditimit konstaton se për periudhën 1.07.2017-30.06.2020, nuk është realizuar plani i auditimeve sipas periudhës së përcaktuar në programin strategjik 2017-2020 dhe planet vjetore të auditimit, por disa nga auditimet e planifikuara nga DAB për çdo vit të mbetura pa u audituar janë mbartur në vitin pasardhës, ose nuk janë realizuar, në kundërshtim me kartën e auditimit të brendshëm dhe rregulloren e brendshme e funksionimit të departamentit të auditimit të brendshëm në OSHEE SHA, të ndryshuar dhe pikës 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Referuar Pasqyrës nr. 2 të planit strategjik dhe vjetor të subjekteve të synuara për auditim për vitet 2018-2020, konstatohet se: **në vitin 2018**, DAB ka programuar auditime në 15 subjekte nga të cilat **7 auditime** në Departamente/Drejtori pranë shoqërisë dhe **8 auditime** në Drejtori / Divizione/ Departamente Rajonale, për të cilat niveli i riskut në **8 prej tyre është vlerësuar i lartë**;

Në zbatimin e kërkesave metodologjike për hartimin e këtyre planeve, vërehen disa mospërputhje të cilat i referohen pikës **3.1.3 të Manualit të AB**, në të cilën shprehet:

“...Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit, ndërsa për sistemet që vlerësohen me një nivel risku më të ulët mund të planifikohen për t'u audituar me rrallë, por jo më shumë se 5 vjet...”, pasi 4 Departamente/Drejtori megjithëse janë vlerësuar me risk të lartë, nuk janë planifikuar për t'u audituar në vitet 2019-2020 megjithatë DAB në pikën 2.2 "Identifikimi i subjekteve" të Kreut II të "Planit Strategjik 2018-2020 dhe Planit Vjetor 2018 të objekteve për tu audituar në OSHEE SHA", ka shprehur qëndrimin se subjektet me risk të lartë është menduar të auditohen çdo vit dhe ato me risk të mesëm dhe të ulët çdo 2-3 vjet.

Konkretisht nga DAB në OSHEE SHA, nuk janë planifikuar për auditim **as për vitin 2019 dhe as për vitin 2020** : Departamenti i Zhvillimit dhe i Menaxhimit të Aseteve, Departamenti i Bilancit të Matjes (Divizioni i Shpërndarjes), Departamenti i Tregtimit të Energjisë Elektrike dhe Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit (Divizioni i Administrimit të Korporatës), edhe pse janë konsideruar me risk të lartë, veprime këto në kundërshtim me pikën 3.1.3 të Manualit të AB.

*Nga Drejtori i DAB nuk është paraqitur pranë Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë asnjë relacion zyrtar lidhur me raportimin në mënyrë periodike për rezultatet e veprimitarisë së auditimit brenda **6 mujorit të parë të vitit 2020** dhe as më parë gjithashtu nuk janë pasqyruar as njoftuar arsyet e mos fillimit në kohë të auditimeve referuar shkaqeve që kanë sjellë vonesa në inicimin në kohë të tyre gjithashtu edhe statusin aktual të auditimeve që janë në proces, në kundërshtim me nenin 6, pika 12 të Kartës së Auditimit të Brendshëm në “OSHEE Group” SHA me nr.27, datë 03.06.2020, ndryshuar me dokumentin me nr.24, datë 02.07.2020 dhe Rregulloren e funksionimit të brendshëm organizativ të drejtorisë së auditimit të brendshëm në “OSHEE Group” SHA, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të “OSHEE Group” SHA nr.27, datë 07.07.2016, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të “OSHEE Group” SHA nr.24, datë 02.07.2020, neni 9.Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi z. G. Sh., në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm në OSHEE SHA. Përsa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr.34, datë 18.09.2020.*

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr.546/4, datë 19.11.2020 protokolluar në OSHEE SHA, nr.12149, datë 23.11.2020 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.12149/40, datë 22.12.2020,“Mbi Projekt Raportin e Auditimit” nga z.Edmond Gorezi, vënë në dispozicion grupit të auditimit më datë 28.12.2020, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: -Për periudhën janar–shkurt 2020 shoqëria ka qenë në një proces ndarje dhe riorganizimi të brendshëm që është shoqëruar me ndarje të aktiviteteve, përgjegjësive dhe

kompetencave, në këto kushte ka qenë e pamundur nga ana e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm kryerja e angazhimeve të auditimit pasi ato do të ishin më shumë një barrë e shtuar se një vlerë e shtuar.

- Për periudhën 2017-2020, realizimi i programit vjetor të auditimit është mesatarisht në masën 90 %. Lidhur me shkaqet e mungesës së realizimit të programit vjetor në masën 100% kemi dhënë shpjegimet e nevojshme në raportin vjetor në organet drejtuese të shoqërisë. Në vlerësimin e DAB niveli i realizimit është i kënaqshëm dhe nuk ka cenuar arritjen e objektivave të shoqërisë.

-Ne lidhje me mungesën e planifikimit për vitin 2018 te 4 subjekteve të vlerësuara me risk te larte vlerësojmë se ka nevojë të ri-verifikohet pasi 3 subjektet e para janë përfshirë në program ndërsa DTI nuk është përfshirë për mungesë Inxhinieri IT, aktualisht tre nga këto struktura janë në proces auditimi në vitin 2020.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

-sipas raportit të DAB për veprimtarinë e 6 mujorit të parë 2020 (raport i cili nuk është paraqitur në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020), auditimet për vitin 2020 nuk kanë nisur më shpejt se muaji Maj 2020 me arsye se shkak është bërë ristrukturimi i shoqërisë OSHEE SHA dhe pandemia Covid 2019. Vlen të theksojmë se auditimet e DAB për vitin 2020, nuk kanë iniciuar që në muajin Janar 2020 periudhë në të cilën nuk gjendeshim përpara faktit të situatës së pazakontë, si pasojë e Covid -19. Plani vjetor i auditimit për vitin 2020 është miratuar që në muajin tetor 2019 dhe nga DAB ende ka pasur auditime të mbartura nga viti 2019 të porealizuara.

- Ristrukturimi i shoqërisë si shkak i përmendur nga DAB për mosfillimin e auditimeve të planifikuara për vitin 2020, nuk është bërë objekt relacioni apo diskutimi nga Drejtoria e DAB në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë dhe nevoja për raportim në mënyrë specifike për mos fillimin e angazhimeve të programuara në planin vjetor 2020 **nuk ka natyrë opsionale por është kërkesë ligjore.** “Mirëkuptimi” i organeve drejtuese drejtuar Drejtorisë së Auditit të Brendshëm duhet të përcillet me vendim nëse ndikon në mosrealizimin e planit auditues edhe kur jemi para faktit të situatave të pazakonta, megjithatë mosrealizimi i planit vjetor të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm është fenomen i mbartur që nga viti 2017, pikërisht nga dokumentet dhe evidencat që DAB i vuri në dispozicion grupit të auditimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme referuar veprimtarisë së DAB janë në **kundërshtim me** -Ligj nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 6 “Roli i auditimit të brendshëm, a) duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, **si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar**; pika vi) **përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve**; neni 14, pika a) organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me nenin 8 të këtij ligji;c) hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor për veprimtarinë e auditimit të brendshëm dhe dërgimin për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, pas miratimit nga titullari i njësisë publike”;-Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe me nenin 6, pika 12 të Kartës së Auditimit të Brendshëm në “OSHEE Group” SHA me nr.27, datë 03.06.2020, ndryshuar me dokumentin me nr.24, datë 02.07.2020 dhe Rregulloren e funksionimit të brendshëm organizativ të drejtorisë së auditimit të brendshëm në “OSHEE Group” SHA, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të “OSHEE Group” SHA nr.27, datë 07.07.2016, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të “OSHEE Group” SHA nr.24, datë 02.07.2020, neni 9., **prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do trajtohet në materialin e auditimit.**

- Për 4 Departamente/Drejtori megjithëse janë vlerësuar me risk të lartë, nuk janë planifikuar për tu audituar në vitet **2019-2020**, megjithatë DAB në pikën 2.2 "Identifikimi i subjekteve" të Kreut II të "Planit Strategjik 2018-2020 dhe Planit Vjetor 2018 të objekteve për tu audituar në OSHEE SHA", ka shprehur qëndrimin se subjektet me risk të lartë është menduar të auditohen çdo vit dhe ato me risk të mesëm dhe të ulët çdo 2-3 vjet. Konkretisht nga DAB në OSHEE SHA, nuk janë planifikuar për auditim **as për vitin 2019 dhe as për vitin 2020** : Departamenti i Zhvillimit dhe i Menaxhimit të Aseteve, Departamenti i Bilancit të Matjes (Divizioni i Shpërndarjes), Departamenti i Tregtimit të Energjisë Elektrike dhe Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit (Divizioni i Administrimit të

Korporatës), edhe pse janë konsideruar me risk të lartë, veprime këto në kundërshtim me pikës 3.1.3 të Manualit të AB., referuar tabelave të paraqitura në akt-konstatim grupi i auditimit është shprehur për vitin 2019-2020, **megjithatë as në vitin 2017** edhe pse ishin planifikuar këto struktura, nuk ishin audituar nga DAB, si rrjedhojë veprimet dhe mosveprimet e mësipërme referuar veprimtarisë së DAB janë në **kundërshtim me** -Ligj nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 6 “Roli i auditimit të brendshëm, a) duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, **si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar**; pika vi) **përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve**; neni 14, pika a) organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me nenin 8 të këtij ligji; c) hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor për veprimtarinë e auditimit të brendshëm dhe dërgimin për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, pas miratimit nga titullari i njësisë publike”;-Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe me nenin 6, pika 12 të Kartës së Auditimit të Brendshëm në “OSHEE Group” SHA me nr.27, datë 03.06.2020, ndryshuar me dokumentin me nr.24, datë 02.07.2020 dhe Rregulloren e funksionimit të brendshëm organizativ të drejtorisë së auditimit të brendshëm në “OSHEE Group” SHA, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të “OSHEE Group” SHA nr.27, datë 07.07.2016, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të “OSHEE Group” SHA nr.24, datë 02.07.2020, neni 9, **prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe trajtohet në materialin e auditimit.**

1. Titulli i Gjetjes Mosrealizimi i auditimeve nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të “OSHEE” SHA, sipas planeve të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, për periudhën 2017, 2018, 2019 dhe 6 mujorin e parë 2020.

Situata: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në OSHEE SHA për periudhën 2017,2018,2019 dhe 6 mujorin e parë 2020 është konstatuar se :

Për vitin 2017 Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të “OSHEE” SHA ,ka hartuar planin vjetor 2017, të objekteve për tu audituar në OSHEE SHA, i cili është miratuar me vendimin nr.47, datë 10.10.2016 të Këshillit Mbikëqyrës në të cilin janë planifikuar 25 auditime, janë realizuar 18 auditime, **nuk janë realizuar 7 auditime** , 1 prej të cilëve *për mungesë Inxhinieri IT në DAB.*

Për vitin 2018 Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të “OSHEE” SHA, ka hartuar planin vjetor 2018, të objekteve për tu audituar në OSHEE SHA, miratuar me vendimin nr.55, datë 10.10.2017 të Këshillit Mbikëqyrës, në të cilin janë planifikuar 16 auditime, janë realizuar 14 të tilla, **2 auditime nuk janë realizuar**, ndërkohë janë përfunduar **3 auditime që janë mbartur nga viti 2017.**

Për vitin 2019 Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të “OSHEE” SHA, ka hartuar programin vjetor 2019, të objekteve për tu audituar në OSHEE SHA, miratuar me vendimin nr.27, datë 18.10.2018 të Këshillit Mbikëqyrës në të cilin janë planifikuar 16 auditime ndërkohë janë realizuar 14 të tilla dhe **2 auditime nuk janë realizuar për shkak të mos planifikimit të duhur të faktorit kohë që duhet për realizimin e tyre nga DAB.**

Për vitin 2020 janë planifikuar të zhvillohen rreth 16 angazhime auditimi, numër i njëjtë me vitin 2019 megjithatë deri në datë 30.06.2020 janë përfunduar rreth 6 auditime. Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2020, Departamenti i Auditimit të Brendshëm ne "OSHEE" SHA, ka ushtruar veprimtarinë e tij referuar planit vjetor të auditimit për vitin 2020, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin Nr.33, datë 22.10.2019. Auditimet të cilat kanë përfunduar janë: Angazhimi i auditimit në Drejtorinë e Sigurimit Teknik ne "OSSH" SHA; Angazhimi i auditimit ne Drejtorinë Rajonale Berat ne "OSSH" SHA; Angazhimi i auditimit ne Drejtorinë Rajonale Fier ne

"OSSH" SHA; Angazhimi i auditimit ne Drejtorinë Rajonale Burrel ne "OSSH" SHA; Angazhimi i auditimit ne Drejtorinë Rajonale Vlorë ne "OSSH" SHA; Angazhimi i auditimit ne Drejtorinë Rajonale Vlore në "FSHU" SHA; Sipas raportit të DAB për veprimtarinë e 6 mujorit të parë 2020 (raport i cili nuk është paraqitur në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020), auditimet për vitin 2020 nuk kanë nisur më shpejt se muaji Maj 2020 me arsye se shkak është bërë ristrukturimi i shoqërisë OSHEE SHA dhe pandemia Covid 2019. Vlen të theksojmë se auditimet e DAB për vitin 2020, nuk kanë iniciuar që në muajin Janar 2020 periudhë në të cilën nuk gjendeshim përpara faktit të situatës së pazakontë, si pasojë e Covid -19. **Plani vjetor i auditimit për vitin 2020 është miratuar që në muajin tetor 2019 dhe nga DAB ende ka pasur auditime të mbartura nga viti 2019 të porealizuara.** Ristrukturimi i shoqërisë si shkak i përmendur nga DAB për mos fillimin e auditimeve të planifikuara për vitin 2020, nuk është bërë objekt relacioni apo diskutimi nga Drejtoria e DAB në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë. Këto veprime janë në kundërshtim me kartën e auditimit të brendshëm dhe rregulloren e brendshme e funksionimit të departamentit të auditimit të brendshëm në OSHEE SHA, të ndryshuar.

- **Për periudhën 1.07.2017-30.06.2020**, nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në OSHEE SHA nuk është realizuar plani i auditimeve sipas periudhës së përcaktuar në programin strategjik 2017-2020 dhe planet vjetore të auditimit, por disa nga auditimet e planifikuara nga DAB për çdo vit të mbetura pa u audituar janë mbartur në vitin pasardhës, ose nuk janë realizuar, në kundërshtim me Ligj nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 14, pika c) hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor për veprimtarinë e auditimit të brendshëm dhe dërgimin për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, pas miratimit nga titullari i njësisë publike”, kartën e auditimit të brendshëm dhe rregulloren e brendshme e funksionimit të departamentit të auditimit të brendshëm në OSHEE SHA, të ndryshuar dhe pikës 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe me nenin 6, pika 12 të Kartës së Auditimit të Brendshëm në “OSHEE Group” SHA me nr.27, datë 03.06.2020, ndryshuar me dokumentin me nr.24, datë 02.07.2020 dhe Rregulloren e funksionimit të brendshëm organizativ të drejtorisë së auditimit të brendshëm në “OSHEE Group” SHA, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të “OSHEE Group” SHA nr.27, datë 07.07.2016, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të “OSHEE Group” SHA nr.24, datë 02.07.2020, neni 9. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi z.G. Sh., në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm në OSHEE SHA.

Kriteri:

Ligj nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 6 “Roli i auditimit të brendshëm , a) duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, **si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar**; pika vi) **përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve**; neni 14, pika a) organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me nenin 8 të këtij ligji;

c) hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor për veprimtarinë e auditimit të brendshëm dhe dërgimin për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, pas miratimit nga titullari i njësisë publike”

-Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe me nenin 6, pika 12 të Kartës së Auditimit të Brendshëm në “OSHEE Group” SHA me nr.27, datë 03.06.2020, ndryshuar me dokumentin me nr.24, datë 02.07.2020 dhe Rregulloren e funksionimit të brendshëm organizativ të drejtorisë së auditimit të brendshëm në “OSHEE Group” SHA, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikqyrës të “OSHEE Group” SHA nr.27, datë 07.07.2016, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikqyrës të “OSHEE Group” SHA nr.24, datë 02.07.2020, neni 9.

Ndikimi/Efekti: Mosrealizimi i plotë i planit të auditimit nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm sipas planeve të miratuara nga Këshilli Mbikqyrës të shoqërisë, ndikon në mungesën e pasqyrimit objektiv, transparent i të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e shoqërisë për arritjen e objektivave dhe në përmirësimin e aktivitetit të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA.

Shkaku: Mos planifikimi i duhur i faktorit kohë dhe mos identifikimi i risqeve të trashëguara vit pas viti në planifikim dhe auditim nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në OSHEE SHA, dhe mungesa e burimeve njerëzore përse i përket fushës së ekspertizës nga ana e inxhinierisë energjitike apo inxhinierisë informative referuar sistemeve elektronike (faturimit), në aspektin e shkaqeve dhe arsyeve që kanë sjellë mosrealizimin e auditimeve të mbartura vit pas viti.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandime: **1.1 Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të planit të auditimit pas miratimit në organet drejtuese të shoqërisë, sipas afateve të përcaktuara me qëllim pasqyrimin objektiv, transparent të të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e shoqërisë OSHEE SHA.

1.2 Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikqyrës i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA, të merren masa për monitorimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në raport me veprimtarinë e shoqërisë, duke sugjeruar plotësimin e burimeve njerëzore të DAB me inxhinierë të fushës së energjisë dhe inxhinierë IT, për identifikimin e risqeve në aspektin e kompetencës e cila nënkupton zotërimin dhe përdorimin e njohurive, aftësive dhe eksperiencës së duhur në ushtrimin e veprimtarisë audituese, faktorë të cilët ndikojnë në mbështetjen drejtuar organeve drejtuese dhe administratorit të shoqërisë për arritjen e objektivave dhe përmirësimin e aktivitetit të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA.

2.12. Të ndryshme, që do të dalin gjatë auditimit

a) Çështja e shpërblimit të veçantë të këshillit mbikëqyrës në fund të vitit 2018.

1. Titulli i Gjetjes Shpërblim i padrejtë i këshillit mbikëqyrës në fund të vitit 2018

Situata: Vendimi i aksionarit nr.15155/1 prot., datë 19.12.2018 “Për miratimin e dhënies së një shpërblimit të veçantë në fund të vitit 2018 për Këshillin mbikëqyrës të OSHEE SHA” në masën e një page mujore, mbi bazën e propozimit të administratorit nr.23130/1 prot., datë 14.12.2018 është në kundërshtim me VKM nr.570, datë 3.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”, pika 6, e cila përcakton:

“Anëtarët e këshillit mbikëqyrës përfitojnë shpërblim për pjesëmarrje në këshillat mbikëqyrës, si më poshtë vijon:...”

çka do të thotë se pagesat e tyre nuk bëhen edhe me shpërblim të veçantë. Referuar sa më sipër pagesat e kryera prej 1,402,500 lekë përbëjnë përfitim të paligjshëm për anëtarët dhe sekretaren e këshillit mbikëqyrës.

Kriteri: - VKM nr.570, datë 3.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”, pika 6.

Ndikimi/Efekti: Rritje të shpenzimeve të shoqërisë si rezultat i akordimit të shpërblimit në fund të vitit të Këshillit mbikëqyrës.

Shkaku: Konsiderimi i ligjshëm i shpërblimit të veçantë në fund të vitit

Rëndësia: I ulët

Rekomandime: Administratori i shoqërisë të marrë masa për t’iu kërkuar anëtarëve përfitues dhe sekretares së këshillit mbikëqyrës shpërblimin e veçantë në fund të vitit 2018 në vlerën 1,402,500 lekë.

Për këtë çështje, subjekti i audituar ka sjellë observacione për Projekt raportin me shkresën nr.12149/4 prot., datë 22.12.2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH me datë 28.12.2020.

Pretendimet e subjektit:

Subjekti pretendon se shpërblimi i këshillit mbikëqyrës është bazuar në ligjin nr.10405, datë 24.03.2011, duke e veçuar VKM nr.570 që ka të bëjë me pjesëmarrjen në mbledhje të anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës, si dhe në miratimin e bërë nga Ministri në cilësinë e asamblesë për këtë rast shpërblimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj me vëmendje observacionin e subjektit për Projektraportin dhe arrin në përfundimin se asnjë nga referencat ligjore të cituara dhe të padetajuara (neni, pika, shkronja) nuk ka të bëjë me shpërblimin e dhënë Këshillit mbikëqyrës në fund të vitit 2018.

Bazuar në sa më sipër grupi i auditimit të KLSH, nuk e gjen të bazuar dhe të argumentuar ligjërisht observacionin në lidhje me shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në fund të vitit 2018, dhe për këtë arsye nuk e merr në konsideratë.

b) Çështja e arbitrazhit ndërkombëtar SCAI nr.600491/2017, me palë paditëse E. AG dhe palë të paditur OSHEE SHA”.

Në relacionin e Administratorit të OSHEE SHA nr.24825/2, datë 11.12.2019 drejtuar Këshillit Mbikëqyrës së Shoqërisë është paraqitur një situatë e cila i është bërë me dije shoqërisë në muajin tetor të vitit 2019.

OSHEE SHA është njoftuar nga Avokatura e Shtetit për një dëm në vlerën **8,367,087 Euro** (1,036,765,750 lekë me kursin e BSH prej 123,91 lekë/Euro) dhe 901,576 CHF (104,267,264 lekë me kursin e BSH prej 115,65 lekë/CHF) referuar çështjes së arbitrazhit ndërkombëtar SCAI nr.600491/2017, me palë paditëse E. AG dhe palë të paditur “OSHEE” SHA dhe deri në zbardhjen e vendimit OSHEE përballet me rritjen e interesave për këtë detyrim. Shoqëria E. AG ka kërkuar

me shkresë pagesën në mënyrë vullnetare të detyrimit prej rreth 9,196,521 Euro (deri në 11.12.2019), i cili rritet çdo ditë me interesat e përlllogaritura sipas vendimit të gjykatës, në të kundërt me zbardhjen e vendimit në Gjykatën Shqiptare, do të vijojë menjëherë me ekzekutim të detyrueshëm. Ky ekzekutim pritet t'i shkaktojë OSHEE SHA, pasoja të rënda në likuiditetin e saj, referuar kostove të energjisë.

Administratori i OSHEE SHA, ka propozuar ngritjen e grupit ndërinstitucional të negociimit të çështjes së arbitrazhit ndërkombëtar SCAI nr.600491/2017,EFT A.G dhe shoqërisë OSHEE SHA, me z. R. K. në cilësinë e Kryetarit të Grupit të punës së çështjet të arbitrazhit,SCAI Nr.600491-2017, E. AG kundër OSHEE SHA, E. S. me detyrë Drejtor i Divizionit Tregtar , OSHEE SHA, I. Q., Drejtor i Departamentit të Tregtimit të Energjisë ,OSHEE SHA, R. R. , Jurist në OSHEE SHA dhe B. N., Avokat Shteti nga Avokatura e Shtetit. Grupi i punës sipas relacionit nr.24825/2, datë 11.12.2019 drejtuar Këshillit Mbikëqyrës së Shoqërisë, do të këshillohet nga studio ligjore ndërkombëtare “Cliffors Chance”, e kontraktuar për përfaqësimin e “OSHEE” SHA, në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar të filluar nga shoqëria E. A.G.

Në vazhdim pasqyrohet çështja nr. 600491 – 2017, që E. A.G ka ngritur ndaj “OSHEE”:

Më 03.08.2017, me shkresën e Sekretariatit të Dhomës Ndërkombëtare të Arbitrazhit Zviceran (SCAI), “OSHEE” është njoftuar për çështjen nr. 600491 – 2017, që E. A.G kishte ngritur ndaj “OSHEE”, për kontratën e shitblerjes me energji elektrike të vitit 2012. Paditësi, E. A.G. ka pretenduar një shumë prej 6,139,637 Euro plus interesa dhe kosto (rreth 9 milionë Euro) për energjinë elektrike që nuk i është lëvruar OSHEE-së/ CEZ Shpërndarje në vitin 2012, për shkak se kontrata nuk është ekzekutuar plotësisht. Bashkë me njoftimin, “OSHEE” i është dërguar Kërkesa për arbitrazh dhe provat shoqëruese të kësaj kërkesë. Në bazë të Rregullave të këtij arbitrazhi, “OSHEE”, duhet të përgjigjej për pretendimet e ngritura brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Në vijim më datë 07.08.2017, “OSHEE” ka ngritur grupit e posaçëm të punës për ndjekjen e këtij procesi, koordinimin e punës me Avokaturën e Shtetit dhe institucione të tjera shtetërore, si dhe mbledhjen e informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm në këtë arbitrazh.

Po në datë 07.08.2017 “OSHEE” ka njoftuar Aksionarin e saj, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Avokaturën e Shtetit për këtë çështje arbitrazhi. Në datë 11.08.2017, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka kërkuar angazhimin maksimal dhe urgjent për ndjekjen dhe procedimin e nevojshëm mbi këtë proces arbitrazhi. Edhe Ministria ka kërkuar të procedohet me njoftimin e Avokaturës së Shtetit si institucioni përgjegjës për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave pasurore të shtetit shqiptar pranë gjykatave ndërkombëtare dhe të huaja.

Më shkresën e datës 17.08.2017, Avokatura e Shtetit ka kërkuar informacion/dokumentacion për të vlerësuar nëse është e nevojshme të vijohet me procedurat e kontraktimit të avokatëve/firmave avokatore me profesion të lirë, në përputhje me ligjin nr. 10018/2008 dhe Rregulloren e miratuar me VKM nr. 392/2009.

Pas mbledhjes së dokumentacionit të disponueshëm në “OSHEE”, më datë 21.08.2017, “OSHEE” i ka dërguar Avokaturës së Shtetit dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë informacion dhe dokumentacion në lidhje me çështjen e arbitrazhit “E. kundër OSHEE”.

Me shkresën e datës 30.08.2017, Avokatura e Shtetit ka rekomanduar: që për shkak të afateve të kushtëzuara kohore, për nevoja të përfaqësimit dhe mbrojtjes së kësaj çështjeje pranë SCAI, është e nevojshme që nga “OSHEE” të përcillet pranë Sekretariatit të SCAI, një letër për përfaqësimin e mëtejshëm në këtë çështje të shoqërisë nga ana e Avokaturës së Shtetit, në cilësinë e institucionit të caktuar me ligj për këtë qëllim, që për këtë çështje të mundësohet kontraktimi i avokatëve me profesion të lirë, në përputhje me ligjin nr. 10018/2008 dhe Rregulloren e miratuar me VKM nr. 392/2009.

Kjo, bazuar në vlerën e dëmshpërblimit të pretenduar (vlerë që tejkalonte vlerën prej 10,000,000 lekë, të përcaktuar në nenin 12 të Rregullores së Avokaturës dhe që legjitimon kontraktimin e avokatëve të lirë), ekspertizës të thelluar teknike të çështjes dhe ligjit të zbatueshëm, atij zviceran.

Për këtë arsye, Avokatura e Shtetit ka kërkuar miratimin paraprak të “OSHEE” për kontraktimin e shërbimit të përfaqësimit dhe mbulimit përkatës të këtyre kostove, në mënyrë që të procedohet me tej.

Më datë 29.08.2017, “OSHEE” ka njoftuar SCAI që përfaqësimi i mëtejshëm i “OSHEE” në këtë çështje do të bëhet nga ana e Avokaturës së Shtetit. Po në datë 29.08.2017, “OSHEE”, në përgjigje të shkresës së Avokaturës së Shtetit, ka rënë dakord me kontraktimin nga ana e Avokaturës së Shtetit të shërbimit të përfaqësimit për këtë çështje.

Në datë 31.08.2017, Sekretariati i SCAI, konfirmon marrjen njoftim për përfaqësimin e “OSHEE” nga Avokatura e Shtetit. Më datë 31.08.2017, Avokatura e Shtetit i kërkon Sekretariatit të SCAI, një shtyrje të afatit për kthimin e përgjigjes ndaj kërkesës për arbitrazh me dy muaj.

Në vijim të procesit, “OSHEE” ka vazhduar duke kërkuar intensivisht informacion dhe dokumentacion në lidhje me këtë çështje si në shoqëri ashtu edhe në institucione të ndryshme si: ERE, KESH, OST, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshillit të Ministrave, ish punonjësve të “OSHEE”, dhe duke i dërguar/ përcjellë çdo informacion/dokumentacion Avokaturës së Shtetit.

Më 12.09.2017 Sekretariati i Dhomës Ndërkombëtare të Arbitrazhit Zvicëran ka informuar se afati i kthimit të përgjigjes të të paditurit kundrejt Kërkesës për Arbitrazh mbaronte më datë 12.10.2017.

Më datë 12.10.2017, Avokatura e Shtetit ka depozituar Përgjigjen e të Paditurit ndaj Kërkesës për Arbitrazh. Më datë 19.12.2017, Avokatura e Shtetit, ka informuar “OSHEE”, mbi shpalljen fituese të firmës ndërkombëtare të Avokatisë Clifford Chance LL.P për çështjen SCAI Nr. 600491 – 2017, duke i dërguar Urdhrin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit për shpalljen e fituesit dhe raportin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Më datë 01.02.2018 me konstituimin e Tribunalit (të përbërë nga 3 arbitra), Tribunali i kërkoj palëve që të bënin pagesën e kostove të arbitrazhit brenda datës 26.02.2018. Vlera e kostove paraprake është në shumën 180,000 CHF.

Më datë 09.02.2018, Avokatët e Clifford Chance, informuan Sekretariatit të SCAI, për caktimin e tyre si përfaqësues të të Paditurit në këtë çështje. Më datë 13.02.2018, Avokatura e Shtetit nënshkroi me Clifford Chance kontratën për ofrimin e shërbimeve Ligjore. Më datë 19.02.2018, OSHEE kreu pagesën e vlerës së kostove paraprake të arbitrazhit.

Më datë 08.03.2018, midis Tribunalit, përfaqësuesve ligjore të palëve, si dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Avokaturës së Shtetit dhe “OSHEE” u zhvillua një takim procedural, për të diskutuar më tej për Urdhrin Procedural Nr. 1, të tillë si: mbi komunikimet dhe parashtrimet, provat dhe referencat ligjore, dëshmitë, ekspertët, prodhimin e dokumenteve, seancat dëgjimore, përkthimet dhe interpretimet etj.

Më datë 28.03.2018, Tribunali nxori Urdhrin Procedural Nr. 1 i cili përcaktoi në vijim skedulën e çështjes së arbitrazhit.

Më datë 19.04.2018, OSHEE depozitoi “Statement of Claim”, së bashku me provat përkatëse. Më datë 28.06.2018, OSHEE depozitoi prapësimet e saj shoqëruar me provat përkatëse. Më datë 05.09.2018 EFT depozitoi parashtrimet e saj shoqëruar me provat përkatëse, me një raport eksperti dhe dëshminë e menaxherit Srdjan Tabor. Më datë 13.09.2018 OSHEE depozitoi kërkesën e saj për prodhim dokumentesh. Më datë 25.09.2018 Tribunali doli me vendim për sa i përket prodhimin të dokumenteve, në të cilin u shpreh se për momentin nuk do urdhëronte prodhim dokumentesh, por ky vendim mund të rishikohej.

Më datë 16.11.2018 OSHEE depozitoi prapësimet e saj, shoqëruar me prova dhe me një raport të ekspertit të Poyry Management Consulting.

Në vijim referuar ecurisë së çështjes së arbitrazhit, avokatët e “Clifford Chance”, kanë dërguar një Memo, të përcjellë elektronikisht në datën 30.01.2019 përmes Avokaturës së Shtetit, në cilësinë e institucionit përgjegjës për përfaqësimin e interesave të shtetit shqiptar përpara gjykatave të huaja apo ndërkombëtare. Pikat kryesore të Memos së Avokatëve të “Clifford Chance” të datës 29.01.2019, ishin:

- Ka arsye të bazuara për të hyrë në negocime për zgjidhje me mirëkuptim të çështjes OSHEE/ EFT (SCAI Case No. 600491-2017),
- Dëmi i EFT-së arrin në shumën 1,831,894 Euro, plus 700,000 Euro interesa, minus një pjesë të rikuperimit të kostos prej përafërsisht 100,000 euro (rreth 2,4 milion Euro)

Për këtë arsye, “OSHEE” SHA me shkresën Nr. 19064/48 Prot., datë 01.02.2019 i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e Aksionarit të Shoqërisë “OSHEE” SHA,

për vlerësimin e këtij sugjerimi dhe ngritjen e grupit të punës për negociimin dhe zgjidhjen me mirëkuptim të çështjes, duke i bashkëlidhur të gjitha materialet që kishin të bënin me mundësinë dhe strategjinë që mund të ndiqet për një zgjidhje me mirëkuptim të kësaj çështjeje. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën Nr. 1468/1 Prot., datë 07.02.2019 është shprehur se jemi të mendimit që shoqëria “OSHEE” i ka të gjitha kapacitetet, që në bashkëpunim me zyrën ligjore dhe Avokaturën e Shtetit, të vendosë për strategjinë më të mirë për vijimin e çështjes dhe për mundësinë e realizimit të negociatave, duke sugjeruar që në çdo rast për këtë vendim-marrje OSHEE të konsultohet me Avokaturën e Shtetit, si institucioni qendror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike për institucionet shtetërore, entet publike dhe shoqëritë publike.

Në zbatim të Urdhrave Proceduralë Nr. 1, datë 28.03.2018 dhe Nr. 2, datë 11.10.2018, në Zyrë, Zvicër në datat 11 – 12 Shkurt 2019, janë zhvilluar seancat dëgjimore të kësaj çështjeje arbitrazhi ndërkombëtar. Në përfundim të seancave dëgjimore, Kryetari i arbitrave/ Tribunalit, Dr. C. B., vuri në vëmendje të palëve, se referuar parashikimeve të nenit 15.8 të Rregullave Zvicerane të Arbitrazhit, nëse palët kanë nevojë për asistencë në lidhje me një zgjidhje të mundshme me mirëkuptim të mosmarrëveshjes, Tribunali është në dispozicion të palëve.

“OSHEE” SHA me shkresën Nr. 3580 Prot., datë 12.02.2019, i ka adresuar një shkresë “E.” A.G për të diskutuar mbi mundësinë e zgjidhjes me mirëkuptim së mosmarrëveshjes. Në përgjigje të kësaj kërkesë “E.” A.G, me shkresën e datës 19.02.2019, është shprehur se është dakord për të arritur një zgjidhje bilaterale dhe ka propozuar që një delegacion i nivelit të lartë të “E.”-së të takohet me përfaqësues të “OSHEE-së” në javën e parë të Marsit (4 Mars 2019) në zyrat e “OSHEE” SHA. Sa më sipër, referuar sugjerimeve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria OSHEE SHA, ka kërkuar nga Avokatura e Shtetit caktimin e përfaqësuesve të saj që do të marrin pjesë në takimin e datës 04 Mars 2019 me përfaqësuesit e “E.” A.G.

Në vijim takimi midis palëve, (përfaqësues së Avokaturës së Shtetit, OSHEE dhe E. A.G) u zhvillua më datë 04.03.2019, në ambientet e “OSHEE” SHA, në të cilën palët shprehën qëndrimet e tyre. Më datë 25.04.2019 palët në këtë proces kanë paraqitur argumentet e tyre pas “Seancës Dëgjimore” të Shkurtit 2019. Më datë 11.10.2019 Tribunali ka marrë vendimin përfundimtar/ final duke vendosur: Pranimin e pretendimeve të palës paditëse duke përcaktuar detyrimin e palës së paditur për të dëmshpërblyer palën paditëse në vlerën prej 6,139,637 Euro, për mos përmbushje të kontratës, plus interes vjetor prej 5% për këtë dëmshpërblim i përlllogaritur nga data 15 Tetor 2012 deri në kryerjen e plotë të kësaj pagese, detyrimin e palës së paditur për të paguar shpenzimet e procesit dhe për t’i rimbursuar paditësit këto kosto në vlerën prej 186,000 CHF, së bashku me interesin vjetor prej 5% për këtë vlerë, nga momenti i shpalljes së këtij vendimi deri në kryerjen e plotë të kësaj pagese si dhe detyrimin e palës së paditur për të paguar të gjitha shpenzimet ligjore të palës paditëse si dhe shpenzimet e tjera në vlerën prej 705,682.04 CHF plus 43,361.58 Euro së bashku me interesin vjetor prej 5% të përlllogaritur nga data e shpalljes së këtij vendimi deri në përmbushjen e plotë të këtij detyrimi.

Ky vendim i është komunikuar zyrtarisht “OSHEE” SHA, nga Avokatura e Shtetit, si dhe bazuar në emailin e konsulentëve ligjorë të Clifford Chance janë analizuar hapat e mundshëm potencialë që mund të merren në këtë drejtim.

Në vijim me shkresën Nr. 67/13 Prot., datë 16.10.2019. Avokatura e Shtetit, bazuar edhe në analizën që i kanë bërë vendimit të arbitrazhit Avokatët e Clifford Chance janë shprehur se:...kërkesat ligjore për kundërshtimin e vendimit, me qëllimin anullimin e tij janë shumë të larta, dhe duhet provuar shkelja e rëndë e koncepteve themelore bazë, ndërsa argumentet juridikë që do të ngriheshin në këtë drejtim, për rastin në fjalë, nuk do të ishin të mjaftueshme dhe do të kishte pak gjasa që OSHEE të kishte sukses në këtë sipërmarrje, pikërisht për shkak të këtyre rrethanave. Analiza e tyre përfundon me këshillimin që, palët e përfshira në mosmarrëveshje të konsiderojnë mundësinë e uljes në negociata me qëllim gjetjen e një zgjidhje të arsyeshme për të vendosur një plan pagese referuar detyrimin që i është ngarkuar OSHEE sipas vendimit të arbitrazhit”.

Në përgjigje të shkresave të Avokaturës së Shtetit, “OSHEE” SHA me shkresën Nr. 19064/70 Prot, datë 24.10.2019 është shprehur se: Ligji Nr. 10018/2008 për Avokaturën e Shtetit, e përcakton fare

qartë, në nenin 9/1 të tij se: “Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës, kryhen nga Avokatura e Shtetit, nëpërmjet zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar”.

Rregullorja e Avokaturës së Shtetit në nenin 5 të saj, parashikon : Avokatura e Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat pasurore të Shtetit Shqiptar pranë Gjykatave kombëtare, ndërkombëtare, të huaja dhe në arbitrazhin ndërkombëtar pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në çështjet e veçanta, Avokatura e Shtetit mund t’ia delegojë të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes organit të interesuar të administratës“.

Dy klauzolat e mësipërme ligjore, të cilat përcaktojnë rolin dhe tagrat e Avokaturës së Shtetit, mbështeten dhe plotësohen dhe nga klauzola tjetër e Rregullores 16/5/b e cila parashikon detyrat e OSHEE SHA, si organ i përfaqësuar në këtë procedurë arbitrazhi: “ Në kuadër të realizimit të një përfaqësimi dhe mbrojtje të plotë, efektive dhe gjithëpërfshirëse, avokatët e shtetit të ngarkuar me çështjen, duhet të asistohen dhe mbështeten në çdo kërkesë apo pretendim nga palët e përfaqësuara prej tyre dhe çdo institucion apo person juridik publik të tretë që ka lidhje direkte apo indirekte me çdo element të përfaqësimit dhe mbrojtjes, sikundër mund të identifikohet rast pas rasti”. Marrëveshja me studion Avokatore të Clifford Chance, por midis Avokaturës së Shtetit dhe Clifford Chance dhe mban datën 13.02.2018. Kjo marrëveshje i është njoftuar “OSHEE” SHA, nëpërmjet shkresës me Nr. 212/2 Prot, datë 04.04.2018 të Avokates së Përgjithshme të Shtetit.

Kontrata midis palëve (Avokaturës së Shtetit dhe Clifford Chance), ka parashikuar një ofrim shërbimi deri në shpalljen e vendimit përfundimtar, duke mos parashikuar një shërbim të plotë edhe në rastet e një apelimi të mundshëm të këtij vendimi përfundimtar.

Në datë 30.10.2019, bazuar në Urdhrin e Brendshëm të OSHEE SHA, Nr.19064/72 Prot., është zhvilluar takimi midis përfaqësuesve të OSHEE SHA dhe Avokaturës së Shtetit, pranë ambienteve të Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, në të cilin Avokatura e Shtetit i qëndron opinionit të dhënë nga avokatët e kontraktuar të studios Clifford Chance, të cilët në opinionin e tyre kanë parashtruar se mundësia e suksesit në një proces ankimimi, me qëllim anulimin e vendimit **është 7 %**.

Për sa sipër, përfaqësuesit e OSHEE SHA dhe Avokatura së Shtetit ranë dakord për nisjen e negociatave me palën paditëse E.A.G, për dakortësimin e një plani pagesash për palën paditëse, për të eliminuar kosto të tjera shtesë si interes ose shpenzime të mëtejshme gjyqësore.

Në kuadër të vlerësimeve të studios ligjore Clifford Chance, sugjerimeve të Avokaturës së Shtetit, sipërcituar për sa i përket mundësisë së ankimit të vendimit të mësipërm dhe dakordësimit për një plan pagesash me palën paditëse, u procedua me një takim, mes palëve. **Në përfundim të takimit nuk u arrit dakordësia.**

Më datë 18.05.2020, përfaqësuesi i “OSHEE GROUP” SHA ka tërhequr në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dokumentacionin e përcjellë nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me këtë çështje. Në zbatim të nenit 135 të K.Pr. Civile, dispozitë e cila përcakton mënyrën e njoftimit të akteve të shtetit të huaj apo dhënies së ndihmës juridike, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka lëshuar vërtetimin ku pasqyrohet konfirmimi se dokumentacioni iu vendos në dispozicion “OSHEE GROUP” SHA, së bashku me kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë. Nga verifikimi i dokumentacionit të tërhequr, është vërejtur se pjesë e dokumentacionit është ndër të tjera vendimi i datës 21.01.2020 i Gjykatës së Lartë të Kantonit Zvicër. Ky dokumentacion iu përcoll me shkresën Nr. 4856 Prot., datë 20.05.2020 edhe Avokaturës së Shtetit.

Grupi i auditimit konstaton se:

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me këtë çështje, në komunikimin zyrtar midis OSHEE SHA dhe Avokaturës së Shtetit në lidhje me ndjekjen e kësaj çështje ka paqartësi referuar kompetencave respektive në funksion të zgjidhjes së saj, sepse megjithëse qëllimi final është zgjidhja e çështjes me dakordësi midis palëve dhe minimizimi i detyrimit financiar i OSHEE SHA që ka kundërt palës paditëse rezulton se në këtë komunikim vihen re “mosmarrëveshje” mbi bazën ligjore dhe kompetencat që ka OSHEE SHA si palë e paditur dhe Avokatura e Shtetit si përfaqësuese e palës së paditur dhe interesave të shtetit shqiptar, referuar kësaj çështje.

Shoqëria OSHEE SHA ndodhet para faktit se Shoqëria E. AG i ka kërkuar me shkresë pagesën në mënyrë vullnetare të detyrimit (i cili deri në datë 11.12.2019 ka qenë rreth 9,196,521 Euro) i cili rritet çdo ditë me interesat e përlllogaritura sipas vendimit të datës 21.01.2020 i Gjykatës së Lartë të Kantonit Zvicër, në të kundërt me zbardhjen e vendimit në Gjykatën Shqiptare, do të vijojë menjëherë me ekzekutim të detyrueshëm.

Ky ekzekutim i vendimit, pritet ti shkaktojë OSHEE SHA pasoja të rënda në likuiditetin e saj , referuar kostove të energjisë.

Për sa i përket zbatimit të një vendimi të një gjykate të huaj përcaktimet ligjore shprehen në nenet e Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, si më poshtë:

“Neni 398 Zbatimi i vendimit të një gjykate të huaj: Vendimi i gjykatës së shtetit të huaj zbatohet në Republikën e Shqipërisë vetëm në bazë të vendimit të gjykatës të apelit që i jep fuqi këtij vendimi dhe ekzekutohet në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij Kodi.

Neni 399 Vendimi i gjykatës së arbitrazhit : Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe për njohjen e vendimit përfundimtar të një arbitrazhi të shtetit të huaj. Sa më sipër, “OSHEE Group” SHA. në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, dispozitat mbi njohjen e vendimeve të huaja dhe arbitrazhit, bëhet përmes Gjykatës së Apelit Tiranë, hap për të cilin OSHEE deri tani nuk ka asnjë njoftim nëse është ndërmarrë nga pala E. A.G.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr.546/4, datë 19.11.2020 protokolluar në OSHEE SHA, nr.12149, datë 23.11.2020 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.12149/41, datë 22.12.2020,“Mbi Projekt Raportin e Auditimit” nga z.R. K., vënë në dispozicion grupit të auditimit më datë 28.12.2020, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Nga z. K. sa më lart pretendohet se në lidhje me zbatimin e rekomandimit që ka lënë KLSH në lidhje me çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar SCAI Nr.600491/2017 me palë paditëse Energy Financing AG dhe palë të paditur OSHEE SHA, kjo e fundit ka zbatuar me rigorozitet dispozitat ligjore dhe referuar konventës së New York , shoqëria E. AG ka dorëzuar në Gjykatën e Apelit Tiranë kërkesën për njohjen e vendimit të arbitrazhit ndërkombëtar SCAI Nr.600491/2017, në datë 11.10.2019. Në përfundim të gjykimit, në datë 10.11.2010 Gjykata e Apelit Tiranë, vendosi: Pranimin e kërkesës së kërkuarit E. A.G, Njohjen e Vendimit nr. 600491/2017, datë 11.10.2019 të Gjykatës së Arbitrazhit “SCAI”. Në lidhje me vijimësinë e procesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, vendimit civil të formës së prerë nr. 600491/2017, datë 11.10.2019 të Gjykatës së Arbitrazhit “SCAI”, njohur dhe dhënë fuqi ligjore në Republikën e Shqipërisë me vendimin nr.118, datë 10.11.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë, plotësuar me vendimin nr.125, datë 24.11.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë, “OSHEE Group” SHA, ka hyrë në marrëveshje për shlyerjen me këste të detyrimit të përcaktuar në vendim.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: -Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se grupi i auditimit në Projekt Raportin e mbajtur referuar çështjes së arbitrazhit ndërkombëtar SCAI Nr.600491/2017 me palë paditëse Energy Financing AG dhe palë të paditur OSHEE SHA, sipas dokumentacionit që shoqëria OSHEE SHA i vuri në dispozicion ka evidentuar aktorët e interesit lidhur me këtë çështje që e ka zanafillën që në kohën kur shoqëria OSHEE SHA ka qenë CEZ Shpërndarje pra shoqëri e privatizuar,megjithatë aktualisht Shoqëria OSHEE SHA (shoqëri me 100% aksione në Shtetin Shqiptar) e cila ka trashëguar edhe të drejtat dhe detyrimet e CEZ Shpërndarje , ndodhet para faktit se Shoqëria E. AG i ka kërkuar me shkresë pagesën në mënyrë vullnetare të detyrimit (i cili deri në datë 11.12.2019 ka qenë rreth 9,196,521 Euro), dhe me njohjen e vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit “SCAI”, njohur dhe dhënë fuqi ligjore në Republikën e Shqipërisë me vendimin nr.118, datë 10.11.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë, plotësuar me vendimin nr.125, datë 24.11.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë, “OSHEE Group” SHA OSHEE SHA pavarësisht faktit se kjo çështje është trajtuar nga Avokatura e Shtetit si institucioni qendror i administratës publike i ngarkuar ekskluzivisht me dhënien e asistencës juridike për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar SCAI Nr.600491/2017 me palë paditëse E. AG dhe

palë të paditur OSHEE SHA, nuk mund të cilësohet vetëm si person juridik publik që ka të drejtë përfaqësimi dhe jo vendim-marrje në këtë çështje sepse në Rregulloren e Avokaturës së Shtetit në nenin 5 të saj, parashikon : Avokatura e Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat pasurore të Shtetit Shqiptar pranë Gjykatave kombëtare, ndërkombëtare, të huaja dhe në arbitrazhin ndërkombëtar pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në çështjet e veçanta, Avokatura e *Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes organit të interesuar të administratës*“. Për sa më lart grupi i auditimit ka evidentuar problematikën që do të shkaktojë për likuiditetin e shoqërisë ekzekutimi i detyrimit i OSHEE SHA ndaj Shoqërisë E. AG **(i cili deri në datë 11.12.2019 ka qenë rreth 9,196,521 Euro)**, ky detyrim rritet çdo ditë me interesat e përllogaritura sipas vendimit të datës 21.01.2020 i Gjykatës së Lartë të Kantonit Zvicër, **dhe me njohjen e vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit “SCAI”, njohur dhe dhënë fuqi ligjore në Republikën e Shqipërisë me vendimin nr.118, datë 10.11.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë, plotësuar me vendimin nr.125, datë 24.11.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ekzekutimi i njohjes së këtij detyrimi pritet ti shkaktojë OSHEE SHA pasoja të rënda në likuiditetin e saj, referuar kostove të energjisë, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.**

1. Titulli i Gjetjes Procedura e ndjekur për ekzekutimin e vendimit përfundimtar në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar SCAI Case no.600491-2017, datë 11.10.2019.

Situata: Në relacionin e Administratorit të OSHEE SHA nr.24825/2, datë 11.12.2019 drejtuar Këshillit Mbikëqyrës së Shoqërisë është paraqitur një situatë e cila i është bërë me dije shoqërisë në muajin tetor të vitit 2019.

OSHEE SHA është njoftuar nga Avokatura e Shtetit për një dëm në vlerën **8,367,087 Euro** (1,036,765,750 lekë me kursin e BSH prej 123,91 lekë/Euro) dhe 901,576 CHF (104,267,264 lekë me kursin e BSH prej 115,65 lekë/CHF) referuar çështjes së arbitrazhit ndërkombëtar SCAI nr.600491/2017, me palë paditëse E. AG dhe palë të paditur “OSHEE” SHA dhe deri në zbardhjen e vendimit OSHEE përballet me rritjen e interesave për këtë detyrim. Shoqëria E. AG ka kërkuar me shkresë pagesën në mënyrë vullnetare të detyrimit prej rreth 9,196,521 Euro (deri në 11.12.2019), i cili rritet çdo ditë me interesat e përllogaritura sipas vendimit të gjykatës, në të kundërt me zbardhjen e vendimit në Gjykatën Shqiptare , do të vijojë menjëherë me ekzekutim të detyrueshëm. Njohja e vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit “SCAI”, njohur dhe dhënë fuqi ligjore në Republikën e Shqipërisë me vendimin nr.118, datë 10.11.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë, plotësuar me vendimin nr.125, datë 24.11.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë, pritet ti shkaktojë OSHEE SHA, pasoja të rënda në likuiditetin e saj, referuar kostove të energjisë.

Administratori i OSHEE SHA, ka propozuar ngritjen e grupit ndërinstitucional të negocimit të çështjes së arbitrazhit ndërkombëtar E. A.G dhe shoqërisë OSHEE SHA, sipas relacionit nr.24825/2, datë 11.12.2019 drejtuar Këshillit Mbikëqyrës së Shoqërisë, do të këshillohet nga studio ligjore ndërkombëtare “Cliffors Chance”, e kontraktuar për përfaqësimin e “OSHEE” SHA, në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar të filluar nga shoqëria EFT A.G. Shoqëria OSHEE SHA ndodhet para faktit se sipas vendimit të datës 21.01.2020 i Gjykatës së Lartë të Kantonit Zvicër, Shoqëria E. AG i ka kërkuar OSHEE SHA me shkresë pagesën në mënyrë vullnetare të detyrimit **(i cili deri në datë 11.12.2019 ka qenë rreth 9,196,521 Euro)** (1,139,540,917 lekë me kursin e BSH prej 123,91 lekë/Euro) i cili rritet çdo ditë me interesat e përllogaritura, në të kundërt me zbardhjen e vendimit në Gjykatën Shqiptare, do të vijojë menjëherë me ekzekutim të detyrueshëm. Ky ekzekutim i vendimit nr.118, datë 10.11.2020, plotësuar me vendimin nr.125, datë 24.11.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë, pritet ti shkaktojë OSHEE SHA pasoja të rënda në

Kriteri:	<p>likuiditetin e saj , referuar kostove të energjisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji Nr. 10018/2008 për Avokaturën e Shtetit; - Rregullorja e Avokaturës së Shtetit në nenin 5 të saj, parashikon: Avokatura e Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat pasurore të Shtetit Shqiptar pranë Gjykatave kombëtare, ndërkombëtare, të huaja dhe në arbitrazhin ndërkombëtar pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë; Në çështjet e veçanta, Avokatura e <i>Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes organit të interesuar të administratës</i>“.
Ndikimi/Efekti:	<p>Nga OSHEE SHA mos vlerësimi i duhur në nivel menaxherial i shoqërisë i çështjes së arbitrazhit ndërkombëtar SCAI Nr.600491/2017 me palë paditëse E. AG dhe palë të paditur OSHEE SHA, e cila do të sillte pasoja të rënda në likuiditetin e saj nëse bëhet i ekzekutuëshëm detyrimi i OSHEE SHA ndaj Shoqërisë E. AG (i cili deri në datë 11.12.2019 ka qenë rreth 9,196,521 Euro) (1,139,540,917 lekë me kursin e BSH prej 123,91 lekë/Euro).</p>
Shkaku:	<p>Mos vlerësimi i duhur në nivel menaxherial i shoqërisë i çështjes së arbitrazhit ndërkombëtar SCAI Nr.600491/2017, me palë paditëse E. AG dhe palë të paditur OSHEE SHA.</p>
Rëndësia:	<p>I lartë.</p>
Rekomandime:	<p>Nga OSHEE SHA, të merren masa për krijimin e provizioneve për shkak të ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit përfundimtar në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar SCAI Case no.600491-2017 të datës 21.01.2020 i Gjykatës së Lartë të Kantonit Zvicër, njohur nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.118, datë 10.11.2020, plotësuar me vendimin nr.125, datë 24.11.2020, për detyrimin e OSHEE SHA si palë e paditur ndaj Shoqërisë E. AG si palë paditëse e detyrimit (i cili deri në datë 11.12.2019 ka qenë rreth 9,196,521 Euro).</p>

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga Administratori i shoqërisë janë kryer komandime të punonjësve në 6 raste nga Drejtoria e Përgjithshme për në Drejtoritë Rajonale, për periudha mbi një vjeçare, duke akorduar krahas pagës së pozicionit të mëparshëm të punës edhe shpenzimet për udhëtime dieta jashtë vendbanimit në vlerën gjithsej 17,938,000 lekë.

Në zbatim të VKM 329, datë 20.04.2016 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar, shërbimet i referohen një afati të caktuar, për një çështje të caktuar e cila nuk mund të zgjasë periudha kohore disa mujore, pasi këto raste ezaurohen me emërimet përkatëse. Po ashtu koncepti i komandimit lidhet me zgjidhjen e një problematike të caktuar emergjente, deri në plotësimin e vakancës të krijuar në strukturë, duke mos penguar në këtë mënyrë vazhdimësinë e procesit të punës dhe duke shmangur problematikat të cilat mund të rrjedhin nga këto vonesa.

Sa më sipër, konstatohet se vendimet e komandimit i kanë shkaktuar shoqërisë OSHEE SHA kosto shtesë në vlerën 17,938,000 lekë, e cila rëndon shpenzimet e shoqërisë duke pasur parasysh dhe rezultatin financiar negativ të saj, si dhe komandimi pa afat i punonjësve rrezikon të ndikojë negativisht në performancën e tyre dhe të punonjësve në varësi të tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 38 - 39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Administratori i OSHEE SHA dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të marrin masa lidhur me punonjësit që komandohen dhe dërgohen me shërbim jashtë qendrës të punës, brenda vendit, duke e përcaktuar qartë në Rregulloren e Brendshme të rasteve në të cilat punonjësit komandohen me afat deri në tre muaj pa të drejtë përsëritjeje, përfshirë dhe elementët e trajtimit financiar të punonjësve të komanduar, si dhe të realizojnë plotësimin e vendeve aktuale vakante për të shmangur komandimet për periudha mbi tre mujore.

Brenda tremujorit të dytë të vitit 2021

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara subjektit data e njoftimit të raportit të përfundimtar të auditimit. Për zbatimin e rekomandimeve të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe në proces të evaduar me vendimin OSHEE SHA, dërguar me shkresën nr.272/16 prot., datë 27/09/2017, rezultoi se subjekti ka hartuar programin dhe ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, brenda afatit 6 mujor nga e Kryetarit të KLSH nr.56, datë 22.06.2018 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, të evaduar në periudhën korrik-shtator 2017”, me shkresën nr.482/20 prot., datë 25.06.2018 është ri-kërkuar zbatimi i tyre dhe në lidhje me to shkalla e realizimit ka qenë si vijon:

- nga 13 masa organizative të rekomanduara, 6 janë zbatuar plotësisht, 1 pjesërisht dhe 6 masa janë në proces zbatimi;
- nga 9 masa për shpërblim dëmi, 1 është zbatuar plotësisht, 7 pjesërisht dhe 1 masë është në proces zbatimi;
- 1 masë për eliminimin e efekteve negative financiare është zbatuar pjesërisht;
- nga 13 masa disiplinore, 10 janë zbatuar plotësisht dhe nuk janë zbatuar 3 masa disiplinore.

Grupi i auditimit edhe pse ka vijuar me kërkesat e vazhdueshme drejtuar shoqërisë, për sa më sipër nuk i është dorëzuar asnjë dokument justifikues apo informacion shkresor në lidhje me shkallën aktuale të realizimit për periudhën objekt auditimi deri në datën 30.06.2020, për zbatimin e rekomandimeve të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe në proces, në zbatim të Vendimit të mësipërm të Kryetarit të KLSH. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 15 shkronja (j) dhe nenin 30 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Për rekomandimet të cilat kanë rezultuar të pazbatuara grupi i auditimit ka arritur në këtë konkluzion për arsye se informacioni dhe dokumentet e dërguara nga OSHEE SHA me observacionin nr.12149/2, datë 22.12.2020, administruar nga grupi të auditimit në datë 28.12.2020 i përkasin vitit

2018, pra ky informacion nuk është përditësuar me gjendjen aktuale të zbatimit të rekomandimeve në proces, të realizuara pjesërisht dhe të pazbatuara të cilësuar më sipër.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 16-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE SHA të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësi të për mos realizimin e masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, si dhe të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, në proces dhe të zbatuara pjesërisht, duke i kushtuar vëmendje të posaçme rekomandimeve të cilat janë në procese gjyqësore.

Brenda tremujorit të dytë të vitit 2021

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës është konstatuar se:

- Këshilli mbikëqyrës nuk ka zbatuar kërkesat e nenit 18, pika 2 të Statutit për t'u mbledhur të paktën gjashtë herë në vit, për vitin 2018 dhe 2019;
- Gjatë veprimtarisë së tij në periudhën gjashtëmujori i dytë 2017 - 30.06.2020, Këshilli Mbikëqyrës ka marrë 55 vendime qarkulluese ose 39 % e nivelit të vendim-marrjes, për çështje me rëndësi jetike për veprimtarinë e OSHEE, në kundërshtim me kuadrin rregullator për funksionimin e tij, pasi vendim-marrja është atribut i mbledhjeve të këtij organi;
- Me vendimin nr.33 datë 14.07.2017 është miratuar shpenzimi për vlerën e kompensimit të pronarit që shpronësohet për realizimin e projektit "Ndërtimi i nënstacionit të TEC Kombinat 110/120 kV, Tiranë, me kosto më të lartë prej 26,674,674 lekë se sa përlllogaritjet sipas legjislacionit shqiptar përkatës, pa u bazuar në legjislacionin përkatës shqiptar, duke sjellë për pasojë shpenzime afër 16 herë më të larta për këtë qëllim;
- Me vendimin qarkullues nr.38, datë 20.12.2018, këshilli mbikëqyrës ka miratuar një shpërblim për 3 anëtarë të komisionit të vlerësimit disiplinor në shumën 120,000 në mënyrë të paligjshme, e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë;
- Vendimi qarkullues nr.1, datë 15.01.2019, për ngritjen dhe funksionimin e një njësie operationale speciale, si pjesë e strukturës së OSHEE SHA është marrë përpara se të dalë VKM nr. 18, datë 16.01.2019 dhe të hyjë në fuqi, 18.01.2019;
- Vendimi nr. 15, datë 05.06.2019 për miratimin e fillimit të procedurave për dhënin me qira të ambientit me sipërfaqe 30 m², me destinacion njësi shërbimi lokal me adresë Lagja Kushtrimi, zyrat e Drejtorisë Rajonale OSHEE Vlorë për një afat 5-vjeçar, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014, pasi afati i dhënies me qira është një vit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 27-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Këshilli mbikëqyrës të ushtrojë plotësisht detyrat e tij, duke u mbledhur të paktën 6 herë në vit, si dhe të përfshijë kontrollin mbi librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë, si dhe publikimin e raporteve financiare dhe të audituesve të pavarur;

- Të shqyrtojë, analizojë me vëmendje, të debatojë dhe të miratojë me votim në mbledhje çështjet që vihen në rendin e ditës dhe të tjera për diskutim, me qëllim që të konsolidohet ecuria e shoqërisë OSHEE, duke shmangur vendimet qarkulluese.

- Këshilli mbikëqyrës t'i kushtojë vëmendje të veçantë referencës ligjore të raporteve dhe relacioneve në shqyrtim, duke kërkuar dhe asistencën e juristëve të shoqërisë për vendim-marrje të veçanta; të revokojë vendimin qarkullues nr.38, datë 20.12.2018, si dhe të rivendosë në afate vendimin nr. 15, datë 05.06.2019.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Gjatë shqyrtimit të ankimimeve për procedurat e prokurimit kundër vendimeve të autoritetit kontraktor është caktuar vetëm një zyrtar për shqyrtimin e tyre, gjë që nuk është në përputhje të plotë me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 78, pika 6, germa "a".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 32-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për caktimin e komisionit të shqyrtimit të ankimimeve ndaj autoritetit kontraktor për çështje të vlerësimit të ofertave me përbërje

nga tre persona, ku të paktën njëri të jetë ekspert i fushës.

Në vijimësi

5-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të programi ekonomik u konstatua se për periudhën objekt auditimi është hartuar me vonesë nga Departamenti Ekonomik si pasojë e vonesave të krijuara nga çdo Drejtori dhe Divizion dhe për rrjedhojë ka sjellë vonesë miratimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, kreu III, pika 2, pasi nga ana e drejtorisë së shoqërisë praktika e plotë e projekt-programit nuk është përcjellë për miratim ministrisë përkatëse brenda datës 01 nëntor të çdo viti.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 34-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Departamenti Ekonomik të marrë masa për bashkërendimin e punës në kohë reale me të gjithë departamentet dhe divizionet e tjerë në mënyrë që të bëhet i mundur hartimi dhe raportimi i programit ekonomik sipas afateve ligjore.

Vazhdimisht

6-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi planifikimit dhe realizimit të buxhetit në llogaritë e arkëtueshme u konstatua se nga ana e OSHEE SHA për çdo vit llogaritë e arkëtueshme zhvlerësohen sipas metodologjisë së re të zhvlerësimit të kërkesave tregtare për arkëtim të raportuar nga audituesi ligjor B. T. A. SHPK në raportin e miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 39 datë 20.07.2017. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 80, Kontrata e furnizimit me energji elektrike, neni 82 -Të drejtat e furnizuesit, përveç të drejtave të përcaktuara në kontratë, neni 84 dhe neni 92, duke sjellë për pasojë pasaktësi në pasqyrimin e bilancit energjetik dhe ekonomik të shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 34-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Departamenti Ekonomik të marrë masa për rakordimin e detyrimeve me Departamentin e Borxhit dhe matjen e saktë të llogarive të arkëtueshme duke bashkërenduar punën për arkëtimin e tyre sipas afateve kohore të përcaktuara në ligj, si dhe të hartojë relacione shpjeguese për llogaritë e arkëtueshme neto nga klientët, metodën e zhvlerësimit të ndjekur çdo vit dhe përpjekjet e kryera nga ana e shoqërisë për arkëtimin e detyrimeve.

Vazhdimisht

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se struktura organizative OSHEE SHA ka ndryshuar çdo vit në periudhën 2018-2020: në vitin 2017 ka nisur procedura e ndarjes së shoqërisë, si dhe është krijuar Sektori i Teknologjive dhe Aseteve të Automatizuara, në varësi të Departamentit të Zhvillimit dhe Menaxhimit të Aseteve, në Divizionin e Shpërndarjes; në 2018, është miratuar struktura e Departamentit të Zhvillimit të Biznesit, janë krijuar tre shoqëri të kontrolluara nga OSHEE SHA (përfshirë licencat e operimit), si dhe Njësia për koordinimin e ankesë/kërkesave; në vitin 2020 është miratuar struktura organizative e OSHEE Group SHA (Shoqëria mëmë)”, me departamentet, sektorët dhe njësitë e strukturës organizative, por nuk janë miratuar sa punonjës do të ketë çdo departament/sektor /njësi e shoqërisë.

Veprimet e mësipërme janë kryer me vonesë nga përcaktimet në vendimin e Entit Rregullator të Energjisë nr.798/2, datë 20.12.2018, pasi periudha tranzitore duhej të përfundonte brenda vitit 2019, si dhe në strukturën dhe përbërjen e saj, duhej të vendoseshin edhe numri i punonjësve.

Veç kësaj, mungojnë kriteret e qarta për diferencimin e punonjësve në grupe sipas klasave nga 1 më i ulëti te 4 më i larti, duke ju lënë në dorë drejtuesve në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore (duke ruajtur fondin e pagave), sipas aftësive dhe përgjegjësive, detyrave dhe shkalles së vështirësisë në kryerjen e tyre, si dhe volumit të punës që punonjësit kanë. Gjithashtu, rezulton se nivelet e pagave për vitet 2017-2020, nuk janë miratuar nga Këshilli mbikëqyrës, brenda kufirit minimal e maksimal të pagës të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive financiare

të OSHEE SHA.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 38-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandime: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë OSHEE SHA të merren masa të menjëhershme për hartimin dhe miratimin e plotë të strukturës organizative, përcaktimin e numrit të nevojshëm të punonjësve për çdo departamentet, sektorët e njësi; si dhe përcaktimin e qartë të kritereve të cilat diferencojnë klasat e pagave për çdo pozicion.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2017, numri mesatar faktik i punonjësve në OSHEE SHA ka qenë 6423, punonjës dhe fondi total i realizuar për pagat në vlerën 4,912,548,844 lekë.

Sipas programit ekonomik për vitin **2017**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 6731 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2017 është realizuar 6423 punonjës. Fondi i pagave ka qenë 2,952,232,694 lekë, pra 69,864,262 lekë më pak se programi.

Sipas programit ekonomik për vitin **2018**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 6331 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar 6296 punonjës. Fondi i pagave ka qenë 4,912,548,844 lekë, pra 366,617,031 lekë më pak se programi.

Sipas programit ekonomik për vitin **2019**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 6331 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2019 është realizuar 6298 punonjës. Fondi i pagave ka qenë 4,974,112,431 lekë, pra 169,884,567 lekë më pak se programi.

Nga grupi i auditimit konstatohet se planifikimi bëhet me rezerva çdo vit, si dhe nuk është argumentuar dhe planifikuar saktë si numri i fuqisë punëtore ashtu edhe fondi i pagave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 40-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandime: Nga Administratori i shoqërisë dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të merren masa për planifikimin e saktë sipas ecurisë në vite të fuqisë punëtore, nevojave të identifikuar nga çdo sektor, si dhe plotësimi e nevojave për punonjës të shoqërisë referuar parashikimeve të programit ekonomik.

Në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi konstatohet se në Drejtorinë e Përgjithshme të OSHEE SHA:

- Nuk është hartuar Rregullorja e Brendshme e ndryshuar, megjithëse kanë hartuar dhe miratuar “Procedura e lëvizjeve të stafit”, “Kodi i sjelljes”, “Procedura e rekrutimit” dhe “Udhëzimet operative në sektorin e planifikimeve, trajnimeve dhe vlerësimet e performancës”;

- Megjithëse “Procedura e rekrutimit” është hartuar dhe miratuar, nuk është bërë për asnjë rast shpallja e vendeve vakante dhe as intervistimi apo testimi i kandidatëve. Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë, nga Burimet Njerëzore nuk ka informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura, sepse nuk ka të dokumentuar hapat që duhet të ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj;

- Në total janë dhënë 70 masa disiplinore, në Drejtorinë e Përgjithshme të OSHEE SHA, nga të cilat 46 “Vërejtje me shkrim” dhe 24 masa “Vërejtje me shkrim, paralajmërim për largim nga puna”. Janë audituar 30 nga këto procedura, pra 42%. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, dhe nuk ka komision apelimi. Në rastet e apelimit të dhënies të masave, rishikimi bëhet nga drejtoria e cila ka dhënë masën.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 43-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Departamenti i Burimeve Njerëzore, të marrë masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj duke u bazuar në “Procedura e rekrutimit”, dhe hartimi dhe miratimi i rregullores së brendshme të shoqërisë OSHEE SHA.

9.2 Rekomandimi: Nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies të masave disiplinore, si dhe ngritjen e

komisionit të apelimit lidhur me masat disiplinore në shoqërinë OSHEE SHA.

Në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në verifikimet e pagesave me bankë u konstatua se shoqëria pagesat e energjisë së importuar i kryen kryesisht në Euro. Procedura e blerjes së valutës kryhet duke bërë një vlerësim të kurseve të këmbimit që bankat e nivelit të dytë ofrojnë në faqet web të tyre, dhe i kërkohet më pas ofertë bankës C., e cila nga rastet e verifikuara deri tani e ka pasur më të ulët se kurset e këmbimit të deklaruara nga bankat e tjera në faqet web.

Duke qenë kurset e këmbimit që bankat e nivelit të dytë publikojnë në faqet web janë për shumta të vogla, përgjithësisht nën 1,000 euro, dhe se OSHEE këmben vlera në miliona euro, oferta që mund të ofrojnë bankat nëse u bëhet kërkesë zyrtare mund të ndryshojë me leverdi ekonomike.

Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë kryer procedurat e marrjes së ofertave nga bankat e nivelit të dytë për të përcaktuar ofertën më të leverdishme ekonomike.

- Nga verifikimi i pagesave të furnitorëve u konstatua se nga Departamenti Ekonomik dhe i Financës nuk është ngritur një sistem i monitorimit të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve në kohë, si dhe për të dokumentuar që pagesat kryhen sipas skadencave kronologjike. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, nenet 1, 12, e 16, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 45-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandime: Nga Departamenti Ekonomik dhe i Financës të merren masa për hartimin dhe kryerjen e procedurave të blerjes së valutave të huaja, që të kenë një gjithë përfshirje të bankave të nivelit të dytë, që operojnë në tregun kombëtar duke reflektuar parimet e ekonomicitetit dhe konkurrencës.

10.2 Rekomandime: Nga Departamenti Ekonomik dhe i Financës të merren masa për hartimin e një sistemi të monitorimit të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve në kohë, si dhe gjurmën e auditimit.

Në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit “Zhdoganimi i praktikave të OSHEE-së”, u konstatua se në vitin 2017 janë prokuruar vlerat 735,000 lekë, për vitin 2018 janë 570,000 lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 565,000 lekë, të cilat kanë të bëjnë me blerjen e energjisë në tregun e jashtëm. Sasia e blerjeve të energjisë si dhe praktikave doganore që kanë lidhje me to, janë të pa parashikueshme, pra duke e vështirësuar procesin e llogaritjes së vlerës së fondit limit. Në këtë situatë do të ishte e përshtatshme përdorimi i procedurës së “Marrëveshjes kuadër”. Veprimet sa më sipër janë në vijimësi të nenit 43, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 46-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që në të ardhmen, shoqëria të kryejë prokurimin e shërbimit të zhdoganimit të praktikave doganore, duke përdorur marrëveshjen kuadër, për një përdorim sa më me efektivitet të fondeve të saj.

Në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje karta SIM për nevoja të OSHEE SHA” 2018, u konstatua se objekti i procedurës ishte i ndryshëm me natyrën e shërbimit që kërkohet nga Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit.

Nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, nuk është përcaktuar qartë dhe saktë objekti i blerjes pasi kërkohen 800 karta SIM, por në thelb kërkohet shërbim interneti.

Në specifikimet teknike kërkohet mbulimi me internet sipas parametrave të kërkuar por pa e saktësuar se cili autoritet certifikues do të japë vërtetimet përkatëse për sa më sipër.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 dhe me nenin 40, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar.

- Më datë 15.08.2018, megjithëse komisioni e gjykoi të përshtatshëm si fitues të procedurës, oferta e

OE me karta SIM Vodafone, 800 copë, tarifa fikse mujore për SIM 600 lekë, me 1 GB internet për SIM, APN private, njësia pas tejkalimit të sasisë (pool) totale është 1 GB dhe kushton 600 lekë me TVSH, oferta e OE është e ndryshme nga ftesa për ofertë e komisionit i cili ka kërkuar karta SIM.

Në procesin e marrjes në dorëzim punonjësi i ngarkuar T. K., ka mbajtur dokumentin për konfirmimin e shërbimit më datë 15.08.2018, në një kohë që fatura e OE V. është lëshuar më datë 11.10.2018 dhe ishte për vlerën e shërbimit të VPN-së në shumën 400,000 lekë pa TVSH, veprime në kundërshtim me pikat 35 dhe 45 të Udhëzimit nr.30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Mos respektimi dhe zbatimi me korrektësi i procedurave të blerjeve të mallrave ose shpenzimeve sjell në rritjen e riskut të keqpërdorimit të burimeve financiare të shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 48-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Nga titullari i Autoritetit Kontraktor të merren masat që në të ardhmen gjatë zhvillimit të procedurave të blerjeve me vlera të vogla dhe marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve, të kryhet në kohë dhe me përgjegjshmëri e profesionalizëm zbatimi i hapave përkatës.

Në vazhdimësi

13. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës me objekt prokurimi “Suporti dhe mirëmbajtja e sistemit Call-Center”, 2019, u konstatua se në kontratën me vlerë 936,000 lekë me TVSH, për një periudhë 12 mujore, lidhur me OE fitues “C. P.”, SHPK, datë 02.08.2019, me nr. 15913/4 Prot., kushtet e veçanta neni 8, pagesa paraprake cilësohet: “AK do ti paguajë OE vlerën prej 936,000 lekë, për shërbimin që ofron menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate”. Operatori ekonomik ka kryer sigurimin e kontratës në vlerën 93,000 lekë. Pra AK, ka pranuar në kontratë të parapaguajë një shërbim i cili mund dhe të mos ofrohej nga OE. Veprimi sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2 dhe të nenit 13.

Parapagimi i shërbimit për të gjithë periudhën, duke vlerësuar se sigurimi i kontratës ishte në vlerën 10 %, të saj, ka shtuar riskun për keqpërdorimin e burimeve financiare të shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 43-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Nga titullari i AK të merren masa që në të ardhmen, formalizimi i marrëdhënieve kontraktuale për blerjen e mallrave ose shërbimeve, të kryhet duke reflektuar parimet e menaxhimit të riskut, lidhur me identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike.

Në vazhdimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i procedurës “Blerje bileta avioni për linjën ajrore Tiranë-Mynih e kthim”, 2019, u konstatua se OE fitues në objektin e aktivitetit kishte: “Shërbime në fushën e turizmit si udhëtime brenda dhe jashtë vendit.”, por pa e cilësuar transportin ajror ndërkombëtar si dhe i mungonte licenca XIII.1.A “Agjenci Udhëtimi” e cila konsultohet në regjistrin e QKB-së.

Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 4 datë 09.01.2018, “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”, pika 6.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 49-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15. Gjetje nga auditimi: Në 46 raste në urdhrin e shërbimit brenda vendit në përcaktimin e qëllimit të kryerjes së shërbimit ishte përshkrimi i përgjithshëm “Arsye pune”, pa u detajuar specifikimet e shërbimit.

Në 36 formularë të kërkesave për shërbim mungonin të shpjeguar qartë dhe me detaje qëllimi i udhëtimit dhe plani i punës.

Në 82 procedura të audituara ishte specifikuar vetëm data e nisjes, por mungonte data e përfundimit të shërbimit.

Në 6 procedura të audituara të muajit dhjetor 2019, të punonjësve në urdhër shërbimet e dhëna nga drejtori i DRM, janë specifikuar vetëm datat e nisjes, vendet ku do të shkohet me shërbim, dhe qëllimi i kryerjes së shërbimit. Në asnjë nga këto urdhër shërbime nuk janë përcaktuar saktë vendi

dhe data e kryerjes së shërbimit, si dhe qëllimi është i përgjithshëm dhe jo i shoqëruar me fiderat përkatës që kanë humbjet më të mëdha, abonentët debitor, zonat se ku ndodhen etj. Nga verifikimi i pasqyrave të shërbimeve të këtyre punonjësve u konstatua janë kthyer në ora 18.00 nga Kukësi në Tiranë, dhe po këtë ditë janë nisur nga Tirana në Shkodër. Arsyet se përse grupi u kthye në Tiranë dhe më pas vazhdoi për në Shkodër nuk janë të përcaktuara në urdhër shërbim. Gjithashtu punonjësit K. T., S. M., D. H., K. R. dhe pse në urdhër shërbim kanë pasur si datë nisje datë 31.12.2019 nga pasqyra e shërbimeve dhe faturat tatimore të fjetjes në hotel rezulton se janë nisur më datë 30.12.2019.

Të gjitha këto parregullsi janë në kundërshtim me nenin 4, pika 19 dhe neni 16, pikat 2.3 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar. Mos respektimi, dhe dokumentimi me korrektësi i procedurave të rimbursimit të shpenzimeve për dieta sjell në rritjen e riskut të keqpërdorimit të burimeve financiare të shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 50 -51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.Gjetje nga auditimi: Në procesin e dokumentimit të shpenzimeve për karburant, në Drejtorinë Rajonale Tiranë, u konstatua se në 26 raste në fletët e udhëtimit nuk është shënuar emri i personit që ka përdorur makinën, si dhe fletët e udhëtimit nuk janë kontrolluar dhe firmosur nga personi i autorizuar për këtë procedurë.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikat 35, 45 të Udhëzimit nr.30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe me Procedurat Operacionale të Menaxhimit të Mjeteve Motorike, (moduli i fletës së udhëtimit), autorizuar nga Administratori i shoqërisë më datë 06.03.2015. Mos respektimi, dhe dokumentimi me korrektësi i procedurave të shpenzimeve për karburant sjell në rritjen e riskut të keqpërdorimit të burimeve financiare të shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 51-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14-16.1 Rekomandimi: Departamenti Ekonomik dhe i Financës si dhe Departamentet e tjera duhet të marrin masa për rishikimin e procedurave të rimbursimit të shpenzimeve për dieta me qëllim që të jenë efektive, dhe të shërbejnë për pasqyrimin e gjurmës së auditimit, si dhe të forcojnë kontrollin për disiplinimin e shpenzimeve të karburantit.

Brenda tremujorit të dytë 2021

17. Gjetje nga auditimi: Shoqëria nuk ka kryer inventarizimet fizike të aktiveve afatgjata për vitet 2017 dhe 2018, duke mos kryer verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre. Shoqëria nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky regjistër. Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7, Inventari i aktiveve dhe detyrimeve, dhe pikat 30, 73 e 74 Inventarizimi i aktiveve, si dhe të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 54-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1 Rekomandimi: Departamenti Ekonomik dhe i Financës të marrë masa për kryerjen e inventarizimeve vjetore të aktiveve fizike të shoqërisë, si dhe për plotësimin e regjistrit të aktiveve që shoqëria zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Brenda tremujorit të dytë 2021

18. Gjetje nga auditimi: Shoqëria nuk ka përfunduar procesin e kalimit të pronësisë nga Inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, duke rrezikuar humbjet dhe mirëmbajtjen e këtyre aseteve. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të

Shpërndarjes SHA”, pikat 1, 2 dhe 3, për regjistrimin e pasurive në zbatim të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, neni 45. Mos përfundimi i këtij procesi rrit riskun, që objektet që nuk kanë të përfunduar procesin mund të tjetërsohen nga palë të treta.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa që të ndiqet me përgjegjshmëri dhe të përshpejtojë përfundimin e procesit të kalimit të pronësisë nga Inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, në shoqërinë OSHEE SHA.

Brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2021

19. Gjetje nga auditimi: Depozitimi në sistemin tatimor i pasqyrave financiare të shoqërisë është kryer jashtë afatit ligjor në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 29. Vonesat në hartimin, aprovimin dhe depozitimin kanë pasoja në vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike, si dhe për vendim-marrjet e palëve të interesuara.

- Aprovimi nga asambleja e ortakëve është kryer jashtë afatit të caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1.

- Më datë 31.01.2019, me numrin e çështjes CN-085852-01-19, nga shoqëria është kryer depozitimi i pasqyrave financiare të periudhës 2017, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në regjistrin e shoqërive tregtare. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 29, Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit. Depozitimi jashtë afateve ligjore është në kundërshtim edhe me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, neni 43, Regjistrimet e tjera të detyrueshme dhe neni 46.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 56-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1 Rekomandimi: Nga Departamenti Ekonomik dhe i Financës të merren masa që në të ardhmen, pasqyrat financiare të hartohen, të depozitohen, të aprovohen brenda afateve ligjore, duke mundësuar vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike lidhur me vendim-marrjet që duhet të marrin palët e interesuara, si asambleja e ortakëve, institute kredi dhënie etj.

Sipas afateve ligjore përkatëse

20. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të shoqërisë ekziston një mospërputhje e llogarive të arkëtueshme midis sistemit faturimit & arkëtimit dhe të pozicionit financiar “Të arkëtueshme” (kontabilitetit) për gjendjen e klientëve më 31 dhjetor 2017. Mospërputhja midis sistemit “SAP” dhe sistemit faturimit, arkëtimit dhe kontabilitetit më 31.12.2017 arrijnë në vlerën 1,169,392 mijë lekë, kundrejt 1,287,749 mijë lekë që rezultonte kjo mospërputhje më 31.12.2016, me pasoja në pasqyrimin e saktë të gjendjes së klientëve.

- Shoqëria OSHEE SHA rezulton me gjendje negative të kapitalit aksioner për (33,212,472) mijë lekë, i cili ka ardhur kryesisht nga humbjet e akumuluar në vitet e kaluara, ku në fund të vitit 2017 rezultojnë (69,292,022) mijë lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike dhe e Financës në bashkëpunim me drejtoritë e tjera, të merren masa për verifikimin dhe saktësimin e diferencave të llogarive të arkëtueshme klientë që janë ndërmjet sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe sistemit të faturimit.

Brenda tremujorit të dytë të vitit 2021

21. Gjetje nga auditimi: OSHEE SHA ka njohur të ardhura nga penalitetet ndaj KESH SHA si rezultat i mos respektimit të kontratës në vlerën prej **5,543,701 mijë lekë** me faturën nr. 4, datë 31.03.2018. Nga KESH SHA, me shkresën nr. 2260/1 datë 02.05.2018, kjo faturë nuk është pranuar,

me argumentin se furnizimi me energji nuk është realizuar për arsye të kushteve të thata klimaterike, pra për arsye madhore e përcaktuara kjo dhe në kontratë.

Diferenca që vjen nga deklarimi si e ardhur e kësaj fature në rezultatin e vitit 2017 sjell efektet që shoqëria ka pasur si rezultat financiar fitim të periudhës në vlerën 3,422,482 mijë lekë para tatimit mbi fitimin dhe 1,566,726 mijë lekë pas taksave, kur në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit nuk duhej ta përfshinte si të ardhur vlerën 5,543,701 mijë lekë, duke pasur rezultatin në vlerën 2,121,219 mijë lekë humbje.

Veprimi i mësipërm ka ndryshuar rezultatin e shoqërisë nga humbje duke u paraqitur me fitim të vitit ushtrimor. Pra, vlera 5,543,701 mijë lekë përbën mbi 10 % të vlerës së të ardhurave totale të OSHEE-së për vitin 2017 e cila është 53,542,863 mijë lekë, pra është një vlerë materiale në raport me të ardhurat e shoqërisë.

Lidhur me këtë çështje ka pasur komunikim shkresor midis Administratorit të OSHEE-së, me KESH SHA, MIE dhe Entit Rregullator të Energjisë. Me vendimin nr. 9687/4 datë 20.12.2018, ish-Ministri i MIE, në cilësinë e aksionerit të vetëm të shoqërisë KESH, ka vendosur për njohjen e faturës dhe ka urdhëruar administratorin për aplikimin e vendimit.

Veprimet më sipër janë në kundërshtim me ligjin Nr.9228, d/atë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare parimet dhe përbërësit e pasqyrave financiare”, neni 9, janë në kundërshtim me Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar, KC12, KC14, pjesa për paraqitjen besnike, janë në kundërshtim me ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, kreu II, neni 167.

Këto veprime, gjithashtu janë në kundërshtim me nenin 5, të VKM nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 57-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1 Rekomandimi: Drejtimi i shoqërisë në bashkëpunim me MIE, duhet të marrë masa që në të ardhmen, përgatitja dhe hartimi i pasqyrave financiare të kryhet me përgjegjshmëri, vërtetësi e në afatet përkatëse, sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, duke pasqyruar situatën financiare dhe performancën ekonomike, për disponimin e informacioneve palëve të interesuara në kohë, për vendim-marrjet përkatëse.

Brenda tremujorit të dytë të vitit 2021

22. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017 janë përlllogaritur shpenzime amortizimi në vlerën 2,528,909,000 lekë. Në shënimet shpjeguese nga drejtimi i shoqërisë nuk janë paraqitur informacione sqaruese lidhur me vlerësimet dhe arsyet e përcaktimit të jetës së dobishme të AAM-ve, pra për normat e amortizimit të aplikuara në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore në kundërshtim me pikën 75 të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16, Aktivitet Afatgjatë Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje).

- Në lidhje me përlllogaritjen e shpenzimeve të amortizimit, shoqëria përdor norma menaxheriale si dhe normat fiskale, duke paraqitur diferencën në shpenzimet e pazbritshme, të rezultatit të periudhës ushtrimore. Normat menaxheriale dhe ato fiskale të përdorura kanë mbetur të pandryshuara nga periudha e ish CEZ. Jetëgjatësia e aktiveve është rishikuar nga vlerësimi i kryer nga grupi i ekspertëve vlerësues dhe kontabël, që me urdhrin nr. 1460, datë 20.02.2015. Nga shqyrtimi i normave menaxheriale dhe atyre fiskale në rastin e klasës VE1, automjete autovetura është vendosur jeta e dobishme e asetit në 4 vjet. Nga verifikimet u konstatua se në periudhën 2016, ishin blerë 11 Makina elektrike tip "Golf" (autovetura), me vlerë totale 50,024,700 lekë me afat amortizimi në 4 vjet. Vendosja e jetës së dobishme nuk është e justifikuar dhe e argumentuar me materiale shpjeguese ose manualet përkatëse.

Duke mos përdorur norma menaxheriale të mirëargumentuara nga specialistët përkatës dhe duke mos e përcaktuar me fleksibilitet jetëgjatësinë e aktiveve, duke vlerësuar dhe zhvillimin e teknologjisë, shoqëria rrezikon të mos kryej me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën

23, shkronja d, e Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, si dhe në kundërshtim me pikën 75 të SNK 16, Aktivët Afatgjatë Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 60-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1 Rekomandimi: Nga drejtimi i shoqërisë të merren masa për vlerësimin e jetëgjatësisë së aktiveve, duke përdorur fleksibilitet dhe relacione të mirë argumentuara nga specialistët përkatës, për klasa specifike të aktiveve dhe jo të përgjithshme, për planifikimin në kohë të zëvendësimit të aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.

Brenda tremujorit të dytë 2021

23. Gjetje nga auditimi: Në opinionin e dhënë nga audituesit e pasqyrave financiare, në raportet auditimit dhe/apo letrat e rekomandimit për drejtimin, konstatohet se audituesit e pasqyrave financiare ndër vite, kanë kryer auditimin e tyre në zbatim të SNA 200 “Objektivat e përgjithshëm të audituesit të pavarur në kryerjen e një auditimi, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”, por nuk janë shprehur për zbatimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë në përputhje me SNA 250 “Mbajtja parasysh e ligjeve dhe rregullave në një auditim të pasqyrave financiare”, pikat 2-3.

Mos pajtueshmëria me ligjet dhe rregullat mund të rezultojë në dënimin me gjoba, hapjen e çështjeve gjyqësore apo në pasoja të tjera, të cilat mund të kenë një efekt material në pasqyrat financiare.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 61-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë dhe Departamenti Ekonomik dhe i Financës të marrin masa që në të ardhmen, audituesit ligjorë në auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë, të mbajnë në konsideratë dhe SNA 250 “Mbajtja parasysh e ligjeve dhe rregullave në një auditim të Pasqyrave Financiare

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Shoqëria nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë, veprime në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16.

- Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre, pika 103.

Mos shqyrtimi dhe vlerësimi i vlerës së mbetur dhe jetës së dobishme të AAM-ve si dhe mos evidentimi i linjave të vjetra të dala jashtë përdorimit, ka si pasojë mos pasjen e saktë dhe objektive të situatës së Aktiveve Afatgjatë Materiale, si dhe planifikimit të investimeve për periudhat e ardhshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 62-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

24.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike dhe e Financës në bashkëpunim me drejtoritë e tjera, të merren masa për shqyrtimin e vlerës së mbetur dhe jetës së dobishme të AAM-ve me vlera materiale të linjave të vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur, të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë dhe evidentimin e tyre.

Brenda tremujorit të dytë 2021

25. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbajtur për inventarët e datës 31.12.2019 u konstatua se shoqëria ka gjendje 4069 pjesë materiale e artikuj të ndryshëm, të vlerësuar si jashtë përdorimit me vlerë kontabël të mbetur 179,436,025 lekë.

Nga administratori i shoqërisë janë iniciuar procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit pas vlerësimit të komisioneve të ngritura. Më datë 04.06.2018, eksperti i vlerësimit i caktuar nga MIE, ka dorëzuar raportin e vlerësimit, për shkarkimin nga librat kontabël vlerën e inventarit prej 179,436,025 lekë, dhe më datë 18.10.2018, me vendimin nr. 29, Këshilli Mbikëqyrës ka aprovuar raportin si dhe ka miratuar vlerën e inventarit 108,784,007 lekë të vlerësuar për tu shitur si skrap, sasinë 495,137 kg në

vlerën 30,956,459 lekë, si dhe miratimin e vlerës së inventarit 70,593,018 lekë për tu asgjësuar. Bazuar në relacionin e administratorit të shoqërisë për shtyrjen e afatit të ekspertes Edlira Tirana për rivlerësimin e artikujve të miratuar për t'u shitur si skrap, pasi e ka aprovuar Këshilli Mbikëqyrës, me shkresën nr. 16029/8 Prot., datë 09.08.2019, i ka përcjellë për miratim aksionerit, MIE, vendimin nr. 23, datë 25.07.2019.

Me shkresën nr. 8472/1 Prot., datë 15.11.2019, aksioneri i shoqërisë e ka konsideruar të mbyllur misionin e ekspertit vlerësues dhe kontratën e lidhur me të dhe i kërkohet OSHEE, për zhvillimin e procedurës së ankandit publik për sasinë e materialeve skrap.

Shoqëria deri në përfundim të datës së auditimit, nuk ka iniciuar procedurat për hapjen e ankandit publik, duke shkaktuar rritje të kostove për mbajtjen e tyre.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 108 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" të ndryshuar.

Mos kryerja në kohë e ankandit sjell vështirësi logjistike, duke bllokuar hapësira magazinuese si dhe rrit riskun për dëmtime dhe zhvlerësime të mëtejshme të vlerës së aktiveve të vendosura për shitje.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

25.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për hapjen e procedurës së ankandit publik për shitjen e materialeve skrap, bazuar në raportin e ekspertit vlerësues, dhe proceduar më pas në vijimësi sipas situatës.

Brenda gjashtëmuajorit të parë 2021

26. Gjetje nga auditimi: Nga kontrollet e kryera në librat e blerjes për deklarimet e faturave të blerjes në sistemin tatimor, u konstatua se kishte fatura që i përkisnin periudhave ushtrimore të mëparshme ose të lëshuara nga subjektet disa muaj më parë dhe që departamentit të financës, u ishin vënë në dispozicion në muajin e deklaruar. Në librat e blerjeve të muajit mars 2018, u konstatua e deklaruar një faturë me vlerë 149,812,588 lekë pa TVSH e cila i përkiste datës 07.07.2017, pra e deklaruar 8 muaj me vonësë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në departamentin e kontabilitetit u konstatua se me shkresën nr. 17226/6 Prot., datë 20.03.2018, dërguar drejtorit të departamentit ekonomik C. K., në vijim të shkresës me nr. 17226/2 Prot., datë 11.08.2017 e ardhur nga OE "4 A-M SHPK" për likuidimin e situacionit përfundimtar, dërgohet dokumentacioni i plotë, nga P. L., drejtor i divizionit të shpërndarjes. Fatura tatimore është firmosur nga personi i caktuar për ndjekjen e kontratës E. M..

-Në librat e blerjeve të muajit shtator 2018, u konstatua fatura me nr. 33, nr. Serial 40421633, me vlerë 29,287,167 lekë pa TVSH dhe 35,144,006 lekë me TVSH, e lëshuar nga A. L. SHPK, datë 24.10.2017. Me shkresën nr. 14454/6 Prot., datë 07.09.2018, nga drejtori i divizionit të shpërndarjes P. L., dhe referuar kërkesës për likuidim të situacionit përfundimtar të OE me datë 18.09.2018, me nr. 14494/2 Prot., i është dërguar drejtorisë së departamentit ekonomik, dosja e plotë bashkë me faturën tatimore.

Fatura tatimore është firmosur nga personi i caktuar për ndjekjen e kontratës M. D. dhe proces verbali i marrjes në dorëzim të punimeve është i datës 17.11.2017.

Në situatat e mësipërme vonesa e dërgimit të faturës tatimore në Departamentin ekonomik, për kontabilizim dhe deklarim në librat e shitjes, sjell problematikat në vijim:

- Në kontabilizimin e aktivitetit dhe përcaktimin e datës së hyrjes në përdorim. Në Standardin Ndërkombëtar i Kontabilitetit 16, Aktivitet Afatgjatë Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje), neni 55, përcaktohet se amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, pra pasi aktivi është marrë në dorëzim dhe është bërë pjesë e sistemeve përkatëse. Ky veprim sjell shtrembërime në llogaritjen e saktë të amortizimit të aktiveve të shoqërisë duke ndikuar në rezultatin e shoqërisë.

Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 5, të SNK nr.16, Aktivitet Afatgjatë Materiale, me nenin 4, të ligjit nr. 48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

Veprimet e mësipërme sjellin efekte dhe në raportin e TVSH-së kreditore dhe debitore, duke mos pasqyruar detyrimet e sakta në kohë të shoqërisë, për pagesat e TVSH.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 64-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

26.1 Rekomandimi: Nga Departamenti Ekonomik dhe i Financës të merren masa që procesi i firmosjes së faturës tatimore nga personat e autorizuar si një dokument zyrtar i shoqërisë, i pranimit dhe marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, të kryhet me përgjegjshmëri dhe në afatin e duhur.

Vazhdimisht

27. Gjetje nga auditimi: Gjatë procesit të inventarizimit fizik të vlerave materiale në magazinat e OSHEE-së, në zbatim të Urdhrit nr. 24506, datë 06.12.2019, “Për inventarizimin e vlerave materiale në magazinat e shoqërisë, nga komisionet përkatës, u evidentuan artikuj me qarkullim të ngadalshëm në këto magazina, me vlerë totale në 283,914,390 lekë, artikuj të bërë hyrje në periudha të mëparshme dhe në ato të vitit 2019.

Nga filtrimi i informacionit për artikujt me qarkullim të ngadalshëm u konstatua se në inventarin e datës 31.12.2019, nga hyrjet e bëra në vitin 2017, kishte ende gjendje artikuj në vlerën 60,755,110 lekë. Në relacionin teknik drejtuar Drejtorisë Ekonomike, për nevojat e shoqërisë për bazë materiale për mirëmbajtje, për buxhetin e vitit 2017, nga drejtori i Divizionit të Shpërndarjes, janë hartuar dhe përlllogaritur në Planin e Mirëmbajtjes, sasisë vjetore të parashikuara, jo në përputhje me nevojat reale për vitin 2017, duke krijuar material stok.

Përlllogaritja jo e saktë e sasive të artikujve të kërkuar për tu blerë, sjell riskun e krijimit të materialit stok, që përveç se bllokun fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe eficient të burimeve financiare të shoqërisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 66-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

27.1 Rekomandimi: Nga Divizionit të Shpërndarjes të merren masa për planifikimin e bazës materiale për mirëmbajtje, sipas kërkesave të bazuara në raporte të mirë argumentuara, të specifikuara dhe të detajuara, për shmangien e krijimit të materialeve stok dhe një menaxhim me efektivitet dhe eficient të burimeve financiare të shoqërisë.

Vazhdimisht

28. Gjetje nga auditimi: OSHEE ka krijuar detyrime të reja ndaj KESH, për periudhën 2019 në vlerën 944,117,000 lekë. Mes shoqërive KESH dhe OSHEE është lidhur Marrëveshja më datë 06.04.2018 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”. Marrëveshja e ripagimit të detyrimeve të prapambetura ndërmjet KESH dhe OSHEE ishte një nga kushtet e vendosura nga BERZH për bërjen efektive të huasë nga Marrëveshja e Huasë e datës 30.06.2016 ndërmjet KESH dhe BERZH projekti “Shqipëria: Ristrukturimi i KESH”.

Pjesë e marrëveshjes së lidhur mes shoqërive KESH dhe OSHEE datë 06.04.2018 është edhe skeduli i ripagimit të detyrimeve të prapambetura nga shoqëria OSHEE skedul i cili parashikon pagesat fikse që kjo shoqëri duhet të likuadojë për llogari të KESH.

Për vitin 2019, vlera e programuar për t’u paguar ishte 17,379,228 Euro, nga OSHEE është paguar vlera prej 9,783,789 Euro, duke mbetur diferenca prej 7,595,439 Euro.

- Detyrimet e OSHEE ndaj OST për transmetim energjie, hua dhe interesa për periudhën 2017-2019, janë në vlerën 13,8 miliardë lekë deri në 31.12.2019, duke u rritur me ritme të larta. Nga viti 2016 deri në vitin 2017 detyrimet janë rritur me 6.4%, nga viti 2017 deri në vitin 2018 detyrimet janë rritur me 47.7%. Pas vitit 2018 deri në 31.12.2019, OSHEE ka reduktuar detyrimin e saj ndaj OST në masën 2.1%.

- Mbështetur në akt rakordimet përkatëse ndërmjet OSHEE dhe OST u konstatua se ndërmjet shoqërive ka problematika mbi mosnjohjen e detyrimeve dhe të drejtave reciproke midis tyre. Në akt rakordimin e datës 12.05.2020 që i korrespondon periudhës së vitit 31.12.2019 në balancat neto të shoqërive ka një mospërputhje. Më saktësisht në rakordimin e ekspozimeve ndërmjet OSHEE dhe OST sipas OSHEE, balanca neto është 10,479,843,512 lekë ndërsa sipas OST balanca neto është 12,993,121,526 lekë pra me një diferencë 2,513,278,014 lekë, vlera të cilat mund të ndikojnë

në performancën financiare të shoqërisë.

- OSHEE, nga ana e saj përballet çdo vit me një situatë mjaft të vështirë sa i përket arkëtimit të faturave të energjisë elektrike, kryesisht nga shoqëritë e Ujësjetës Kanalizimeve detyrimi i të cilave më datë 31.12.2019, është në vlerën 15.61 miliardë lekë ose afërsisht 130 milion euro. Mos arkëtimi i këtyre faturave, ndërkohë që OSHEE duhet të paguajë detyrime fiskale për këtë energji të pa arkëtuar.

Për të kryer pagesat e energjisë gjithashtu OSHEE ka marrë hua afatshkurtra nga viti 2017 deri në 7,078,820 mijë lekë në Over Drafte.

Vështirësitë e shkaktuara në sistemin energjetik për arsye klimaterike, mungesa e reshjeve gjatë viteve 2017 dhe 2019, detyroi OSHEE të blinte energji elektrike në tregun e jashtëm me çmime jo të favorshme.

Duke u nisur nga pozicioni që ka OSHEE në sistemin energjetik, si mbledhësja kryesore e arkëtimit nga konsumatori fundor, ka bërë që mungesa e likuiditetit të ndikojë në pagesat e planifikuara ndaj KESH, OST, si dhe për detyrimet korentë.

Në lidhje me detyrimet e ndërsjella midis KESH-OSHE-OST dhe MIE nga KLSH ne zbatim të planit vjetor të auditimit, miratuar nga Kryetari i KLSH, do të kryhet një auditim performance, me fokus të veçantë detyrimet e ndërsjella.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 68-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

28.1 Rekomandimi: Drejtimi i OSHEE-së, në bashkëpunim me asamblenë (MIE) të marrin masa për vlerësimin e situatës debitorë dhe kreditorë, duke përdorur masa shtrënguese për rritjen e arkëtimit, përdorimin me efikasitet të fondeve për investime si dhe pagesat në kohë të debitorëve.

Vazhdimisht

29. Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës së shërbimit të konsulencës “Studimi i zhvillimit të rrjetit inxhinierik për furnizimin me energji elektrike në qendër të Tiranës në përputhje me zhvillimin urban të Bashkisë së Tiranës” 2019, kontraktori BOE “I.” SHPK & ”A.” SHPK ka dorëzuar me 10 ditë vonesë dokumentin “Projekt-ide” të studimit, në kundërshtim me termat e referencës. Dorëzimi i kontratës është bërë në afat sipas dokumentit me nr.197 prot., datë 16.01.2020, me përjashtim të marrjes së lejes së ndërtimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 108-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

29.1 Rekomandimi: Administratori i kontratës, në të gjitha rastet të marrë në konsideratë plotësimin e dokumentacionit sipas termave të referencës dhe më pas të kryhen procedurat e financimit, me qëllim realizimin e plotë të kontratës së shërbimit.

Brenda tremujorit të dytë 2021

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit është konstatuar se:

- Janë vendosur kritere të pa argumentuara teknikisht dhe ligjërisht, si dhe jo në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si numri i punonjësve (“Pajisja me kartela të sigurimit teknik për punonjësit e OSHEE” 2019, “Shërbimi i internetit” 2017), gjuha e ofertës jo në gjuhën shqipe (“Blerje ndarësa, izolatorë fishekë siguresë TM për DR, morseta detaje etj. për DTL” 2019) në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, neni 61, paragrafi i dytë i pikës 2 dhe DST, seksioni 4, pika 4.6 etj.;

- Grupi i përllogaritjes së fondit limit, specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të kualifikimit nuk ka ezauruar plotësisht kërkesat e VKM nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, neni 59, pika 2, duke sjellë për pasojë mungesë saktësie në përllogaritjen e fondit limit si në procedurat e prokurimit “Inspektimi dhe konformiteti për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në n/stacione, linjat 35 KV dhe kabina elektrike”, “Blerje videowall për godinën e OSHEE SHA” etj.;

- Nga Komisioni i vlerësimit të ofertave janë skualifikuar OE me ofertën më të ulët, për detyrime në ditën e hapjes së ofertave (“Blerje materiale të nevojshme për Arkivën Qendrore dhe Arkivat e Drejtorive Rajonale” 2019), me evidentim gjobë të pa njoftuar dhe të likuiduar në vlera të pa

konsiderueshme në sistemin tatimor (“Blerje uniforma dhe pajisje sigurie për punonjësit e OSHEE”) etj., nuk është në përputhje me frymën e legjislacionit për prokurimin publik, kjo edhe në funksion të nxitjes së pjesëmarrjes dhe të konkurrencës së operatorëve ekonomikë, në kuptim të rritjes së efikasitetit dhe efikasitetit të procedurave të prokurimit publik;

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka skualifikuar OE me ofertën më të ulët për çështje si mosrealizim i numrit të fuqisë punëtore prej 0,75 % (“Pajisja me kartela të sigurimit teknik për punonjësit e OSHEE” 2019), për shkak të mungesës së përkthimit të një pjese të dokumentacionit teknik (“Rikonstruksion i kabinave elektrike muraturë, Fiderat A6, A7, A11, A12, A14, A15 NST Rajonal Tiranë 220/20 kV”), në një kohë që në zbatim të nenit 53, pika 4 të LPP, Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla;

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE të cilat nuk kanë plotësuar të gjitha kriteret e kualifikimit si specifikimet teknike (“Furnizim me vaj transformatori i pa përdorur për nevoja të Drejtorisë së Tensionit të Lartë dhe për nevojat të tjera të OSHEE SHA” 2018), mungesë e kopjeve të certifikuara të bilanceve nga organet tatimore (“Blerje mjetesh motorike në kuadër të grupeve të përbashkëta të kontrollit OSHEE SHA dhe Polici e Shtetit”) etj. ;

- Kanë shfaqur mangësi zyrtarët e ngarkuar gjatë zbatimit të kontratave kryesisht atyre të shërbimeve lidhur me afatet dhe cilësinë e tyre (“Inventarizimi dhe vlerësimi i Aktiveve Materiale Afatgjata të OSHEE SHA, si dhe ngritja e sistemit të administrimit dhe përgatitja e procedurave të brendshme të menaxhimit të tyre”, “Marrje me qira operacionale të makinave për NJOS” etj.), duke vepruar në kundërshtim me kushtet dhe afatet e kontratave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 83-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

30.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor OSHEE SHA të marrë masa për përzgjedhjen dhe trajnime të specifikuara të zyrtarëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si dhe për raste të veçanta të kërkojë nga APP mendime paraprake për trajtimin e tyre, me qëllim që të eliminohen efektet negative të konstatuara dhe të arrihet menaxhimi me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e kontratës Marrëveshje Kuadër” me objekt: “Inspektimi dhe konformiteti për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në n/stacione, linjat 35 KV dhe kabina elektrike” 2019 nuk janë respektuar termat e referencës në zbatimin dhe dokumentimin e saj, si: koha e matjeve, mungesa e plotësimi të raporteve të inspektimit, mungesa e kërkesës për matje shtesë, formaliteti i numri i kabinave të inspektuara gjatë një dite pune dhe koha e regjistruar për inspektimin e një kabine, pasi praktikisht është e pamundur që të kryhet inspektimi dhe të plotësohet dokumentacioni për 14-16 kabina gjatë një dite pune etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 83-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

31.1. Rekomandimi: Administratori i OSHEE SHA të ngrejë një grup pune që të analizojë zbatimin e kësaj kontrate deri në këtë periudhë, duke nxjerrë përgjegjësitë për mangësitë e evidentuara, si dhe të rishikojë të gjithë dokumentacionin e zbatimit, duke zbritur ato zëra të situacionit të cilat janë përfshirë në preventiv, por nuk janë kryer në përputhje me termat e referencës.

Brenda muajit qershor 2021

32. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e kontratës “Inventarizimi dhe vlerësimi i Aktiveve Materiale Afatgjata të OSHEE SHA, si dhe ngritja e sistemit të administrimit dhe përgatitja e procedurave të brendshme të menaxhimit të tyre”, 2019 është kryer dorëzimi i dokumenteve draft nga ana e kontraktorit, si dhe kanë vazhduar diskutimet dhe komunikimet e më pastajme me përfaqësues të AK, në shkelje të afateve të dorëzimit të raportit të vlerësimit paraprak për 110 ditë, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr.16545/11 prot., datë 23.01.2019 pika 7.4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 83-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

32.1 Rekomandimi: Autoriteti kontraktor të mbajë në konsideratë caktimin e zyrtarëve jo vetëm ekspertë të fushës, por dhe njohës dhe zbatues të termave të referencës e kushteve kontraktore në kontratat e shërbimeve, duke i paraprirë me trajnime të kësaj fushe specifike.

Në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Investimi për sistemin SCADA” me fondin total 199,405,302 lekë pa TVSH, në datën e zhvillimit të tenderit 14.05.2018, kanë marrë pjesë 4 OE dhe janë skualifikuar 3, nga të cilët njëri nuk ka paraqitur ofertë. Subjekti “A.” SHPK është shpallur fitues me ofertë ekonomike me vlerë 194,985,000 lekë pa TVSH në kundërshtim me kriteret ligjore (neni 53/3 të LPP) dhe ato të vendosura në DT (kriterin 1/d të kreut I të shtojcës 12), pasi rezultoi me detyrime të papaguara të sigurimeve shoqërore në vlerën 569,992 lekë

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 86-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

34. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion ne rrjetin TM - TU në Zonën e Thumanës – Borizan – F.14 N/ST F. Krujë” 2018 ” me fond limit 160,468,450 lekë, KVO ka kualifikuar BO T.SHPK & S. SHPK & E. SHPK & E. SHPK me ofertë 158,498,502 lekë pa TVSH në një kohë që oferta e paraqitur nga ana e tyre duhej refuzuar pasi, nuk i plotëson kërkesat e kuadrit ligjor për ndarjen sipas përqindjes së kryerjes së punëve, si dhe duhej skualifikuar për shkak se OE nuk plotësojnë kriteret teknike dhe profesionale për numrin e punonjësve dhe llojet e licencave që duhet të zotërojnë sipas përqindjes së punëve në marrëveshje.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 74, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe Shtojca 12 e DT, pika 2.3.1 Kapacitetet teknike dhe profesionale, germa “c”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 100-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

33-34.1 Rekomandimi: Autoriteti kontraktor OSHEE SHA të analizojë në mënyrë të veçantë zhvillimin e këtyre procedurave të prokurimit dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për të siguruar përzgjedhjen dhe trajnimin e zyrtarëve të përfshirë në procedurat e prokurimit, në ato drejtime ku shfaqen mangësi të njohjes dhe zbatimit të kriterëve dhe kushteve të përgjithshme e të veçanta të vendosura prej tij.

Brenda muajit qershor 2021

35. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion kabinash elektrike dhe ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC, linjë TM, qyteti Selenicë” 2018 me fond limit 41,924,896 lekë, nga ana e KVO është kualifikuar BOE “M. ltd” SHPK dhe “A.” SHPK në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” ndryshuar, neni 46 pika 1 dhe neni 53 pika 3; me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 74 pika 3; si dhe Dokumentet standarde të tenderit pika 2.3.1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 114-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

35.1 Rekomandimi: KVO të marrë masa që në të ardhmen të kryej vlerësim sa më objektiv duke ruajtur paanshmërinë në procedurat që vlerësohen qofshin ato me ofertë më të ulët apo më të lartë, duke pasur në vëmendje plotësimin e të gjitha kriterëve për kualifikimin e ofertuesve.

Vazhdimisht

36. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me “Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC në zonën e Peqinit” 2018 me fond limit 156,150,918 lekë, nga ana e Njësisë së prokurimit janë hartuar dokumentet e tenderit ku për sa i përket pikës 2.3 -Kapaciteti teknik është kërkuar licencë N.P – 12 –D (Punime të inxhinierisë së mjedisit), kriter i pa nevojshëm në këtë nivel licence për punime në vlerë (101,000,000-200,000,000 lekë), veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” ndryshuar, neni 12 pika c dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 57 pika 2 dhe neni 61 pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 117-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

36.1 Rekomandimi: Titullari i AK të OSHEE SHA të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të

stafit dhe Njesisë së prokurimit, me qëllim që në të ardhmen të vendosen kritere konkurruese sa më të pranueshme, duke mos cenuar realizimin e kontratës, zvogëlimin e konkurrencës dhe rritjen e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit.

Vazhdimisht

37. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtim kabina Ajrore dhe Rrjet TU me ABC” 2018 me fond limit 103,264,887 nga ana e KVO është kualifikuar BOE “D. SHPK” dhe “B. SHPK” në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” ndryshuar, neni 46 pika 1 dhe neni 53 pika 3; me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 74 pika 3, si dhe me Dokumentet standarde të tenderit, pika 2.3.2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 120-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

37.1 Rekomandimi: Titullari i AK të OSHEE SHA të marrë masa që në të ardhmen të kryej vlerësim sa më objektiv duke ruajtur paanshmërinë në procedurat që vlerësohet qofshin ato me ofertë më të ulët apo më të lartë, duke pasur në vëmendje plotësimin e të gjitha kritereve për kualifikim në respekt të frymës së ligjit.

Vazhdimisht

38. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me “Rikonstruksion i rrjetit TU me kabull me vetëmbajtje ABC në Agjencinë Burrel (Loti II)” me fond limit 50,797,989 lekë, nga ana e Njesisë së prokurimit janë hartuar dokumentat e tenderit ku për sa i përket pikës 2.3 Kapaciteti teknik është kërkuar licenca, N.P – 1 –B (Punime Gërmimi në tokë), N.P – 2- D (Punime civile dhe industriale) N.P – 12- C (Punime të inxhinierisë së mjedisit) N.S -14-D (Impiante të brendshme, Elektrike, Telefoni, TV etj.) kritere të pa nevojshme në këtë nivel licence për punime në vlerë (D =101,000,000 - 200,000,000 lekë) do ishte më se e mjaftueshme kategoria A. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” ndryshuar, neni 12 pika c dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 57 pika 2, neni 61 pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 114-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

39. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Spostimi i fiderave në N/Stacionin 110/35/10 Korçë” me fond limit 18,843,813 lekë, nga ana e titullarit të AK pas ardhjes së ankesës është nxjerrë shkresa nr. 99/1prot., datë 18.02.2019 për ngritjen e komisionit për shqyrtim ankese, duke emëruar në këtë pozicion veten e tij, veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kreu X neni 78 pika 6, shkronja a.

- Nga ana e titullarit të AK pas kthimi të përgjigjes së ankesës ri cakton dhe një herë KVO të marrë një vendim tjetër pas shqyrtimit të ankesës nga ana e tij, veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; kreu X neni 78 pika 6, shkronja a.

- Nga ana e KVO është kualifikuar BOE “M.” ltd dhe “A. SHPK” në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 46 pika 1 dhe neni 53 pika 3; me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 74 pika 3, 3; si dhe Dokumentet standarde të tenderit, pika 2.3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 123-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

38-39.1 Rekomandimi: Titullari i AK të OSHEE SHA të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të saj si dhe Njësitë e prokurimit të marrin masa që në të ardhmen të vendosin kritere konkurruese sa më të pranueshme duke mos cenuar realizimin e kontratës, zvogëlimin e konkurrencës dhe rritjen e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit.

Vazhdimisht

40. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit billing u konstatua se janë identifikuar 21277 abonentë të cilët vetëm për periudhën 2018-2020 kanë krijuar një borxh në vlerën 7,218,283,741

lekë dhe 2,942,019,409 lekë kamatëvonesa. Kjo vlerë për OSHEE SHA konsiderohet si llogari e arkëtueshme ose të ardhura të munguara. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” nenet 80, 82, 84 dhe 92.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 135-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

40.1 Rekomandimi: Administratori i OSHEE SHA të marrë masa të menjëhershme për identifikimin e abonentëve problematik, qofshin këto buxhetorë apo Jo buxhetorë, njoftimin e tyre për detyrimin e krijuar, trajtimin rast pas rasti duke u nisur dhe nga natyra e secilit dhe gjetjen e një zgjidhje sa më efikase për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura dhe shmangien e krijimit të debitorëve të rinj.

Menjëherë

41. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të blerjes së energjisë nga importi për periudhën 2017-2020 u konstatua se nga ana e furnitorëve të energjisë elektrike për sasinë e energjisë së blerë në import për mbulimin e humbjeve nuk respektohen kushtet e secilës kontratë, nenet 1-5. Edhe pse në total sasia e furnizuar është e plotë, oraret e furnizimit furnitorëve nuk janë respektuar në përputhje me kushtet kontraktore.

Sasia totale e energjisë e furnizuar jo në përputhje me kushtet e kontratës është 13,346 MWh, në vlerë 914,024 euro (113,256,714 lekë me kursin e këmbimit të BSH 123,91 lekë/euro) vlerë e cila përbën shpenzim jo në përputhje me kushtet e kontratës. Nga kjo sipas viteve:

- Për vitin 2017 në muajt nëntor dhe dhjetor u konstatua një sasi energjie prej 5,712 MWh e furnizuar jo në përputhje me kontratën nga furnitorët GEN-I Tirana për sasinë 3,564 MWh, GSA SHPK për sasinë 1,682 MWh dhe EFT AG për sasinë 466 MWh. Nga furnizimi jo në përputhje me kontratën përkatëse, furnitorët janë likuiduar në shumën prej 373,033 euro vlerë e cila përbën shpenzim jo në përputhje me kushtet e kontratës.

- Për muajt tetor dhe nëntor vitin 2018 nga auditimi u konstatua një sasi energjie prej 4,512 MWh e furnizuar jo në përputhje me kontratën nga furnitorët G.Tirana për sasinë 1,540 MWh, G. SHPK për sasinë 1,184MWh dhe E. AG për sasinë 1,788MWh. Nga furnizimi jo në përputhje me kontratën furnitorët janë likuiduar në shumën prej 362,905 euro vlerë e cila përbën shpenzim jo në përputhje me kushtet e kontratës.

- Për muajin mars 2019 u konstatua një sasi energjie prej 1,760 MWh e furnizuar jo në përputhje me kontratën nga furnitorët G.Tirana për sasinë 768 MWh dhe E. AG për sasinë 992 MWh. Nga furnizimi jo në përputhje me kontratën furnitorët janë likuiduar në shumën prej 115,302 euro vlerë e cila përbën shpenzim jo në përputhje me kushtet e kontratës.

- Për vitin 2020 në muajin mars u konstatua një sasi energjie prej 1,362 MWh e furnizuar jo në përputhje me kontratën nga furnitorët G. SHPK për sasinë 1,110MWh dhe E. AG për sasinë 252MWh. Nga furnizimi jo në përputhje me kontratën furnitorët janë likuiduar në shumën prej 62,784 euro vlerë e cila përbën shpenzim jo në përputhje me kushtet e kontratës.)

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kontratat e shitje-blerjes së energjisë nenet 1-5, specifikisht pika 5.2 e nenit 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 135-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

41.1 Rekomandimi: Furnizimi i Shërbimit Universal të marrë masa që në të ardhmen të kryej një monitorim të plotë nëpërmjet grupeve të sasive të furnizuara dhe respektimit të kushteve të hartuara pranuar dhe nënshkruara nga palët me kontratat respektive, me qëllim realizimin e një furnizimi me energji në rrjet për përmbushjen e nevojave të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Në vazhdimësi

42. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të qirave, rezulton se OSHEE SHA nuk ka ndjekur procedura të hapura apo me buletine, në gazetata kombëtare apo mediat e shkruara, për ofrimin e ambienteve sa më të përshtatshme dhe me çmim konkurrues, por ka vepruar sipas propozimeve të ardhura nga njësitë respektive sipas rretheve dhe më tej ka ndjekur një procedurë negociimi për çmimin, sipërfaqen, kushtet etj.

- Shoqëria OSHEE SHA ka shpenzuar 281,354,580 lekë në vit për pagesat e qirave, një shumë kjo e

konsiderueshme, nisur dhe nga fakti se shërbimin e arkëtimit për shoqërinë, prej disa vitesh e ofrojnë edhe posta shqiptare, bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e licencuara për operacione financiare etj.

- Nga auditimi i praktikave të ndjekura për marrje me qira të ambienteve, çmimet e lidhjes së kontratave në proporcion me sipërfaqen dhe krahasimi me çmimet e tregut në faqet web të agjencive imobiliare apo gazetave që operojnë në këtë fushë, u konstatua se çmimet e negociuara nga OSHEE SHA për lidhje kontratash qiraje, janë më të larta se çmimet e tregut.

- Nga auditimi konstatohet se në kontratat e qiramarrjes, parashikohet në nenin 5.3 mbajtja e penaltetit. Në kontratën e qiradhënies nuk parashikohet një nen i tillë, dhe për pasojë shoqëria OSHEE SHA nuk mund të mbajë penaltete lidhur me vonesat në pagesë të cilat për 3 raste shkojnë në vlerën 452,205 lekë. Gjithashtu, në kontratat e qiradhënies neni 11, pika 1 parashikohet zgjidhja e kontratës në raste mos pagese, por kjo pikë nuk është zbatuar asnjëherë nga ana e OSHEE SHA.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 146-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

42.1 Rekomandimi: Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse të përmirësojë procedurat e marrjes me qira të ambienteve që të jenë transparente, të hapura nëpërmjet buletineve, gazetave apo medias, për ofrimin e ambienteve sa më të përshtatshme dhe me çmime konkurruese.

42.2 Rekomandimi: Administratori i OSHEE SHA në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse të analizojnë situatën mundësinë e reduktimit të kostove lidhur me ambientet e marra me qira, duke u nisur nga fakti se shërbimin e arkëtimit për shoqërinë, prej disa vitesh e ofrojnë edhe bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e licencuara për operacione financiare, etj.

42.3 Rekomandimi: Departamenti Ligjor në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa për shtimin e penalteteve në kontratat e qiradhënies dhe sanksionimin e subjekteve debitore nga kontratat e shmangien e krijimit të detyrimeve.

Menjëherë.

43. Gjetje nga auditimi: Shoqëria OSHEE SHA, nuk ka ndërtuar gjurmën e auditimit për proceset kryesore të punës, si dhe nuk ka hartuar as plane të kontrollit të brendshëm (Plani lokal), në kundërshtim me ligjin Nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin” neni 4/ pika 19, dhe neni 4/ pika 3, për të ndihmuar në kryerjen e veprimtarive të njësisë publike, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqe 148-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

43.1 Rekomandimi: OSHEE SHA dhe Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit, të merren masa për monitorimin e kontroleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të shoqërisë në nivel qendror dhe rajonal sipas shkallës së përgjegjësisë dhe të raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri të nëpunësi autorizues i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga shoqëria, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë.

Në vijimësi

44. Gjetje nga auditimi: Drejtimi i OSHEE SHA, ka rreth 3 vjet pa amenduar politikën dhe udhëzimet e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në shoqëri, në kundërshtim me ligjin nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, Urdhrit të Ministrit të Financave Nr.8980 dt.15.07.2010 “Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. OSHEE SHA edhe pse është ndarë dhe ristrukturuar si shoqëri, ajo zbaton politikën së riskut, versioni 14.09.2016, konkretisht aneksi 4, pika 3/g.

Nga auditimi është konstatuar se këto politika nuk janë ndryshuar periodikisht edhe pse mund të jenë në proces amendimi, sepse OSHEE SHA vazhdon punon me Udhëzimet e Administrimit të Riskut versionin 1.1, Nr. 1061 Prot., datë 4.4.2017 dhe Politikën e Administrimit të Riskut versionin 1.1, Nr. 27917 Prot., datë 24.11.2016 dhe me dokumentin e Politikës së Administrimit të Riskut në OSHEE SHA, versionin 1.1, Nr. 27917 Prot., datë 24.11.2016.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqe 148-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

44.1 Rekomandimi: OSHEE SHA dhe Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit të marrin masa për amendimin e politikave të riskut referuar ndryshimeve strukturore që ka pësuar shoqëria nga ndarja e saj në shoqëri (mëma dhe bija), duke përditësuar politikat dhe monitorimin e objektivave të shoqërisë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

Në vijimësi

45. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në OSHEE SHA nuk ka realizuar planin e auditimeve sipas periudhës së përcaktuar në programin strategjik 2017-2020 dhe planet vjetore të auditimit, por disa nga auditimet e planifikuara nga DAB për çdo vit të mbetura pa u audituar janë mbartur në vitin pasardhës, ose nuk janë realizuar, për shkak të mosplanifikimit të duhur të faktorit kohë.

Sipas raportit të DAB për veprimtarinë e 6 mujorit të parë 2020 (raport i cili nuk është paraqitur në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020), auditimet për vitin 2020 nuk kanë nisur më shpejt se muaji Maj 2020 me arsyen se shkak është bërë ristrukturimi i shoqërisë OSHEE SHA dhe pandemia Covid 2019. Vlen të theksojmë se auditimet e DAB për vitin 2020, nuk kanë iniciuar që në muajin Janar 2020 periudhë në të cilën nuk gjendeshim përpara faktit të situatës së pazakontë, si pasojë e Covid -19. Plani vjetor i auditimit për vitin 2020 është miratuar që në muajin tetor 2019 dhe DAB ende ka pasur auditime të mbartura nga viti 2019 të porealizuara. Ristrukturimi i shoqërisë si shkak i përmendur nga DAB për mos fillimin e auditimeve të planifikuara për vitin 2020, nuk është bërë objekt relacioni apo diskutimi nga Drejtoria e DAB në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 6 “Roli i auditimit të brendshëm a) duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, *si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar; pika “vi”) përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve; neni 14, pika a) organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me nenin 8 të këtij ligji; kartën e auditimit të brendshëm dhe rregulloren e brendshme e funksionimit të departamentit të auditimit të brendshëm në OSHEE SHA, të ndryshuar dhe pikës 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe Rregulloren e funksionimit të brendshëm organizativ të drejtorisë së auditimit të brendshëm miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të “OSHEE Group” SHA nr.27, datë 07.07.2016, të ndryshuar.*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 11 faqe 155-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

45.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të planit të auditimit pas miratimit në organet drejtuese të shoqërisë, sipas afateve të përcaktuara me qëllim pasqyrimin objektiv, transparent të të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e shoqërisë OSHEE SHA.

Në vijimësi

46. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se jo i gjithë personeli i DAB-së është pajisur me certifikatën e Audituesit të Brendshëm, si dhe ka në përbërjen e vet vetëm një auditues që është inxhinier i fushës së energjisë, një inxhinier i teknologjisë së informacionit (IT) dhe një Inxhinier fizike. Kjo problematikë krijon vështirësi në formimin e grupeve të punës, në misione komplekse auditimi, referuar edhe sistemeve dixhitale të faturimit SAAP, Billing, me të cilat operon OSHEE SHA. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 6 “Roli i auditimit të brendshëm” a) duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, *si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar; pika “vi”) përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve; neni 14, pika a) organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me nenin 8 të këtij ligji; dhe Rregulloren e funksionimit të brendshëm organizativ të drejtorisë së auditimit të brendshëm, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të “OSHEE Group” SHA nr.27, datë 07.07.2016, të ndryshuar.*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 11 faqe 155-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

46.1 Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE SHA, të merren masa për monitorimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në raport me veprimtarinë e shoqërisë, duke sugjeruar plotësimin e burimeve njerëzore të DAB me inxhinierë të fushës së energjisë dhe inxhinierë IT, për identifikimin e risqeve në aspektin e kompetencës e cila nënkupton zotërimin dhe përdorimin e njohurive, aftësive dhe eksperiencës së duhur në ushtrimin e veprimtarisë audituese, faktorë të cilët ndikojnë në mbështetjen drejtuar organeve drejtuese dhe administratorit të shoqërisë për arritjen e objektivave dhe përmirësimin e aktivitetit të OSHEE SHA.

Në vijimësi

47. Gjetje nga auditimi: OSHEE SHA është njoftuar nga Avokatura e Shtetit për një dëm në vlerën 8,367,087 Euro (1,036,765,750 lekë me kursin e BSH prej 123,91 lekë/Euro) dhe 901,576 CHF (104,267,264 lekë me kursin e BSH prej 115,65 lekë/CHF) referuar çështjes së arbitrazhit ndërkombëtar SCAI nr.600491/2017, me palë paditëse E.AG dhe palë të paditur “OSHEE” SHA dhe deri në zbardhjen e vendimit OSHEE përballet me rritjen e interesave për këtë detyrim. Njohja e vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit “SCAI”, njohur dhe dhënë fuqi ligjore në Republikën e Shqipërisë me vendimin nr.118, datë 10.11.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë, plotësuar me vendimin nr.125, datë 24.11.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë, pritet ti shkaktojë OSHEE SHA, pasoja të rënda në likuiditetin e saj, referuar kostove të energjisë.

Sipas vendimit të datës 21.01.2020 të Gjykatës së Lartë të Kantonit Zvicër, Shoqëria E. AG i ka kërkuar OSHEE SHA me shkresë pagesën në mënyrë vullnetare të detyrimit (i cili deri në datë 11.12.2019 ka qenë rreth 9,196,521 Euro) (1,139,540,917 lekë me kursin e BSH prej 123,91 lekë/Euro).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 12 faqe 164-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

47.1 Rekomandimi: Nga OSHEE SHA, të merren masa për krijimin e provizioneve për shkak të ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit përfundimtar të arbitrazhit në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar SCAI Case no.600491-2017 të datës 21.01.2020 i Gjykatës së Lartë të Kantonit Zvicër, njohur nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.118, datë 10.11.2020, plotësuar me vendimin nr.125, datë 24.11.2020, për detyrimin ndaj Shoqërisë E. AG si palë paditëse.

Menjëherë

C.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Këshilli mbikëqyrës me vendimin qarkullues nr.38, datë 20.12.2018, ka miratuar një shpërblim të veçantë në fund të vitit 2018 për tre anëtarë të komisionit të vlerësimit disiplinor të NJOS, përfaqësues të MIE: A. D., E. S. dhe B. L., në shumën 120,000 lekë pa asnjë referencë ligjore për akordim shpërblimi të veçantë në fund të këtij viti.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë OSHEE SHA të marrë të gjitha masat **për arkëtimin e vlerës prej 120,000 lekë** nga A. D., E. S. dhe B. L., në cilësinë e anëtarëve të komisionit të vlerësimit disiplinor të NJOS, për përfitimin e paligjshëm të shpërblimit të veçantë në fund të vitit 2018.

Brenda tremujorit të dytë 2021

2. Gjetje nga auditimi: Këshilli mbikëqyrës dhe sekretarja e këtij këshilli, me vendimin e aksionarit nr.15155/1 prot., datë 19.12.2018 “Për miratimin e dhënies së një shpërblimit të veçantë në fund të vitit 2018 për Këshillin mbikëqyrës të OSHEE SHA” kanë marrë shpërblim të veçantë në vlerën 1,402,500 lekë, i cili përbën përfitim të paligjshëm, pasi është në kundërshtim me VKM nr.570, datë 3.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”, pika 6.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 12 faqe 164 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë OSHEE SHA të marrë të gjitha masat **për arkëtimin**

e vlerës prej 1,402,500 lekë përfituar padrejtësisht si shpërblimi i veçantë në fund të vitit 2018. nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës z. I. B., z. E. K., zj. E. Ç., zj. R. X., z. A. B. dhe zj. Xh. F. nga 255,000 lekë secili.

Brenda tremujorit të dytë 2021

3. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e kontratës nr.16545/11 prot., datë 23.01.2019 “Inventarizimi dhe vlerësimi i Aktiveve Materiale Afatgjata te OSHEE SHA, si dhe ngritja e sistemit të administrimit dhe përgatitja e procedurave të brendshme të menaxhimit të tyre”, dorëzimi i dokumenteve draft nga ana e kontraktorit, si dhe diskutimet dhe komunikimet e më pastajme me përfaqësues të AK, tregon se kontraktori “D.” SHPK & “D.A.” SHPK & “H.-H. T. T.” SHPK & “S.” SHPK & “A.” S.R.L ka qenë në shkelje të afateve të dorëzimit të raportit të vlerësimit paraparak për 110 ditë. Për këtë në zbatim të nenit 20.1/c të kontratës duhej të penalizohej me 4,381,000 lekë për dorëzim raporti me vonesë, të cilat janë të ardhura të munguara për OSHEE SHA nga burimet e tjera, pra dëm ekonomik.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 83-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë OSHEE SHA të marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës prej 4,381,000 lekë për penalitet të pa mbajtur kontraktorit “.” SHPK & “D. A.” SHPK & “H.-H. T. T.” SHPK & “S.” SHPK & “A.” S.R.L për dorëzim raporti me 110 ditë vonesë.

Brenda tremujorit të dytë 2021

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës të punimeve për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC në zonën e Peqinit” me fond limit 156,150,918 lekë, me operatorë fitues dhe zbatues të punimeve “B.” SHPK, nga verifikimet në terren i grupit të auditimit pasi u morën në analizë zërat e mëposhtëm: qafore abonenti dhe linje, tirantues linje, shtresë monolite betoni C 16/20 së bashku me transport etj., u konstatua se zëri shtresë monolite betoni C 16/20 nuk është në cilësinë dhe sasinë e prokuruar, duke e likuiduar padrejtësisht në sasinë totale me një diferencë nga realizimi faktik prej 170,338 lekë e cila konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet dëmshpërblehet nga përfituesi. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 7 dhe 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit”, si dhe kontrata nr. 1773 prot datë 13.07.2017.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 117-119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: OSHEE SHA të marrë masa që t’i kërkojë kontraktorit “B. SHPK”, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 170,338 lekë, të cilën e ka përfituar më tepër për punime të pakryera.

Brenda tremujorit të dytë 2021

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës të punimeve për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC për 26 kabina Elbasan-Cërrik” me vlerë të preventivuar 106,963,866 lekë dhe zbatues të punimeve “E.” SHPK, nga verifikimet në terren i grupit të auditimit, pasi u morën në analizë zërat e mëposhtëm: qafore abonenti dhe linje, tirantues linje, shtresë monolite betoni C 16/20 së bashku me transport etj., u konstatuan disa zëra punimesh nuk janë në përputhje me sasinë e kontraktuar. Vlera e përfituar padrejtësisht për punime të pa kryera është 699,075 lekë e cila konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet dëmshpërblehet nga përfituesi, veprime në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 7 dhe 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit”, si dhe kontrata nr. 9/7 datë 08.01.2019.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 130-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: OSHEE SHA të marrë masa që t’i kërkojë kontraktorit “E. SHPK”, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 699,075 lekë, të cilën e ka përfituar më tepër për punime të pakryera.

OSHEE SHA dhe Drejtoria Rajonale Elbasan të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për verifikimin e sasisë dhe cilësisë së punimeve të kryera në të gjitha kabinat e kësaj kontrate dhe të informojë KLSH për rezultatet e këtij kontrolli.

Brenda tremujorit të dytë 2021

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës të punimeve për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC në njësinë Lushnje” me zbatues të punimeve “V.” SHPK, nga verifikimet në terren i grupit të auditimit, pasi u morën në analizë zërat e mëposhtëm: qafore abonenti dhe linje, tirantues linje, shtresë monolite betoni C 16/20 së bashku me transportin etj., u konstatuan disa zëra punimesh jo në përputhje me sasinë e kontraktuar. Vlera e përfituar padrejtësisht për punime të pa kryera është 450,500 lekë e cila konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet dëmshpërblehet nga përfituesi. Veprime në kundërshtim me ligjin nr.8402, date 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 7 dhe 12, si dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit”, kontrata nr.21214/9 datë 18.01.2018.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 131-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: OSHEE SHA të marrë masa që t’i kërkojë kontraktorit “JV V.&R. shpk”, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 450,500 lekë, të cilën e ka përfituar më tepër për punime të pakryera, si dhe OSHEE SHA të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për verifikimin e sasisë dhe cilësisë së punimeve të kryera në të gjitha kabinat e kësaj kontrate dhe të informojë KLSH për rezultatet e këtij kontrolli.

Brenda tremujorit të dytë 2021

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës të punimeve për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i dy fiderave të rinj 20 kv, F-9, 20 kv-Karburnarë dhe Fideri 10, 20 KV, drejtim spitalit Lushnjë n/st Plasmasi 110/20/6 KV, kalimi nga 6KV në 20 Kv i kabinave të fiderave 6KV (Puntoria), lidhur me Autoritetin Kontraktor OSHEE SHA dhe Kontraktuesin “A.” SHPK, nga verifikimet në terren i grupit të auditimit u konstatua se zëri i punimeve “Tokëzues linje” dhe elementët e tij nuk janë në përputhje me sasinë e kontraktuar. Vlera e përfituar padrejtësisht për punime të pa kryera është 18,276 lekë e cila konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet dëmshpërblehet nga përfituesi. Veprime në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 7 dhe 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit”, si dhe kontrata nr. 1822/9 datë 10.05.2018.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: OSHEE SHA të marrë masa që t’i kërkojë kontraktorit “A.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 18,276 lekë, të cilën e ka përfituar më tepër për punime të pakryera.

Brenda tremujorit të dytë 2021

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës të blerjes së energjisë nga importi për muajin nëntor 2018 me furnitorin N. E. u konstatua se nga ana e furnitorit të energjisë elektrike për sasinë e energjisë së blerë në import për mbulimin e humbjeve nuk janë respektuar kushtet e kontratës nenet 1-5. Për këtë muaj ky operator ka nënshkruar dy kontrata shit-blerje energjie, një për profilin bandë me një çmim prej 73.65Euro MW/h dhe atë në profilin pik me çmim 84.85 Euro MW/h.

Edhe pse në total sasia e furnizuar është e plotë, kushtet e furnizimit nga ana e furnitorëve nuk janë në përputhje me kontratën. Ky operator për 13 ditë të ndryshme ka furnizuar në profilin pik me një diferencë më pak prej 503 MWh energji, të cilën e ka furnizuar në profilin bandë i cili ka një diferencë çmimi prej 11.2 euro MWh. Vlera prej 5,633 euro (697,985 lekë me kursin e këmbimit të BSH 123,91 lekë/Euro) si diferencë midis çmimit të blerjes së energjisë në profilin bandë dhe pik përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kontratën e shitje-blerjes së energjisë elektrike, nenet 1-5, specifikisht pika 5.2 e nenit 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 138-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: OSHEE SHA të marrë masa për të kërkuar në rrugë administrative dhe ligjore arkëtimin e vlerës prej 5,633 euro (697,985 lekë) të përfituar padrejtësisht nga furnitori N. E. nga kontratat e shit-blerjes së energjisë elektrike për muajin nëntor 2018.

Brenda tremujorit të dytë 2021

C.2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Blerje materiale të nevojshme për Arkivën Qendrore dhe Arkivat e Drejtorive Rajonale” 2019, KVO ka skualifikuar OE “D. G.” SHPK, me arsyetimin se ka detyrime të pashlyera ditën e hapjes së ofertave, në një kohë që sipas deklaratës përkatëse, në zbatim të kërkesave të DT, ky OE nuk ka detyrime në momentin e nënshkrimit të deklaratës, si edhe pas vërtetimit nga organet tatimore që nuk ka detyrime tatimore, **duke i shkaktuar efekt financiar negativ në përdorimin e fondeve të OSHEE SHA në vlerën 4,296,000 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis OE të shpallur fitues dhe OE të skualifikuar.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 70-114 të Projektraportit të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor OSHEE SHA të marrë masa për trajnime të specifikuara të zyrtarëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si dhe për raste të tilla të veçanta të kërkojë nga APP mendime paraprake për trajtimin e tyre, me qëllim që të eliminohen efektet negative të konstatuara dhe menaxhimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Vazhdimisht

2. Gjetje nga auditimi: Në përlllogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit “Inspektimi dhe konformiteti për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në n/stacione, linjat 35 KV dhe kabina elektrike” është përfshirë zëri “Kontrolli vizual i pajisjeve” e cila është detyrë ligjore dhe funksionale të OSHEE SHA, duke sjellë **për pasojë përdorimin pa efektivitet të vlerës 8,153,994 lekë, të destinuar për këtë qëllim në fondet e kësaj kontrate.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 70-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Autoriteti kontraktor OSHEE SHA të marrë masat e nevojshme për të argumentuar dhe dokumentuar teknikisht dhe ligjërisht në çdo rast prokurimi përlllogaritjen e fondit limit, me qëllim rritjen efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

Vazhdimisht

3. Gjetje nga auditimi: Në tenderin “Blerje uniforma dhe pajisje sigurie për punonjësit e OSHEE” KVO dhe zyrtari i marrë me shqyrtimin e ankesës duke skualifikuar BO “M. SHPK dhe “A. K.” SHPK, për një gjobë të pa njoftuar dhe të likuiduar në vlerën 2,447 lekë, **i kanë shkaktuar OSHEE SHA një efekt financiar negativ në përdorimin e fondeve prej 22,374,000 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis BO të shpallur fitues pas vendimit të KPP181/2019 datë 29.03.2019 dhe BO të skualifikuar për detyrime tatimore ditën e hapjes së ofertave.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 70-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor OSHEE SHA të marrë masa për trajnime të specifikuara të zyrtarëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si dhe për raste të tilla të veçanta të kërkojë nga APP mendime paraprake për trajtimin e tyre, me qëllim që të eliminohen efektet negative të konstatuara dhe menaxhimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Vazhdimisht

4. Gjetje nga auditimi: Zbatimi i kontratës “Marrje me qira operationale të makinave për NJOS”

për vitet 2017, 2018 dhe 2019 është shoqëruar me mangësi lidhur regjistrimin e konsumit të karburantit, km të përshkuara dhe me normën e kombinuar të konsumit në fakt të karburantit për 100 km, e cila rezulton deri në 58 % më e lartë krahasuar me atë të ofertuar në specifikimet teknike, me pasoja në koston e përdorimit të tyre si rezultat i normave më të larta të konsumit të kombinuar për 100 km, **ka sjellë për pasojë përdorim të fondeve pa efektivitet për blerjen e karburantit në vlerën 8,156,551 lekë për vitet 2017, 2018 dhe 2019.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 70-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5. Gjetje nga auditimi: Zbatimi i kontratës “Marrje me qira operationale të automjeteve për nevojat e OSHEE SHA” për vitet 2017, 2018 dhe 2019 është shoqëruar me mangësi lidhur me normën e kombinuar të konsumit të karburantit në fakt për 100 km, e cila në fakt ka rezultuar 0,4 litra më shumë se ajo e parashikuar, si dhe krahasuar me atë të ofertuar duke shkaktuar për pasojë **përdorim të fondeve pa efektivitet për blerjen e karburantit në vlerën 6,002,659 lekë për vitet 2018 dhe 2019.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 70-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4 - 5.1. Rekomandimi: Autoriteti kontraktor OSHEE SHA të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë në zbatimin e këtyre kontratave për periudhën 2017-2019, si dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e kontratave në përputhje me specifikimet teknike të OE ofertues fitues, duke saktësuar dhe qartësuar detyrat e zyrtarëve të përfshirë në zbatimin e kontratave të mallrave të kësaj natyre, me qëllim që të eliminohen efektet negative të konstatuara dhe të sigurohet menaxhimi me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike.

Vazhdimisht

6. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Pajisja me kartela të sigurimit teknik për punonjësit e OSHEE” 2019, KVO duke mos konsideruar devijim të vogël mosrealizimin prej mesatarisht 0.75 % të numrit të fuqisë punëtore të OE të skualifikuar, si dhe duke kualifikuar OE me detyrime për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën prej 333,929 lekë, i kanë shkaktuar **OSHEE SHA efekt negativ financiar në përdorimin e fondeve pa eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet në vlerën prej 2,968,400 lekë**, e cila përfaqëson diferenca midis OE të shpallur fitues edhe në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kualifikimit dhe atij të skualifikuar për shkaqe që mund të konsideroheshin devijime të vogla.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 70-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion i kabinave elektrike muraturë, Fiderat A6, A7, A11, A12, A14, A15 NST Rajonal Tiranë 220/20 kV”, nga skualifikimi i OE me ofertën më të ulët për shkak të mungesës së përkthimit të një pjese të dokumentacionit teknik, kur mund të trajtohej si devijim i vogël; si dhe për shkak të disponimit të makinerive në një kontratë tjetër, pa analizuar atë, i kanë shkaktuar OSHEE SHA **përdorim të fondeve pa efektivitet në vlerën 406,588 lekë**, e cila përfaqëson **diferencën midis ofertës të shpallur fituese dhe asaj më të ulët të skualifikuar.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 70-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Realizimi i shërbimit të riparimit të transformatorëve të fuqisë TM/TU me fuqi deri në 1.8 MVA” 2019, marrëveshje kuadër, KVO ka skualifikuar OE me shumatoren e çmimeve më të ulët në vlerën 1,211,068 lekë për njësi, në paraqitje të ofertës së të cilit është ulur fondi limit, si dhe mungon inxhinieri elektrik muajin fundit, për të cilat KVO mund të kërkonte sqarime dhe mund ta konsideronte devijim të vogël, **duke i shkaktuar OSHEE SHA rritje te koston për njësi dhe ulje të efektivitetit të përdorimit të fondeve publike në vlerën prej 15,889,715 lekë (7.9 % e fondit limit).**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 70-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Spostimi i fiderave në N/Stacionin 110/35/10 Korçë” me fond limit 18,843,813 lekë, nga ana e KVO është kualifikuar BOE “M.” ltd & “A.” SHPK, dhe BOE “I.” SHPK & “A.”. Pas paraqitjes së akcesës së pa drejtë nga ana e BOE “M.” ltd & “A.” SHPK dhe provokimin e një situate konfuze në këtë autoritet kontraktor të

vogël në staf, titullari i AK shqyrton ankesën dhe i jep të drejt ankuesit **duke i shkaktuar efekt financiar negativ në përdorimin e fondeve të OSHEE SHA në vlerën 3,288,787 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis OE të shpallur fitues dhe OE të skualifikuar.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 123-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6-9.1 Rekomandimi: AK të marrë masa për të përzgjedhur ekspertë dhe për të trajnuar zyrtarët që përfshihen në procedurat e prokurimit publik, me qëllim parandalimin e shfaqjes së rasteve të tilla dhe rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike.

Vazhdimisht

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën mars 2018 – qershor 2020 rezultoi se, me VKM nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë, Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Burimeve njerëzore nuk janë marrë masat për reflektimin e ndryshimeve ligjore për caktimin e dietës ushqimore në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet përkatëse për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive. Nga llogaritja e listë pagesave të periudhës mars 2018 – qershor 2020 rezulton se ky përfitim është në masën 1,716,642 mijë lekë, nga 1,029,985.3 mijë lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma prej 686,656,879 lekë e cila konsiderohet efektit financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 38-44 të Projektraportit të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masat e duhura, për mungesën azhurnimit të legjislacionit, dhe të ndiqen procedurat administrative për personat përgjegjës, bazuar në Kodin e Punës dhe Rregulloren e brendshme të Shoqërisë. Administratori i Shoqërisë, Departamenti Ligjor të marrë masat e duhura dhe të kryejë ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive, duke nxjerrë aktet përkatës për mos vazhdimin e dietës ushqimore më tepër nga përcaktimet ligjore.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 89 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën 61,898,675 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore; për periudhën objekt auditimi, janë humbur 45 çështje gjyqësore në Gjykatën e Lartë të Tiranës, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën 38,889,675 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Për periudhën objekt auditimi, janë humbur 4 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë, në vlerën 3,689,300 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. ***Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera 105,285,897 lekë e cila konsiderohet efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.***

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 41-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Nga Administratori, Departamenti Ligjor dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të shoqërisë të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga Administratori i shoqërisë janë kryer komandime të punonjësve në 6 raste nga Drejtoria e Përgjithshme për në Drejtoritë Rajonale, për periudha mbi një vjeçare, duke akorduar krahas pagës së pozicionit të mëparshëm të punës edhe shpenzimet për udhëtime dieta jashtë vendbanimit në vlerën gjithsej 17,938,000 lekë.

Në zbatim të VKM 329, datë 20.04.2016 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar, shërbimet i referohen një afati të caktuar, për një çështje të caktuar e cila nuk mund të zgjasë periudha kohore disa mujore, pasi këto raste ezaurohen me emërimet përkatëse. Po ashtu koncepti i komandimit lidhet me zgjidhjen e një problematike të caktuar emergjente, deri në plotësimin e vakancës të krijuar në strukturë, duke mos penguar në këtë mënyrë vazhdimësinë e procesit të punës dhe duke shmangur problematikat të cilat mund të rrjedhin nga këto vonesa.

Sa më sipër, konstatohet se vendimet e komandimit i kanë shkaktuar shoqërisë **OSHEE SHA kosto shtesë në vlerën 17,938,000 lekë, e cila rëndon shpenzimet e shoqërisë me shpenzime pa efektivitet**, duke pasur parasysh dhe rezultatin financiar negativ të saj, si dhe komandimi pa afat i punonjësve rrezikon të ndikojë negativisht në performancën e tyre dhe të punonjësve në varësi të tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 38 - 39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Nga Administratori i OSHEE SHA dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të analizohen kostot shtesë të ardhura nga komandimi pa afat dhe të merren masa të menjëhershme për plotësimin e vendeve vakante, amendimi i procedurave të lëvizjeve të stafit, duke përcaktuar me rregullore kriteret e komandimit dhe elementët e përfitimit.

Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 dhe neni 203 pika 1 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; në nenin 63 të kontratës kolektive si dhe në kontratat individuale të punës pika 6, i kërkojmë Administratorit të shoqërisë OSHEE SHA që në varësi të kompetencave të tij ligjore, duke vlerësuar përgjegjësinë e evidentuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

Nga “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për:

1. Z. C. K., me detyrë Drejtor i Departamentit Ekonomik dhe të Financës, pasi nuk është ngritur dhe miratuar procedura e monitorimit të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve në kohë si dhe për të dokumentuar që pagesat kryhen sipas skadencave kronologjike; mos dhënia e informacionit për normat e amortizimit të aplikuara, si dhe vendosje e normave menaxheriale jo të argumentuara; mos shqyrtimi dhe vlerësimi i vlerës së mbetur dhe jetës së dobishme të AAM-ve etj.;

2. Z. A. Zh., me detyrë Drejtorit i Departamentit të Kontrollit dhe i Rekuperimit të Humbjeve, pasi ka proceduar dhe dokumentuar për shpenzimet për udhëtim e dieta jo konform udhëzimeve përkatëse;

3. Z. P. L., me detyrë Drejtorit i Divizionit të Shpërndarjes, për dorëzim me vonesë i faturave tatimore në Drejtorinë e Kontabilitetit duke sjellë vonesa në likuidimin e detyrimeve dhe pasaktësi në llogaritjen e shpenzimeve të amortizimit;

4. Z. L. M., me detyrë Drejtor i Logjistikës, në cilësinë kryetarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla për parregullsitë e evidentuara në këtë fushë; në cilësinë e administratorit të kontratës deri më 16.01.2020, për parregullsitë në zbatimin e kontratës “Marrje me qira operationale të makinave për NJOS” për vitet 2017, 2018 dhe 2019;

5. Z. A. Q., me detyrë titullar i AK Korçë, në cilësinë e anëtarit të shqyrtimit të ankesës për parregullsitë në procedurën e prokurimit “Spostimi i fiderave në nënstacionin 110/35/10 Korçë” me

efekt financiar për buxhetin e shoqërisë;

6. Z. A. G., me detyrën e shefit të Sektorit të Shërbimeve të Brendshme për plotësimin e dokumentacionit justifikues për shpenzimet e karburantit jo konform udhëzimeve përkatëse; për problematikën në blerjet e vogla në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve; në cilësinë e anëtarit të KVO për parregullsitë në procedurën e prokurimit Blerje materiale të nevojshme për Arkivën Qendrore dhe Arkivat e Drejtorive Rajonale” 2019; në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit “Blerje uniforma dhe pajisje sigurie për punonjësit e OSHEE”; në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit për parregullsitë në zbatimin e kontratës “Inventarizimi dhe vlerësimi i Aktiveve Materiale Afatgjata të OSHEE SHA, si dhe ngritja e sistemit të administrimit dhe përgatitja e procedurave të brendshme të menaxhimit të tyre”; gjatë zbatimit të kontratës “Marrje me qira operationale të automjeteve për nevojat e OSHEE SHA” për vitet 2017 dhe 2018;

7. Z. O. Dh. në cilësinë e anëtarit të komisionit për parregullsitë për hartimin e preventivit, fondit limit, kriterëve (kapaciteteve teknike) për kualifikim, specifikimeve teknike dhe termave të referencës, si dhe të Administratorit të kontratës “Inspektimi dhe konformiteti për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në n/stacione, linjat 35 KV dhe kabina elektrike”; në cilësinë e anëtarit të KVO, për parregullsitë në procedurën “Pajisja me kartela të sigurimit teknik për punonjësit e OSHEE”;

8. Zj. E. M., në cilësinë e anëtarit të komisionit për parregullsitë për hartimin e preventivit, fondit limit, kriterëve, specifikimeve teknike dhe termave të referencës për procedurën “Inspektimi dhe konformiteti për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në n/stacione, linjat 35 KV dhe kabina elektrike”;

9. Zj. B. P., në cilësinë e anëtarit të komisionit për parregullsitë për hartimin e preventivit, fondit limit, kriterëve, specifikimeve teknike dhe termave të referencës për procedurën “Inspektimi dhe konformiteti për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në n/stacione, linjat 35 KV dhe kabina elektrike”;

10. Zj. A. K., në cilësinë e anëtarit të komisionit për parregullsitë për hartimin e preventivit, fondit limit, kriterëve, specifikimeve teknike dhe termave të referencës për procedurën “Inspektimi dhe konformiteti për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në n/stacione, linjat 35 KV dhe kabina elektrike”;

11. Z. A. B., në cilësinë e anëtarit të komisionit për parregullsitë për hartimin e preventivit, fondit limit, kriterëve, specifikimeve teknike dhe termave të referencës për procedurën “Inspektimi dhe konformiteti për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në n/stacione, linjat 35 KV dhe kabina elektrike”;

12. Zj. S. A., në cilësinë e anëtarit të komisionit për parregullsitë për hartimin e preventivit, fondit limit, kriterëve, specifikimeve teknike dhe termave të referencës për procedurën “Inspektimi dhe konformiteti për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në n/stacione, linjat 35 KV dhe kabina elektrike”;

13. Zj. S. K., në cilësinë e anëtarit të komisionit për parregullsitë për hartimin e preventivit, fondit limit, kriterëve, specifikimeve teknike dhe termave të referencës për procedurën “Inspektimi dhe konformiteti për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në n/stacione, linjat 35 KV dhe kabina elektrike”;

14. Z. A. Z., në cilësinë e anëtarit të KVO për parregullsitë për procedurën e prokurimit “Blerje uniforma dhe pajisje sigurie për punonjësit e OSHEE”; në cilësinë e anëtarit të përgatitjes së specifikimeve teknike për parregullsitë në procedurën “Pajisja me kartela të sigurimit teknik për punonjësit e OSHEE”;

15. Z. B. K., në cilësinë e zyrtarit të shqyrtimit të ankesave për parregullsitë për procedurën e prokurimit “Blerje uniforma dhe pajisje sigurie për punonjësit e OSHEE”; në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit për parregullsitë në zbatimin e kontratës “Inventarizimi dhe vlerësimi i Aktiveve Materiale Afatgjata të OSHEE SHA, si dhe ngritja e sistemit të administrimit dhe përgatitja e procedurave të brendshme të menaxhimit të tyre”;

16. Z. A. M., në cilësinë e anëtarit të KVO për parregullsitë në procedurën e prokurimit ”Furnizim

- me vaj transformatori i pa përdorur për nevoja të Drejtorisë së Tensionit të Lartë dhe për nevojat të tjera të OSHEE SHA
- 17. Z. D. Xh.**, në cilësinë e anëtarit të KVO për parregullsitë në procedurën e prokurimit "Furnizim me vaj transformatori i pa përdorur për nevoja të Drejtorisë së Tensionit të Lartë dhe për nevojat të tjera të OSHEE SHA
- 18. Z. K. N.**, në cilësinë e anëtarit të KVO për parregullsitë në procedurën e prokurimit "Furnizim me vaj transformatori i pa përdorur për nevoja të Drejtorisë së Tensionit të Lartë dhe për nevojat të tjera të OSHEE SHA"
- 19. Z. D. Sh.**, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit për parregullsitë në zbatimin e kontratës "Inventarizimi dhe vlerësimi i Aktiveve Materiale Afatgjata te OSHEE SHA, si dhe ngritja e sistemit të administrimit dhe përgatitja e procedurave të brendshme të menaxhimit të tyre";
- 20. Zj. M. I.**, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit për parregullsitë në zbatimin e kontratës "Inventarizimi dhe vlerësimi i Aktiveve Materiale Afatgjata te OSHEE SHA, si dhe ngritja e sistemit të administrimit dhe përgatitja e procedurave të brendshme të menaxhimit të tyre";
- 21. Zj. S. D.**, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit për parregullsitë në zbatimin e kontratës "Inventarizimi dhe vlerësimi i Aktiveve Materiale Afatgjata te OSHEE SHA, si dhe ngritja e sistemit të administrimit dhe përgatitja e procedurave të brendshme të menaxhimit të tyre";
- 22. Zj. V. K.**, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit për parregullsitë në zbatimin e kontratës "Inventarizimi dhe vlerësimi i Aktiveve Materiale Afatgjata te OSHEE SHA, si dhe ngritja e sistemit të administrimit dhe përgatitja e procedurave të brendshme të menaxhimit të tyre";
- 23. Z. M. B.**, në cilësinë e anëtarit të KVO për parregullsitë në procedurën "Investimi për sistemin SCADA";
- 24. Zj. S. V.** në cilësinë e anëtarit të përgatitjes së specifikimeve teknike për parregullsitë në procedurën "Pajisja me kartela të sigurimit teknik për punonjësit e OSHEE";
- 25. Z. E. T.**, në cilësinë e anëtarit të KVO, për parregullsitë në procedurën "Pajisja me kartela të sigurimit teknik për punonjësit e OSHEE";
- 26. Z. E. Ç.** në cilësinë e anëtarit të KVO, për parregullsitë në procedurën "Pajisja me kartela të sigurimit teknik për punonjësit e OSHEE";
- 27. Zj. E. K.**, në cilësinë e anëtarit të KVO për parregullsitë në procedurën e prokurimit "Rikonstruksion i kabinave elektrike muraturë, Fiderat A6, A7, A11, A12, A14, A15 NST Rajonal Tiranë 220/20 kV" 2018
- 28. Z. A. Gj.**, në cilësinë e anëtarit të KVO për parregullsitë në procedurën e prokurimit "Rikonstruksion i kabinave elektrike muraturë, Fiderat A6, A7, A11, A12, A14, A15 NST Rajonal Tiranë 220/20 kV" 2018
- 29. Z. A. K.**, në cilësinë e anëtarit të KVO për parregullsitë në procedurën e prokurimit "Rikonstruksion i kabinave elektrike muraturë, Fiderat A6, A7, A11, A12, A14, A15 NST Rajonal Tiranë 220/20 kV" 2018
- 30. Z. E. B.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit për hartimin e "Termave të referencës", përcaktimin e "Fondit limit" dhe "Kritereve të kualifikimit" në procedurën "Shërbimi i internetit", 2017;
- 31. Z. P. Gj.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit për hartimin e "Termave të referencës", përcaktimin e "Fondit limit" dhe "Kritereve të kualifikimit" në procedurën "Shërbimi i internetit", 2017;
- 32. Z. L. R.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit për hartimin e "Termave të referencës", përcaktimin e "Fondit limit" dhe "Kritereve të kualifikimit" në procedurën "Shërbimi i internetit", 2017;
- 33. Z. B. T.**, në cilësinë e administratorit të kontratës "Studimi i zhvillimit të rrjetit inxhinierik për furnizimin me energji elektrike në qendër të Tiranës në përputhje me zhvillimin urban të Bashkisë së Tiranës", 2019;
- 34. Z. I. H.**, në cilësinë e anëtarit të KVO për parregullsitë për procedurën e prokurimit Blerje

materiale të nevojshme për Arkivën Qendrore dhe Arkivat e Drejtorive Rajonale” 2019;

35. Z. A. H., me detyrë mbikëqyrës në zbatimin e punimeve me objekt “Ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC për 26 kabina Elbasan-Cërrik” për mos monitorim të saktë të punimeve;

36. Z. Gj. D., në cilësinë e anëtarit të KVO për parregullsitë në procedurën “Spostimi i fiderave në nënstacionin 110/35/10 Korçë”;

37. Z. M. H., në cilësinë e anëtarit të KVO për parregullsitë në procedurën “Spostimi i fiderave në nënstacionin 110/35/10 Korçë”;

38. Zj. A. B., në cilësinë e anëtarit të KVO për parregullsitë në procedurën “Spostimi i fiderave në nënstacionin 110/35/10 Korçë”;

39. Z. Z. Dh., në cilësinë e anëtarit të KVO për parregullsitë në procedurën “Rikonstruksion kabinash elektrike dhe ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC, linjë TM, qyteti Selenicë”;

40. Z. F. D., në cilësinë e anëtarit të KVO për parregullsitë në procedurën “Rikonstruksion kabinash elektrike dhe ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC, linjë TM, qyteti Selenicë”.

E.1 PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte **“Vërejtje me paralajmërim”** për:

- 1. Z. D. M.,** në cilësinë e titullarit të NJOS deri më datë 01.02.2018;
- 2. Z. L. B.,** në cilësinë e titullarit të NJOS deri më datë 28.01.2019;
- 3. Z. Q. L.,** në cilësinë e administratorit të kontratës “Marrje me qira operationale të makinave për NJOS” deri më 31.12.2017;
- 4. Zj. A. S.,** në detyrën e përgjegjës të financës të NJOS deri më 05.02.2018;
- 5. Z. E. B.,** në cilësinë e Drejtorit të Prokurimeve;
- 6. Z. J. S.,** në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit për parregullsitë në zbatimin e kontratës “Inventarizimi dhe vlerësimi i Aktiveve Materiale Afatgjata te OSHEE SHA, si dhe ngritja e sistemit të administrimit dhe përgatitja e procedurave të brendshme të menaxhimit të tyre”; dhe në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën “Investimi për sistemin SCADA”;
- 7. Z. B. L.,** në cilësinë e anëtarit të Njësisë së prokurimit Burrel;
- 8. Znj. E. Gj.,** në cilësinë e anëtarit të Njësisë së prokurimit Burrel;
- 9. Z. E. A.,** në cilësinë e anëtarit të Njësisë së prokurimit Burrel;
- 10. Zj. A. P.,** me detyrë mbikëqyrëse në zbatimin e kontratës “Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC në zonën e Peqinit”;

V. ANEKSE

Aneksi 1 Prokurimet në Drejtoritë Rajonale.

1- Praktika e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion kabinash elektrike dhe ndërtim rrjeti TU me kabull me vet mbajtje ABC, linjë TM, qyteti Selenicë” me fond limit 41,924,896 lek, u audituan dokumentacioni i inicimit të procedurës, nevoja për investim, procedura e prokurimit si më poshtë:

- Kërkesë për prokurim nga drejtori i divizionit të shpërndarjes Petraç Lika me nr. 7743/2 prot., datë 20.04.2017

“Rikonstruksion kabinash elektrike dhe ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC, linjë TM, qyteti Selenicë me vlerë të preventivuar 41,924,896 lekë (pa TVSH).

- Urdhër prokurimi nr. 7743/3 prot., datë 26.04.2017 për procedurën e prokurimit “Rikonstruksion kabinash elektrike dhe ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC, linjë TM, qyteti Selenicë” dhe ngritjen e njësisë së prokurimit të përbërë nga; A. Gj., V. K. dhe D. M..

- Urdhër nr. 7743/4 prot datë 26.04.2017 për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave të përbërë nga; E.B. kryetar, F. D. dhe Z. Dh. anëtarë.

- Procesverbali nr. 1 hartimit dokumenteve të tenderit datë 22.04.2017 hartuar nga njësia e prokurimit.

- Njoftim i kontratës me shkresë nr. 7743/5 datë 26.04.2017 me afat dorëzimi ofertash datë 22/05/2017 ora 15:00.

-Procesverbal nr. 2 datë 22.05.2017 për hapjen , zhvillimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e procedurës “Rikonstruksion kabinash elektrike dhe ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC, linjë TM, qyteti Selenicë” ku morën pjesë 2 operator ekonomik

1-BO: “M.” SHPK&”A.” SHPK 39,769,810 lekë;

2-OE: “S.” SHPK 40,635,660 lekë.

- Procesverbal nr.3 datë 01.06.2017 për shqyrtimin dhe vlerësimin e procedurës me objekt “Rikonstruksion kabinash elektrike dhe ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC, linjë TM, qyteti Selenicë” me fond limit 41,924,896 lek

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u kualifikuan të dy operatorët pjesëmarrës ku nga renditja I pari u rendit BO: “M.” SHPK&”A.” SHPK me vlerë oferte 39,769,810 lek dhe I dyti OE: “S.” SHPK me vlerë oferte 40,635,660 lek.

- Raporti përmbledhës hartuar me shkresën 7743/6 prot., datë 08.06.2017.

- Formulari I njoftimit të fituesit nr. 7743/7 prot., datë 08.06.2017

- Urdhër nr. 7743/8 prot., datë 03.07.2017 për lidhjen e zbatim kontrate me objekt “Rikonstruksion kabinash elektrike dhe ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC, linjë TM, qyteti Selenicë” me operator fitues BO “M.” SHPK&”A.” SHPK me vlerë oferte 39,769,810 lek.

-Urdhër nr. 7743/9 datë 03.07.2017 për mbikëqyrje punimesh me objekt “Rikonstruksion kabinash elektrike dhe ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC, linjë TM, qyteti Selenicë” dhe person përgjegjës në mbikëqyrje Arjola Qisko me licencë MK. 2791.

- Kontratë nr. 7743/10 datë 03.07.2017.

Formular I njoftimit të kontratës së nënshkruar nr. 7743/11 datë 07.07.2017.

2- Në drejtorinë rajonale Elbasan është audituar procedura e prokurimit “Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC në zonën e Peqinit” me vlerë të preventivuar 156,150,918 lekë.

Për këtë procedurë është audituar sistemi elektronik i prokurimit dhe dosje e inicimit të procedurës dhe realizimit të saj.

-Me shkresë nr. 8455/3 prot., datë 08.05.2017 Administratori i shoqërisë i delegon dhe autorizon Drejtorit të drejtorisë rajonale Elbasan z. B. M. për realizim procedure prokurimi.

- Me urdhrin nr. 5 datë 16.05.2017 titullari i AK edhe pse shkresa për delegim i vjen me vlerë të preventivuar krijon komisionin për përllogaritjen e fondit limit.

- Komisioni i krijuar sipas urdhrit nr. 5 i përbërë nga K. M., D. S. dhe R. C. përllogarit vlerën e

kontratës 156,150,918 lek.

-Me shkresën nr. 05/1 prot., datë 16.05.2017 titullari i AK drejtoria rajonale Elbasan ka nxjerr urdhër ,prokurimin me objekt “Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC në zonën e Peqinit” me njësi prokurimi A. H., M. D. dhe A. M..

-Me shkresën nr. 5/2 prot., datë 16.05.2017 titullari i AK drejtoria rajonale Elbasan ka nxjerr urdhër për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të ofertave për procedurën me objekt “Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC në zonën e Peqinit” të përbërë nga L. R., K. S. dhe E. V..

-Shkresa Datë 16.05.2017 procesverbali i hartimit të dokumenteve të tenderit.

Në licencat profesionale të kërkuara nga NJP e përbërë nga A. H., M. D. dhe A. M. kërkohet licencë N.P – 12 –D (Punime të inxhinierisë së mjedisit) pra NJP e AK Elbasan kërkon licencë të nivelit D punimet (101,000,000-200,000,000 lek) në inxhinierin e mjedisit ndërkohë që këtu kemi punime të karakterit N.P 11. NJP kërkon licencat kategoria N.S – 3- A (Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensor, shkalle lëvizëse transportuese) vetëm NJP mund ti gjej këto tip zërash në preventiv.

Për vendosjen e këtij kriteri mban përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga A. H., M. Dauti dhe A. M. veprime në kundërshtim me *Veprim në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik nr. 9643 LIGJI Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/2014 Neni 12 pika c dhe Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016;) neni 57 pika 2*

- Me shkresën nr. 5/3 prot., datë 16.05.2017 është bërë njoftimi i kontratës me datë zhvillimi tenderi datë 12.06.2017 ora 9:00.

- Publikuar në buletin nr. 20 datë 22.05.2017 të agjencisë së prokurimit publik me afat kohor dorëzimi ofertash data 12.06.2017 ora 9:00.

-Me procesverbalin datë 12.06.2017 mbi llogaritjen e ofertës anomalisht të ulët ku rezultoi se janë kualifikuar ;

BO “B. N” & “B.” SHPK me vlerë oferte 155,407,257 lek

-Me procesverbalin nr. 3 datë 14.06.2017 KVO ka shprehur se operatori ekonomik BO “B. N” & “B.” SHPK me vlerë oferte 155,407,257 lek i plotëson të gjitha kriteret dhe e kualifikon për fazën përfundimtare.

-Raporti përmbledhës hartuar me shkresën datë 22.06.2017.

Titullari i AK me shkresën nr. 05/4 datë 22.06.2017 nxjerr vendimin për miratim e renditjes përfundimtare dhe shpalljen fitues të operatorit ekonomik BO “B. N” & “B.” SHPK me vlerë oferte 155,407,257 lek për procedurën e prokurimit “Rikonstruksion rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC në zonën e Peqinit” .

-Formulari i njoftimit të fituesit nr. 5/5 prot., datë 22.06.2017

-Kontratë nr. 5/6 datë 05.07.2017.

Formular i njoftimit të kontratës së nënshkruar nr. 5/7 datë 05.07.2017.

3-Në drejtorinë rajonale Elbasan është audituar procedura e prokurimit “Ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC për 26 kabina Elbasan-Cërrik” me vlerë të preventivuar 106,963,866 lekë.

Për këtë procedurë është audituar sistemi elektronik i prokurimit dhe dosje e inicimit të procedurës dhe realizimit të saj.

- Me shkresë nr. 27009/3 prot., datë 19.10.2018 Administratori i shoqërisë i delegon dhe autorizon Drejtorit të Drejtorisë rajonale Elbasan z. B. M. për realizim procedure prokurimi.

- Me urdhrin nr. 9 datë 25.10.2018 titullari i AK edhe pse shkresa për delegim i vjen me vlerë të preventivuar krijon komisionin për përlllogaritjen e fondit limit.

- Komisioni i krijuar sipas urdhrit nr. 9 i përbërë nga K. M., D. S. dhe R. C. përlllogarit vlerën e kontratës 106,963,866 lek.

- Me shkresën nr. 9/1 prot., datë 25.10.2018 titullari i AK drejtoria rajonale Elbasan ka nxjerr urdhër prokurimin me objekt “Ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC për 26 kabina Elbasan-Cërrik” me njësi prokurimi A. H., K. B. dhe A. M..
- Me shkresën nr. 9/2 prot. Datë 25.10.2018 titullari i AK drejtoria rajonale Elbasan ka nxjerr urdhër për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për procedurën me objekt “Ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC për 26 kabina Elbasan-Cërrik” të përbërë nga L. R., M. M. dhe N. C..
- Shkresa Datë 25.10.2018 procesverbali i hartimit të dokumenteve të tenderit.
- Për këto dokumente të hartuara ka ardhur email nga APP për korrigjimin e tyre pasi nuk janë në përputhje me natyrën dhe proporcion me objektin e prokurimit.
- Shkresa nr. 9/4 prot., datë 26.11.2018 modifikim i dokumenteve të tenderit.
- Publikuar në buletin nr. 43 datë 29.10.2018 të agjencisë së prokurimit publik me afat kohor dorëzimi ofertash data 27.11.2018 ora 9:00.
- Me procesverbalin datë 2.12.2018 mbi hapjen e ofertave ku kanë paraqitur ofertë ;
BO “E.” SHPK & “E.” SHPK me vlerë 105,232,154
BO “R.” SHPK & “I. E.” SHPK me vlerë oferte 97,544,009 lek
- Me procesverbalin nr. 3 datë 06.12.2018 KVO ka shprehur se operatori ekonomik BO “E.” SHPK & “E.” SHPK me vlerë 105,232,154 vlerësohet si e vlefshme ndërsa oferta tjetër ka mangësi.
- KVO me shkresën datë 06.12.2018 ka nxjerr vendimin për vlerësimin e ofertave ku vlerëson të vlefshme ofertën BO “E.” SHPK & “E.” SHPK me vlerë 105,232,154 dhe skualifikon ofertë e BO “R.” SHPK & “I. E.” SHPK me vlerë oferte 97,544,009 lekë edhe pse me diferencë midis tyre.
- Raporti përmbledhës hartuar me shkresën datë 15.12.2018.
- Titullari i AK me shkresën nr. 9/5 datë 15.12.2018 nxjerr vendimin për miratim e renditjes përfundimtare dhe shpalljen fitues të operatorit ekonomik BO “E.” SHPK & “E.” SHPK me vlerë 105,232,154 për procedurën e prokurimit “Ndërtim rrjeti TU me kabull me vetmbajtje ABC për 26 kabina Elbasan-Cërrik”.
- Formulari i njoftimit të fituesit nr. 9/6 prot. datë 15.12.2018
- Kontratë nr. 9/7 datë 08.01.2019.
- Formular i njoftimit të kontratës së nënshkruar nr. 9/8 datë 09.01.2019.

1/1 Procedurat e prokurimit sipas viteve dhe grupeve të auditimit

Tabela nr.1 Procedura prokurimit të shqyrtuara nga grupi i auditimit të KLSH për IT

Viti	Nr.	Objekti I Prokurimit	Fondi Limit	Tipi I procedurës	Vlera e kontratës	Data e lidhjes
	1	Mirembajtje e 1200 SpeedData Android KT45	17,683,200	E hapur	16,999,920	19.11.2018
	2	Sherbim Mirembajtje te Sistmit Flare HR & Payroll	3,400,000	Kërkesë për propozim	3,360,000	31.12.2018
2018	3	Permiresimi dhe mirembajtja 3 vjecare e sistemin te Arkive/Protokoll dixhitale	85.800.000	E hapur	80,223,000	24/01/2019
	4	Shtimi i funksionaliteteve te SAP dhe blerja e licensave te perdoruesve	27.000.000	E hapur	26,800,000	18/01/2019
	5	Mirëmbajtje dhe upgrade për infrastrukturën e Server Room primar dhe Server Room Disaster Recovery	124.400.000	E hapur	121,480,000	24/01/2019
2019	6	Aplikacion Mobile per nevojat e OSHEE SHA	2.000.000	Kërkesë për propozim	1,900,000	03/05/2019
	7	Mirembajtje e Access Control ekzistues dhe Blerje Access Control per hyrjen Lindore ne Godine Qendrore	2.420.000	Kërkesë për propozim	2,342,000	03/05/2019
	8	Mirëmbajtjen e Sistemit ARMS	12.420.000	E hapur	12,420,000	09/07/2019
	9	Mirembajtja e sistemit financiar menaxherial SAP	13.000.000	E hapur	12,780,000	09/08/2019
	10	mirembajtje 3 vjecare e platformes elektronike te blerjes se energjise elektrike	15.000.000	E hapur	14,785,000	16/09/2019
	11	Mirembajtje per tre vjet e sistemit i meaxhimit automatik te Rradhes/DVR/Kamera/ne KNK dhe Shtimi i KNK- ve me Sistemin e manaxhimit automatik te rradhes	76.800.000	E hapur	74,600,000	10/09/2019
	12	Upgrade dhe mirembajtja 3 vjecare e Platformes se Monitorimit te Hec-eve te vegjel	160.000.000	E hapur	72,324,974	08/04/2019
	13	Rritja e sigurise dhe kapaciteteve te Infrastruktures se Netëork dhe ruajtjes se te dhenave te sistemeve teknologjike sipas nevojave te OSHEE	165.000.000	E hapur	159,800,000	08/04/2019
2020	14	Mirembajtja dhe Pershtatja e Sistemit te burimeve njerezore sipas ndarjes se OSHEE SHA	6.000.000	Kërkesë për propozim	5,760,000	Njoftim fituesi
	15	Upgrade dhe mirembajtje të infrastrukturës aktuale te datacenter	170.000.000	E hapur	166,500,000	31/01/2020

	primar dhe DR Site.				
--	---------------------	--	--	--	--

Tabela nr. 2 Regjistri i realizimeve 2017 (pa blerjet dinamike të biletave dhe procedurat IT)

Nr	Objekti i prokurimeve	Fondi limit i përgjithshëm pa TVSH		Vlera e Prokuruar		Procedura	Data e kontrates	Firma Fituese
		Investime	Shpenzime	Investime	Shpenzime			
1	Marrje me qera automjete per llogari te NJOS		2,979,000		2,979,000	Kerkese per Propozim-Sherbime	18.08.2017	T.A.
2	Sherbimim i internetit		6,553,333		5,890,000	Kerkese per Propozim-Sherbime	22.08.2017	A.
3	F/V Motogjenerator me naftë per nevojat e OSHEE	7,656,666		6,660,000		Kerkese per Propozim-Mallra	18.09.2017	R.
4	F/V UPS ne dhomen e serverave	6,260,020		5,998,200		Kerkese per Propozim-Mallra	05.09.2017	S. Co
5	Sherbimi i transportit i materialeve te blera me fondet e BB		27,057,319		21,725,120	E hapur-Sherbime	15.09.2017	F.T.
6	Blerje bokse individuale per matesa elektronike 1 dhe 3 fazore		149,575,400		137,930,000	E hapur - mallra	15.01.2018	A." shpk
7	Sherbimi i pastrimit		30,300,184		27,537,926	E hapur-Sherbime	15.12.2017	C. F.
8	Materialet e arkives		7,800,000		7,680,000	Kerkese per Propozim-Mallra	11.12.2017	K. KH
9	Blerje videowall per godinen e OSHEE SHA.	54,781,955		26,000,000		E hapur-Mallra	12.01.2018	A. C.+ R.
10	Sistem kufizues akses kontrolli	6,850,000		6,450,120		Kerkese per Propozim-Mallra	13.02.2018	P. S.
11	Mirembajtja e sistemit financiar menaxherial SAP		6,396,960		6,390,000	Kerkese per Propozim-Mallra	12.01.2018	S-S.

Tabela nr. 3 Regjistri i realizimeve 2018 (pa blerjet dinamike të biletave dhe procedurat IT)

Nr	Objekti i prokurimeve	Fondi limit i përgjithshëm pa TVSH		Vlera e Prokuruar		Procedura	Data e kontrates	Firma Fituese
		Investime	Shpenzime	Investime	Shpenzime			
1	Mirëmbajtje dhe upgrade për infrastrukturën e Server Room primar dhe Server Room Disaster Recovery		131,491,228		129,760,000	E hapur-Mallra	31.01.2018	A.+S.
2	Ndertim Rrjeti TM 20 kV, rikonstruksion dhe ndertim kabina elektrike dhe rrjet TU me percjellesa me vetembajtje ABC, Fideri VJ 7, VJ 8, NST 110/35/20/6 kV Vlorë 2 (punetori)	69,694,571		65,730,746		E hapur-Pune	19.02.2018	S.
3	Blerje pjese kembimi dhe riparim Automjetesh		119,867,306		129,572,484	E hapur-Sherbime	04.06.2018	A.
4	Rrjeti elektrik shperndares i NST 110/20 kV Golem Fiderat 6,7,8 (punetori)	73,498,224		71,840,622		E hapur-Pune	23.02.2018	K.

5	Trasmetimi GRPS per PDA		7,800,000		7,254,000	Kerkese per Propozim Sherbime	10.05.2018	A.
6	Mirembajtje i sistemit te leximit ARMS		4,200,000		4,140,000	Negociim pa njoftim paraprake Sherbime	20.03.2018	K.
7	Sigurim i detyrueshem TPL automjetesh, sigurim kasko dhe karton jeshil per vitin 2018		5,403,559		5,399,695	Kerkese per Propozim Sherbime	10.04.2018	I.
8	Rrjeti Shperndares 20kV nga N/Stacioni 110/20kV Fieri Ri fiderat 10, 11, 12 dhe N/Stacioni 110/20kV Fieri 2 (punetori)	63,701,552		59,881,463		E hapur-Pune	27.04.2018	I.AL-." sh.p.k
9	Ndertimi i Rrjetit të ri elektik 20 kV në Fushe Kruje, Fideri "F 2" (punetori)	71,229,152		68,240,478		E hapur-Pune	19.04.2018	C.
10	Ndertim i dy fiderave te rinj 20kV, F-9, 20kv-Karbanare dhe fideri 10, 20kV, drejtim Spitalit Lushnje -n/st Plasmasit 110/20k/6kV, kalimi nga 6kV në 20kV i kabinave të fiderave 6kV	84,289,758		79,242,261		E hapur-Pune	10.05.2018	A.&I.
11	Ndertimi i Rrjetit të ri elektik 20 kV në Fushe Kruje, Fideri "F4"	117,445,684	111,572,418			E hapur-Pune	27.04.2018	G.&P.
12	Marrje me qira operacionale te makinave te NJOS		6,516,000		6,510,000	Kerkese per Propozim -Mallra	23.04.2018	T. A.
13	Sherbim GPS per mjetet motorike te OSHEE SHA.		4,996,200		4,470,000	Kerkese per Propozim Sherbime	20.04.2018	A.
14	Paisja me kartela te sigurimit teknik per punonjesit e OSHEE		14,915,000		14,790,000	E hapur-Sherbime	11.05.2018	H.
15	Asistence dhe Mbeshtetje profesionale per pergatitjen e studimeve, realizimin apo modifikimin sipas rastit te plan-veprimeve te ndarjes se aktivitetit te Shperndarjes dhe rritjes se efektivitetit menaxherial		174,850,000		162,652,250	Sherbim Konsulence	08.06.2018	E. Z.
16	Studim, analiza e furnizimit te pandërprere me energji elektrike dhe rritja e shkalles se sigurise se rrjetit te Tiranes		64,400,066		60,468,650	Sherbim Konsulence	19.07.2018	E.+G.
17	Sherbimi i riparimit te transformatoreve te fuqise TM/TU me fuqi deri ne 1.8 MVA		200,000,000		200,000,000	Marreveshje kuader E hapur-Sherbime	15.05.2018	E.
18	Auditim i pasqyrave financiare dhe projekteve te Bankes Boterore		4,293,120		3,590,000	Kerkese per Propozim Sherbime	02.07.2018	D. A. A.
19	Investimi për sistemin SCADA	199,405,302		194,985,000		E hapur-Pune	13.08.2018	A.
20	Furnizim me materiale teknike per NJOSE	2,593,004		2,585,000		Kerkese per Propozim -Mallra	27.06.2018	L.
21	Sherbimi i printimit		119,850,000		118,980,000	E hapur-Sherbime	16.07.2018	B. E.cs+ I.

22	Riparimi i transformatoreve te nenstacioneve (DTL)		100,000,000		100,000,000	Marreveshje kuader E hapur-Sherbime	27.08.2018	R. E. E.
23	Sistem per menaxhimin automatik te rradhes, monitorim audio-video ne ambientin e punes dhe raportim mbi performancen e Qendrave te kujdesit ndaj Klientit te OSHEE	59,736,666		57,050,000		E hapur-Mallra	25.07.2018	A.C.
24	Blerje matesa elektronik 1 dhe 3 fazor	199,760,000		191,400,000		E hapur-Mallra	25.07.2018	I. P.
25	Blerje Kabell fuqie dhe aksesore	169,992,000		163,473,000		E hapur-Mallra	20.07.2018	A. E.
26	Blerje shtylla druri dhe B/A	89,275,000		86,410,000		E hapur-Mallra	08.10.2018	R.-M. Ki
27	Kabell ABC dhe aksesore	199,763,000		183,682,000		E hapur-Mallra	31.07.2018	A. I. ing
28	Rikons.Kab.Murature, Fiderat F-321;322;324;325 dhe ndertimi i Baterise te Re me 8 Tubo (seg.N/ST.-Rr.S. Delvina) dhe shtrirja e 5 Fiderave te rinje, Fiderat F-324/1;324/2;326/1;326/2;322/1	299,332,912		299,151,858		E hapur-Pune	31.08.2018	I.+C.
29	Sherbimi i Internetit		74,040,000		73,671,120	E hapur-Sherbime	31.07.2018	A.
30	Blerje karburanti Diesel DI dhe Benzine		179,490,039			E hapur-Mallra	10.09.2018	K.
31	Shtese kontrate pritim zarfimim i fatures		10,576,000		10,569,760	Negociim pa njoftim paraprake Sherbime	23.07.2018	A. Co
32	Blerje kancelari dhe shtypshkrime		59,349,466		10,569,760	E hapur-Mallra	21.09.2018	I.
33	Blerje mjete motorike ne kuader te grupeve te perbashketa te kontrollit OSHEE Polici e Shtetit	58,200,000		56,970,000		E hapur-Mallra	17.09.2018	M. T.
34	Studimin e vleresimit te humbjeve te Energjiise elektrike ne traktin lidhes nga njesia gjeneruese deri ne piken e lidhjes ne rrjetin e OSHEE SHA.		7,953,367		7,559,625	Sherbim Konsulence	05.10.2018	A.
35	Printim i faturës dhe zarfimi në versionin Selfmailer të OSHEE SHA		57,704,400		53,352,000	E hapur – sherbime	24.01.2019	“A. D. P.S. & S.” sh.p.k
36	Blerje celesa per seksionet kumutuese TL-TM	138,500,000		131,400,000		E hapur-Mallra	11.10.2018	E. P.
37	Mirembajtje 1200 Speed Data Android KT45		17,683,200		16,999,920	E hapur-Sherbime	19.11.2018	P. S.
38	Ndertimi i salles multimediale dhe upgrade i stabilizimit te tensionit per pajisjet	19,950,000		19,450,000		E hapur-Mallra	09.11.2018	A.+A.
39	Rikonstruksion ne rrjetin TM-TU ne zonen e Thumanes - Borizane F.8 N/St F. Kruje	160,468,450		158,498,502		E hapur-Pune	12.11.2018	T.+S.+E. + E.
40	Blerje Transformator Fuqie TL/TM per nevoja te OSHEE SHA.	199,400,000		197,215,370		E hapur-Mallra	12.12.2018	E. SH

41	Rikonstruksion i kabinave elektrike murature, fiderat A6, A7, A11, A12, A14, A15, N/St. Rajonal 220/20kV Tirane	120,257,060		112,431,731		E hapur-Pune	21.11.2018	SH.I.
42	Rikonstruksion i kabinave elektrike ndertimor dhe elektrik (Rikonstruksion i kabinave murature te fiderave C15, C7, C14, C5, C6, 312, 311, Q1 dhe Q2 te N/stacionit Traktora)	110,083,113		103,602,081		E hapur-Pune	19.12.2018	E.P.
43	Rrjeti shperndares 20kV, N/Stacioni 110/20kV, Pogradec, fiderat 1, 9, 10, rikonstruksion kabina, kabina të reja dhe linjë TU me përcjellsa me vetmbajtje ABC)	34,633,517		31,523,724		E hapur-Pune	28.12.2018	E.
44	Pritim zarfimim i fatures (3 muaj)		10,569,760		8,423,363	Negociim pa njoftim paraprake Sherbime	12.11.2018	A. C.
45	Rrjeti elektrike shperndares 20 kV, i Nenstacionit 110/20 kV, POGRADEDEC (Fideri 5, 6, 7 dhe kolektori, linjë TM, rikonstruksion kabina, kabina të reja dhe linjë TU me përcjellsa me vetmbajtje ABC)" (Punetori)	99,188,847		111,920,612		E hapur-Pune	28.12.2018	"E." sh.p.k
46	Sherbimi i mirembajtjes se sistemit Flare & HR Payroll		3,400,000		3,360,000	Kerkese per Propozim Sherbime	31.12.2018	K.
47	Rrjeti Shperndares 20 kV nga Nenstacioni 110/20 kV Fieri i Ri fiderat 10 deri 12 dhe Nenstacioni 110/20 kV Fieri 2 fiderat M1 deri M10. Rrjeti shperndares TU me kablllo me vetmbajtje ABC per keto fidera, Fiderat M1, M2, M3 Nenstacioni 110/20 kV Fieri 2" (Punetori)	94,499,681		83,999,078		E hapur-Pune	15.01.2019	A.
48	Ndertim rrjeti TU 0.4kV ne Rajonin Shkoder	132,516,267		127,965,031		E hapur-Pune	24.12.2018	K.
49	Rikonstruksion i rrjetit elektrik TM, TU ne qytetin e Lezhes	154,079,733		136,885,517		E hapur-Pune	20.12.2018	4A.
50	Inventarizimi dhe vleresimi i Aktiveve Materiale Afatgjata te OSHEE SHA., si dhe ngritja e sistemit te administrimit dhe pergatitja e procedurave te brendshme te menaxhimit te tyre		347,400,000		337,000,000	Mbi Kufirin e larte monetar-Sherbime	23.01.2019	D.
51	Blerje kapikorda, morseta dhe aksesore per nevojat e OSHEE SHA.	49,992,600		47,495,300		E hapur-Mallra	06.02.2019	M. P.
52	Blerje uniforma dhe paisje sigurie per punonjesit e OSHEE	198,150,000		190,530,000		E hapur-Mallra	22.05.2019	M. A. + M. + K.
53	Rikonstruksion i kabinave dhe ndertim i rrjetit TU me kabell ABC ne Njesine Lushnje	92,763,852		88,332,188		E hapur-Pune	18.01.2019	I. E. + R.
54	Mirëmbajtje dhe upgrade për infrastrukturën e Server Room primar dhe Server	124,180,792		121,480,000		E hapur-Mallra	24.01.2019	A.+S.

	Room Disaster Recovery							
55	Shtimi i funksionaliteteve të SAP dhe blerja e licensave të përdoruesve të rinj	26,850,000		26,800,000		E hapur-Sherbime	18.01.2019	S-S.

Tabela nr. 4 Regjistri i realizimeve 2019 (pa blerjet dinamike të biletave dhe procedurat IT)

Nr	Objekti i prokurimeve	Fondi limit i përgjithshëm pa TVSH		Vlera e Prokuruar		Procedura	Data e kontrates	Firma Fituese
		Investime	Shpenzime	Investime	Shpenzime			
1	Marrje me qira operacionale te makina per NJOSE per vitin 2019		10,284,000		10,280,000	E hapur-Mallra	17.01.2019	T. A.
2	Amendim Kontrate sherbimi i pastrimit te zyrave administrative te OSHEE		5,507,785		5,507,785	Amendim Kontrate	31.01.2019	C. F.
3	Permiresim dhe mirembajtje 3 vjecare e sistemit te protokoll arkives digjitale	85,800,000		80,223,000		E hapur-Mallra	19.02.2019	I.
4	Mirembajtje 3 vjecare e ashensoreve te godines qendrore te OSHEE SHA.		6,450,000		6,200,000	Kerkese per propozim-Sherbime	08.04.2019	H.K.
5	Sigurimi i punonjesve te OSHEE SHA. nga aksidentet ne pune		119,280,000		119,000,000	E hapur-Sherbime	25.03.2019	I.+S.
6	Rritja e sigurise dhe kapaciteteve te Infrastruktures se Network dhe ruajtjes se te dhenave te sistemeve teknologjike sipas nevojave te OSHEE SHA.	164,500,667		159,800,000		E hapur-Mallra	08.04.2019	A.+S.+I.
7	Upgrade dhe mirembajtje 3 vjecare e platformes se Hec-eve te vegjel		72,324,974		70,063,200	E hapur-Mallra	22.05.2019	E.+A.
8	Mirembajtje 2-vjecare e automjeteve ne pronesi te OSHEE SHA		195,000,000		195,000,000	Marreveshje Kuader E hapur-Sherbime	03.06.2019	A.
9	Inspektimi dhe konformiteti per pajisjet dhe Instalimet elektrike dhe mbikqyrja e fushes elektromagnetike ne n/stacione, linjat 35 KV dhe kabina elektrike	196,040,490		196,040,490		Marreveshje Kuader E hapur-Sherbime Shumatorja 33,276 ALL	02.05.2019	N. C.
10	Pajisja me siguracion TPL e mjeteve motorike ne pronesi te OSHEE SHA per vitin 2019-2020		4,998,500		4,986,470	Kerkese per propozim-Sherbime	11.04.2019	I.
11	Ndërtim i aplikacionit Mobile për OSHEE SHA	1,980,000		1,940,000		Kerkese per propozim-Mallra	03.05.2019	K.
12	Mirembajtje e Access Control ekzistues dhe Blerje Access Control per hyrjen Lindore ne Godine Qendrore	2,360,000		2,342,000		Kerkese per propozim-Sherbime	03.05.2019	P. S.
13	Sherbimi GPS per automjetet		4,344,000		3,994,760	Kerkese per propozim-Sherbime	26.04.2019	A.
14	Pastrimi i zyrave administrative dhe qendrave te kujdesit ndaj klientit te OSHEE 3 mujore		6,884,482		5,509,665	Negociim pa shpallje-Sherbime	25.04.2019	C. F.
15	Pajisje me Kartela te sigurimit teknik per punonjesit e OSHEE		14,960,000		14,712,000	E Hapur-Sherbime	03.07.2019	H.

16	Sherbimi i riparimit te Trasformatoreve te fuqise deri ne 1,8 MV		200,000,000		200,000,000	Marreveshje Kuader E hapur-Sherbime	03.06.2019	E.
17	Mirembajtjen sistemi ARMS 3 vjet		12,420,000		12,420,000	E Hapur-Sherbime	09.07.2019	K.
18	Implementimi i një zgjidhje Enterprise për menaxhimin Operacional-Teknik të aseteve të rrjetit		196,280,000		179,500,000	E hapur-Mallra	09.07.2019	I.
19	Blerje materiale të nevojshme për Arkivën Qendrore dhe Arkivat e Drejtorive Rajonale		44,948,500		43,470,000	E hapur-Mallra	02.09.2019	K.
20	Studimi i zhvillimit te Rrjetit inxhinierik per furnizimin me energji elektrike ne qender te Tiranes ne perputhje me zhvillimin Urban te Bashkise Tirane		53,393,333		51,229,400	Sherbim konsulence	14.10.2019	I.
21	Mirembajtje e sistemit menaxhial SAP		12,780,000		12,780,000	E Hapur-Sherbime	09.08.2019	S-S.
22	Shërbimi GPRS		40,176,000		36,961,920	E Hapur-Sherbime	09.08.2019	A.
23	Lyerje me boje e fasades veriore te Godines se Oshee SHA	1,181,052				Kerkese per propozim-Pune	30.07.2019	M. shpk
24	Furnizim, vendosje dhe Mirembajtje e elementeve te brandimit ne Qendrat e Kujdesit Ndaj Klientit dhe Zyrat Administrative te OSHEE SHA		59,603,000		59,603,000	Marreveshje Kuader E hapur-Sherbime	02.09.2019	D.P.
25	Martje me qera operationale të mjeteve motorike per 3 vjet		91,728,000		88,600,000	E hapur-Mallra	13.09.2019	C.
26	Pastrimi i zyrave administrative dhe qendrave te kujdesit ndaj klientit te OSHEE 3 mujore		9,182,775		8,502,570	Negociim pa shpallje-Sherbime	27.08.2019	C. F.
27	Mirembajtje per tre vjet e sistemit i meaxhimit automatik te Rradhes/DVR/Kamera/ne KNK dhe Shtimi i KNK- ve me Sistemin e manaxhimit automatik te rradhes		76,600,000		74,600,000	E hapur-Mallra	10.09.2019	A. C.
28	Permiresimi dhe Mirembajtja 3 vjeçare e Platformes Elektronike te Blerjes se Energjise Elektrike		14,978,273		14,785,000	E Hapur-Sherbime	16.09.2019	C.c.P.
29	Auditim financiar dhe per projektet e Bankes Boterore per vitin ushtrimor 2018		15,150,000		12,000,000	E Hapur-Sherbime	27.09.2019	G.Th.
30	Blerje karburant Diesel D1 dhe Benzine per vitin 2019-2020		179,645,900		179,645,900	E hapur-Mallra	13.11.2019	K.
31	Blerje kancelari dhe shtypshkrime për nevojat e shoqerisë OSHEE SHA		126,736,606		122,361,614	E hapur-Mallra	12.02.2020	I.
32	Upgrade dhe mirembajtje te infrastrukture aktuale te datacenter dhe Dr site		169,905,000		166,500,000	E hapur-Mallra	31.01.2020	A. C. + S.

Tabela nr.5 Regjistri i realizimit të prokurimeve 2020

Nr	Objekti i prokurimeve	Fondi limit i përgjithshëm pa TVSH		Vlera e Prokuruar		Procedura	Data e kontrates	Firma Fituese
		Investime	Shpenzime	Investime	Shpenzime			

1	Pastrimi i zyrave administrative dhe qendrave te kujdesit ndaj klientit te OSHEE 4 mujore		7,346,220		6,197,429	Negociim pa shpallje-Sherbime	10.02.2020	Clean Fast
2	Printim i fatures te energjise elektrike dhe zarfimi ne versionin Selfmailer		44,460,000		43,368,000	E hapur-Mallra	21.04.2020	I. A.
3	Printim i fatures te energjise elektrike dhe zarfimi ne versionin Selfmailer		8,892,000		8,892,000	Amendim kontrate	10.02.2020	
4	Mirembajtja dhe pershtatja e sistemit te burimeve njezore sipas ndarjes se OSHEE SHA		5,893,000		5,760,000	Kerkese per propozim - Sherbime	05.06.2020	K.
5	Blerje materiale per mirembajtjen e sistemit elektrik te godines qendrore te OSHEE Group SHA		1,989,743		1,490,000	Kerkese per propozim - Mallra	30.04.2020	P.
6	Siguracion TPL dhe nderkombetar per automjete		4,748,600		4,734,358	Kerkese per propozim - Sherbime	14.04.2020	I.
7	Blerje materiale dhe sherbime ne kuader te parandalimit te perhapjes se virusit Covid-19		29,300,000			Negociim pa shpallje-Mallra		
	Loti 1. Blerje doreza plastike kirurgjikale (pako 100 copeshe) dhe dezifektant duarsh me baze alkoli ne paketim 0.5 lt		6,300,000		6,289,500		20.03.2020	A.
	Loti 2. Blerje maska respiratore me filter dhe valvul te tipit FPP1		11,000,000		10,500,000		18.03.2020	F.
	Loti 3. F.V Dezifektim ambientesh te brendshme dhe te jashtme.		12,000,000		10,680,000		19.03.2020	C.F.
8	Blerje panele mbrojtese per arketaret e qendrave te kujdesit ndaj klientit ne kuader te masave mbrojtese per parandalimin e perhapjes se virusit Covid-19		3,000,000		2,940,000	Negociim pa shpallje-Mallra	10.04.2020	S.
9	Sherbim GPS per mjetet		3,318,000		3,080,000	Kerkese per propozim - Sherbime	27.04.2020	A.
10	Sherbimi i pastrimit per nevojat e OSHEE Group SHA. per nje afat prej 5 muajsh		7,746,786		6,046,272	Negociim pa shpallje-Sherbime	22.06.2020	P. S.
11	Blerje Maska Kirurgjikale nje perdorimshe te thjeshta ne kuader te masave mbrojtese per parandalimin e perhapjes se virusit Covid-19		11,760,000		11,060,000	Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit	05.05.2020	O.N. 360 shpk

Aneksi 2 Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomik-financiare në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet e prore, si dhe realizimi i tij
Pasqyra e performancës (realizimi i të ardhurave).

OSHEE PASH (000 / ALL)	Buxhet (parashikim)		Realizmi		% ndryshimit 2018-2017
	2017	2018	2017	2018	
TË ARDHURA	53,660,482	55,030,323	60,322,436	56,605,005	-7%

Të Ardhura Kryesore	53,292,343	54,875,877	54,647,170	55,736,486	2%
Të Ardhura nga Energjia	51,792,343	53,697,804	53,542,863	54,647,173	2%

Në vitet 2017-2018 realizimi i të ardhurave është më i lartë sesa shumat e parashikuara. Kjo nënkupton që shoqëria arrin të parashikojë realizimin e të ardhurave brenda një skenari realist.

Sipas raportit për programin ekonomik nr. 28118 prot., datë 27.12.2017 norma e arkëtimeve për vitin 2017 (periudha janar-shtator 2017) në faqen 14 të këtij raporti cilësohet në 99%. Kjo nënkupton që nga shitjet e faturuara në 9 mujorin e parë të vitit 2017 shoqëria arrin të arkëtojë 99% të shitjeve.

Sipas raportit për programin ekonomik nr. 24052 prot., datë 27.12.2018, faqe 12, vëllimet e shitjes të energjisë elektrike për vitin 2017 janë në shumën 64,547,328,000 lekë me TVSH ose duke i zbritur vlerën e TVSH paraqiten në shumën 53,789,440,000 lekë pa TVSH. Meqenëse të ardhurat nga energjia të cilat në pasqyrën e performancës përfaqësojnë shitjet neto të energjisë ose shitjet pa TVSH janë në shumën 53,542,863,000 lekë dhe shoqëria raporton se arkëton 99% të shërbimit dhe energjisë që faturon, atëherë për vitin 2017 kanë mbetur pa arkëtuar vetëm 1% të shitjeve ose shuma 246,577,000 lekë.

Sipas raportit për programin ekonomik nr. 25969 prot., datë 27.12.2019, faqe 12, vëllimet e shitjes të energjisë elektrike për vitin 2018 janë në shumën 64,841,539,000 lekë me TVSH ose duke i zbritur vlerën e TVSH paraqiten në shumën 54,034,615,000 lekë pa TVSH.

Meqenëse të ardhurat nga energjia ose shitjet neto janë 54,647,173,000 lekë dhe shoqëria raporton se arkëton 101% të shërbimit dhe energjisë që faturon, kjo nënkupton që shoqëria përveçse ka arkëtuar për vitin 2018 të gjitha shitjet që ka faturuar gjithashtu ka faturuar dhe shërbime të energjisë të viteve të kaluara të cilat gjithashtu i ka arkëtuar.

Sipas raportit nr. 25969 prot., datë 27.12.2019, faqe 16, jepen detyrimet e prapambetura deri fund nëntor 2019.

Detyrimet e prapambetura japin shifrat për energjinë e faturuar por të pa arkëtuar.

Energjia e cila faturohet ose çdo faturë që shoqëria e faturon për konsumatorët e saj raportohet në shitjet neto të shoqërisë po atë vit dhe nëse nuk arkëtohet, çdo faturë e pa arkëtuar del në aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar si llogari e arkëtueshme ose si e drejtë e shoqërisë mbi abonentët e saj për shitje të cilat i ka kryer por nuk i ka arkëtuar. Në fund të vitit 2017 në llogaritë e arkëtueshme të shoqërisë duhet të pasqyrohet vlera e principalit (faturës së faturuar por të pa arkëtuar) për faturat e prapambetura të periudhës 2007-2014 dhe për faturat e prapambetura të viteve 2015,2016 dhe 2017.

Llogaritë e arkëtueshme sipas raportit të programit ekonomik- financiar në fund të vitit 2017 janë 66,432,016,000 lekë vetëm për abonentët, në mospërputhje me llogaritë e arkëtueshme të deklaruara në pasqyrën e pozicionit financiar të shoqërisë për të njëjtin vit të cilat paraqiten në shumën 27,162,037,000 lekë.

Në këtë shifër merren parasysh edhe provigjionet e llogarive të arkëtueshme të cilat për vitin 2017 janë në shifrën 29 milion lekë sipas raportit ekonomik nr. 24052 prot., datë 27.12.2018 faqe 52 që edhe po të zbriten nga llogaritë e arkëtueshme të raportuara, përsëri ka mospërputhje.

Shoqëria raporton në programin ekonomik se në fund të vitit 2017 ka arkëtuar 99% të shitjeve ose nuk ka arkëtuar shumën prej 246,577,000 lekë sipas analizës së kryer vëllimit të shitjeve.

Sipas të dhënave të paraqitura në programin ekonomik nr. 25969 prot., datë 27.12.2019 shoqëria ka në vitin 2017 shumën prej 7,203,655,000 lekë pa arkëtuar ose 13% të vëllimit të shitur dhe të faturuar.

Njësia 000/ Lekë

Detyrimet e prapambetura				
Fatura 2007-2014	Fund 2016	Fund 2017	Arkëtime Fund 2017	% uljes së LLA
Principal	51,175,006	48,483,178	2,691,828	5%
Kamatë	40,494,045	34,170,998		
	91,669,051	82,654,176		

Fatura 2015	Fund 2016	Fund 2017		
Principal	6,191,191	5,874,183	317,008	5%
Kamatë	2,935,839	4,690,112		
	9,127,030	10,564,295		
Fatura 2016	Fund 2016	Fund 2017		
Principal	7,275,128	5,639,739	1,635,389	22%
Kamatë	974,201	2,869,761		
	8,249,329	8,509,500		
Fatura 2017		Fund 2017		
Principal	0	6,434,916		
Kamatë	0	768,739		
	0	7,203,655		
Totali	109,045,410	108,931,626		

LLA 2017		66,432,016		
Kamatvonesa		42,499,610		

Ekziston tendenca për rritje të arkëtimit të faturave të prapambetura por kjo tendencë është e ulët për vitet 2007-2015 dhe vetëm për vitin 2016 ka një përmirësim të arkëtimit me 22%

Të dhëna nga pasqyra e pozicionit financiar

OSHEE BILANCI (000/Leke)	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2018
AKTIVE	76,660,608	78,577,369
Aktive Afatgjata	39,318,897	43,339,036
Aktive Afatgjata Materiale	38,512,254	42,538,730
Aktive Afatgjata Jo - Materiale	805,182	788,410
Aktive Financiare	1,461	11,896
Aktive Afatshkurtra	37,341,711	35,238,333
Inventarët	6,043,898	6,167,517
Llogari të Arkëtueshme neto	20,932,065	20,328,223
Llogari të Arkëtueshme të tjera neto	6,229,972	6,534,726
Mjete monetare dhe ekuivalente	1,710,861	185,034
Mjete monetare të ngurtësuara	2,424,915	2,022,833
Të ardhura të përlogaritura	-	-

Të dhëna për grupin e auditimit KLSH Detyrime me vlerë neto të realizueshme

Detyrimet e abonentëve 2017-2020			
	Principal	Kamat vonesa	Total detyrimi
Detyrime krijuar deri më 31.12.2017	11,849,023,588	12,254,556,684	24,103,580,271
Viti 2018	2,626,529,820	1,805,908,488	4,432,438,308
Viti 2019	3,122,212,168	1,036,693,392	4,158,905,560
Viti 2020	1,469,541,752	99,417,529	1,568,959
Total Detyrime	19,067,307,328	15,196,576,093	32,696,493,098
Detyrime 2018-2020	7,218,283,740	2,942,019,409	8,592,912,827

E njëjta situatë është edhe për vitin 2018.

Vëllimi i shitjeve për vitin 2018 është 54,034,615,000 lekë pa TVSH.

Raportimi financiar i OSHEE kryhet sipas “Sistemit Uniform të Llogarive” për Kompanitë e licencuara i cili është hartuar nga ERE në korrik 2018 në përputhje me kërkesat e nenit 35 dhe 45 të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”(i ndryshuar), si dhe kërkesave të Standardeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit si dhe Vendimit Nr. 166, datë 19.07.2018 të ERE Mbi fillimin e procedurave për miratimin e sistemit të njehsuar dhe standard të llogarive për të licencuarit në veprimtaritë e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal, në sektorin e energjisë elektrike.

Neni 45 i Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike

Standardet e njësura të llogarive

1. ERE, harton dhe miraton një sistem të njësuar dhe standard të llogarive për të gjithë të licencuarit që veprojnë në tregun të energjisë elektrike, mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe standardet e pranuar ndërkombëtare mbi kontabilitetin.

2. Raportimi vjetor financiar i të licencuarve tek ERE bëhet sipas këtij sistemi.

Sipas Sistemit Uniform të Llogarive, Kategoritë dhe struktura e Kërkesave për Arkëtim fq 11 citohet: *Kërkesat për arkëtim ndaj klientëve do të raportohen me vlerën e faturës, nga e cila është zbritur një provizion për rënie vlere. Provizioni për rënie vlere do të llogaritet nëse ka një farë sigurie që kompania nuk do të jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë sasinë sipas kushteve fillestare në lidhje me vlerësimin respektiv. Për qëllime të llogarive rregullatore kërkesat për arkëtim do të raportohen në llogaritë e Grupit 41 Klientë, të shënuara me një kod tre-shifror.*

Njësia 000/lekë

Detyrimet e prapambetura				
Fatura 2007-2014	Fund 2017	Fund 2018	Arkëtime Fund 2018	% uljes se LLA
Principal	48,483,178	44,820,309	3,662,869	8%
Kamatë	34,170,998	31,457,360		
	82,654,176	76,277,669		
Fatura 2015	Fund 2017	Fund 2018		
Principal	5,874,183	5,242,758	631,425	11%
Kamatë	4,690,112	4,946,079		
	10,564,295	10,188,837		
Fatura 2016	Fund 2017	Fund 2018		
Principal	5,639,739	5,083,415	556,324	10%
Kamatë	2,869,761	4,413,335		
	8,509,500	9,496,750		
Fatura 2017	Fund 2017	Fund 2018		
Principal	6,434,916	4,375,802		
Kamatë	768,739	2,252,098		
	7,203,655	6,627,900		
Totali	108,931,626	102,591,156	6,340,470	
LLA 2018		59,522,284		
Kamatvonesa		43,068,872		

Edhe në vitin 2018 ekziston tendenca për përmirësim të arkëtimeve por sërish mbetet e ulët.

Pasqyra e performancës Vitet 2017-2018

OSHEE PASH (000 / ALL)	Buxhet		Realizmi		% ndryshimit 2018-2017
	2017	2018	2017	2018	
TE ARDHURA	53,660,482	55,030,323	60,322,436	56,605,005	-7%
Te Ardhura Kryesore	53,292,343	54,875,877	54,647,170	55,736,486	2%
Te Ardhura nga Energjia	51,792,343	53,697,804	53,542,863	54,647,173	2%
Konsumatoret Familjare	24,667,884	25,075,987	25,479,245	25,721,308	1%
Konsumatoret Private	20,592,219	21,658,755	20,389,060	20,459,452	0%
Konsumatoret Buxhetore	2,547,627	2,661,872	2,933,577	3,097,426	5%
Konsumatoret Jo Buxhetore	3,557,206	3,760,325	4,091,844	3,992,360	-2%
Kliente ne 35 kv FMF	51,730	0	0	663,414	100%
Jo buxhetore ne 35 kv FMF	0	0	0	38,362	100%
Tarife e sherbimit te shperndarjes	0	0	0	21,937	100%
Lidhjet e reja	375,677	540,865	649,137	652,914	1%
Te ardhura nga Kamatvonesat	1,500,000	1,178,073	1,104,307	1,089,313	-1%
Te Ardhura te Tjera	368,139	154,446	5,675,266	868,519	-553%
SHPENZIMET	43,078,889	49,886,859	56,999,853	53,365,361	-7%
Shpenzime Energjie	25,054,202	30,451,970	39,606,411	34,193,492	-16%
Energji e Blere	20,790,636	25,746,987	34,966,858	29,260,771	-20%
E Importuar	4,905,259	8,100,203	22,803,120	8,977,587	-154%
Blerje Lokale KESH	5,800,000	5,925,000	4,170,670	5,983,830	30%
Blerje Lokale HEC	10,085,377	11,721,784	7,993,068	14,299,354	44%
Blerje nga burime te rinovueshme	0	0	0	0	
Tarifa e Transmetimit	4,263,566	4,704,983	4,639,553	4,932,721	6%
Marzhi Bruto	26,738,141	23,245,834	13,936,452	20,453,681	32%
Marzhi Bruto %	52%	43%	26%	37%	30%
Shpenzime Operative	13,828,707	13,207,068	12,212,980	11,339,486	-8%
Lende te konsumueshme	412,582	408,028	322,054	324,559	1%
Shpenzime per te punesuarit	6,424,609	6,419,219	6,254,604	6,026,037	-4%
Mirëmbajtje	2,961,656	2,567,967	1,517,725	1,373,012	-11%
Penalite, gjoba demshperblime	0	1,000,000	1,528,681	989,203	-55%
Reklamim dhe publicitet	109,735	14,000	23,895	11,165	-114%
Qira	487,050	465,805	469,302	489,570	4%
Shërbimet Postare	691,528	725,870	713,047	732,702	3%
Shpenzime te IT	330,551	310,000	57,056	60,457	6%
Shpenzime Ligjore	505,543	7,788	54,807	104,229	47%
Konsulentë dhe Auditim	385,000	119,000	57,927	117,649	51%
Te tjera	1,520,453	1,169,391	1,213,882	1,110,903	-9%
Dëmtime dhe Provigjone	1,114,936	3,269,725	2,651,553	4,745,583	44%

EBITDA	13,662,637	8,101,560	5,851,492	6,326,444	8%
Zhvlërësimi dhe amortizimi	3,081,044	2,958,096	2,528,909	3,086,800	18%
Fitim / Humbje Operative (EBIT)	10,581,593	5,143,464	3,322,583	3,239,644	-3%
Shpenzime Financiare - neto	-894,345	-596,221	-16,515	45,180	137%
Te ardhura financiare	365,853	393,223	1,057,340	1,575,218	33%
Shpenzime financiare	1,260,198	989,444	1,073,855	1,530,038	30%
Te ardhura te jashtë zakonshme	0		109,899	0	
Fitim / Humbja përpara Taksave	9,687,248	4,547,243	3,415,967	3,284,824	-4%
Tatim Fitimi	1,645,787	1,633,860	1,575,808	1,337,449	-18%
Fitim / Humbja e Periudhës	8,041,461	2,913,383	1,840,159	1,947,375	6%

Realizimi i të Ardhurave;

Në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017 ka një rënie prej 7% në të ardhurat e realizuara. Në të njëjtën përqindje kanë rënë dhe shpenzimet

Të ardhurat përbëhen nga të ardhurat nga energjia që ka pësuar rritje, të ardhurat nga kamatëvonesat dhe të ardhurat të tjera që kanë pësuar rënie. Të ardhurat e tjera janë ulur pasi në vitin 2017 në këto të ardhura janë përfshirë faturimi i penaltiteteve ndaj KESH SHA për mos përmbushje të detyrimeve kontraktore.

Realizimi i shpenzimeve për energjinë edhe kanë pësuar ulje me 7% që më së shumti ndikohet nga uljet në blerjet e energjisë elektrike të importuar gjithashtu vlen të theksohet se kanë pësuar rritje të ndjeshme shpenzimet për blerje energjie elektrike, kjo si rezultat i vendimeve të ERE për kalimin e detyrimit të blerjes së energjisë nga HEC-et e rinj dhe me koncesion nga KESH SHA në OSHEE SHA përkatësisht me 30% dhe 44%. Rritja e shpenzimeve për blerje energjie për mbulim humbjesh si rezultat dhe i situatave jo të favorshme hidrike për Shqipërinë dhe rajonin ka sjell rritje të ndjeshme të çmimit për MW të energjisë ku çmimi në pikë arrin deri në 90Euro për MWh dhe ai në band në 70Euro/MWh, situatë kjo që ka çuar dhe shoqërinë në rritjen e shpenzimeve për blerje energjie.

Kemi rritje të tarifës së transmetimit gjithashtu me 6%

Shpenzimet operative kanë pësuar ulje me 8% por sërish ulja në numrin e të punësuarve është fare e pandjeshme. Shpenzimet për paga zënë mbi 50% të buxhetit për vitet 2017-2018 dhe mbi 40% për vitet 2019-2020. Më këtë numër të lartë punonjësish shoqëria duhet të rriste performancën e saj financiare.

	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Buxhet 2020
Shpenzime Operative	12,212,980	11,339,486	15,289,000	14,746,107
Shpenzime për të punësuarit	6,254,604	6,026,037	6,103,000	6,650,398
% e pagave në shpenzimet operative	51%	53%	40%	45%

	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Nr punonjësve	6423	6296	6298	6407

Janë rritur gjithashtu shpenzimet për konsulencë juridike dhe auditim si pasojë e reformimit të shoqërisë

Dëmtime dhe provigjione janë rritur me 44% në 2018 në krahasim me vitin 2017. Sipas programit ekonomik nr. 25969 prot., datë 27.12.2019, fq 53, seksioni 3.7 ky zë përbëhet nga 2 grupe:

- Provigjione të përlllogaritura për Llogaritë e Arkëtueshme
- Shpenzime për TVSH e pakreditueshme si rezultat i shpenzimeve të panjohura nga Tatimet Nuk shpjegohet metoda e ndjekur për provigjionimin e llogarive të arkëtueshme.

	Mil/Lekë		
	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Dëmtime dhe provigjione	-2,652	-4,746	-2,466
Shuma për zhvlerësimin e magazinës	-148	-60	0
Provizione për konsumatorët familjarë	0	0	735
Shuma të parashikuara për klientë privatë	-491	-603	-452
Shuma për institucione publike buxhetore	-175	-466	-119
Shuma për institucione publike jo buxhetore	-1,587	-1,122	-1,390
Shuma të parashikuara për shpenzime	-2,481	-2,854	-1,240
Rimarrje zhvlerësim inventari	6	69	0
Rimarrje zhvlerësim klientëve familja	2,224	291	0
Provizioni i Llogarive të arketueshme	-29	-1,900	-1,226

Llogaritja është kryer nga grupi i auditimit të KLSH sipas të dhënave të raportuara në programin ekonomik duke mbledhur të gjitha zërat me përjashtim të zërave shuma për zhvlerësimin e magazinës, shuma të parashikuara për shpenzime e cila më së shumti lidhet me shpenzime për proceset gjyqësore dhe rimarrje zhvlerësim inventari.

OSHEE PASH (000 / ALL)	Buxhet				Realizimi		
	2017	2018	2019	2020	2017	2018	2019
Dëmtime dhe Provigjione	1,114,936	3,269,725	1,815,739	2,467,868	2,651,553	4,745,583	2,466,000
EBITDA	13,662,637	8,101,560	8,116,418	8,849,937	5,851,492	6,326,444	(3,647,000)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	3,081,044	2,958,096	3,110,466	3,264,265	2,528,909	3,086,800	3,207,000
Fitim / Humbje Operative (EBIT)	10,581,593	5,143,464	5,005,952	5,585,672	3,322,583	3,239,644	(6,854,000)
Shpenzime Financiare - neto	(894,345)	(596,221)	197,579	(467,015)	(16,515)	45,180	(622,000)
Te ardhura financiare	365,853	393,223	1,779,194	466,541	1,057,340	1,575,218	467,000
Shpenzime financiare	1,260,198	989,444	1,581,615	933,556	1,073,855	1,530,038	1,089,000
Te ardhura te jashtë zakonshme	0				109,899	0	0
Fitim / Humbja përpara Taksave	9,687,248	4,547,243	5,203,531	5,118,657	3,415,967	3,284,824	(7,476,000)
Tatim Fitimi	1,645,787	1,633,860	1,013,628	1,456,213	1,575,808	1,337,449	0
Fitim / Humbja e Periudhës	8,041,461	2,913,383	4,189,903	3,662,444	1,840,159	1,947,375	(7,476,000)

Parashikimi i dëmtimeve dhe provigjioneve kryhet në skenar me optimist se sa situata edhe pse shifra e llogarive të arkëtueshme është shumë e lartë dhe shoqëria është në vështirësi arkëtimi për fatura të viteve kryesisht 2007-2013 periudhë kur kjo shoqëri ka qenë në menaxhim të ish Cez.

Parashikimi i fitimit para interesave dhe taksave kryhet gjithashtu në skenar optimist. Edhe pse viti 2019 figuron me humbje, viti 2020 parashikohet me fitime duke ndjekur shifrat e parashikuara të vitit 2018. Shoqëria raporton në programin ekonomik të vitit 2020 shifra të cilat në thelb nuk paraqesin një bazë studimore por thjesht duke u nisur nga parashikimi i një viti më parë.

Meqenëse OSHEE SHA shoqëria mëmë duke nisur që nga 01.01.2020 përbëhet edhe nga 3 (tre) shoqëri të tjera bija OSSH, FSHU dhe FTL SHA, nuk paraqiten në programin ekonomik se si do ndikohen të ardhurat e shoqërisë pas ndarjes. Në bazë të vendimit të ERE Nr. 264 datë 20.12.2018

secila nga këto bija nis aktivitetin e pavarur ekonomik në 01.01.2020. Ndërkohë parashikimi i programit ekonomik vijon me po të njëjtat shifra sikurse një vit më parë kur këto shoqëri vepronin si një e vetme.

Shpenzimet financiare përkojnë me efektet e kursit të këmbimit dhe të rivlerësimit të kredive etj. Kredia e disbursuar nga Banka Botërore në fund të vitit 2018 ishte rreth 4.6 miliard Lekë dhe shlyerja do të fillojë vetëm në vitin 2021. Vetëm në vitin 2018 shoqëria ka të ardhura financiare, në vitet 2017 dhe 2019 figuron me më shumë shpenzime financiare të cilat në 2019 janë rritur në krahasim me 2017.

Pasqyra e performancës 2017-2019

OSHEE PASH (000 / ALL)	Realizimi		Ndryshimi 2017-2019	ne % 2017-2019
	2017	2019		
TE ARDHURA	60,322,436	57,235,000	-3,087,436	-5%
Te Ardhura Kryesore	54,647,170	56,013,000	1,365,830	2%
Te Ardhura nga Energjia	53,542,863	56,013,000	2,470,137	4%
Konsumatorët Familjare	25,479,245	26,281,000	801,755	3%
Konsumatorët Private	20,389,060	20,905,000	515,940	2%
Konsumatorët Buxhetore	2,933,577	3,413,000	479,423	14%
Konsumatorët Jo Buxhetore	4,091,844	4,195,000	103,156	2%
Klientë privat ne 35 kv FMF	0	497,000	497,000	100%
Jo Buxhetorë ne 35 kv FMF	0	0	0	
Tarife e shërbimit te shpërndarjes	0	61,000	61,000	100%
Lidhjet e reja	649,137	661,000	11,863	2%
Te ardhura nga Kamatëvonesat	1,104,307		-1,104,307	
Te Ardhura te Tjera	5,675,266	1,222,000	-4,453,266	-364%
			0	
SHPENZIMET	56,999,853	64,089,000	7,089,147	11%
Shpenzime Energjie	39,606,411	43,127,000	3,520,589	8%
Energji e Blere	34,966,858	37,640,000	2,673,142	7%
E Importuar	22,803,120	22,179,000	-624,120	-3%
Blerje Lokale KESH	4,170,670	4,113,000	-57,670	-1%
Blerje Lokale HEC	7,993,068	11,068,000	3,074,932	28%
Blerje nga burime te rinovueshme	0	280,000	280,000	100%
Tarifa e Transmetimit	4,639,553	5,487,000	847,447	15%
Marzhi Bruto	13,936,452	12,886,000	-1,050,452	-8%
Marzhi Bruto %	26.03%	23.01%	0	-13%
Shpenzime Operative	12,212,980	15,289,000	3,076,020	20%
Lende te konsumueshme	322,054	332,000	9,946	3%
Shpenzime per te punesuarit	6,254,604	6,103,000	-151,604	-2%
Mirëmbajtje	1,517,725	1,436,000	-81,725	-6%
Penalitete, gjoha e dëmshpërblime	1,528,681	4,474,000	2,945,319	66%
Reklamim dhe publicitet	23,895	7,000	-16,895	-241%
Qira	469,302	500,000	30,698	6%
Shërbimet Postare	713,047	852,000	138,953	16%
Shpenzime te IT	57,056	141,000	83,944	60%

Shpenzime Ligjore	54,807	22,000	-32,807	-149%
Konsulentë dhe Auditim	57,927	122,000	64,073	-%
Te tjera	1,213,882	1,300,000	86,118	7%
Dëmtime dhe Provigjone	2,651,553	2,466,000	-185,553	-8%
EBITDA	5,851,492	-3,647,000	-9,498,492	260%
Zhvlërësimi dhe amortizimi	2,528,909	3,207,000	678,091	21%
Fitim / Humbje Operative (EBIT)	3,322,583	-6,854,000	-10,176,583	148%
Shpenzime Financiare - neto	-16,515	-622,000	-605,485	97%
Te ardhura financiare	1,057,340	467,000	-590,340	-126%
Shpenzime financiare	1,073,855	1,089,000	15,145	1%
Te ardhura te jashtë zakonshme	109,899	0	-109,899	
Fitim / Humbja përpara Taksave	3,415,967	-7,476,000	-10,891,967	146%
Tatim Fitimi	1,575,808	0	-1,575,808	
Fitim / Humbja e Periudhës	1,840,159	-7,476,000	-9,316,159	125%

Kur krahasojmë situatën nga 2017-2019 vëmë re se:

- Të ardhurat nga energjia janë rritur por të ardhurat e shoqërisë kanë rënë me 5% si pasojë e rënies së të ardhurave të jashtëzakonshme të cilat nuk aplikohen në çdo kohë (në vitin 2017 këto të ardhura janë si pasojë e faturës së kompensimit të aplikuar ndaj KESH).
- Shpenzimet për energjinë janë rritur me 11% (si rezultat dhe i situatës hidrike jo të favorshme dhe nevojës së blerjes në import) kurse shpenzimet operative me 20%.
- Janë rritur shpenzimet për konsulencë si pasojë e konsulencës së nevojshme për ndarjen e shoqërisë në zbatim të ligjit nr 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”
- Janë rritur shpenzimet financiare neto

Pasqyra e pozicionit financiar 2017-2020

OSHEE BILANCI (000/Leke)	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2020
KAPITALI	-33,212,472	-31,489,712	-38,965,953	-35,303,509
Kapitali aksionar	30,083,349	29,936,709	29,936,709	29,936,709
Rezerva rivlerësim asetesh	1,250,030	1,135,996	1,135,996	1,135,996
Rezerva të tjera	2,916,011	2,916,011	2,916,011	2,916,011
Humbje të akumuluar	-69,292,022	-67,425,803	-65,478,428	-72,954,668
Të ardhura neto vjetore	1,830,160	1,947,375	-7,476,241	3,662,443
DETYRIMET	109,873,080	110,067,081	119,816,319	118,709,027
Detyrimet Afatgjata	10,540,409	10,548,996	10,734,523	11,998,093
Huatë afatgjata neto	10,540,409	10,548,996	10,734,523	11,998,093
Hua Të tjera	-	-		
Detyrimet Afatshkurtra	99,332,671	99,518,085	109,081,796	106,710,934
Llogaritë e Pagueshme Tregtare	72,197,636	70,636,922	82,549,242	80,178,380
Detyrime taksa dhe sig. shoqërore	2,672,876	2,671,890	3,061,131	3,061,131
Tatimi mbi të ardhurat	5,610,932	5,071,144	2,471,144	2,471,144
Pjesa afatshkurtër e huave afatgjata	7,205,076	5,680,847	5,783,654	5,783,654
Provizione	2,984,656	5,838,383	7,078,698	7,078,698
Huatë afatshkurtra	1,000,000	3,532,542	6,186,976	6,186,976
Detyrime të tjera afatshkurtra	7,661,495	6,086,357	1,950,951	1,950,951

Total Kapitali dhe Detyrimet	76,660,608	78,577,369	80,850,366	83,405,518
------------------------------	------------	------------	------------	------------

Humbjet e akumuluar përbëjnë më shumë se gjysmën e kapitalit dhe nëse arrijnë në nivelin që humbjet janë 60% e kapitalit për 3 vjet rresht atëherë shoqëria nis procedurat për falimentin. Menaxhimi i situatës ekonomike financiare reflektohet në shpenzimet e rritura dhe në kapitalin aktual të shoqërisë.

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Totali Kapitalit	-31,525,771	-39,002,012	-35,339,569
Kapitali	35,936,091	26,512,475	37,651,159
Humbje akumuluar	-67,461,862	-65,514,487	-72,990,728
% Humbjes/kapitalin	-53%	-40%	-52%

Ka një rritje të detyrimeve afatshkurtra kryesisht e ndikuar nga rritja e llogarive të pagueshme tregtare në vitin 2019 në krahasim me vitin 2017, efekti zinxhir i cili vjen dhe nga rritja e llogarive të arkëtueshme.

Janë rritur gjithashtu provizionet çka shpjegon vështirësinë e shoqërisë për të arkëtuar nga llogaritë e arkëtueshme

Janë rritur edhe huatë afatshkurtra si overdraftet të cilat shpjegojnë nevojën e vazhdueshme për likuiditet të shoqërisë

Detyrimi afat gjatë ndaj CEZ as, OSHEE gjatë 2018 me pagesën e fundit prej 22 Milion Euro ka shlyer totalisht sipas afateve detyrimin ndaj CEZ i cili në vitin 2014 rezultonte 85 Milion EURO. Detyrimet e tjera janë zvogëluar për 18.4% ose Rreth 2.4 miliard Lekë dhe lidhen kryesisht me investimet në proces.

Detyrimet për blerje energjie;

Detyrimet ndaj HEC-ve private janë ulur me 27% ose 0.55 miliard Lekë.

Detyrimet ndaj shoqërive të importit të energjisë janë zvogëluar për 28.4% ose 3.3 miliard Lekë.

Për furnitorët me detyrime më të mëdha (KESH, Posta Shqiptare, OST)

Tabela me poshtë tregon në mënyrë të detajuar krahasimin e detyrimeve në fund të vitit 2018 në krahasim me ato në fund të vitit 2017:

000/Lekë

Nr	Përshkrimi i detyrimit	Detyrimet më 31.12.2017	Detyrimet më 31.12.2018	%
1	Shuma e Detyrimit ndaj KESH SHA	57,298,391	60,943,589	6%
2	Shuma e Detyrimit ndaj OST SHA	9,130,232	10,652,971	16%
3	Furnitorë për energji HEC	2,022,814	1,470,895	-28%
4	Furnitorë për import energjie	11,715,803	8,383,541	-29%
5	Detyrim ndaj CEZ AS (Marrevëshja)	2,737,129	(0)	0
6	Kredi Banka Botërore (Hua Afatgjatë IBRD Pr. RE)	2,910,662	4,591,034	57%
7	Hua Ministria e Financave	2,500,000	2,500,000	-
8	Overdraft nga Bankat	-	2,532,542	100%
9	Shuma e Detyrimit ndaj Posta Shqiptare SHA	168,376	169,323	0.5%
10	Detyrime tjera	12,860,482	10,499,578	-18%
11	Detyrime ndaj Tatimeve	8,529,192	8,323,607	-3%
TOTALI		109,873,080	110,067,080	0.01%

Detyrimet sipas gjendjes së bilancit në fund të vitit 2018 kanë pësuar një rritje prej vetëm 0.18% në krahasim me gjendjen e tyre në fund të vitit 2017 ose me rreth 0.2 miliard Lekë.

Në marrëveshje me KESH dhe me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë OSHEE ka paguar të gjitha detyrimet ndaj KESH SHA sipas planit të rimëkëmbjes të sektorit energjetik.

Pagesat ndaj OST pavarësisht vështirësive financiare u shlyen 100%. Ndërsa rritja prej 16.7% në detyrimet ndaj OST lidhet me llogaritje të disbalancave të viteve të mëparshme për të cila OSHEE nuk ka rënë dakord dhe të cilat janë duke u shqyrtuar në një proces gjyqësor.

Detyrimet ndaj HEC-ve private janë ulur me 27% ose 0.55 miliard Lekë.

Detyrimet ndaj shoqërive të importit të energjisë janë zvogëluar për 28.4% ose 3.3 miliard Lekë.

OSHEE gjatë 2018 me pagesën e fundit prej 22 Milion Euro ka shlyer totalisht sipas afateve detyrimin ndaj CEZ i cili në vitin 2014 rezultonte 85 Milion EURO.

Kredia e disbursuar nga Banka Botërore në fund të vitit 2018 ishte rreth 4.6 miliard Lekë dhe shlyerja do të fillojë vetëm në vitin 2021.

Detyrimet e tjera janë zvogëluar për 18.4% ose Rreth 2.4 miliard Lekë dhe lidhen kryesisht me investimet në proces. Nuk jepen sqarime për investimet që kanë nisur dhe janë në proces dhe sa është realizuar nga secili investim. Sipas programit ekonomik për vitin 2017 parashikon investime me fonde të OSHEE në shumën 12,273,413,311 dhe investime me fonde të Bankës Botërore në shumën 3,467,648,000 lekë. Sipas programit ekonomik për vitin 2018 parashikon investime me fonde të OSHEE në shumën 8,757,419,000 lekë dhe investime me fonde të Bankës Botërore në shumën 2,017,995,590 lekë. Sipas programit ekonomik për vitin 2019 parashikon investime me fonde të OSHEE në shumën 9,984,927,428 lekë dhe investime me fonde të Bankës Botërore në shumën 1,490,606,000 lekë. Sipas programit ekonomik për vitin 2020 parashikon investime me fonde të OSHEE në shumën 8,935,241,000 lekë dhe investime me fonde të Bankës Botërore në shumën 1,597,045,000 lekë.

Janë të njëjtat investime të cilat janë në proces që nga viti 2017-2020 por nuk jepen detajime sa është përqindja e realizuar e secilit dhe cilat janë detyrimet e tjera ndaj këtyre investimeve.

GRUPI I AUDITIMIT

1. G. P., Përgjegjësi i Grupit të Auditimit
2. B. Sh., Auditues
3. S. H., Auditues
4. J. Zh., Audituese
5. I. B., Audituese

DREJTORI I DEPARTAMENTIT
K. XH.